

BIBLIOTEKA

854 - 31

IC 19



VIKTOR CANOSINAJ

# DASHURI NË IKJE

roman

8SH-31  
C 19

Viktor Canosinaj

# Dashuri në ikje

*Roman*



*Redaktor:*  
Sokol JAKOVA

*Arti grafik:*  
Arben Çela

© Autori  
Tel.: 04 342069  
Cel. 069 22 78479  
E-mail: vikcan2001@yahoo.co.uk

ISBN: 987-99943-975-1-8

*Tirazhi:*  
500 kopje

Tiranë, 2007

# 1.

Të gjithë vraponin drejt detit. Ishte një ikje e çmendur, e shoqëruar me të rrëzuar, me thirrje, ulërima, lotë, mallkime, me të mbytur që kishin mbetur mbi ujë dhe askush nuk mund t'i nxirrte prej tij. Në kuvertën e anijes ikësit sa vinin e ngjesheshin më shumë pas njëri-tjetrit. Qëndronin në këmbë, si në një përshpirtje masive; të hutuar, të trembur, duke mërmëritur lutje drejt Zotit.

Të tjerë hipnin në anije pandërprer, si të ndërkryer, të tmerruar nga idea se anija mund të nisej dhe t'i linte në tokë, larg asaj bote iluzore që e kishin ëndërruar pafundësisht. Frika se mos anija e huaj nuk nxinte më njerëz të tjerë, lexohej në sytë e të gjithëve. Ishin sy anormalë, të lebetitur, si sytë e atyre kafshëve të dobëta në çastet e flijimit para një egërsire që i ka vënë nën kthetra.

Vildani u afrua buzë kuvertës duke çarë me bërryla. Pamja e portit e bëri të mbeste pa fryshtë për ca çaste. Një grup djemsh që po ngjiteshin në anije nëpër një litar të trashë, u rrëzuan befas. Disa prej tyre ranë në det. U dëgjuan klithma. Me qindra njerëz ishin grumbulluar mbi kalatën e betontë. Po binte nata. Afrimi i errësirës e shtoi ngutjen dhe panikun dhe më shumë. Kohë pas kohe breshëri automatikësh zbrashteshin në ajër, pa shkaktuar asnjë reagim mes asaj përcartjeje. Vildani mori nga kici i gjerë i anijes ku hipnin shumë të ardhur rishtazi. Nuk donte të mbeste i vetëm në atë ikje lemeritëse. Kishte rreth dy orë në atë vapor panamez

dhe asnjë shok apo i njojur nuk i kishte dalë para. Vrulli i njerëzve që hipnin e pengoi të çante më tej. Filloi të shtynte brinjazi deri sa mbërriti te bordura e gjerë prej hekuri. U mbajt fort për t'i shpëtuar rënies në det.

Pamja poshtë tij e ngjethi. Në një anije të vogël, ngjitur me vaporin panamez, njerëzit kishin filluar të shkelnin mbi supet dhe kokat e njëri-tjetrit për të arritur të hipnin lart në kuvertën shpëtimtare. Ishte e pamundur të njihje njeri mes asaj katrahure.

Befas, një vajzë e re e solli në vete. Ajo nuk e kishte thirrur me emër, por vetëm me fjalët anormale: "Ej, ju me pardesy". Vildani ia nguli sytë pa qenë i sigurtë në se fjalët i qenë drejtuar atij.

- E kam me ju, - thirri vajza. - Ju lutem më ndihmoni!

Ai e vështroi për pak çaste. Kurrë në jetën e tij nuk qe ndodhur përpara një fytyre të atillë të trembur, me një pamje lutjetje cep më cep, me dy sy të zmadhuar që të vështronin si nga një botë tjetër. Vajza ishte larg vendit të kthyer në urë për t'u ngjitur në vapor. Djemtë që shtyheshin si dema nuk e linin të afrohej. Një e shtyrë, sado e vogël, mund ta flakte atë në det.

- Ju lutem! - thirri vajza përsëri. Në sytë e saj u formuan dy lotë, të mëdhenj, të shndritshëm, që u shkëputën nga qerpikët dhe iu varën faqeve. Dora e saj e djathtë u zgjat drejt tij me një shpresë pothuaj të humbur.

- Më kuptoni, dreqi ta hajë! - ia ktheu ai. - Nuk mundem.

Por dora e vajzës nuk u ul. **Vildani vuri re se një valë e madhe të ardhirish rishtazi, si duket me ndonjë tren, po mësynin drejt portit. Ai as vetë nuk e kuptoi se si u lëshua poshtë, mes njerëzve që tentonin të hipnin. I çmendur, i foli dikush, pse zbret. Ai ndjeu disa këmbë që e shkelën në shpatulla. U afrua te vajza dhe e tërhoqi për dore. Ajo u bind si fëmijë. E mori para vetes dhe të dy filluan të çanin**

për të hipur në kuvertë. Nuk flisnin. Vildani ndjente duart e vajzës që e kishin mbërthyer për rrobash dhe dridhjen e përgjithshme të saj, të shkaktuar nga tmerri i rënies në det.

Të shtyrat dhe goditjet e ikësve u shtuan. Nuk mund të kërkoje dot arsy, ndihmë, bile as mëshirë. Ishte një luftë e egër. Më të fortët do të iknin, më të dobit do të mbesnin në tokë, bashkë me hallet e tyre dhe pasigurinë që do të sillte e nesërmja.

- Tani vër këmbët në supet e mijë dhe hip, - i foli ai vajzës, duke e mbërthyer për beli e duke e ngritur. Ajo u bind. Ishte delikate, e pamësuar me ato lloj aventurash. Për fat, të shtyrat nga poshtë e morën me vete dhe ajo arriti të kapet në bordin e vaporit. Atje, një grup djemsh që me sa dukej po prisnin shokë të tjerë, e tërhoqën për krahësh dhe e shtynë mes njerëzve. Vildani e ndoqi pas. Vajza po tundte duart dhe po e kërkonte me sy. Ai iu afrua. Ajo u ngjesh pas tij dhe filloi të qante me ca ngashërima të thella. Ishte plotësisht e shokuar.

- Qaj se të bën mirë, - i foli ai. - Është më se normale të qash sot.

Të shtyrat i ngjeshën ata mes një kabine hekuri dhe bazamentit të një elektrovinçë. Dukej një vend disi i mbrojtur. Aty ishim mbledhur disa grupe familjarësh. Kishin disa fëmijë të vegjël. Vildani i vuri supet kabinës së hekurt. Vajza e panjohur vazhdonte të strukej pas tij.

- Faleminderit! - tha ajo papritur.

Ai e vështroi jo pa habi.

**Vajza buzëqeshi me buzë të dridhura.**

- Pse e bëre? - pyeti.

- Më duket se ti mu lute. Apo jo?

- Ti po prisje të dashurën?

- Unë nuk kam të dashur.

Vajza mori frymë si e lehtësuar.

- Po ti, pse ke marrë arratinë pa të dashurin?

- As unë nuk kam të dashur, - ja ktheu ajo. - A e di pse të kërkova ndihmë pikërisht ty?

Vildani mblodhi supet.

- Sepse më krijoive bindjen që do të më ndihmoje.

- Mund ta kishin bërë dhe të tjerë.

Ajo ngriti sytë dhe e vështroi për hëré të parë nga afër. Edhe ai e ndali vështrimin në sytë e saj. Provtoi një trembje të lehtë. Vajza e panjohur kishte tipare të ëmbla, flokë të gjatë, të errët, të ndarë në mes, ndarje që të kujtonte krehjen primitive të një indianeje filmash. Por ishin veçanërisht sytë e saj që të shkaktonin një tërheqje të parezistueshme.

- Jam Alba Tomorri, - tha ajo. - Vendosa ta lë Fakultetin Ekonomik në vit të fundit. Kisha kohë që e mendoja ikjen. Prindërit e dinin. Nuk më penguan. U nisa me një grup shoqesh dhe shokësh të fakultetit, por i humba ata në rrëmujën e portit. Po ti, kush je?

Ai nënqeshi.

- Një ikës. Kaq. Në këtë vapor nuk kanë rëndësi detajet e tjera.

Ne jemi të gjithë ikës. Të barabartë. Kërkojmë Tokën e Premtuar, në një botë ndryshe, siç thotë një këngë e Eros Ramazotit. Jemi si në një anije që shkon drejt një ishulli lumturie. Jo një ishull imagjinar, sigurisht.

- Ti shkruan letërsi? - e ndërpren ajo.

Ai i ktheu sytë mënjanë.

- Nuk ka rëndësi, - tha.

- Më fal, mbapse të shkakton siklet intimiteti i papritur.

- Mos harro se jemi gati të përqafuar. Anuk është intimitet ky?

Alba mbështeti ballin në gjoksin e tij.

- Unë nuk njoh njeri tjetër. Nëse ti do... mund të largohem...

- Jo. Qëndro. Edhe unë të njoh vetëm ty. Në këtë ikje e dija se do ta gjeja një bashkudhëtar. Quhem Vildan Bregu.

Shkurt me thërrasin Vili. Jam 28 vjeç. Një ish-mësues province. U mësoja rinisë së fshatit letërsinë e Realizmit Socialist.

Befas, nga kalata u dëgjuan të shtëna të dendura. U hapën fjalë se kishin ardhur trupa speciale dhe do të bastisnin vaporin panamez. Njerëzit e mbetur në tokë filluan t'i lagonin. Motorrët e vaporit u ndezën. Për ndonjë gjysmë ore kapiteni i panjohur provoi ta largonte atë nga kalata, por më kot.

- Kemi ngecur në rërë, - tha Vili me keqardhje. - Zor se mund të dalim me gjithë këtë ngarkesë.

- Rëndësi ka që mos të na dëbojnë me dhunë, - ia ktheu Alba.

Brenda pak minutave mes ikësve u përhap një dëshpërim i përgjithshëm. Ankthin e shtonte nata e ftohtë, të shtënat, ulërimat, të qarat, sirenat e makinave të policisë.

Pak para mesnatës u dëgjuan befas thirrje gjëzimi. Gojë më gojë u përhap lajmi se po tentohej për ta nxjerë vaporin nga rëra duke e tërhequr me anë të një lokomotive. Iku, iku, filluan të thërrisin si të çmendur një grup djemsh. Fëmijët ndërprenë të qarët. Ikësit filluan të përqafoheshin. Kishte të krisur në kalatë që çanin mes ushtarëve e policëve të armatosur dhe hidheshin në det. I ndihmonin të ngjiteshin në vapor me anë të litarëve.

Po dalëngadalë, ngazëllimi i shkaktuar nga lokomotiva ra. Kur motorrët e vaporit u fikën, u kuptua se tentativa kishte dështuar. Ikësit filluan të strukeshin për të marrë një sy gjumë. Ishte një natë e ftohtë marsi, por me një qiell të kthjellët, të mbushur me yje.

\* \* \*

Alba pshëretiu thellë. Vili ndjeu gjoksin e saj të fortë që u ngjesh pas kraharorit të tij.

- Përpiku të flesh, - i foli.
- Nuk mundem, - ia ktheu ajo.
- Kam me vete pak bukë dhe një shishe me ujë të sheqerosur.
- Tani nuk dua asgjë, faleminderit. Pra, ti qenke përgatitur për ikje?
  - Po. Një vendim i vjetër.
  - Pse nuk provove ambasadat?
  - Nuk pata guxim. Nuk jam trim.
  - Më tre go diçka për veten.
  - Ndoshta është akoma shpejt.
  - Jo, mua më duket se kemi kohë që njihemi.  
Ai vuri duart në supet e saj.
- Pas mbarimit të fakultetit kam kaluar pesë vjet në Veri. Isha një idealist i vonuar. Shkruaja prozë, novela dhe romane, ku njërit e mirë fitonin mbi të keqen dhe sistemi i dështur ku jetonim kishte shanse për t'u përmirësuar. Pastaj, vrulltazi, erdhi një ditë që u zhgënjeva, u neverita nga ai raelitet kriminal ku fshatari hante bukë misri të mykur me lëng turshish, ku nxënësit e mi vinin në shkollë pa ngrënë dhe unë përpinqesha t'u mësoja poema të neveritshme kushtuar komunizmit. Dogja gjithçka kisha shkruar dhe ika. U ktheva në shtëpi dhe po bëj muaj të tërë pa punë.
  - Nuk shkruan më?
  - Jo. Vetëm një idiot mund të shkruaj sot. Kam kohë që i trembem një gjendjeje depresioni. Nganjëherë më duket se do të sëmurem.
  - Ne të gjithë jemi me depresion, - ia ktheu ajo. – Mos u shqetëso për këtë. Një gjë e tillë më ka ndodhur edhe mua.
  - Ma thua për të më ngushëlluar?
  - Jo. Po tregohem më e sinqertë se ç'duhet.

Instiktivisht ata u ngjeshën dhe më pranë njëri-tjetrit. Vili ndjeu erën e këndshme të flokëve të saj. Ajo pshëretiu

rishtazi. Dy djem të rinj aty pranë ndezën nga një cigare. Në qoftë se ajo gabon dhe më tradhëton kur të jem andej nga Italia, do ta vras, tha njëri prej tyre. Është e bukur. Ia kam frikën. Mos mendo budallallëqe, ia ktheu tjetri. Nuk tradhëtojnë vetëm ato që janë të bukura.

- Ndonjë... vajzë, andej nga Veriu? - pyeti Alba papritur.

- Sigurisht, - iu përgjigj ai. - Ndenjëm dy vjet bashkë. E kisha kolege. Ishte një tip që s'e kuptova dot. Një ditë të bukur u fejua në Tiranë dhe iku. Më fal, më tha një ditë në telefon. Këtë zgjidhje ma imponoijeta. U binda se nuk më kishte dashur kurrë.

- Po ti?

- E doja sipas mënyrës time. Isha dhe duhet të jem akoma naiv. U besoj njerëzve më shumë se ç'duhet. Sidomos femrave.

- T'u duk vetja i tradhëtuar?

Ai bëri një gjest të lehtë nervozizmi.

- Të lutem mos e përdor këtë fjalë bajate! Ne shqiptarët çdo gjë e lidhim me besnikëri dhe tradhëti. Ajo thjesht iku. Unë s'u ndjeva i tradhëtuar, por i braktisur,

i vetmuar. Vetminë e kam urryer gjithmonë. E kuption?

Alba pohoi me kokë.

- Ishte e bukur ajo?

- Për fatim tim të keq... Gabimi im ishte se i dhashë më tepër dashuri se ç'meritonte. Ndërsa në këtë kohë të egër që po vjen duhet të jesh i ftohtë dhe cinik. Epoka e ndjenjave po vdes.

- Je i sigurtë?

- Po, e ndjej. Është një vdekje e përgjithshme.

Alba ngriti sytë.

- Po atëherë pse rrezikove dhe zbrite për të më ndihmuar? Unë isha e panjohur për ty. Pse nuk u tregove cinik, i ftohtë?

Vilit iu duk vetja tërësisht i çarmatosur.

Alba zgjati krahët dhe ata të dy u përqafuan fort, gjatë.

- Po ikim, - tha Vili i mallëngjyer. - Gjithçka i ngjan një legjende biblike. Çudi! Edhe ky vapor panamez quhet "Legjendë". Dëgjoji njerëzit si klithin. Është një kor legjendar, kori i robërve që ikin drejt lirisë, pa pyetur se mund të vritten, se mund të mbyten. Jemi të mjerë, Zot i madh, sa të mjerë! Tani më dhimbën të gjithë, më dhimbset vetja. Jemi një masë mjeranësh. Pse vallë duhej të na katandisnin kështu?

Pa e kuptuar, ai kishte filluar të qante. Ajo nuk diti si ta ngushëllonte. Ata u kthyen të dy nga kuverta e gjatë e vaporit për të parë më mirë se si ikësit festonin nisjen e tyre. Kur anija doli nga porti, një grup djemsh filluan të thërrisin në kor: Italia, Italia.

- Ty të pëlqen Italia? - pyeti Alba.

- Po, shumë, - u përgjigj ai. - Ndoshta ngaqë kam lexuar shumë letërsi italiane. Po ty?

- Në këtë vapor të gjithë janë të magjepsur nga Italia. Edhe unë. Ajo është stacioni i parë i parajsës. Në ditët e mërzisë së madhe, kur gjithçka dukej se nuk kishte më kuptim, kur fikeshin dritat dhe bënte ftohtë, kishte raste që së bashku me Gertën, një shoqen time të ngushtë, kalonim në lajthitet për t'i shpëtuar realitetit.

- Ç'lajthitet?

- Bridhnik nëpër botë me imagjinatë. Në Itali, Francë, Amerikë. Hipnim nëpër avionë fantazma, anije, trenat të shpejtësisë së lartë. Kur na mërzitez Roma, ia këpusnim për Paris. Kur në Paris fillonte shiu, ia mbathnim në ndonjë plazh të bukur tropikal. Por, kur vinin dritat, vështroheshim të trembura. Na dukej se ndonjë mbrëmje do të çmendeshim.

- Po sikur Muri i Berlinit të mos ishte shembur, mbase shumë prej nesh do të ishin çmendur, - tha Vili. - E kam praktikuar edhe unë arratisjen tënde imagjinare.

- Po ti, nga shkoje zakonisht?

- Më pëlqen Kanadaja ose... hëm... Zelanda e Re.
- Pse kaq larg?

- Ndoshta ngaqë këta vende ishin të paarritshëm edhe në imagjinatë. Në Veri kam punuar në një zonë pranë kufirit. Kloni elektrik dhe patrullat e kufitarëve dukeshin me sy. Kur shëtisja në këmbë, ndalesha shpesh dhe e vështroja atë gardh me gjemba duke pyetur veten: pse duhet të jetoj brenda këtij gardhi? Kush ua jep të drejtën disave të na rrethojnë si bagëti? E lodhja kokën gjatë, pastaj...

Ata heshtën një copë herë, duke parë se si brigjet e Durrësit po mbeteshin pas.

- Ç'bëhet tani Gerta, ajo shoqja jote? – pyeti Vili për të ndërruar temë.

- Ajo është me origjinë hebreje. Iku para disa muajsh në SHBA.
- Po pse fantazoje pikërisht me të?

Alba uli kokën. Ishte përgatitur për atë pyetje, megjithëse instiki femëror e pengoi të ishte e lirshme. Ç'do të mendonte njeriu pranë saj kur të merrte vesh se...

- Ishte koha më e zyrtë për mua, - tha. – Isha ... e braktisur, po të përdor shprehjen tënde.

- Pse të braktisen?

- Ai ishte student në Francë. Kur nisën përbysjet e mëdha, vendosi të mos kthehej më në Shqipëri.

- Sigurisht që të telefonoi.

- Po. Më tha më fal. Dua ta nis gjithçka nga e para. Zëre se nuk ishim njohur, iu përgjigja. Bëj ç'të duash. Nuk arrita ta kuptoj dot. Mbështetje ai donte të harronte gjithçka kishte lënë pas.

- Ai nuk të donte, - foli Vili ftoht. – Kaq.

Ajo pshëretiu.

- Ndoshta, - tha. – Duhet të jetë shumë e vështirë për ta kuptuar se sa e do një njeri. Mbështetje ai donte të do tjetri ty.

Vili i vuri dorën nën mjekër.

- Ti do ta lije, po të kishe qenë në Francë? – pyeti befas.  
Ajo nuk e shmangu vështrimin.

- Ndoshta, - tha. - Nuk jam e sigurtë. Nuk mund ta imajinoj se ç'mund të ndodhë me njeriun kur ai është larg, në Francë, në një botë tjeter.

Ai e përkëdheli lehtazi në faqe.

- Falemnderit për sinqeritetin! – tha.

Nga pasditja moti u vrenjt. Deti sa vinte e dallgëzohej. Kur vapori hyri në Kanalin e Otrantos, ata që nuk ishin mësuar me lundrime dhe që përbënин shumicën e kuvertës, morën një pamje të trembur. Anija filloj të lëkundej keqazi. Ishin lëkundje që brënda pak minutave i dërrmuani përfundimisht ikësit e lodhur. Dallgët që e godisnin vaporin në brinjë, shpesh binin mbi kuvertë. Ishin vrunduj uji të kripur që binin mbi kokat dhe supet e njerëzve tërësisht të pambrojtur. Gratë dhe fëmijët filluan të thërrisin të tmerruar. Ngado shpërthyen të vjellat, rënkitet. Ikësit u lidhën me njëri-tjetrin për të mos u rrëzuar.

Vili ndërroi vend më Albën për ta mbrojtur atë nga goditjet e dallgëve. Ajo pothuaj qe mbërthyer me thonj pas tij. Ishte e këputur, dridhej nga të ftohtët, e kishte zënë deti dhe e kishte mbuluar një pamje e zbëhtë. Ai detyrohej ta mbante për mezi që ajo të arrinte të qëndronte në këmbë.

Një dallgë tepër e fuqishme u ngrit mbi kuvertë dhe Vili ndjeu goditjen e ujit në shpinë. U lag i téri. Pas dy goditjeve të tjera e humbi fare konceptin e të lagurit dhe të të ftohit. Kullonte i téri ujë. Befas, Alba ia plasi një të vjelle të pandërpërë. Ai gati po e mbante në krahë.

- Më fal, - mërmëriti ajo. Pastaj u lidh me duar pas belit të tij.

\* \* \*

U duk se kaluan ditë të tëra nën goditjet e dallgëve, lëkundjeve, të ftohit dhe urisë.

Kur ra nata, u duk sikur vapori u ndal. Por disa këmbëngulën se ai po lëvizte në drejtim të Greqisë. Ky kapiten i poshtër duhet varur, thirri dikush, ndoshta i dehur. Më duket se po na çon në Kinë. Deti kishte rënë disi dhe dallgët nuk arrinin dot deri në kuvertë. Po mbërrijmë, tha dikush, por askush s'e besoi. Idea e mbërritjes ishte ende tepër e largët. Vili filloj të kollitej mbytur. E ndjeu kraharorin të rënduar.

- Ti ke temperaturë, - tha Alba e trembur.

Orët e pritjes u dukën edhe më të tmerrshme se pjesa e lundrimit nën dallgë. Idea se nuk po ecrin më ose po shkonin në drejtim të paditur, ishte shumë më çarmatosëse se të gjitha vështirësitet e një deti dimëror. Fëmijët qanin pandërprer. E qara e tyre e bënte pritjen dyfish më torturuese.

Të cilitur nga të ftohtit dhe tensioni i pritjes, ikësit filluan të thërrisin me dëshpërim. Një grup djemsh kërkoi të pushtonte urën e komandimit dhe ta detyronte kapiterin të hynte në Brindizi. Por grupe të tjera nuk i lejuan. U hap lajmi se kapiteni po bisedonte me autoritetet e portit të Brindizit.

Vili nuk po kuptonte më ç'po ndodhë. Vetëm dridhej e kollitej. Kokën e ndjeu të rënduar. Papritur, kuverta ushtoi nga thirrje të mbytura. Ikësit nuk kishin më fuqi të gëzoheshin. Na pranuan, dëgjoi ai si nga larg zërin e vajzës që e mbante ngjitur pas trupit të saj. Vaporë po lëviz. Shikojti ato dritat. Janë dritat e Brindizit.

- Ato nuk janë drita, - ia ktheu ai. – Janë vegime dielli tropikal. Ja, shikoji si shkëlqejnë rrezet e diellit mbi gjethet e lagura të palmave.

Ajo filloj të qante e trembur. Ai kishte temperaturë të lartë. E kishte mbërthyer kllapia. Edhe kur hynë në port, nuk po mësohej me idenë se kishin mbërritur dhe duhej të zbrisnin. Alba u rrëzua disa herë së bashku me të, ndërkohë që njerëzit filluan të dyndeshin nga ana e kalatës.

Zbarkimi në Tokën e Premtuar filloi t'i ngjante detaj më detaj ngjitjes masive në vapor. Ikësit shtyheshin, goditeshin, rrëzoheshin, thërrisin, kërkonin ndihmë. Shkallët e anijes ishin shumë të ngushta për atë lumë njerëzish. Burrat dhe djemtë filluan të hidheshin në kalatën e betontë nga i tërë bordi i gjatë i anijes. Ishte një lartësi që në disa vende arrinte gati dhjetë metra. Megjithatë, ata kërcenin pa pyetur se mund të thyenin këmbët, duart apo kokën. Hidheshin me ngut, pa parë mirë se ku do të binin, sepse nga pas vinin të tjerë.

Alba e pa veten mes rrjedhës së ikësve. Një dorë të Vilit e kishte hedhur mbi sup dhe me tërë fuqitë që i kishin mbetur po përpinqej ta mbante atë në këmbë. Shtytjet nga pas nuk e linin të ndalej. Nuk e kuptoi sa kohë kaloi deri sa iu afrua shkallëve. Aty shtytjet ishin të papërballueshme. Ajo nuk mundi t'i shpjegonte Vilit asgjë. Ai vetëm dridhej dhe fliste përqart.

Filloi të shtynte duke qarë. Godiste me kokë, me krahë, me këmbë. E mbërtheu pardesynë e Vilit me dhëmbë nga frika se mos ai i shkëputej dhe humbiste mes turmës. Dalëngadalë iu afrua shkallëve. As vetë nuk e kuptoi se nga i erdhë një fuqi e verbër. Filloi të hapte një shteg me trup deri sa mbërriti në shkallën e parë. Pastaj filloi të tërhiqte bashkikësin e saj me duar e me dhëmbë. Shtytjet e njerëzve e ndihmuani. Ajo bëri pak hapa, pastaj u rrokullis nëpër shkallë, duke e marrë me vete edhe Vilin. Të tjerë u rrëzuan pas saj, duke lëshuar klithma e duke u mbajtur nëpër litarët anësorë të shkallëve për të mos rënë në det.

Alba ndjeu një bërryl që iu përplas në beton, pastaj pjesën anësore të kokës që kërciti thatë. Duke rënkuar nga dhimbjet, u ngrit dhe ktheu sytë pas. Pa Vilin që kishte mbetur në shkallinën e fundit. Njerëzit gati po e shkelnin. Ajo u fut mes këmbëve të tyre dhe e tërhoqi gati zvarë për disa metra.

Për pak çaste, Vili erdhi në vete dhe provoi të ngrihej. Ka shumë drita, mërmëriste, bën shumë ngrohtë. Është një plazh tipik tropikal.

Alba arriti ta shpinte deri te një grumbull arkash të mëdha ku kishin zënë vend grupe familjarësh. E pështeti në njérën prej arkave pa ditur ç'të bënte më. U ul pranë tij plotësisht e hutuar. Nuk kishte parë deri atë ditë një njeri në atë gjendje. Ia mori Vilit kokën në prehër. Ai digjej dhe vazhdonte të fliste përqart.

- Përpiku ta mbledhësh me ndonjë plastmas, - foli një grua. – Nuk duhet ta rrahë era.

Ajo vështroi një herë përreth që të fiksonte vendin, pastaj vrapi drejt një magazine të madhe ku njerëzit po shtyhesin për të marrë copa plastmasi. Ishte një vazhdim i luftës së nisur që në ikje, një betejë që duhej shpënë deri në fund. Filloi të sulmonte si gjithë të tjerët deri sa dora i mbërtheu nëj copë të butë e të ndotur plastmasi. Por të njëjtën copë e kishte mbërthyer edhe një djalë. Ata filluan ta tërhiqnin secili nga vetja. Djali ishte më i fortë dhe Alba po lëkundej e tëra nga tërheqjet e tij.

- Jo, - klithi! – Nuk ta jap! Burracak!

Kur e pa ashtu të shfytuar, djali e lëshoi plastmasin pa folur. Alba u kthye me vrapi te arkat. E hapi plastmasin dhe e mblodhi Vilin me të si në një thes. Pastaj u ul pranë tij, duke ia vendosur supet dhe kokën mbi këmbët e veta. Mbajti vesh gjatë frymëmarrjen e tij të çrregullt, kollën e frikshme, përqartjet. Ndërkohë që tjetri s'ndjente gjë, i përkëdhelte flokët e lagur, faqet, buzët e thara. Në një çast, u përkul instiktivisht dhe e puthi. Idea se ndodhta kishte filluar ta donte atë njeri ende të panjohur, e trembi. Gjithçka i ngjan një legjende biblike, iu kujtuan fjalët e tij. Mbase edhe unë jam në përqartje e sipër, mendoi. Duhet të kem ethe.



### 3.

Në një cep të dritares së dhomës së spitalit dukej një pjesë e kaltër qelli dhe një degë e lulëzuar peme. Vili nuk e ndjeu hyrjen e infermieres dhe Albës. Pas pak ajo u detyrua të kollitej për ta përmendur. Infermierja u largua. Ai u kthyesh vulltazi dhe vajza që i qëndronte përballë e mrekulloi. Flokët e gjatë i binin mbi supe, të shndritshën, të bukur deri në dëshirë për t'i përkëdhelur. Kishte një fytyrë të bardhë, të mbushur, me buzë rozë, të fryra e të ëmbla që buzëqeshnin me një ngacmim nga më tunduesit në botë. Kishte veshur një palë xhinse të ngushta dhe një xhakavento lëkure.

Vili lëvizi vendit dhe fërkoi zytë.

- Alba, je ti? – tha.
- Po, - u përgjigj ajo. – Unë e tëra.
- Pse je bërë kaq e bukur?
- Kështu kam qenë.

Ajo la një çantë në fund të krevatit dhe iu afrua. Ai zgjati krahët. Ndenjën të përqafuar për minuta me radhë.

- Sa kohë kemi që njihemi? – pyeti Vili.

Ajo buzëqeshi.

- Që prej kohësh që nuk mbahen mend.
- Duhet të jemi takuar dikur, diku.
- Ndoshëtë Zelandën e Re. Para tre vjetësh.

Ajo e përkëdheli me dhimbësuri.

- Nuk mbaj mend asgjë, - tha ai. – Pra, ti më paske sjellë në spital?

- Deri te një ambulancë në port. Vetë ndenja me një grup familjarësh për dy ditë. Pastaj erdhi një çift i moshuar italianësh dhe më çuan në shtëpinë e tyre. Aty u bëra njeri. Hëngra, u lava, fjeta sa u fryva. Ata ishin dy njerëz të mrekullueshëm. Më bënë këtë veshje dhuratë. Më dhanë edhe këtë çantë me rroba e ushqime për ty. Kam dy ditë që të kërkoj nëpër spitale.

Edhe ai e përkëdheli në shenjë mirënjojjeje.

- Ti mendove se nuk do të kërkoja. Kështu? – pyeti ajo.

- Jo. Thjesht mendova se humbëm njëri-tjetrin.

- Të lutem, mos më gënje! E mendove apo jo?

Ai uli sytë.

- Po, - tha. – Por nuk doja ta besoja ndarjen. E ndjeja që ti do të vije. Nuk do të kishte kuptim po të mos vije. Do të ishte një ndarje e shëmtuar.

Toni i saj ndryshoi befas.

- Ç'do të thuash me këtë? – foli si me frikë. – Që... tani duhet të ndahemi?

Ai e kupto se gjatë atij eksodi makabër mes tyre kishte ndodhur vërtet diçka tepër serioze, e pashërueshme. Me sa dukej asnjëri nuk guxonte ta mendonte ndarjen.

- E përmenda ndarjen ashtu kot, - foli pa e vështruar. – Unë... jam vetëm. Nuk kam njeri tjetër.

- Sot edhe unë mbta vetëm, - tha Alba. – Takova një kushërirë. Ishte me të shoqin dhe djalin. Më luti të shkoja me të, por nuk pranova. Takova edhe shoqet e shokët e kursit. Ata u nisën në një kamp, në Napoli.

- Pra... qëndrove përmua?

Ajo pohoi me kokë si fajtore. Vili zgjati krahët dhe e përqafoi përsëri. Alba u pështet në kraharorin e tij si një ditë më parë në anije. Nuk e panë infermieren që kishte hyrë në dhomë. Ajo buzëqeshi miqësisht.

- Jeni të fejuar? – pyeti.

Ata ulën kokat të dy.

- As vetë nuk e dimë ç'jemi aktualisht, - u përgjigj Vili.  
- E çuditshme! – ia bëri infermierja. – Atëherë zoti Bregu, mjekët mendojnë se mund të dilni. Mund të merrni me vete një kurë antibiotikësh.

Ai vështroi nga Alba.

- Sonte nga mesnata nisen disa autobuzë, - tha ajo. – Andej nga Riviera Ligure. A shkojmë?

Ai u vesh pa e zgjatur me rrobat që i kishte sjellë Alba dhe kur doli jashtë në rrugë, vështroi i etur gjithçka që i kapte syri.

- Pra, jemi në një botë tjetër, - tha me mosbesim.

- Po, - iu përgjigj ajo. – Ditët e para unë isha si e dehur. U desh të hyja në atë shtëpi italiane për ta kuptuar se sa të varfër jemi dhe ç'kemi lënë pas. Atëherë i besova ato që Gerta, ajo shoqja ime hebreje, më shkruante në letrën e parë nga Amerika. Jeta ime filloi sot, më thoshte. Deri dje kam vegjetuar.

Ata u paraqitën në një shkollë për t'u rregjistruar në grupin e fundit të refugjatëve që do të niseshin atë natë, pastaj hëngrën diçka dhe dolën për të shëtitur nga bregu i detit.

Udhëtimi me autobuz qe i gjatë. Autostrada e pafund, monotone. Vili dhe Alba fjetën për disa orë pështetur në supët e njëri-tjetrit. Kur hynë në zonën e Rivierës Ligure, të gjithë u ngjeshën pas xhamave të dritareve. Po udhëtonin përgjatë një bregu shkëmbor, të mbushur me vila dhe qyteza të ndërtuara në shpat të malit. Larg, në breg, kohë pas kohe, dalloheshin porte të vegjël turistikë, të mbushur me jahte të bardhë e motoskafë.

Ajo zgjati dorën dhe kapi gishtat e dorës së tij.

- A do të më tregosh tanë ç'plane ke? – pyeti.

Vili nënqeshi si me keqardhje.

- Jeta më ka mësuar të mos bëj plane, - tha. – Por nëse gjithçka rrjedh normalisht, do të qëndrojë gjatë në këtë vend. Kam ca ide të çmendura. Dua të filloj universitetin nga e para, të shkruaj, të përkthej letërsi italiane. Më duhet të fshij nga truri bolshevizmin që kemi lënë pas.

Alba nxori nga çanta një shishe të vogël me ujë mineral. E hapi, piu e menduar, pastaj ia kaloi tjetrit. Vili vështroi profilin e saj.

- Si të duket? - pyeti.

- Ide e bukur, - tha ajo. - Do të doja edhe unë të bëja të njëjtën gjë. Fakulteti më dhimbset.

- Duhet të presim e të shohim ç'do të ndodhë.

Alba uli sytë.

- Do të doja që fillimin e kësaj rruge të gjatë që na pret, ta bënim bashkë. Më premton?

Edhe ai uli sytë.

- Unë nuk premtoj më , - tha.

- Edhe këtë, ta ka mësuarjeta?

- Po. Nuk dua të marrë poza bamirësi apo shpëtimtari.

Jam dakort të bashkudhëtojmë. Se ç'do të ndodhë rruqës...

Nga dreka, pasi kaloi Gjenovën dhe disa qytete të vegjël turistikë, autobuzi hyri në Savona. U ndal në një kamp të madh që i ngjante një reparti ushtarak. Vilit i kapën sytë në një tabelë të madhe fjalët "Kazermat Blinji". Në sheshin qëndror të kampit po prisnin një grup ushtarake shpëtimtarësh. Në bazë të listave, ata filluan shpërndarjen e refugjatëve nëpër kazerma.

Vili dëgjoi emrin e Albës, pastaj te tjin.

- Do të shihemi, - tha ajo duke shkuar pas një grupi grash e vajzash. Duke ndjekur pas një ushtarak, ai hyri në një kapanon.

- Zgjidh një krevat dhe një komodinë, - i foli italiani.

Vili iu afrua krevatit më të afërt, la çantën mbi komodinë,

u shtri, vuri duart nën kokë dhe duke mbyllur sytë mërmëriti i kënaqr: filloi.

\* \* \*

Ditët e marsit filluan të kalonin njëra pas tjetrës me regjimin monoton të një jete kampi drejtuar nga ushtarakët; ngrënje me orar, mësim gjuhe, vizita mjekësore, plotësim dokumentash. Vili dhe Alba vazhdonin të qëndronin bashkë. Autoritetet e kampit, pa llogaritur refugjatët e tjerë, i dinin për të fejuar.

Një mbrëmje të ngrohtë, ndërsa kishin dalë në shëtitoren në breg të detit dhe qenë ulur padashur në një bordurë të gjerë ku zakonisht mblidheshin të rintjtë e dashuruar, atyre iu duk vetja edhe më të huaj në atë vend. U mungonte lirshmëria dhe natyrshmëria e të rintjve italianë. Vështronin të hutuar se si djemtë dhe vajzat e bordurës përqafoheshin, putheshin shpenguar, i thërrisnin njëri-tjetrit me epitete përkëdhelës.

Papritur një çift qëndroi përballë tyre dhe u lidh; vajza i hodhi djalit krahët rrëth qafës, ndërsa ai ia kaloi duart rrëth belit. Ishte skena tipike e dashurisë në atë vënd. Ata të dy filluan të putheshin gjatë, pastaj duart e djalit u ulën te vithet e vajzës. Nuk donin të lëviznin më prej aty.

Alba filloi të queshte dhe u ngjesh pas Vilit. Ai ndjeu aromën ngacmuese të trupit të saj, të flokëve. Kishte kohë që nuk bënte dashuri. Iu duk vetja si fillestar, i ngathët. Alba po priste. Ai ndjente frymëmarrjen e saj të shpeshuar, rrahjen e zemrës mes gjoksit që qe puthitur në brinjë të tij.

- Ku jemi puthur për herë të fundit? - pyeti.

- Në Vankuver, Kanada, - tha ajo.

Ata qeshën, pastaj filluan të putheshin e përqafoheshin gjatë, duke harruar orarin e darkës, të paraqitjes në kamp, të apelit.

Në ditët që pasuan ardhja te bordura në breg të detit u bë e paevitueshme. Ata takoheshin te sheshi i kampit, dilnin dhe këmbët i sillnin aty. Fillonin putheshin ende pa u ulur. Kishin menduar tërë paraditen për ato puthje. Ndoshta edhe diçka më shumë. Por kur vinte çasti për atë diçka më shumë, të dy ndaleshin dhe vështroheshin si me frikë. Mendonin të njëjtën gjë; të mos binin rob të njëri-tjetrit. Të dy e nuhatnin se si në çdo dashuri, njëri do të ishte viktima dhe tjetri pushtuesi. Askush nuk donte ta ndërmerrte hapin e parë. Kur largoheshin prej aty, asnjeri nuk guxonë të pyeste se ç'po ndodhë, se ç'do të vinte të nesërmën.

Në njëren prej atyre mbrëmjeve, ndërsa po i afroheshin bordurës, Vilit i kapi veshi rastësish fjalët e një djali që po tymoste së bashku me një grup shokësh e shoqesh: shikoni, erди kjo shqiptarja e bukur. Nuk qe i sigurtë në se edhe Alba i dëgjoi ato fjalë. Provoi një lloj trembjeje instiktive nga fakti që atë e pëlqenin edhe italianët. Sigurisht është xhelozë, mendoi. Kam filluar ta dua, mbaroi kjo punë.

Për t'i shpëtuar monotonisë së kampit, ata filluan të bënин udhëtime të gjata me tren, larg Savonës. Autoritetet e kampit i kishin pajisur me një dokument për të udhëtuar falas. I luteshin kuzhinierit të kampit t'u jepte me vete drekën dhe niseshin të përqafuar ku t'u mbushej mendja, të lumtur, ndonëse kishin fare pak lireta në xhep dhe me to mund të blenin e shumta nga një akullore.

Një ditë Albës iu shkrep të shkonin në Piza.

- Dua të shoh atë kullën e shtrembër, - tha. - Ndoshta mund të rrëzohet pikërisht sot.

Ata morën trenin duke qeshur. Shitetën gjatë nëpër Piza dhe kur iu afroan kullës, Albës i shkëlqyen befas sytë si të një çapkëneje çamarroke.

- Kam një ide, - tha. - Të lutem mos ma prish!

Ajo i pëshpëriti në vesh diçka dhe ai tundi kokën jo pa

habi. Vështruan njëherë rrötull, mes turistëve të shumtë, pastaj kapërcyen sheshin që rrëthonë kullën dhe iu afroan asaj fare pranë. Alba u pështet në murin e gurtë dhe e tërroqi Vilin nga vetja.

- Me puth - tha. - Mbase nulla fillon lëviz.

Ai e puthi me ngut, ndërsa disa turistë filluan t'i fotografonin. Pastaj u dëgjua bilbili i një polici dhe ata u larguan me vrap. Por polici arriti t'u dilte përballë.

- Pse e bëtë? - pyeti.

- Thjesht për ta patur kujtim, - ia ktheu Alba.

- A e dini se ky kujtim mund t'ju kushtojë një gjobë të thartë?

- E dimë. Por e dimë gjithashtu që ju do të na falni. Të premtojmë se nuk e përsërisim më.

Polici ngriti supet në shenjë dorëzimi.

- Habi! Ç'idera kanë njerëzit! – ia bëri duke qeshur. - Shkoni. Ç'dreq gjobe t'ju vë?

Ata u larguan kapur për dore dhe vazhduan të shëtisnin nëpër qytet deri në mbrëmje vonë. Pastaj morën një tren ndërgytetës, gjetën një kabinë bosh, u ngjeshën pranë njërijtjetrit e vazhduan të linin pas puthje, pothuaj në çdo kilometër.

\* \* \*

- Besoj të pëlqen pylli, - ia bëri Alba me qejf një mëngjes të ngrrohtë, duke vështruar nga malet e blertë mbi qytet. - A bëjmë një shëtitje andej?

- Shkojmë, - ia ktheu ai.

- Ndonjë ekskursion tjeter? - pyeti kuzhinieri duke përgatitur disa panine. Vili iu lut t'u tregonte ç'drejtëm duhej të ndiqnin. Kuzhinieri filloi ta përshkruante rrugën me qejf, ku duhej të merrnin autobuzin e ku t'i zbrisnin. Herë pas

here e vështronte Vilin me zili dhe qeshte.

- Mik, - i foli kur Alba u largua disi, - je me fat. Ke një të fejuar të bukur. Por kujdes! Mos lejo njeri të ta marrë!

Vili pohoi me kokë. Përsëri përjetoi instiktivisht trembjen që kishte provuar pak kohë më parë te bordura.

- E ke provuar ndonjëherë të ta marrin të fejuarën nga krahët? - vazhdoi kuzhinieri.

- Jo, - gënjeu ai.

- Mua më ka ndodhur vite më parë. Porko mondo! Ma mori një tjetër vetëm se kishte veturë të bukur. Dhe ajo iku. Pavarësisht së unë iu luta të mos më linte.

- Gjëra që ndodhin.

- Eh, kështu ështëjeta! - psherëtiu kuzhinieri. - Atëherë, gjithçka gati. Argëtohu miku im!

Ata të dy morën autobuzin në afërsi të kampit. Ishte një linjë që të conte në qendër të Savonës. Aty morën një autobuz tjetër, stacioni i fundit i të cilit ndodhej në këmbë të malit, në një fshat të vogël me fare pak banorë. Pyetën në një bar dhe baristi u vizatoi një hartë primitive në një copë letër. Vili dhe Alba u nisën kapur për dore.

. Pylli kishte marrë gjallërinë e plotë të pranverës. Toka qe mbushur me bar e lule, gurët dhe trungjet e dushkut me myshk të freskët në një ngjyrë jeshile të errët që kundërmonte një aromë të këndshme. Kohë pas kohe nëpër kurorat e pemëve dëgjohej ndonjë cicërimë e vëtmuar.

- Është koha që zogjtë thërrasin njëri-tjetrin për t'u çiftuar, - tha Vili duke vështruar lart nëpër degë.

Ajo u skuq lehtazi. Nuk foli.

Ata u ngjitën për rrëth dy orë, me një ritëm të ngadalë, duke pushuar në ndonjë vend nga ku dukej deti e duke biseduar. Befas u doli para një kasolle e vogël, e drunjë, e modelit alpin.

- Është tamam si kasolle përrallash, - tha Alba.

Ata u afroan. Dera qe mbyllur vetëm me një shul. Vili e hapi.

Brenda panë një mjedis të rregulluar; dyshemenë të shtruar me lëkurë bagëtish, dy shtretër të mbuluar me batanije, një stufë, një fener, dru të çara, një raft të vogël me ushqime. Nëpër muret e drunjë qenë varur shumë fotografi gjuetarësh e alpinistësh.

- Duhet të jetë kasollja e ndonjë klubit gjuetarësh, - tha Vili. - Si do t'ia bëjmë?

- Hyjmë, - ia ktheu ajo. - Po na gjetën brenda, u themi se duam të bëhem anëtarë të klubit. Një kasolle në mes të pylilit nuk mund t'i mohohet askujt.

Ata hynë me ndrojtje. Alba ndezi stufën dhe filloi të përgatiste drekën. Hëngrën në dysheme, ulur pranë zjarrit, duke pirë verë nga gryka e së njëjtës shishe dhe duke u vështruar si dy fëmijë të zënë në faj nga të rriturit. Mendonin të njëjtën gjë. Po përgatiteshin secili me mënyrën e vet.

Pasi mbaruan së ngrëni, ndenjën rrëth një orë duke biseduar gjëra fare kot. Gjithçka po kthehej në një luftë nervash. Alba filloi të dorëzohej e para. Bëri disa lëvizje nervoze.

- Pse nuk më fton pranë teje? - pyeti më në fund gati me inat.

- Po prisja që ti të vije vetë, - tha ai.

Sapo ajo u struk mes krahëve të tij, Vili filloi ta puthte gjatë, me buzët hapur, gati duke i kafshuar buzët e saj të fryra. Në një çast pushimi Alba u ngrit në këmbë dhe filloi të zhvishej.

- Të lutem, mos më vështro për ca sekonda, - tha.  
Ai u bind.

- Ç'po bën? – pyeti.

- Dua të bëj dashuri me ty, - u përgjigj ajo me një sinqeritet çarmatosës.

Kur u kthye drejt saj, ai pa në këmbë një krijesë marramendëse, të bardhë, të ëmbël. Flokët e gjatë e të zi kontrastonin edhe më dukshëm me bardhësinë e trupit. Gjoksi i saj që ulej e ngrivej me ritmin e çrregullt të pritjes së dashurisë, e detyroi Vilin të zgjaste dorën. Për ca çaste dora e tij mbeti e tendosur, duke u dridhur, lutëse, e robëruar. Ajo nuk po lëvizte.

- Ti... po më provokon? - tha ai.

- Jo, - ia ktheu Alba qetësisht. - Po pres që ti të zhvishesh. Është vapë... zjarri... vera...

Ai u bind përsëri. Pas pak Alba iu ul në prehër dhe Vili e nuhati se po binte rob.

- Kam frikë, - tha pas një akti të vrullshëm dashurie, ndërsa të dy po qëndronin shtrirë, pranguar me njëri-tjetrin.

- Pse? - foli ajo me habi. - Nga gjuetarët?

- Nga ty.

- Nuk të kuptoj.

- Ti më kupton fare mirë. Je shumë e bukur. Bukuria jote më tremb. Më duket se do të të dashuroj si i çmendur. Kjo është e meta ime fatale. E provova përsëri. Nuk mund të rri pa i falur dikujt dashurinë time prej të çmenduri. Ka raste që e urrej tipin tim. Dua të jem antipodi i vetes, por me sa duket, nuk mundem. Jam i mallkuar ta vuaj deri në fund këtë tip.

- Ti nuk ke të drejtë të më fyesh - foli ajo e prekur. - Unë nuk do të luaj kurrë koketën me ty. Nuk do të provokoj. Jam kjo që jam, ndoshta ca naive.

- Nuk desha të të fyeja. Thashë atë që ndjej.

- Unë...

- Të lutem mos bëj deklarata dashurie! Jemi mirë kështu.

Kuptohemi mirë pa folur. Apo jo?

- Nuk kisha ndër mend të deklaroja gjë. Desha të të them se nuk ke arsyen për të urryer tipin tënd.

Ai u kthye në brinjë dhe e puthi. Nuk e kuptuan sa ndenjën ashtu, duke u vështruar nga fare pranë. Pastaj Vili afroi buzët te veshi i saj dhe mermëriti: dua prapë. Ajo buzëqeshi me cepat e buzëve, pastaj e tërhoqi mbi vete...

- Ua! Po bie nata! - thirri Alba befas, pasi ata ishin shtrirë rishtazi pranë e pranë, duke përjetuar akoma magjinë e asaj që kishte ndodhur.

- Pse të mos rrimë këtu? - ia ktheu ai qetësisht. - Ndoshta do ta kërkojmë këtë kasolle dhe s'do ta gjejmë dot më.

- Vili... vërtet të rrimë? - ia bëri ajo duke vështruar përreth si me frikë.

- Ti, do?

Ajo iu lëshua rishtazi në prehër, pa u menduar gjatë.

Të nesërmen, ndërsa po mbërrinin në kamp, ai u ndal papritur dhe:

- Ti më kërkove rastësisht të shkonim në pyll? - pyeti.

- Jo, - u përgjigj ajo në çast. - Doja të bëja dashuri me ty. Një natë të pashë në ëndërr. Po bënim dashuri në një plazh tropikal. Nuk munda të duroj dot më. Kjo është e gjitha.

- Falemnderit! - tha ai kokulur.

- Dëgjo edhe një gjë, - vazhdoi ajo. - Unë nuk do të të gënjej kurrë. Fli i qetë për këtë.

- As unë, - tha Vili.

## 4.

Ajo veturë luksoze, një "Jaguar" jeshil, që ndeshej jo fort shpesh nëpër rrugë, hyri në kamp si një vetëtimë verbuese. Prej saj zbriti një zonjë e moshuar, e veshur me një kostum blu, me bizophteri të shtrenjta nëpër duar e qafë. Dy nga ushtarakët e kampit dolën për ta pritur. Një grup refugjatësh u afroa te vutura për ta parë nga afër.

Ndërkohë Vili dhe Alba po shëtisnin në sheshin mes kapanoneve.

- Ç'është ajo veturë e bukur? - pyeti ajo.

Ai ngriti supet.

- Vil, a do të kemi edhe ne një ditë një veturë të bukur?

- Mbase ndonjë të përdorur. Gjërat luksoze më duken të paarritshme, sikur nuk janë krijuar për mua.

- Po për kë?

- Për një kategori tjeter njerëzish.

Ajo e vështroi për pak caste.

- Do të doje të ishe i pasur? - pyeti papritur.

Vili hapi krahët sikur të donte të çlirohet nga një siklet.

- Të them të drejtën, do të doja të kisha një shtëpi të bukur druri në breg të detit, të mbushur me libra dhe kaq.

Pasuan disa minuta heshtje.

- Po ti, do të doje të ishe e pasur si ajo italia me veturë?

Alba uli kokën.

- Nuk e di, - tha. - Mbase. Njeriu kërkon gjithmonë ato që i mungojnë. Ne vijmë nga hiçi. As vetë nuk e dimë se ç'duam

më parë.

Vili vazhdoi të çapitej pa folur.

- Zonjusha Tomorri! - u dëgjua një e thirrur pas ndonjë gjysmë ore. - Ju kërkojnë.

Ishte një nga ushtarakët e kampit. Ai e mori Albën me vete. Vili vështroi nga vetura si me frikë, pastaj nga Alba. Në ecjen e saj dalloi një lloj ngurimi. Paç fat, e uroi nga pas.

Ishte një zyrë e madhe, komode, por që stononte me figurën aristokratike të zonjës. Alba përshëndeti me ndrojtje. Italiania i buzëqeshi. Kishte një pamje serioze. Dikur duhej të kishte qenë shumë e bukur.

- Më quajnë Ana. Do të doja t'ju afroja një punë, - tha ajo papritur. - Autoritetet e kampit më treguan se jeni vajzë inteligjente.

- Më falni, - tha Alba duke iu dridhur zëri. - Kam shumë emocione. Ju faleminderit! Ë... a do të më jepni pak kohë të mendohem?

Zonja buzëqeshi.

- Sigurisht. Jeni e fejuar?

- Unë? Ë... si t'ju them... jo zyrtarisht e fejuar. Jemi njohur tani vonë... e kam mik.

- Ah, mik! Pra, duhet të pyesni edhe atë?

- Në se më lejoni.

- Mirë. Do t'ju lë numrin e telefonit. Thuajini mikut tuaj se do të interesohem t'i gjej edhe atij ndonjë punë.

- Vërtet?! Ju... pra... jeni shumë e mirë. Ju faleminderit njëmijë herë!

Alba nuk po dinte ç'të bënte nga hutimi.

- Po më pëlqeni, - tha zonja duke u ngritur e duke nxjerrë nga çanta një kartvizitë. – Ky është një plus tjetër. Femrat e rëndomta nuk i duroj dot. Atëherë, më telefononi. Mirupafshim!

Alba u kthye te Vili me kartvizitën në duar.

- Ana Sartori, - lexoi ai me zë. – Vila e Trëndafilave, 26.

## Pieve Ligure.

Alba ia tregoi të gjitha me një frysë. Priti që ai ta përqafonte e ta ngrinte peshë nga gëzimi, por Vili vetëm buzëqeshi.

- Falemnderit që mendove edhe për mua, - tha.

- Ti... nuk po gëzohesh?

- Nuk para gëzohem leht. Por... se si më duket që ti do të shkosh te ajo Vila e Trëndafilave. Atje, mes njerëzish të panjohur...

- Ti do që të mos shkoj?

Ai tundi kokën vrullshëm.

- Nuk desha të them këtë. Shko. S'duhet ta humbasim këtë rast, as ti e as unë. Së shpejti kampi do të mbylljet.

Ai e kuptoi se kishte reaguar ftoht dhe u përpoq të gjallërohej. I hodhi krahun dhe ndërsa nisën të shëtisnin, e puthi në flokë, duke nuhatur vjedhurazi aromën e këndshme të tyre.

\* \* \*

“Jaguari” jeshil erdhi rishtaz në kamp pas tri ditësh. Alba po e priste te porta e madhe me çantën pranë këmbëve. Ajo i shtrëngoi Vilit dorën, duke e puthur shkarazi.

- Do të të shkruaj ose telefonoj, - tha duke u larguar drejt veturës.

- Marrim autostradën apo rrugën «Aurelia» ? – pyeti Sartori.

- Si? Ah, po, si të doni, - ia ktheu ajo e hutuar edhe më shumë nga vetura luksoze dhe prania e italiane aristokrate që shndriste nga bizhuteritë.

Rugja «Aurelia» e përshkonte Rivierën Ligure bregut të detit dhe shkonte deri tutje në Francë apo Spanjë. Ishte hapur që në kohën e Romës së Lashtë. Këto ishin detajet që Alba

dinte për të. Disa herë kishte udhëtuar me Vilin, me autobuzët e linjës, deri në Gjenovë dhe kishin mbetur si të shushatur. Ajo zonë të godiste me prezantimin e parë. Për dy shqiptarë të ardhur nga një vend i shkatërruar, ku djegjet e thyerjet ishin kthyer në zbatimje, riviera ishte një dhuratë e rrallë. Kishin dëgjuar nga ata pak italianë që kishin takuar, ca emra vendesh përrallorë, ku pasanikët prishnin paratë e tyre gjatë verës; Porto-Fino, Santa Margerita, Rapalo, Kamoli.

Atyre vazhdonin t'u dukeshin ato vende si zonat e ndaluara ushtarake që kishin lënë pas, atje, në atdheun e tyre ngjyrë gri.

- Oh, vogëlushja ime Alba! – foli Sartori me një ton miqësor.  
– Çlirohu e dashur, rri mirë në sedilje. Mos ki emocione.

Alba lëvizi vendit.

- Më fëlni zonjë, jam e pamësuar... unë...

- Dini ta ngisni veturën?

- Jo, - u përgjigj ajo, e pushtuar nga një komplexk i mundimshëm inferioriteti. – Nuk kam patur rast ta mësoj.

- S'ke faj. Kam parë një ditë në TV një emision përvendin tënd dhe jam lemerisur. Përpiku të harrosh vogëlushe. Tashmë ankthi përfundoj. Ti je e re, e bukur. Do të doja të isha edhe një herë e re në këtë vend të bekuar!

- Ju jeni ende e re, - tha Alba. – Në vendin tim do t'ju merrnin për një pesëdhjetëvjeçare.

Sartori buzëqeshi.

- Oh, fantazira! – tha me një dhimbje të lehtë. – Rinia ka mbetur larg, tepër larg.

Vetura la pas Gjenovën dhe pas pak Alba pa buzë rrugës një tabelë ku qe shkruar "Pieve Ligure". Kishin mbërritur në një qytezë të vogël turistike, me shtëpi e vila të bukurë në shpat të malit. Ato nisin poshtë, në bregun shkëmbor dhe vazhdonin njëra mbi tjetrën, deri në majë të malit.

Vetura mori nëpër një rrugë të ngushtë, përpjetë shpatit

të malit dhe më në fund hyri në një oborr të madh, të asfaltuar, të rrethuar ngado me trëndafilë. Alba u mek. Kurrë në jetën e saj nuk kishte parë një mrekulli të atillë. E mahnitur nga ngjyrat dhe aromat e trëndafilave, as që e kishte vënë re se po qëndornte para një vile trikatëshe si kështjellë. E lyer në një ngjyrë të ëmbël kremi, kombinuar me të bardhë, vila krijonte që në pamjen e parë një ndjenjë të përgjithshme shlodhjeje dhe qetësie.

Një grua e re hapi një derë të drunjtë me kanate të mëdhenj.

- Sara, gjithçka në rregull? – pyeti Sartori pa e vështruar.
- Si urdhëroni zonjë! – u përgjigj tjetra.
- Është ankuar Mimi?
- Tani së fundi u bë pak nervoze.

- Shpirtja! E nervozon vëtmia, - ia bëri Sartori me keqardhje, duke hyrë brenda. Një kone bardhoshe, tepër e pakënaqur ngajeta, me ca përdredhje si prej prostitute, i doli para. Zonja e mori në krahë dhe fillloi ta përkëdhelte me dashuri. Konia me emrin Mimi puliti qepallat e kënaqur.

- Sara, njihu me Albën dhe tregoi dhomën e saj! – urdhëroi Sartori.

Alba u përmend. Sara, që duhej të ishte guvernante, e mori për krahu. Nëpërmjet ca shkallëve të ngushta, u ngjitën në katin e tretë. Aty mbretëronte një heshtje kishe. Dukej që nuk banonte njeri prej kohësh. Sara hapi derën e një dhome të madhe me dy dritare nga deti.

- Urdhëroni zonjushë, - tha. – Kjo do të jetë dhoma juaj. Ju do të qëndroni këtu pa qera dhe ushqimi në të gjitha rastet do të jetë gratis. Zonja Sartori ju orfon një pagë mujore prej 75000 lireash. Jeni dakort?

- Ë? Sigurisht, sigurisht.
- Ju duhet të bindeni në mënyrën më absolute, - vazhdoi tjetra. – Zonja nuk duhet të bëhet nervoze. Duhe ta dini se

ju mori këtu për bamirësi. Është prekur shumë nga ju refugjatët shqiptarë.

Alba pohoi me kokë.

- Në dhomë keni një zile. Në çdo orë që të bjerë ajo zile, ju duhet të zbrisni te zonja. Aktualisht ajo po shkruan një vepër madhore kushtuar jetës së saj dhe është tepër sensibël. Nuk duron dot vulgaritete dhe gjëra të bezdisshme.

- Ju kuptova, - tha Alba.

- Nuk kam mbaruar! Në dhomë keni një garderobë. Mund të vishni ç'të doni. Kur dilni me zonjën, nuk mund të visheni sidokudo. Asaj nuk i pëlqeijnë xhinset dhe xhakoventot. Ndjehem e detyruar t'ju kujtoj se çdo gabim, sado i vogël, mund të ketë pasoja. Duhet ta vlerësoni bamirësinë që ju bëhet zonjushë. Mbarova.

Guvernancja ktheu shpatullat me lëvizje prej ushtarakeje dhe doli. Alba vazhdonte të qëndronte si statujë, duke hedhur sytë sa majtas e djathtas si me mosbesim. Ndodhej në një dhomë të madhe, të lartë, të mobiluar bukur. Asaj iu kujtua në çast shtëpia që kishte lënë pas në Shqipëri. U ngjeth. Ai ishte një apartament i mjerë, me një dhomë e kuzhinë, i ndërtuar në kohën e kontributave vullnetare. Dhoma e prindërve, kuzhina e saja dhe motrës së madhe, deri sa kjo e fundit qe martuar. Prindërit nuk kishin patur kurrë pozitë. Kishin qenë dy mësues të thjeshtë.

Albën e dehu hapësira. U afrua te njëra prej dritareve dhe hapi perden anash. Para i doli një pamje marramendëse, plot dritë; një gji deti pa fund, me një ngjyrë të ëmbël blu. Dielli pranveror shkëlqente mbi sipërfaqen e valëzuar deri në dhimbje sysh. Një vapor i madh turistik, i bardhë, po i afrohej Gjenovës, ndërsa pranë bregut kishin hedhur sperancën disa motoskafë. Bregu shkëmbor qe i mbushur me vila, pemë, gjelbërim e lule.

Ajo u pështet në parvaz duke psherëtirë thellë.

- Zoti im, më ruaj mendtë e kokës! – mërmëriti.

Të nesërmen paradite zbriti në sallën e madhe të ndenjies veshur me një fustan stofi, me jakë të mbyllur. Sartori qe ulur në një kolltuk të gjerë pranë një vetratë të madhe që vështronë nga deti. Alba u tremb kur dëgjoi se ajo po fliste me vete. Gjatë ditës së djeshme kishte arritur ta njihte disi dhe kishte vënë re se plaka kishte çaste përhumbjeje. Zonja i kishte treguar diçka për jetën e saj. Kishte patur tre burra, të cilët të gjithë kishin vdekur në rrëthana tragjike. I pari, një oficer marine, qe vrarë në një betejë detare gjatë Luftës së Dytë Botërore. I dyti, një bankier, kishte vrarë veten. Ndërsa i fundit, një sipërmarrës ndërtimesh, kishte humbur jetën në një aksident rrugor para dy vjetësh.

- Mirëdita zonjë! – i foli.

Sartori e pa dhe buzëqeshi.

- Ah, para se të fillojmë, eja pak me mua, - tha.

E çoi pranë një komodine të madhe dhe i la në duar një kuti bizophush dhe një orë.

- Vëri këto! – urdhëroi. – Dikur i kam mbajtur unë.

Alba u bind. Deri atë ditë nuk kishte prekur kurrë flori me dorë dhe kur e pa veten me vëthë, varëse e byzylyk të florinjtë, u trondit nga ndryshimi.

- Po të trukohesh, mund të bëhesh edhe më e bukur, - tha Sartori me një ton që nuk linte shteg për asnjë lloj përgjigjeje.

- Tani, uluni dhe merrni atë bllokun e madh.

Alba zuri vend pranë zonjës dhe vuri mbi gjunjë një bllok, në kapakun e të cilit qe shkruar: "Jeta e një gruaje të vëtmuar". E hapi. Në bllok ishin hedhur disa kapituj.

- Mund të shkruani pa gabime? – pyeti Sartori.

- Besoj se po, - iu përgjigj Alba.

- Atëherë, mos kam mbetur te njojja me Serxon?

Alba leksi disa nga fragmentet e fundit.

- Jo zonjë. Këtu flitet për një nisje në luftë.

- Ah, po, - ia bëri Sartori duke vështruar tutje në det. – Janë çastet kur destrojeri i Serxhos u nis për në betejën e parë kundër anglezëve në Afrikën Veriore. Shkruaj: "Serxho nuk donte të më lëshonte nga krahët e tij. Thesari im, më tha, po sikur të vritem? Unë e vështrova e tmerruar. Së shpejti do të martoheshim. Kishim bërë dashuri vetëm disa herë. Jo i dashur, i thashë, nuk do të vritesh. Ai u nis për në luftë me sy të përlotur..."

Alba vështroi nga zonja në bisht të syrit

- Tingëllon e pabesueshme? – pyeti befas Sartori.
- Ndoshta... për një ushtarak... lotët...

- Gabohesh! Edhe gjenerali më trim mund të qajë për një femër. Serxho ishte tip i ndjeshëm. Ai më dashuronte çmendurisht. Dëgjo vogëlushe, femra nuk është femër po nuk e bëri një mashkull për të qarë.

Alba vështroi në breg të detit një motoskaf të vetmuar. Mendimi i parë që i shkoi nëpër mend qe se a mund të qante Vili për të. Në ç'rrethana? Sipas logjikës së Sartorit, ajo nuk ishte femër, në se nuk e bënte atë të përlotej.

- Por në kohën tonë ndoshta ishte ndryshe, - vazhdoi zonja. – Sot romantizmi ka vdekur. Liberalizmi seksual e prishi këtë botë. Sot më shumë rëndësi ka një prezervativ se sa një trëndafil. Të gjithë flasin për prezervativë dhe sëmundje, a thua se jetojmë në ndonjë fermë derrash të infektuar. Meshkujt janë bërë vuajeristë të fëlliqur dhe maniakë. Nuk do të doja të isha vajzë në këtë kohë prezervativësh.

Alba u skuq dhe ulti kokën. Shpërthimi i befasishëm i zonjës e shtangu. Plaka u bë nervoze për ca çaste.

- Me sa duket, rraca njerëzore e ka në gen fëlliqësinë, - psherëtiu. – Ku e lamë?

- Ai u nis për në luftë me sy të përlotur...

- "Pastaj unë mbeta e vetmuar. Zot, sa shumë vetmi dhe priteje i ke dhënë jetës sime! Anija e tij luftonte larg në det

dhe unë prisja në ankth. Dilja në breg të detit dhe kërkova më sy në horizont destrojerin e tij..."

Sartori vazhdoi të diktonte edhe ndonjë orë, pastaj u ngrit.

- Mjaft për sot, - tha. – Tani pres një mikeshë.

Pasdite Alba e shoqëroi atë në Rapalo, ku kishte një port të madh turistik dhe një kështjellë mesjetare. Bënë një shëtitje në breg të detit, pastaj u ulën në një lokal të shtrenjtë ku zonjën e njihnin mirë. Erdhën edhe disa zonja të tjera të moshuara dhe filluan të luanin me letra. Alba u tërhoq mënjanë. Kishte çaste që Sartori e harronte fare ekzistencën e saj ose i linte të kuptonte se kishte për detyrë të qëndronte pranë saj e heshtur, si ata rojet e pallatit të mbretëreshës Elisabetë që nuk reagojnë ndaj asnje ngacmimi të turistëve.

Në mbrëmje u kthyen në vilë. Pas darke zonja piu disa ilaçe dhe u mbyll në dhomën e saj. I kryente veprimet si e programuar, pa qejf, me një ritëm të ngadalshëm, sa të krijonte bindjen se jeta i qe kthyer në bezdi.

Alba u ngjit në dhomë dhe u gozhdua para televizorit. I ndërronte kanalet herë pas here. Në të vërtetë nuk e kishte mendjen te ekrani.

Ndjehej e vetmuar. Mendonte vetëm ardhjen e Vilit, por këtë gjë përpinqej t'ia fshihte vetes. Nuk donte ta pranon se qe e dashruuar si e marrë pas tij.

Papritur iu kujtua Gerta dhe vendosi t'i shkruante një letër të gjatë për të rejat e fundit. Nga kampi i kishte shkruar vetëm një herë. Do të ikim të dyja nga ky vend, i kishte thënë një mbrëmje të largët shoqja hebreje. Kam një parandjenë të fortë se do të ikim.

Ja, ku jemi, të ikura, pshërëtiu Alba.

## 5.

Ndërsa shëtiste i vetëm në sheshin qëndror të kampit, Vili qëndroi një çast dhe vështroi në drejtimin nga duhej të binte Pieve Ligure.

Ishte dashur ajo mungesë dyditëshe për ta kuptuar përfundimisht se qe dashruar pas Albës. E kishte pritur një gjë të atillë, i qe trembur që atje në anije. Kishte qenë bosh shpirtërisht për afro dy vjet. I vetëm. I qe ruajtur dhe larguar çdo lloj lidhjeje qëllimi.

Por kishte ardhur ajo njojje dhe nuk kishte mundur të rezistonte më. Kam mbetur i njëjtë tip i dobët, mendoi. Víktimë e nevojës për të dashruar dikë.

Shëtiti nëpër sheshin e zbrazur të kampit edhe ndonjë gjysmë ore, pastaj u fut në kapanon për të parë ndonjë film në TV. Ishte e vetmja mënyrë për të harruar disi Albën. E dinte se para gjumit ajo do ta mundonte rishtazi deri sa të lodhej dhe të flinte, për t'u zgjuar prapë me emrin e saj në buzë.

Të nesërmen që në mëngjes e kërkuan në komandën e kampit. Një zyrtar i bashkisë që vinte shpesh aty, e përshëndeti thatë, pastaj foli prer:

- Zoti Bregu, ju dhe disa të tjera keni paraqitur kërkesa për bursa për të vazhduar universitetin. Jam i autorizuar t'ju njoftoj se shteti ynë jep bursa vetëm në rrugë shtetërore, jo personave të veçantë. Pra, bursat do t'i jepen Tiranës. Interesohuni në rrugë të tjera. E qartë?

Vili pohoi me kokë. E kishte pritur atë lloj përgjigjeje. Vendosi të shkonte njëherë në Universitetin e Gjenovës. Iu duk e pabesueshme që një ditë mund të hynte aty si student. Edhe arkitektura, edhe vjetërsia e godinës, sikur ia përforcuan atë ide.

Hyri në një sekretari dhe u përpoq të shpjegonte shkurtimisht ç'kërkonte.

- Interesant! – ia bëri një mesoburrë me një palë syze miopike, të vockla sa vetë kokërdhokët e syve. – Je shqiptari i parë që vjen këtu. S'kisha parë ndonjëherë shqiptar. Më vjen keq të ta them, por ne si universitet nuk japim bursa në këtë rrugë. Duhet të kërkoni gjetiu.

Ai i dha disa adresa fondacionesh, pastaj e mati një herë me sy duke thënë:

- Më dukesh djalë i fortë. Po të punosh gjëkundi, mund të ndjekësh edhe universitetin. Ka plot të rinj italianë që veprojnë kështu.

Vili ia nguli sytë i gjallëruar.

- Sa para më duhen si fillim? – pyeti.

- S'do ishte keq të kishe një dhjetë milionë lireta, - ia ktheu tjetri. -

Lëre të iki ky shtator. Puno një vit. Mik, ky është kapitalizmi. Këtu nuk jemi as në Moskë e as në Tiranë.

Vili e falenderoi në mënyrë neutrale dhe doli. Këtu nuk të llaston njeri, mendoi. Nuk ka njeri që të na mbajë me bursa. Atij i erdhi për të qeshur me imazhin e kapitalizmit të bollëkut, pa dhimbje koke, që kishin patur pothuaj të gjithë në Shqipëri. Por ishin dashur ato javë në kamp pér ta kuptuar se kishin ardhur në një vend që kishte me dhjetra probleme pér vete, ku nuk i kishte vështruar njeri si heronj, por si viktima, të cilat kanë nevojë pér një strehë, bile shumëkush me bezdi.

Me t'u kthyer në kamp, ai shkroi disa kërkesa radhazi

për ndonjë bursë, qoftë edhe njëvjeçare. Por i hodhi zarfet në kutinë postare pa ndonjë shpresë. Filloi ta shtynte kohën duke lexuar për orë e orë me radhë. Kampi kishte filluar të përgjysmohej. Shumë vetë, me të cilët kishte krijuar një farë njohjeje, ishin larguar për të kërkuar punë në Gjenovë, Torino e Milano. Disa të tjerë, më aventurierë, kishin kaluar kufirin dhe kishin hyrë në Zvicër e Gjermani.

Pas ndonjë jave mbërriti një letër nga Alba. Vili e mori zarin me duar të dridhura dhe u pështet pas murit të një kapanoni. Filloi t'i përpinte rreshtat si i etur, por pastaj u detyrua ta lexonte letrën për së dyti.

Instiktivisht, e afroi te buzët dhe e puthi.

Pas asaj letre qëndrimi në kamp u bë edhe më i padurueshëm.

Kishte hyrë maji dhe ditët ishin zgjatur. Sado të shëtisje e sado të lexoje, përsëri mbeste kohë bosh. Ai vendosi t'i shtrohej punës. Gjeti një vëllim me novela e tregime të Alberto Moravias dhe filloi të përkthente. Nisi të shkruante edhe kapitujt e parë të një romani, subjektin e të cilit kishte kohë që e vërtiste nëpër mend. Gjithçka zhvillohej në një anije që lundronte drejt një ishulli parajsor, por që nuk arrinte kurrë atje. Njerëzit, të cilitur, kërkonin të zbrisnin, por nuk i lejonin. Ata që tentonin të arratiseshin, i vrisnin. Kërkimi i ishullit vazhdonte, por një ditë të gjithë e kuptionin se ai ishull nuk ekzistonte kurrkund...

Papritur, nga fundi i majit, një mesditë, Alba e rjoftoi në telefon të nisej.

Ai lëshoi një breshëri fjalësh, pa e kuptuar as vetë se ç'tha.

- Të pres në stacion, - dëgjoi rishtazi zérin e saj. – Të pres, të pres, të pres.

Vili filloi të bënte gati çantën, ndërsa ëmbëlsia e fjalëve "të pres" i ngacmonte tërë qënien.

Alba kishte dalë në stacionin e vogël të trenit ku kishte

fare pak njerëz. Kishte veshur një fustan të kaltër, kishte bërë një trukim të lehtë, nën flokë i shndrisnin dy vëthë të mëdhenj floriri, ndërsa mbi kraharorin e zbuluar një zinxhir. Imazhi i dikurshëm i vajzës së vaporit panamez qe zbehur edhe më.

Sapo e pa, ajo iu lëshua në krahë, duke harruar gjithçka rrretherrotull.

- Eja, - tha pastaj. – Po të pret pronari i serrave ku do të punosh.

Ata ecën një copë herë në këmbë, përgjatë rrugës "Aurelia", pastaj u ngjitën në një fermë të vogël ku kultivoheshin lule. Bëheshin nja pesëmbëdhjetë serra, të ngritura njëra mbi tjetrën në shpat të malit. I priti një plak i dobët, veshur me rroba pune. Ishte pronari. U prezantua me emrin Benarrivo, pastaj, pa humbur kohë, paraqiti kushtet e veta; garantonte një vend për të banuar dhe paguante 700000 lireta në muaj. Puna ishte në të zezë.

- Italinë po e ha korruzioni, - tha ftoht Benarrivo. – Nuk është fajti im. Unë duhet të shfrytëzoj dikë që të fitoj. Të marr ty se je emigrant, ke nevojë. Edhe gjyshin, edhe bananë tim, i kanë shfrytëzuar dikur në Australi. Po të punësoj një me dokumenta, unë humbas. Në këtë vend të kërkojnë shumë taksa.

Vili shtangu nga ai parashtrim. Nuk i kishte shkuar nëpër mend se një pronar, një borgjez, mund t'i ngjante një cigani që merret me pazare kuajsh. Ai ende nuk dinte shumë gjëra në lidhje me rregullat e punës, paga iu duk e vogël, megjithatë pranoi pa e zgjatur.

- E dija se do të pranoje, - ia bëri Benarrivo duke buzë-qeshur e duke vështruar në bisht të syrit nga Alba. Ai i çoi të dy te një shtëpi e vjetër dykatëshe, pranë serrave. Kati i parë i saj qe kthyer në magazinë, por kati i dytë ishte ende i banueshëm.

- Djalosh, është hotel me tre yje sepse nuk do të paguash asgjë, - tha pronari.

Vili e falenderoi disa herë radhazi. Benarrivo doli duke folur nëpër shkallë:

- Nesër në orën 7 fillon puna!

Ata të dy mbetën vetëm, në këmbë. Ai u përmend i pari dhe mbylli derën. Ajo u clirua nga bizhutë, pastaj hoqi me vrull fustanin. Vili ra në gjunjë para saj si para statujës së një perëndie të gjithëpushtetshme dhe pështeti fytyrën në pjesën trullosose nën kërthizë.

- Je një mrekulli, - rënroi.

- Të duket ty, - iu përgjigj Alba.

Edhe ajo ra në gjunjë, ngjitur me të dhe pas pak ata filluan të bënin dashuri me etjen e dy beduinëve të përvëluar nga dielli, që, pas qindra kilometresh nëpër shkretëtirë, bien në një oaz.

\* \* \*

Të nesërmen Vili doli në një shesh të vogël para shtëpisë dhe Benarrivo e njohu me një punëtor tjetër me emrin Lino.

- Shko me të, - tha shkurt.

Pas prezantimit dhe pyetjeve të para të njohjes, Lino, një burrë afro të pesëdhjetave, me një fytyrë të zgjatur e me sy me bisht si prej mongoli, filloi të zbriste tëposhtë shkallëve me ngut. Vili i shkoi pas. Iu afroan disa thasëve të mbushur me torfë pylli dhe me një material të përgatitur me lëvozhgë pishe.

- Këta thasë duhen çuar lart te serra 12, - tha Lino duke hedhur në shpinë njërin prej tyre.

Vili përsëriti veprimet e tij, por kur thesi zuri vend mes shpatullave, iu morën këmbët. Shtrëngoi nofullat dhe filloi të ngjitej shkallëve pa guxuar të vështronte përpara. Deri te

serra 12 duhej të ngjiste me dhjetra shkallë, në të përpjetë. Nga mesi i rrugës filloi të dihaste, por i dha zemër vetes duke menduar se fillimi është gjithmonë i vështirë.

Ndërkohë Lino qe shkëputur. Dukej që ishte mësuar me atë punë. Vili u përpoq t'i afrohej, por më kot. Te shkallët e fundit nuk po mbushej dot me frymë. Thesi gati po i rrëshqiste. E mbajti atë me thonj deri pranë serrës.

- Tani do të sjellësh edhe gjashtë të tjerë, - tha Lino. – Tre me torfë dhe tre me material pishe.

Vili nuk guxoi ta vështronë. Mori tatëpjetë shkallëve me kokën varur. Hajt, duro, i foli vetes. Nuk ka vdekur njeri nga puna. Gjatë ngjitjes së dytë provoi të shlodhej disa çaste, por që nga lart u dëgjua një zë inatçor:

- Jo, jo miku im! Mos ndalo! Nuk është socializëm sovjetik ky. Këtu nuk paguan shteti.

Vili e rihodhi thesin në shpinë pa u ndier.

Në hapat e fundit të rrugës së shtatë thesi desh e mori me vete. Mezi drejtoi shpinën. Mushkëritë i thernin. Nuk ngopej dot me frymë. Vuri re se italianni e ndiqte vazhdimisht në bisht të syrit. Ishte tip i vrenjtur. Ai nxori nga një kazan i madh plastike disa thasë më të vegjël me material pishe të ngopur në ujë. Derdhi në një bankinë të betontë nga një thes prej secilit material dhe filloi t'i përziente me duar.

- Ja, këtë punë do të bësh! – urdhëroi. - Nxirr thasë nga kazani dhe fut të tjerë!

Ai mbushi material të përzier me një kovë të madhe plastike dhe shkoi nga fundi i serrës. Filloi ta shtronë materialin mbi bankinë. Me sa dukej aty do të mbilleshin lule të reja.

Vili iu fut përzierjes menduar, i ngushëlluar nga fakti se të paktën ai proçes ishte më i lehtë se mbajtja e thasëve në shpinë nëpër shkallët pa fund. Mbushë material me kova dhe ia shpinte Linos. Pastaj shkonte te kazani i madh, nxirrte

thasët e lagur dhe fuste të thatët. Përizonte, mbushte, shkonte te Lino, kthehej, përziente rishtazi.

Ishte mpirë i téri kur Lino tha si me bezdi:

- Është mesditë. Shko të hash ndonjë gjë.

Por Vili nuk lëvizi. U ul mbi një arkë druri te hyrja e serrës dhe vari krahët. Nuk ndjente as etje e as uri.

- Hajt, material! – e përmendi zëri i Linos.

Ishte ora 13 pa 15 minuta. Gjithçka filloj nga e para. Arriti rrijë çast që Vili nuk ndjente më asgjë. Kryente veprime mekanike. Ndërsa po afroheshin minutat e fundit të ditës, ndjeu stomakun t'i therte. Iu morën mendtë.

- Ndonjë problem? – pyeti Lino.

- Gjithçka në rregull, - ia ktheu Vili duke u munduar të sajonte një buzëqeshje. Tjetri foli diçka nëpër dhëmbë në dialektin e pakuptueshëm gjenovez që nga akcenti të kujtonte frëngjishten.

Me siguri më shau, mendoi Vili.

Kur doli nga serra, u ndesh me pronarin.

- Hë, si shkoi? – pyeti ai.

- Shumë mirë, - ia ktheu Vili duke u munduar të qëndronte drejt.

- C'profesion ke bërë në vendin tênd?

- Jam marrë me letërsi.

Tjetri vuri dorën te veshi i djathtë për të treguar se nuk kishte dëgjuar mirë. Vili përsëriti të njëjtat fjalë. Benarrivo nënqeshi si me mosbesim.

- Ah, bukur, - ia bëri. – Lulet e mijë kanë nevojë për estetikë.

Vili u mundua rishtazi të buzëqeshte, por ishte aq i lodhur sa që muskujt e fytyrës nuk iu bindën. U kthyte në shtëpi. U ul në dysheme, i vuri shpatullat krevatit dhe mbylli sytë.

Vonë në mbrëmje, kur Alba hyri në dhomë, e gjeti duke fjetur në atë pozicion. Ajo e shkundi për supi.

- Vili, ngrihu! Të kam sjellë diçka për të ngrënë.
- Oh, më paska zënë gjumi, - ia bëri ai duke fërkuar sytë.
- Tmerr! Nuk kam punuar ndonjëherë në jetën time si sot. Në qoftë se Italia do të jetë vetëm kështu, me thasë në kurriz...
- Nuk e besoj.
- Po ti, shëtitë sot?

Ajo filloi t'i tregonte për një paradite të bukur, të kaluar në Kamoli, buzë detit. Kishte shkruar rreth dy orë kujtimet e Sartorit, ulur në verandën e madhe të një hoteli të qetë. Ndodheshin në një kapitull tepër prekës. Sartori sapo ishte martuar me atë oficerin e marinës dhe kishin ardhur për muaj mjalti pikërisht në Kamoli. Por kishin qëndruar vetëm disa ditë sepse oficerit i kishte ardhur një telegram nga komanda. Destrojeri i tij duhej të nisej për në lundrim...

- I gjori! – ia bëri Vili. – I paska mbetur mjalti përgjysmë.
- Ajo qeshi, pastaj u afrua dhe zgjati krahët.
- Nja një javë jam në lundrim, - tha Vili. – Të lutem mos më kërko intimitete!

Alba uli kokën duke u skuqur.

- Dakort, - tha. – Lundrim të mbarë!

\* \* \*

Në mëngjes ai u ngrit duke u shtremberuar nga dhimbjet e muskuve dhe gjëja e parë që bëri iu lut Zotit të mos kishte punë me thasë. Por sapo doli jashtë, Lino e priti me fjalët: fillojmë nga thasët. Vili e ndoqi pas duke sharë me vete. Sapo e vuri ngarkesën e parë në shpinë, u mundua ta qetësonte veten me argumentin e zakonshëm se në çdo punë fillimi është i vështirë.

Tërë javën nuk iu ndanë punët e rënda, me përjashtim të ndonjë intervali kur e ngarkonin të ujiste lulet në ndonjë serrë. E mbikqyrnin vazhdimisht. Disa herë vuri re pronarin

që, i struktur në ndonjë qoshe, e ruante si spiun për ta kapur duke ndenjur. Kur e shikonte duke punuar me ritëm, Benarrivo afrohej dhe deklaronte të njëjtat gjëra lapidare; unë kam respekt për emigrantët, themeluesi i kësaj ndërmarrjeje, im gjysh, ka qenë emigrant, edhe im atë. Ai i dha 100000 lireta si paradhënie, duke thënë ftoht:

- Unë e di shumë mirë se sa paguhet një punëtor në vendet komuniste.

Vili i shtynte orët duke menduar vazhdimisht se në mbrëmje do të takohej me Albën, do të shlodhej me kokën pështetur në prehrin e saj, do të flisnin shqip. Sa mbaronte punë, nxitonte të bënte dush dhe priste të dëgjonte hapjen e derës. Ajo nxitonte nëpër shkallë dhe ata përqafoheshin si dy fëmijë të lumtur.

Kur ai u mësua me punën dhe filloi të kthehej në shtëpi më pak i lodhur, ata dilnin të dy poshtë, në bregun shkëmbor të detit dhe qëndronin atje të përqafuar deri sa disku i diellit humbiste poshtë, në hapësirën e pafund blu.

Ditët dhe javët filluan të kalonin vrullshëm. Ndonëse Lino abuzonte rregullisht, duke i lënë atij të gjitha punët e rënda, Vili nuk ankohej. Me italianin kishte krijuar një raport neutral, pas asnjë lloj intimiteti. Kur ishte në orë të mirë, Lino këndonte ca këngë të vjetra të viteve '60 ose bërëtë ndonjë pyetje naive që lidhej me botën komuniste.

- Të pëlqen Moravia? – e pyeti Vili një ditë.

Tjetri mbodhi vetullat.

- Kush është ky?

- Shkrimtar italian.

Lino bëri një gjest mospërfilljeje.

- Mua as më plas për letërsi. Kur kam kohë të lirë, shkoj për peshk.

Vili uli sytë duke u skuqur.

- Këtu në Itali punohet shumë, - vazhdoi Lino. – Tepron

vetëm pak kohë për dashuri. Kuptove?

Vili pohoi me kokë...

Më 1 korrik pronari i dha pagën mujore. Vili e mori zarfin me duar të dridhura.

- Ju faleminderit! – tha.

- Jo! – ia bëri Benarrivo duke marrë një pamje prej të prekuri. – Jo djalosh! Jam unë që duhet të them faleminderit sepse ti ke bërë punën. Ato janë paratë e tua.

Ai nxitoi për në dhomë duke ndjerë zemrën që i rrihte fort në kraharor. I nxorri kartmonedhat me kujdes dhe filloj t'i shikonte me mosbesim. Ishte hera e parë në jetën e tij që kalonte aq shumë para nëpër duar. Kur Alba hyri brenda, e gjeti të hutuar pas tyre.

- Urime! – tha. – Hë, janë të bukura, ë?

- Librat më kanë mësuar t'i urrej paratë, - iu përgjigj ai. – Por këto para të nxjerra me thonj, nuk mundem t'i urrej dot.

Ajo u ul në gjunjë, e puthi, pastaj i foli te veshi:

- A bëjmë një festë të vogël sonte? Sartori ka shkuar për darkë në Gjenovë. Jam e lirë.

- Uau! – thirri ai duke i hedhur kartmonedhat përpjetë. – Verën do ta blej, kurse për meze do të të ha ty!

Ajo qeshi duke u skuqur.

Dolën për të blerë dhe ndërsa po kalonin pranë një zyre postare, Vili u ndal papritur.

- Alba, sikur të dërgonin ndonjë lek në shtëpi, - tha i mallëngjyer.

- Dërgojmë, - ia ktheu ajo. – Ata të mitë kanë nevojë.

Hynë në postë dhe plotësuan të dy nga një mandat-dërgimi prej 250000 liretash. Ndërsa shkruante, Vilit iu fanitën para syve prindërit e moshuar, të gozhduar para televizorit, në priti të ndonjë lajmi të mirë nga Italia. Me ato para ata mund të jetonin disa muaj pa kokëçarje ose të belnin ndonjë orendi për shtëpinë ku s'kishte hyrë gje e re prej vitesh.

## 6.

Ishte mëngjes i një të diele korriku kur në oborrin e madh të vilës hyri një veturnë me targën e Milanos. Alba apo që ulur pranë Sartorit me bllokun e madh të kujtimeve mbi gjunjë, kur zonja foli me një ton neutral:

- Eshtë im nip, Renato. Shko prite.

Alba u ngrit. Mimi e ndoqi pas duke iu ngatërruar nëpër këmbë. Ajo hapi derën kryesore dhe konia filloi t'i lehte të sapoardhurit me një zë gërricës që nuk trembte dot asnjë harabel. Miku zgjati duart.

- Oh, jo vogëlushe! Nuk më mban mend?

Vetëm kur hyri brenda ai vuri re Albën.

- Santa Madona! Po ju, kush jeni? – pyeti duke e vështruar i befasuar. Ajo u prezantua. Tjetri ia shtrëngoi dorën me tepër përzemërsi. Ishte një djalë pak mbi të tridhjetat, shtatmesatar, me syze miopike, me flokë të rënë mbi ballë, i veshur me një kostum të lehtë, që i jepte pamjen tipike të një nëpunësi të vogël zyrash. Ai e puthi Sartorin disa herë radhazi, pastaj zuri vend pranë saj. Alba qëndroi në këmbë.

- Atëherë, Renato, ç'na thua? – pyeti zonja.

- Më kishte marrë malli dhe thashë ta kaloj këtë të dielë me hallën time të dashur, - foli miku me qejf.

Ai e përpiu Albën me një vështrim që shprehte ende befasim.

- Ju jeni hungareze? – pyeti.

- Shqiptare, - iu përgjigj ajo.

- Si shqiptare?! Nga ata shqiptarët që erdhën me anije?

- Po.

- Komplimente! Nuk ma kishte marrë mendja se shqiptaret janë kaq të bukura.

Alba u skuq.

- Po ju sjell diçka për të pirë, - tha duke u larguar.

Pas ndonjë gjysmë ore zonja filloj të përgatitej për të dalë. Alba ngriu. Vili po e priste për të shkuar në plazh. Të dielave Sartori s'para largohej nga vila dhe i jepte disa orë leje. Dëgjoi të përmendej emri i plazhit të San Mikeles. Po priste tërë frikë.

- Alba, eja edhe ti me ne, - i foli Sartori me tonin e zakonshëm që nuk pranonte kundërshtim.

- Si urdhëroni! – tha ajo me një fije zë. U ngjit në dhomë dhe filloj të përgatitej krejt e hutuar. Vili nuk kishte telefon në shtëpi. Nuk dinte si ta lajmëronte.

U nisën me një veturë të hapur të Sartorit. Alba u përpooq të dukej në formë, por Renato e pikasi se diçka nuk shkonte.

- Mos vallë nuk të pëlqen San Mikele? – tha me një ton miqësor. – Mund të shkojmë gjetkë.

- Jo, më pëlqen shumë, - ia ktheu ajo.

Vuri re se Sartori e vështroi në bisht të syrit, me një shprehje enigmatike në fytyrë. Alba u sforcua për ta harruar Vilin dhe u kthyte me qejf nga deti. Flokët e gjatë i valë-viteshin mbi supe nga era. Renato futi në kasetofon një kasetë të Stivi Wonderit. Udhëtimi u bë edhe më i bukur.

Në San Mikele, një lagje e vogël e Rapalos, zunë vend në një kënd privat, të mbushur me shezlongë të gjerë. Alba hapi mbi gjunjë një revistë për t'u lënë të tjerëve të kuptonin se mund të diskutonin ç'të donin. Ata të dy ndërruan disa tema radhazi, pinë kafe, pastaj Renato tha me ton tepër miqësor:

- Alba, ju pëlqen të laheni?

Ajo u mat të kundërshtonte, por në çastin e fundit u ngrit.

Në vrullin e largimit nga shezlongu gjoksi i kërceu para dhe vuri re se Renato e vështroi në një mënyrë lakmitare, të cilën meshkujt shpesh nuk janë në gjendje ta fshehin. Ajo provoi një lloj miklimi tinzar. Në ato ditë të shëtitjeve me Sartorin, kishte vënë re se jo pak djem italianë e kishin vështruar në atë mënyrë. Faktin që ishte nga ato femra që nuk mund ta kalonte pa tërhequr vëmendjen, e kishte konstatuar prej vitesh, kur rrugës për në gjimnaz dhe më vonë, në fakultet, kishte dëgjuar me dhjetra ngacmime mistrece me fjalë. Shpesh i vinte për të qeshur kur kujtonte fjalët e një halabaku që me sa dukej kishte pirë disa gota: "Vdeksha shpirto, për ty do të vrisja edhe sulltanin e Brunejit". Po ngacmimet e kishin shoqëruar edhe në Itali. Veç ato nuk kishin brutalitet, zhargone halabakësh. Ishin të sofistikuara. Vështrime si të filmave, buzëqeshje të rrufeshme, të shoqëruara me një xhentilesë për t'u adhuruar. Në përgjithësi meshkujt italianë ishin tepër të sjellshëm me femrat...

Ajo u zhyt e para në ujë dhe filloi të notonte drejt thellësisë. Renato e ndoqi. Shkuan deri pranë një kepi shkëmbor, mbi të cilin ngríhej një kështjellë e vjetër. Renato filloi t'i tregonte se kështjella qe ndërtuar në Mesjetë dhe i përkiste një familjeje fisnike malteze. Duke dashur të mos e fyente me heshtjen e saj të gjatë, Alba e pyeti për profesionin. Mësoi se Renato ishte nëpunës në bashki, gjeometër nga profesioni. Kishte një apartament dhe jetonte atje vetëm.

- Jam 33 vjeç, – tha ai duke qeshur. – Beqar.
- Ah, paske moshën e Jezuit kur e kryqëzuan, - ia bëri Alba duke u zhytur rishtazi në ujë. Ai e priti sa doli, pastaj foli serioz:

- Të gjithë e kemi nga një vit Jezu Krishti.

Kur Sartori dhe nipi i saj u ulën për të ngrënë drekë, ajo provoi të shmangej, por Renato iu lut duke thënë se ishte e ftuar prej tij. Alba u mat rishtazi të kundërshtonte, por Sartori

foli prer:

- Alba, ulu! Ti nuk je sido-kudo, por njeri i shtëpisë. Kur fola herën e fundit me prindërit e tu në telefon, të konsidervoia si vajzën time.

- Ju faleminderit! – tha ajo duke u skuqur.

Sartori hëngri fare pak, pastaj u fut në një kënd të freskët të lokalit për të luajtur me letra me disa gra të tjera të moshuara. E ndodhur vetëm para Renatos, Alba filloi të pyeste për gjëra tepër serioze si mafia, organizimi politik e administrativ i shtetit italian, klima, antikiteti. Si shumicës së italianëve, tjetrit i pëlqente të fliste, të tregonte papushim. Ajo tundte kokën automatikisht, duke dëgjuar vetëm dhjetë për qind të atyre që thuheshin.

Kur edhe pyetjet i mbaruan, u fut prapë në det. Kësaj here Renato nuk e ndoqi.

U larguan nga plazhi nga ora 16. Alba vendosi të mos zbriste më në sallonin e madh të ndenjies, por Renato e thirri. Qe bërë gati për t'u larguar.

- Ju falenderoj për shoqërinë, - tha duke ia shtrënguar dorën në mënyrë pak të tepëruar.

- Ju faleminderit edhe juve! – ia ktheu ajo.

Kur zbriti poshtë, te Vili, e gjeti atë shtrirë përmbyss me sy të mufatur. Disa libra e fletore qenë shpërndarë në dysheme. Ajo e kuptoi se ai s'kishte lëvizur nga vendi tërë ditën. Dukej tepër nervoz. Iu ul pranë dhe pëshpëriti:

-Më fal, nuk qe faji im.

- Desh u çmenda këtu brenda! - thirri ai. - Është temperaturë ferri.

Ajo u përpoq t'ia shpjegonte të gjitha.

- Ç'ishte ky tip? – ia bëri Vili duke fërkuar fytyrën e përgjumur.

- Një tip tutje, - tha ajo.

Ai e afroi nga vetja dhe e përqafoi, megjithatë, ca nga

acarimi e ca nga vapa, atë mbrëmje nuk mundën të bënin dashuri.

Në ditët që pasuan Alba u përpoq t'i kushtonte Vilit sa më shumë kohë, por një mëngjes governantja i foli me një ton të ftohtë:

- Zonjushë, do të doja t'ju vija në dukje se nuk bëni mirë që futeni aq shpesh në apartamentin e të fejuarit tuaj. Ju punoni për Sartorin dhe duhet të tregoheni ca më e kujdes- shme. Për ju nuk duhet të krijohet asnjë opinion joserioz.

Alba shtangu. Nuk i kishte pritur ato fjalë.

- Më falni, - tha, - po këtu jemi në Itali, jo në Arabinë Saudite.

Sara nënqeshi.

- Mos guxoni të bëni ironi me mua, ju, shqiptare!

Alba uli kokën.

- Kjo ishte një këshillë e juaja? – pyeti.

- Ju e dini fare mirë se unë s'flas kurrë në emër të vetes, u përgjigj tjetra.

Aba u largua e turbulluar. Mbase e kam tepëruar vërtet, mendoi. Fundja do ta takoj ca më rrallë. Eh, e lehtë ta thuash!

\* \* \*

Një paradise, ndërsa po transportonin lule së bashku me Linon, me një furgon të ndërmarrjes, nga serrat, poshtë te kopshti i kameljeve, Vili pa një veturë të hapur që i parakaloi me shpejtësi. Lëvizi vrulltazi dhe nxorri kokën nga dritarja e vogël e kabinës. Njohu flokët e Albës, fustanin e saj. Veturën e ngiste një djalë, ndërsa në sediljen e pasme qe ulur Sartori. Ai provoi brenda çasttit një turbullim të fortë.

- Ç'pate? – pyeti Lino me një nënqeshje të lehtë. – Ç'farë pe?

- Hiç, - iu përgjigj ai ftoht.

U bë nervoz. Filloi të punonte pa e patur mendjen dhe rrëzoi për tokë disa vazo me lule ndërsa po shkarkonin furgonin. Ishte jashtë mase vapë. Një ajër i ngrohtë e i thatë s'të linte të mbusheshe me frymë. Ata dolën në diell, mes disa parcelave me kamelie të rritura, të cilave u duhej pastruar terreni ku qenë rradhitur. Aty s'kishte vënë njeri dorë prej kohësh dhe vazot qenë mbuluar nga barërat dhe bimët e egra endacake.

I mësuar prej vitesh me atë lloj pune dhe me atë diell përvëlues, Lino pastronte tokën me shat, ndërsa Vili largonte vazot me lule, duke u ngarkuar sa mundej.

- Përpiku të marrësh më shumë! – i foli Lino.

I mytur në djersë, duke e patur mendjen te vetura e hapur, Vili u ndal dhe thirri me inat:

- Dëgjo, më nuk jam skllav!

Tjetri përplasi shatin përtokë.

- Pse, - thirri edhe më fort, - unë ç'jam që kam bërë tërë jetën këtë punë?

- Unë fola për vete.

- Ju të vendeve komuniste nuk doni të punoni, prandaj morrët arratinë, - vazhdoi tjetri. - Ky vend ka arritur këtu ku është sot me punë.

- E di, e di, - tha Vili duke mbushur rishtazi duart me vazo.

Ata i ndenjën njeri tjetrit tërë ditën me hundë. Vili u kthyte në dhomë duke sharë ç'të mundte; Linon, Benarrivon, kameliet, vetrurat e hapura, nipat e zonjave pasanike, bile edhe vetë Diillin. Megjithatë, vendosi të luante të paditurin kur të takohej me Albën. Ndoshata nuk është faji i saj, tha me vete. Kushedi si do të kenë qenë rrethanat.

Të nesërmen doli në punë më me humor, por Benarrivo e priti me lajmin më çarmatosës në botë.

- Djalosh, po të njoftoj se për ty ka punë edhe një javë, -

tha. – Pastaj duhet tē largoheni.

Vili ngriu.

- Po pse... unë... kam punuar...

- Nuk kam asnjë ankesë pér ty. Është thjesht problem mungese fronti pune.

Vili u mendua disa çaste.

- A mund ta mbaj shtëpinë me qera? – pyeti.

Por tjetri qe përgatitur pér atë pyetje.

- Jo, - tha. – Duhet ta lirosh pas një javë.

Vili nuk po arrinte tē kuptonte dot asgjë. Në fillim dyshoi se do ta kishte largimin dhuratë nga Lino. Ia nguli sytë disa herë me urrejtje.

- Porka putana! – ia bëri tjetri me inat. – Pandeh se ta kam bërë unë? Unë s'jam budalla. Kujt do t'i jap urdhëra po tē ikesh ti? Hë, fol!

Vili uli kokën.

- Është e vërtetë që s'ka më punë? – pyeti.

- Gjithçka që thotë pronari është e vërtetë, - u përgjigj tjetri pa e vështruar.

Në mbrëmje Vili zbriti në një skelë tē vogël buzë detit pér tē pritur Albën. E kishin lënë pér tē shëtitur me një anije tē vogël turistike. Ashtu si edhe ai, ajo nuk qe në gjendje ta shpjegonte vendimin e Benarrivos.

- Të lutem, mos u mërzit kështu, - tha. – Do tē gjejmë ndonjë punë tjetër. Unë do t'i lutem prapë Sartorit.

Ata u ngjitën në anije dhe zunë një stol tē veçuar. Ndërsa iu larguan bregut dhe ajri i freskët i detyroi tē shtrëngoheshin pranë njëri-tjetrit, Vili e ndjeu veten më tē lehtësuar.

- Më thuaj, ç'të bëj që tē kthej humorin? – foli Alba.

- Vetëm më ler tē tē shoh, - ia ktheu ai. – Ke marrë një ngjyrë mulateje. Je bërë si çokollatë me lajthi dhe unë... dua tē tē kafshoj!

Ajo klithi ëmbëlsisht me dorën para gojës, ndërsa ai e

kafshoi në sup.

- Vil, e di, jam çokollatë që nuk shkrij. Prit sa të kthehem i  
në breg. Ai pështeti kokën në supin e saj.
- Do të doja të udhëtonim kështu, pafundësisht, - psherëtiu.
- Pas çdo dite që kalon ndjej më shumë nevojë për ty.

Alba hapi gishtat e dorës dhe i futi nëpër flokët e tij. Nuk guxoi t'i tregonte rishtazi për Renaton, i cili e kishte njofuar Sartorin se pushimet verore do t'i kalonte së bashkë me të. Njoftimi i Renatos e kishte befasuar disi Sartorin, por ajo ishte treguar tepër e kënaqur. Eja i dashur, kishte thënë, kemi nevojë për ca shoqëri...

Alba vazhdoi të përkëdhelte flokët e Vilit dhe iu kujtua lundrimi i stërmundimshëm i marsit. Çudi, si ështëjeta, mërmëriti.

\* \* \*

Të nesërmen, menjëherë pas punë, Vili mori autobuzin e Rekos, një qyteti turistik aty pranë. Deri në mbrëmje u vërtit nëpër restorante e piceri duke kërkuar punë, pa marrë asnje premtim. Ke gjetur kohë të keqë për të kërkuar punë, i tha një kamarier. Në gusht italianët bëjnë vetëm leje dhe dashuri.

Nga hutimi, Vili u kthye për të dytën herë në një restorant pranë detit. Hajt, me që paske mbetur keq, po të jap një dhomë dhe ushqim gratis, i tha pronari.

- Si, pa rrogë?! – ia bëri Vili.
- Djalosh, nuk kam kohë të humbas!
- Ai u kujtua se s'kishte ku shkonte dhe pranoi
- Mirë, - tha i lëkundur. – Do të vij pas ca ditësh.
- U kthye në shtëpi pa e besuar akoma kontratën mesjetare që kishte bërë.

Ditët e fundit te Benarrivo u bënë të padurureshme. Lino përpinqej të mbaronte të gjitha punët e rënda. I mjerë,

mendonte Vili pa u ankuar. Ja shpëtove për dy javë, për një muaj, po pastaj, kujt do t'ia ngarkosh thasët dhe kovat në kurriz? Zot, pse duhet të jenë njerëzit kaq të këqinj?

Por kur filloi punë në restorant, ai u bind se nga Lino dhe serrat e Benarrivos qe ankuar kot. Në aneksin e ngushtë të kuzhinës, ku laheshin enët, të mbysnin avujt dhe aromat e gjellëve plotë salcë. Vili ndjentë djersën se si i rridhte nëpër fytyrë e shpinë. Pjatat dhe gotat s'kishin të mbaruar. Ai qe bërë tepër nervoz.

Gjithçka kishte filluar të djeshmen pasdite, në Pieve, kur i kishte telefonuar Albës dhe governantja i kishte thënë me një zë mistrec: "Alba është e zënë. Herë tjetër mos telefononi në orare të papërshtatshme". Kam një problem të ngutshëm, ishte përpjekur të justifikohej ai.

Alba kishte zbritur pas ndonjë ore me pamje të mërzitur dhe e kishte njoftuar se të nesërmen do të nisej për pushime në mal, së bashku me Sartorin dhe nipin e saj. Vili kishte psherëtirë pa dashur. Ajo e kishte kapur për krahu. Të lutem më kupto, kishte thënë, pushimet e Sartorit nuk i organizoj unë. Sikur të ikje fare nga ajo vilë e mallkuar, ia kishte kthyer ai, pa e fshehur dot turbullimin që i kishte shkaktuar lajmi i pranisë të nipit të Sartorit në mal. Vil, duhet të kesh më shumë besim te unë, kishte thënë Alba gati e prekur. Nuk është punë besimi, por vëtmie, kishte vazhduar ai...

Vili ndjeu një dëshirë të fortë për të marrë arratinë një orë e më parë nga restoranti. Një nga kamarierët e kishte këshilluar të shkonte në Gjenovë. Atje ka më shumë shanse, i kishte thënë ai. Po ndërtohen goxha objekte. Verën që vjen do të jetë festë e madhe, 500-vjetori i zbulimit të Amerikës. Ti besoj e di që Kolombi ishte gjenovez. Ik mik! Tregohu i shkathët se përndryshe...

Vili e shoshti planin e Gjenovës për një javë resht. Pa Albën, si në Reko si në Gjenovë, ishte njëlloj. Sartori kushedi

kur mund t'i jepte përgjigje për ndonjë punë tjetër. Po të rregullohej vetë në Gjenovë, më vonë mund të tërhiqtë edhe Albën. Kishte gjithsej 800000 lireta. Iu dukën shumë.

Pas tri ditësh u vendos në një garsonierë të vogël, në një nga lagjet e vjetra të qytetit ku jetonin kryesish emigrantë dhe kërciste sherri pothuaj për natë. Fqinj kishte një kamerunas dhe një filipinas me të cilët ndante të njëjtën banjo. Kishte paguar për atë garsonierë 600000 lireta për dy muaj. Punë kishte gjetur në një restorant vetëm të shtunave e të dielave në darkë.

Mëgjesin e parë në shtëpinë e re u zgjua nga një zile e thatë dhe nervangritëse e kamerunosit. Ai merrej me tregtinë e ca ringla-stringlave, veshjesh afrikane, punimesh artistike në dru dhe ca maskave primitive. Dilte herët nga shtëpia.

Vili u përpoq të flinte rishtazi, por më kot. U ngrit, piu një kafe dhe doli. Duhej të kërkonte poshtë e lartë për punë deri nga ora 10 sepse më vonë vapa të mbyste. Rrugët zbrazeshin.

Trokiti në disa lokale, por më kot.

- Duhet të presësh shtatorin or mik, - i tha një djalë që shpërndante pica. – Atëherë fillojnë punët e mëdha.

Vili nënqeshi. Kishte mbetur me 100000 lireta në xhep.

Vonë pasdite, kur vapa u lehtësua disi, ai rinisi trokitjet, thjesht për të bindur veten se nuk po rrinte kot. Por papritur, pronari i një restoranti i bëri shenjë të afrohej. Kishte një furgon për të shkarkuar. Vili pranoi pa e zgjatur, pa bërë asnjë lloj marrëveshjeje paraprake. Kur mbaroi punë, italiani i la në dorë 20000 lireta.

- Ju lutem, mos kini ndonjë punë afatgjatë? – pyeti Vili duke i futur paratë në xhep pa i parë fare. Tjetri u mendua një çast.

- A ke patentë? – pyeti.

- Jo.

Italiani bëri një gjest keqardhjeje dhe u largua. Për herë parë në jetën e tij letërsia iu duk Vilit gjëja më kot në botë dhe u pendua që nuk ishte bërë shofer apo mekanik. Në ato çaste mallkoi vjershat e rinisë së parë, fakultetin, novelat, romanet, përkthimet dhe gjithçka që lidhej me botën e letrave.

Bëri një shëtitje të shkurtër, pastaj u kthyte në dhomë. Qe kthyer edhe kamerunasi. Po dëgjonte një kasetë me ca këngë të mistershme afrikane, me një ritëm që të detyronte të tundeshe. Vili u ul pa ditur ç'të bënte. Padashur sytë i shkuante një kalendar i varur në mur. Ishte data 28 gusht. Mbështetë kthyer, mendoi. Doli rishtazi, hyri në një kabinë telefonike dhe formoi numrin e Sartorit. Nga ana tjetër e linjës u dëgjua zukatja ritmike e sinjalit. Ka ardhur, foli ai me vete. Ka ardhur. Alba, ngrije, të lutem. Zukatja u bë acaruese deri sa e prishi ritmin dhe u kthyte në një piskamë të neveritshme. Jo, ajo nuk ishte kthyer.

Ai hyri në dhomë me kokën dhe krahët varur. Ndezi sobën, pastaj fërgoi në një tigan të nxirosur dy kokrra vezë. Hëngri pa pikë oreksi, sa për të mbushur barkun. U mat njëherë t'i afrohej çantës dhe të nxirrte librin me tregime e novela të Moravias për të përkthyer ndonjë faqe, po nuk ndjeu asnje shtytje. Në dhomë nuk kishte as televizor e as radio.

Atëherë u shtri dhe mbylli sytë në pritje të gjumit. Si shpeshherë atyre ditëve të fundit, para syve, në një mjedis fantazmagorik, iu fanit Alba. Pastaj ajo zbriti në një livadh të bukur mes pyllit. Shëtiste me një fustan të tejdukshëm. Nipi i Sartorit, një figurë me konture të paqarta, e ndiqte pas dhe zgërdhihej duke shijuar linjat e trupit të saj, këmbët e gjata, vithet e ngritura, të rrumbullakta e të tendosura si të një skulpture të vjetër greke...

Ai e dëboi me nervozizëm atë imazh. Solli para syve

kasollen alpine ku kishin kaluar ato orë dehëse të dashurisë së tyre të parë. Prekte çdo pjesë të trupit të Albës, shijonte buzët e saj, aromën e flokëve, të gjoksit. Në vesh i kumbonin rënkimet e ëmbla të saj. Nuk kishte mundur të shpëtonte dot prej atyre rënkimeve. Ishin gjëja që e kishin magjepsur më shumë në dashurinë me të. Alba, ke finalen e dashurisë më të bukur në botë, i kishte thënë ai një mbrëmje, ndërsa ishin shtrirë të dy në dysheme, në dhomën e tij në Pieve Ligure, pas një akti dashurie nga më të pakontrolluarit. Është një finale që i ngjan mbytjes së një anijeje. Është një mbytje tërheqëse, e bukur. Unë e di që mund të mbytem dhe nuk dua të largohem nga anija. Me siguri më pëlqen të mbytem. Dua të zbuloj çfarë vjen pas mbytjes.

Pas atyre fjalëve ajo kishte mbuluar fytyrën me duar.

- Vil, të lutem mos thuaj të tillë gjëra, - ia kishte bërë duke u skuqur deri në rrënjet e flokëve. Por kishte qenë një lutje e thënë me një lloj falenderimi të thellë, me një sedër të përkë-dhelur femërore. Ndonëse kishte ndjerë turp, asaj i kishin pëlqyer thellë ato fjalë, aq thellë sa nuk kishte mundur të qetësohej deri sa qe larguar...

Vili e kuptoi se nuk do të flinte dot. U ngrit, u afrua te dritaria e hapur dhe u pështet me bërryle në parvazin e saj. Ngriti sytë nga një copë qielli që dukej mes pallateve të gurtë të asaj lagjeje të vjetër mesjetare. Kur sytë iu lodhën, yjet atje larg filluan t'i përndriteshin sikur të ishin pictuar nga dora e Van Gogut. Konturet e tyre gati u puthiten me njëri-tjetrin.

## 7.

Ulur në një kolltuk të gjerë, në verandën e shtëpisë verore të Sartorit, me një pulovër supeve, Alba vështronte yjet dhe shijonte ajrin e freskët të malit. Ndodheshin rrëth 1000 metra mbi nivelin e detit, në një fshat të vogël mes pyjeve, ku gjithçka ishte e pastër, e pacënuar, ku ende kishte lule, zogj, kafshë të egra. Albës i kishte prirë ajo klimë, i kishte ardhur befas një oreks i llahtarshëm dhe ndjente se qe shëndoshur.

Pranë saj, Renato po shfletonte një gazetë, duke thënë herë pas here: e çmendur, Italia po bëhet çdo ditë e më e çmendur. Pak më parë ai i ishte lutur për një shëtitje rrëth shtëpisë, por ajo nuk kishte pranuar. Gjatë atyre ditëve Renato kishte treguar për të një përkujdesje të tepëruar. Po bënte çmos që ajo të kënaqej nga pushimet në mal. Bile kishte arritur deri atje sa t'i hapte edhe derën e veturës. Alba qe përpjekur të bindte veten se të gjitha ato ishin detaje të xhentilesës së mashkullit italian, por përvoja nuk mund të thoshte dot të rjejtën gjë. Ajo kishte venë re se tjetri po tërhiqej pas saj, ndoshta pa e kuptuar edhe vetë.

Një ditë ai i kishte sjellë një tufë me lule të mbledhura në pyll. Qe lodhur e djersitur, bile kishte gjerricur edhe dorën në një shkurre për të kapur një zambak të egër. Albën e kishte prekur ai detaj. Je shumë i mirë, i kishte thënë. Po bën përmua më shumë se ç'e meritoj. Jo, i kishte thënë ai duke e vështruar ngultazi përmes syzeve miopike, ti meriton më shumë...

Ndërsa Renato ktheu faqen e gazetës, ajo e vështroi në bësht të syrit. Pse duhet të rri kaq vonë këtu, me këtë njeri, pyeti veten. Nuk guxoi ta kujtonte Vilin në ato çaste. Gjatë atyre ditëve kishte provuar shpesh turp të përzier me faj kur e kishte kujtuar atë. Por pastaj qe munduar të qetësohej me argumentin se në një mjedis italianësh nuk mund të sillej si një shqiptare anadollake. Duhej t'u përshtatej botës dhe sjelljes së tyre.

Pas pak u ngrit.

- Natën e mirë! –tha. – Do të shihemi nesër.
- Fli mirë, - ia ktheu ai. – Nesër është dita e fundit. Na pret shëtitja me kuaj. Do të jetë shumë bukur.

Ajo hyri në dhomën e saj në majë të gishtave duke dashur të mos shqetësonte Sartorin. U shtri duke e ditur se nuk do të flinte dot. Ato ditë, ndoshta për shkak të klimës dhe vendit të bukur, kishte provuar etje për dashuri. Një etje të cilën nuk e kishte njohur kurrë më parë. Nuk dinte si të çlirohen prej saj.

Një ditë, rastësisht, kishte dëgjuar në TV një bisedë mes grash lidhur me problemet e seksit. Është normale që femra, kur ndjehet tepër e ngarkuar seksualisht, të masturbojë për t'u çliruar nga tensionet, kishte thënë një seksologe. Trupit i bën mirë masturbimi. Ai mban në një gjendje elasticiteti muskulini jetik që komandon orgazmën tonë...

Ajo qe skuqur nga turpi duke dëgjuar atë bisedë. E befasonte lirshmëria me të cilën femrat italiane diskutonin për seksin dhe dashurinë. Edhe në ato çaste nuk guxonë ta conte masturbimin nëpër mend.

O Zot, çfarë magjie ndodhi atë natë në atë kasolle të bukur alpine së cilës nuk mundem t'i shpëtoj dot, pyeti veten. Solli ndër mend intimitetet me njeriun që kishte dashur për herë të parë dhe provoi zhgënjam. Nuk ishte një zhgënjam që buronte nga dëshira për hakmarrje, i lindur nga fakti se ai e

kishte braktisur pas ikjes në Francë. Jo, zhgënjimi i kishte ardhur natyrshëm, pasi kishte filluar të bënte dashuri me Vilin dhe kishte mësuar detajin e dëgjuar edhe nga Sartori se meshkujt nuk janë të gjithë njëlljo.

Për vite me radhë, e ndikuar nga librat dhe filmat, ajo e kishte imaginuar seksin diçka tepër trullosose. Por nga njeriu, me të cilin kishte patur lidhje për afro një vit, rrallë kishte mbetur e kënaqur deri në trullosoje. Vetja nuk i qe dukur aspak heroinë librash apo filmash dhe kishte dyshuar se mos ishte vetë fajtore, se mos ndoshta kishte ndonjë mangësi fatale. Atëherë ajo nuk arrinte ta kuptonte arsyen. Kishte dyshuar gjithashtu se librat dhe filmat ekzagjeronin, duke e mitizuar seksin fare kot.

Dyshimet e kishin lodhur gjatë. Disa herë, e nervozuar, ajo qe matur t'i thoshte njeriut të Francës se mbase diçka nuk funksiononte, por nuk kishte mundur. Ishte një ndrydhje e pakapërcyeshme, të cilën, siç kishte mësuar më vonë, e vuanin shumë femra, trembur nga fakti se po të kërkonin atë që donin në të vëretë, do të dukeshin si zuska. E lodhur, ajo kishte vendosur ta mbyllte atë kapitull, duke menduar se fundja limiti i kënaqësisë dashurore mbaronte aty dhe më tej s'kishte asgjë të jashtëzakonshme.

Vetëm kur i qe dhënë Vilit, kishte filuar të kuptonte shumë dataje dhe t'u jepte përgjigje dhjetra pyetjeve që e mundonin prej vitesh. Kishte parë se limiti i dashurisë i ngjante një shkëputjeje të ëmbël, përhumbëse, nga realiteti banal, se ajo vetë nuk kishte asnë të metë fatale, se librat dhe filmat nuk ekzagjeronin. Kënaqësia që i kishte dhënë dashuria me atë njeri i qe dukur gjëja më e mistershme në botë, para së cilës qe dorëzuar me trup e shpirt, duke u çliruar nga çdo lloj frenimi e kompleksi.

Befas i lindi pyetja se a kishte Renato të dashur dhe si duhej të bënte dashuri me të. Po Sartori, si kishte bërë dashuri

me atë oficerin simpatik të marinës? Po... prindërit e saj? Po motra e madhe? Jo rrallë Alba kishte dyshuar se mes së motrës dhë të shoqit kishte diçka që nuk shkonte. Duhej të ishte patjetër diçka intime sepse motra nuk pranonte të tregonte. Shpesh ishte e mërzitur, nervoze dhe kur Alba e pyeste "Ç'ke kështu", ajo bënte në gjest padurimi.

Mesiguri është e pakënaqur nga seksi, mendoi Alba. Kishte lexuar një ditë në një nga gazetat e Renatos përfundimet e një ankete publike të realizuar me femra evropiane të moshës 17 – 30 vjeç dhe qe habitur kur kishte mësuar se afro gjysma e tyre ishin të pakënaqura nga seksi me partnerin. Bile edhe në Shanghai të Kinës shkaku kryesor i divorceve gjithnjë në rritje ishin pakënaqësitë seksuale të grave...

Alba ndjeu nëpër trup një ngrohtësi gjithnjë e më bezdisëse. Ideja se Renato mund të vinte befas dhe të hynte në dhomë, e tmerroi. Iu duk se nuk do të ishte e zonja për ta larguar. U ngrit me vrull, mbylli derën me çelës pastaj mori një kasetofon që e kishte blerë pak kohë më parë, vuri kufjet në vesh dhe u shtri rishtazi. Kishte zgjedhur një kasetë të Baljonit dhe muzika e tij sikur ia largoi disi mendjen nga gjithçka kishte bluar në kokë pak më parë.

Megjithatë, vonë në mëngjes, u zgjua për shkak të një ëndërre erotike tepër të çuditshme. Ndërsa Renato përgjonte pas një shkurreje, ajo dhe Vili bënин dashuri në mes të pyllit, mbi lëkurën e një ariu të murrmë. Papritur, Renato kishte shtënë që nga shkurrja me çifte, në çastet më të bukura. Gjuetarët e mallkuar, kishte thënë Vili me inat...

\* \* \*

Jëshumië larg shtëpisë, në një fëmijërishtë madhe të rrëfihuaf me pemë, ndodhej një bujtinë e vjetër dhe një stallë kuajsh. Ishin të shumtë klientët që vinin aty thjesht për të mësuar të

kalëronin. Ato ditë Alba kishte marrë nga Renato leksionet e para të hipizmit.

Ata hëngrën mëngjes në bujtinë, pastaj Alba u ngjit në një dhomë të ndërrohej. Veshi një palë streçe, një bluzë të ngushtë, mbathi një palë çizme të lehta, flokët i lidhi bisht dhe në kokë vuri një kasketë. Renato po e priste te fusha e hipizmit. Zgjodhën nga një kalë dhe Alba u mat të hipte. Por kali ishte tepër i lartë dhe nuk e fuste dot këmbën në yzengji. Renato u afroa për ta ndihmuar. Ajo ndjeu se si duart e tija e mbërthyen për beli dhe i dhanë një shtytje përpara.

Dolën nga fusha dhe morën përgjatë një shtegu që futej thellë në pyll. Kalëronin paralelisht, duke biseduar për botën e hipizmit dhe përdorimin e kuajve në kinema. Por, papritur, Alba ndjeu një dëshirë të papërmabjatur për të marrë revan.

- A bëjmë një garë? – pyeti.
- Ç' garë? – ia ktheu ai i hutuar.
- Unë po nisem para, ti përpiku të më arrish!

Ajo ia nguli kalit thembrat e çizmeve në brinjë dhe tërhoqi frerët fort. Kafsha hingëlliu njëherë gjatë, pastaj kërceu përpara me vrull. Alba u përkul, duke dashur të puthitej sa më mirë pas shpinës së gjerë të kafshës. Në fillim pati frikë, pastaj dëshira për të rrezikuar iu kthye në fiksim. Filloi të thërriste me një gjëzim anormal dhe të nxiste kalin që të vraponte më shpejt.

Renato u tmerrua.

- Alba, jo ashtu! Do të biesh! – filloi të thërriste duke e ndjekur pas. Por ajo nuk e kishte më mendjen tek ai. Çante nëpër shtegun e ngushtë dhe vetja i dukej si nëpër ata filmat me Far Uest. Rrezimit i trembej, por kishte një besim të verbër se një gjë e atillë nuk do të ndodhë.

- Alba, ndalu, për hir të Zotit! – thërriste Renato nga pas.

Brenda pak çasteve shtegu mori tëposhtë dhe sa vinte e po ngushtohej. Instiktivisht, kafsha filloi të ndjente diçka

dhe të fredohej. Alba ngriti sytë dhe pa se përballë ngriheshin shkëmbinj. Më tej ishte hon. Shtegu merrete një kthesë të fortë nga e djathta. Ajo klithi e tmeruaç dhe tërhoqi frerët me sa mundi. Kur arriti pranë shkëmbinjve, kali hingëlliu i trembur dhe u ngrit mbi këmbët e pasme. Alba humbi kontrollin, çizmet i dolën nga yzengjitetë, rrëshqiti dhe arriti të kapej vetëm me një dorë te jelet e gjata. Njëra këmbë iu ngatërrua te frerët. Kali u tremb edhe më shumë dhe po bënte çmos ta rrëzonte.

Por në ato çaste ia mbërriti Renato. Ai e mbërtheu kafshën për frerësh me dorën e djathtë, ndërsa me të majtën mbajti Albën. Ajo u lidh pas trupit të tij dhe sapo u çlirua nga pengesa e frerëve, e mori edhe Renaton me vete. Ranë të dy përtokë të shtrënguar pas njëri-tjetrit.

Alba u përmend dhe vuri re se tjetri ia kishte ngulur sytë i hutuar.

- Ishe përrallore, - tha. – Një amazonë.

Ajo u ngrit vrulltazi.

- Ti nuk më arrite dot, - ia ktheu duke buzëqeshur. – Megjithatë, më shpëtove. Do kisha thyer ndonjë brinjë.

- Në se tenton ta bësh edhe një herë tjetër, do të vritesh, - tha ai.

- Ndoshta.

Ata u ulën mbi shkëmbinjtë aty pranë, duke soditur një luginë të ngushtë që shtrihej poshtë.

- Do të doja të rrezikoja edhe unë një herë ashtu, - ia bëri Renato befas, duke lëshuar një gur poshtë në hon.

Ajo vuri re se tjetri ia kishte ngulur sytë në mëyrë të pakontrolluar. U shtir se po vështronte diçka poshtë në luginë.

- Vazhdojmë, - tha pastaj. – Kuajt po presin.

Pas një shëtitje të gjatë, nga mesdita, ata u kthyen në bujtinë. Përkëdhelën kuajt për herë të fundit, pastaj u

ndërruan dhe u ulën për të ngrënë. Restoranti i vogël, me një dekoracion mesjetar, ku gjithçka ishte e drunjtë, përfshи edhe gotat e verës, kundërmonte një aromë ngacmuese mishi të pjekur në zgarë. Dëgjoheshin ca këngë të vjetra gjenoveze. Një çift të moshuarish ishin lidhur për beli dhe po kërcenin në një shesh të vogël mes tavolinave.

Zoti im, mendoi Alba. Sikur jeta të ishte gjithmonë kështu!

Sartori, Renato dhe disa klientë të tjerë filluan të përplasnin duart për të shoqëruar çiftin që po kërcente. Ajo u bashkua me ta. Ndjeu dëshirë ta shijonte atë ditë të bukur deri në fund.

Një kamarier solli një damixhan me verë, pastaj tre pjata të mëdha, të mbushura me biftekë, djathë dhe disa lloje sallatash. Ndonëse po e gjerryente stomaku, Alba filloi të hante në mënyrë të përmbajtur. Druhej nga Sartori në çdo veprim. Si gjithmonë, zonja hëngri fare pak dhe doli në verandë. Nuk e duronte dot tymin e mishit të pjekur dhe tepërimin me zhurma.

Duke e nuhatur gjendjen e Albës, Renato ia mbushi gotën duke qeshur.

- Ha e pij, mos e çaj kokën! Çin-çin!

Alba e ngriti gotën e drunjtë dhe piu gjatë. Për dreq, i pihej, i hahej, i kërcehej. Ishte një ditë misterioze. Dalëngadalë vera e gjallëroi. Renato e vuri re atë detaj.

- A kërcejmë? – pyeti.

- Mirë, - pranoi ajo. – Por nuk dua muzikë gjenoveze.

Renato u afrua te një magnetofon i madh dhe ndërroi diskun. Lokali u mbush me tingujt e një violine, pastaj violina u shoqërua nga një benç. Ishte muzikë amerikane "kauntri" që i shkonte plotësisht atij mqedisi me stallën e kuajve dhe fushën e hipizmit pranë. Klientët u gjallëruan dhe filluan të thërrisinin.

Alba ndjeu prekjet e Renatos dhe vështrimet e tij që e

sulmonin kudo në trup. Ishte një situatë që ajo e njihte mirë. Vallëzimi krijonte vetiu një lloj intimiteti që një djalë mund ta shtynte fare lehtë në tundim. Në gjimnaz dhe fakultet ajo kishte patur gjithmonë sukses nëpër mbrëmjet e vallëzimit. Kishte patur raste që djemtë ishin grindur për një vallëzim me të. Provonte gjithmonë një miklim të ëmbël kur kujtonte fjalët e një shoku në mbrëmjen e maturës. Alba, je bombë fare, i kishte thënë ai. Do të doja të bija dëshmor duke kërcyer me ty...

Papritur ajo u pushtua keqazi nga një shtytje tinzare për të luajtur koketën me njeriun që kishte pranë. Pati një dëshirë të pafrenueshme për të parë se deri në ç' shkallë ai do të marrosej pas saj. Filloi të kërcente pa asnjë lloj kontrolli. Ishte veshur me një fustan të shkurtër e të hollë veror dhe çdo hedhje e trupit i zbulonte kofshët dhe e bënte gjoksin të tundej në mënyrë tepër provokuese. Përdredhjet e belit e detyronin Renaton t'i zhvendoste duart herë pas here për të mos lejuar që ajo t'i shkëputej. Ai ishte mekur plotësisht. Pas syzeve miopike pasqyrohej edhe më mirë një lloj dëshire e zbuluar mashkulli për diçka që i ka munguar prej kohësh.

- Je fantastike! – tha kur u ulën – Më ke çuditur vërtet.

Ajo e vështroi me një lloj inati të befasishëm.

- Ti çuditesh se si mund të kërcejë ashtu një shqiptare.

Apo jo?

- Unë u çudita me ty. Kaq.

- Ju italianët pandehni se ne vijmë nga xhungla. Kështu?

Ai hapi krahët në shenjë dorëzimi.

- Nuk doja të thoja aspak këtë.

Ajo piu disa gllënjka verë.

- Ju nuk do të na pranoni kurrë për të barabartë! Dhe kjo provon se vuani si komb nga kompleksi i inferioritetit ndaj të tjerëve që janë më para se ju. Këtë inferioritet fatal doni me çdo kusht ta shfryni ndaj nesh që erdhëm me anije nga

ferri komunist.

- Alba, të lutem! Unë kam kohë që e kam konstatuar se ti nuk je një femër e rëndomtë. Për mua kombësitë dhe rracat janë thjesht një konvencion i vendosur nga njerëzit. Të gjitha femrat janë njëlloj.

Ajo tundi kokën.

- Nuk është aspak ashtu!

- Ndoshta. Ky është mendim im.

Alba zgjati dorën dhe e preku në parakrah.

- Më fal, - tha. - U tregova arrogante.

- S'është nëvoja të kërkosh falje.

Ai ngriti damixhanin dhe rimbushi gotat.

Kur u ngriten, Alba u detyrua të mbështetetë në supin e tij. Vera i kishte rënë në kokë.

- Të lutem, - mërmëriti. - Nuk dua të më shohë zonja Sartori kështu.

- Mos u bëj naive, - ia ktheu Renato. – Është normale që njeriu të pijë një ditë, thjesht për qejf. Eja, po të çoj në shtëpi. Halla ime është e shoqëruar.

Alba hyri në dhomë. E mylli derën nga brenda me çels, por pas pak minutash u dëgjua një trokitje.

- Alba, jam unë, - foli Renato. – Kishe harruar kasetofonin në veturë.

Ajo hapi derën dhe e mori kasetofonin duke e falenderuar.

Vërtet erdhi për kasetofonin, pyeti ajo veten. U zhvesh dhe para se të shtrihej u vështrua te një pasqyrë e madhe pranë krevatit. Vetja iu duk ndryshe. Koketë dhe gjysmë-prostitutë, mendoi. Iu kujtua një bisedë që kishte bërë kohë më parë me Gertën, shoqen e vet hebreje, në lidhje me prostitucionin fizik e shpirtëror të njerëzve. Tirana ishte pa drita. Nëpër rrugë dëgjeshin krisma dhe sirena makinash policie. Te çdo femër fle në mënyrë letargjike koketa dhe prostituta i kishte thënë Gerta. Është instiki i stërlashtë i

kopesë, kur femra ishte e të gjithëve dhe e askujt. E fortë është ajo femër që u nuk i lë të zgjohen qoftë koketën qoftë prostitutën.

Koketë dhe prostitutë lindesh apo bëhesh gjatë jetës e kishte pyetur Alba. Gerta kishte mbrojtur idenë se e tillë lindesh. Jo, i kishte thënë Alba, e tillë bëhesh gjatë jetës. Prostitutat dhe koketat në shumë raste janë më të forta dhe zgjohen nga letargja pa u dhënë leje. Pastaj bëjnë ligjin. Njeriu në përgjithësi është i dobët dhe e ka në gen vesin, të keqen. Prishja e letargjisë varet nga një mori rrëthanash në të cilat vihet femra ose edhe mashkulli, në një moment të caktuar.

Gerta e kishte vështruar e menduar nën dritën e zbehtë të një qiriri. Ato kohë Alba ishte në një gjendje shpirtërore krejt të lëshuar. Nga Franca kishte marrë atë lajmin e ftohtë. E pra, kjo provon se teza ime është e vërtetë, kishte këmbëngulur Gerta. Koketëria dhe prostitucioni i njërzëzve janë në shpirt dhe shpirti lind së bashku me njeriun. Jo, kishte këmbëngulur Alba, njeriu e zgjedh vetë shpirtin e tij, kur fillon kupton botën dhe jetën. Ai zgjedh atë shpirt që i pëlqen, pastaj ia përshtat trupit të tij.

Ato ishin futur në një debat pa krye në lidhje me trupin e shpirtin, të mirën e të keqen.

Me sa duket, dëshira për të qenë koketë e prostitutë është futur në listën e të drejtave të njeriut, ia kishte bërë Gerta në fund, e lodhur. Morali është relativ. Ajo që për ne të dyja mund të duket e pamoralshme, për shumë të tjera mund të jetë esencë e moralit. Varet nga sistemi i referimit. Më thuaj, cili duhet marrë tanë e tutje si sistem referimi i vlerave morale në këtë shoqëri të trullostor?...

Alba ia nguli sytë fytyrës në pasqyrë. Sot nuk është e vështirë për të gjetur një femër, iu kujtuan fjalët e Vilit, të thëna gjatë aventurës biblike me anijen panameze, por një njeri.

Po ekzagjeroj, tha pastaj me vete. Nuk bëra asgjë të keqe. Vetëm e tepërova me atë verën. Është i gjithi faji e verës. Po të mos kisha pirë...

Ajo u shtri dhe fjeti pas pak.

\* \* \*

Kur u zgjua, vuri re se kishte fjetur afro tri orë. U vesh me ngut dhe trokiti në dhomën e Sartorit. Por në shtëpi nuk ndodhej askush. Renato ia mbarriti pas ndonjë gjysmë ore. Ai ishte jashtë mase në formë. E ftoi për një kafe në verandë. Harron se mua më ka dalë vera, mendoi Alba. Më duket se erdhi dita t'i tregojmë kufinjtë njëri – tjetrit.

Me t'u ulur në verandë, ajo filloi të sillej ftoht. Renato filloi të kujtonte vrapinin e llahtarisor me kalë, por Alba reagoi sikur të ishte fjala për ndonjë ngjarje që s'kishte fare lidhje me të. E piu kafenë duke vënë disa herë në dukje se i dhimbte koka.

- Një shëtitje në pyll do të të bënte mirë, - tha ai.
- Jo, - ia ktheu ajo. – Më duhet t'i shkruaj një letër të gjatë të fejuarit.

Ai u pështet në kolltuk, duke lëshuar një "Ah, të fejuarit" neutrale. Ajo priti që tjetri të pyeste diçka më shumë, por më kot. Gjatë atyre ditëve Renato nuk i kishte bërë asnjëherë pyetje për detaje intimë, por Alba e kishte nuhatur se ai ishte fare mirë në dijeni të marrëdhënieve të saja me Vilin.

- A mund t'ju bëj një pyetje pak... bezdisëse? – tha.
  - Sigurisht, - ia ktheu tjetri. – Të lutem mu drejto me ti. Alba nuk e vështroi.
  - A ke ndonjë vajzë? – pyeti.
- Renato hapi krahët duke lëshuar një psherëtimë të zgjatur.
- Si të të them? Në këtë moment ndoshta jo. U grindëm para se të nisesha për pushime. Ajo nuk e kuptonte pse doja

të vija vetëm. Por edhe unë nuk dija si t'ia shpjegoja. Ishte një situatë pak e çuditshme. Të lutem, i thashë, kam nevojë të rri ca kohë vëtëm. Kaq.

Vetëm, mendoi Alba me një nënqeshje të brendshme. E kuptoi se ishte futur në një situatë shumë më delikate nga sa kishte pandehur. Nuk e kishte pritur atë sinqueritet të tjegrit. Ishte një sinqueritet me një nëntekst tepër të lexueshëm. Pse ai duhej t'i tregonte se qe grindur me të dashurën e tij?

- E ndjej se kur të kthehem, do të ndahemi, - vazhdoi Renato.- Kur u takuam për herë të fundit, ajo mu duk ndryshe. Nuk më tërhoqte më si më parë. Ishte e çuditshme.

Alba e kuptoi se e kishte dreqosur.

- Sikur... të largohesha? – foli pa e ngritur kokën. Por tjetri e gozhdoi duke thënë me një ton lutës:

- Do të doja të mos më lije vetëm. E di fare mirë se ti nuk ke për të shkruar asnjë letër. Unë e kuptoj pozitën tënde. Mos u shqetëso për këtë.

Alba bëri një gjest pranimi dhe e kuptoi se nuk kishte asnjë të drejtë ta fyente.

- Që të flas sinquerisht, nuk jam ende në gjendje të konceptojë psikologjinë e një italianni, - tha. - Gjithësesi, do të doja të të falenderoja për gjithçka keni bërë këto ditë. Më duket se e keni tepëruar me shpenzime.

- As mos e mendo këtë!

- Sikur të të afroja unë një darkë?

- Në asnjë mënyrë!

- Unë punoj, - nguli këmbë ajo. – Zonja Sartori më paguan.

- Okej, një birrë do ta pi ja me qejf.

Ata e mbyllën ditën e fundit në mal në mënyrë miqësore. Të nesërmen u larguan. Renato drekoi në Vilën e Trëndafilave. Pasdite u nis për në Milano. Alba e shoqëroi deri te porta e madhe e oborrit.

- Do të doja që ndonjë ditë të vije për të vizituar Milanon,

- tha ai.

- Ta, mendoj, – ia ktheu ajo.

U ngjit në dhomë duke pritur që telefoni të binte nga çasti në çast. Por Vili mori vetëm nga mbrëmja.

- Alba, paske ardhur?! – thirri. – Sonte natën do të vij atje. Lëre hapur portën e prapme të vilës. Kupton? Për të tjerat mendoj unë. Do të vij! Nuk duroj dot!

Ajo vështroi pérreth e hutuar.

- Prit, është me rrezik, - tha. – Ku je? Ndoshta dal unë...

Por ai e uli receptorin, duke thënë "Më prit". Ajo vështroi rishtazi pérreth, duke e mbërthyer kokën me duar. Filloi të mendonte pasojat që do të kishte sikur Vilin ta gjenin në vilë ose edhe sikur ta shikonin duke hyrë. Po sikur ndokush ta pikaste duke kapërcyer gardhin dhe të rjoftonte policinë? Po sikur t'i telefonin Sartorit në mes të natës? Iu duk se Vili e kishte detyruar qëllimi ishtë të vihej në pozitën e bashkëfajtores. Mesiguri do që të më dëbojnë nga puna, mendoi me inat. Është bërë xheloz si budalla për Renaton.

Por më vonë, kur mendoi se ai kishte tërë ato ditë të gjata që e priste i vettuar, pa marrë asnje letër, asnje telefonatë, e kuptoi se Vili duhej të ishte në një gjendje gati të pakontrolluar. Më do, tha me vete. Është gati të bëjë çdo lloj marrëzie.

Sartori ndoqi ritualin e saj të zakonshëm. Ra për të fjetur herët. Alba e përgjoi gjatë përfundimit të sëmundjes se ajo nuk do të ngrihej më, pastaj u ngjit në dhomë përfundimisht. Derën e prapme të vilës e kishte lënë hapur, duke u shtirë para vetes se kishte harruar ta mbyllte që në drekë. Por në vend që të qetësohej, filloi të dridhej e tëra nga frika. Po ta merrte vesh, Sartori do të mendonte pa dyshim se ajo ishte një aventuriere, se ishte mësuar edhe më parë me aventura të atilla. Largimi nga vila ishte i sigurtë. Guvernantja ia kishte bërë të qartë se në atë vend pune duhej të tregohej tepër serioze.

Për t'u larguar disi nga ato mendime, vendosi t'u shkruante një letër prindërve, por nuk mundi. Atëhere vendosi t'i shkruante Gertës, t'i tregonte se si i kishte kaluar pushimet lart në mal dhe kishte mësuar të kalëronte. Pse jo, do t'i tregonte edhe tmerrin që po hiqte duke pritur Vilin.

Shkroi nja tri faqe me një shkrim tepër të keq, pastaj doli dhe u ul te shkallët, përballë portës së pasme të vilës. Po afronte mesnata.

Dera u shty ngadalë, si nëpër ata filmat me tmerre. U duk koka, pastaj trupi i Vilit. Ai e kërkoi me sy, zgjati duart, e preku, pastaj filloi ta përqafonte e puthte pa e përmbajtur dot mallin. Nuk kishte fare frikë. Gati e mori në krahë deri në dhomë. Je i çmendur, i pëshpëriste ajo, më ler të qetësohem. Mos të pa njeri ku hyre... policët... karabinierët...

- Në Itali s'të arrestojnë për dashuri, - foli ai duke u zhveshur. - Ky është vendi i dashurisë.

Ajo u dorëzua dhe e trembur vazhdoi të priste të gjitha sulmet e tija. Ishte një etje që e tmerroi shumë më tepër se pasojat që mund të vinin nga Sartori. Krahët e tij e shtërgonin si me ankth, si me alarm, sikur ai trembej se mos ajo i ikte. Puthjet e tij e përvëlonin kudo.

- Më fal, - psherëtiu Vili në fund, duke pështetur fytyrën mbi barkun e saj. – Nuk di se si më erdhi. Nuk mundja të duroja dot. Nuk mund ta imagjinosh si të kam pritur. Kam qenë shumë i mërzitur, vetëm. E kuptoj... nuk dua që për shkakun tim...

Ajo i përkëdheli flokët.

- Do Zoti nuk ndodh gjë! – pëshpëriti.

Ai vazhdoi t'i tregonte për atë periudhë që kishin kaluar larg njëri – tjetrit. Ndërsa Alba ia përshkroi pushimet në mal thatë, si një angari që ajo qe detyruar ta kalonte për shkak të Sartorit.

- Nganjëherë më duket se Sartori të ka marrë peng, - tha

ai papritur.

U ngrit dhe vështroi nga deti. Sipërfacja e tij e lëmuar shkëlqente nën një hënë të zbehtë.

- Je një peng i privilegjuar. Sa bukur duket bota që këtu! O Zot, çfarë kryevepre!

Alba u përpoq t'ia largonte mendjen nga ajo temë. Frika e ndonjë njoftimi për policinë apo karabinierët i kishte dalë disi. Iu var atij në qafë dhe filloi ta puthte e shtërmgonte pas vetes, duke dashur që aktin tjetër të dashurisë ta shijonte edhe më shumë.

Ata i mori dremia në krahët e njëri – tjetrit rreth orës 4 të mëngjesit. Kur Alba u zgjua nga lehjet e një qeni, vuri re se jashtë kishte zbardhur. Ajo e shkundi Vilin e trembur. Ai u ngrit, vështroi njëherë përreth, pastaj filloi të vishej me ngut.

- Herën tjetër do të vij unë te ty, - i foli ajo, ndërsa ai doli nga porta. Alba e ndoqi me sy deri sa kërceu gardhin. Për disa minuta u dëgjuan të lehura qensh, pastaj gjithçka ra në qetësi. Ajo u kthyte në krevat, por nuk mundi të flinte më. Padashur, dora i ndeshi në dysheme një bluzë të hollë pambuku me mëngë të shkurtëra. Nga ngutja, Vili kishte harruar ta vishte. Ajo e mori, e përkëdheli njëherë, pastaj e futi mes ndërrresave të saj, thellë në sirtar.

Tërë mëngjesin e paraditen priti me frikë ndonjë reagim të Sartorit apo telefonatë, por me sa dukej Vilin e kishte ndihmuar fati.

Jemi të çmendur të dy, mendoi ajo. Plotësisht të çmendur.

## 8.

Valët e buta nuk arrinin të përplaseshin në shkëmbinjtë e bregut, vetëm sa i ledhatonin ata, pastaj tërhiqeheshin si duar të penduara.

- Serxhos i pëlqente çmendurisht gjoksi im, - psherëtiu Sartori. – Ai kthehej nga lundrimet e gjata dhe betejat e rrezikshme me një uri prej ujku. E puthte dhe kafshonte gjoksin tim si i marrë. Ana, këto janë dy mina të bukura, por tepër të rrezikshme, më thoshte. Ato mund të hedhin në erë edhe destrojerin tim.

Alba kafshoi buzën. Ato ditë zonja plakë sikur kishte lajthitur. E kishte kapur një valë kujtimesh erotike pa fund. Nga ndrojtja, ajo e modifikoi fjalinë e tretë në “E puthte dhe përkëdhelte...”. Por:

- Lexoje këtë frazën e fundit, - tha Sartori pas pak.

Ajo u detyrua ta lexonte frazën siç ishte diktuar, duke u skuqur e tëra.

Herën e fundit, kur kishte ardhur i etur pas mesit të natës, Vili kishte bërë të njëjtën gjë me gjoksin e saj. Vonë, pas ikjes së tij, ajo kishte parë si e trembur një njollë në krahun e djathtë, të verdheme në mavi. Kishte provuar një ndjenjë të fortë e të çuditshme malli.

- Thënë mes femrash, - vazhdoi Sartori, - meshkujt e tipit të Serxhos kanë një frikë subkoshiente se mos tradhëtohen, braktisen, humbin ato simbole të feminilitetit që i adhurojnë aq shumë. Por janë meshkuj me ndjenja të forta dhe

dashurojnë me gjithë zemër.

Alba kishte ulur kokën që tjetra të mos arrinte ta shikonte në fytyrë. Ndërsa Sartori u përhumb në kujtime, ajo gjithashtu filloj të imaginonte takimin e nesërm me Vilin, në shtëpinë e tij në Gjenovë. Kishte kaluar mesi i shtatorit dhe që nga ajo aventura e mesnatën nuk ishin takuar dot më.

Ai kishte vazhduar të kërkonte punë dhe para disa ditësh kishte filluar si ndihmës i një mjeshtri që shtronte pllaka. Italiani, një barez makut që punonte si i tërbuar, i kishte premtuar pagë të mirë dhe i kishte dhënë në dorë gjysmë milioni. Fillimisht, Vili ishte i kënaqur, ndonëse tjetri e shfrytëzonte tërë ditën. Megjithatë, ia kishte frikën se mos ai e mashtronë. Barezi kishte një fytyrë tepër të dyshimtë.

Befas Sartorit i erdhi rishtazi ndër mend motivi erotik i mëparshëm.

- Ai sikur u trembej minave dhe gjithçkaje tjetër shpërthyese, - psherëtiu. – Sikur e ndjente që anija e tij do të shkatërrrohej nga një silurë nëndetëseje.

Ndërsa po ktheheshin për në vilë, zonja pyeti:

- Të ka telefonuar Renato këto ditë?
- Po, - u përgjigj Alba. – Disa herë.
- I poshtri! – ia bëri zonja me një qortim të ëmbël. – Për mua është kujtar vetëm një herë.

Alba nuk diti ç'të thoshte. Sa herë që përmendej Renato, vihej në një gjendje trazimi të përgjithshëm.

- Është djalë i mirë, - vazhdoi Sartori. – Ka shpirt të ndjeshëm. Ka ngjarë nga mua.

- Është e vërtetë, - pohoi Alba.
- Eh, Renato! Ka mbetur trashëgimtari im i vetëm në këtë botë. Kështu erdhijeta! E dua sepse ai ka një prirje të fortë drejt një jete të rregullt familjare. Nuk është aventurier. Më kujton burrat e dikurshëm italianë. Burrat e sotëm po

prishen. Janë bërë si amerikanë, si nëpër ato telenovelat ku heronjtë bukuroshë i marrin njeri – tjetrit gratë e dashnoret.

Alba u sikletos edhe më tepër nga ato fjalë. Pse duheshin thënë pikërisht atë ditë dhe nga zonja Sartori? Po trashë-gimia, ç'hynte?

Arriti të shkëputej nga ato mendime vetëm kur gjeti në vilë një letër të dërguar nga Gerta. Ishte një letër e gjatë ku ajo i tregonte për punën në një piceri të quajtur "Mëkate me salcë" dhe lidhet me një djalë të quajtur Arnold, i cili ishte picashpérndarës. Ashtu si edhe ajo, paraditeve, ai ndiqte fakultetin e Sociologjisë. Është tip romantiku, shkruante Gerta, i pëlqen të bëjë surpriza me lule dhe fjalë të ëmbla shkruar mbi pica me shirita salce. E di ç'më kishte shkruar një ditë? "Gerta, je një yll ende i pazbuluar". Picën e shkruar ma kishte dërguar në shtëpi të paketuar dhe të lidhur me fjongo. Nuk mund ta imagjinosh sa jam lumturuar atë natë. U përpoqa t'i bëja edhe una një surprizë. I dhashë adresën e një apartamenti disa kate poshtë timit ku nuk banon njeri. Ka një kërkësë për një picë të çuditshme me sheqer sipër, i thashë. Ja, e ke gati. Ai nuk dyshoi. Do jenë kinezë, tha. Por te dera e apartamentit gjeti një letër ku i kisha shkruar: "Arnold, je një yll i zbuluar tani vonë". Kur u kthyesh në piceri, ai fluturonte nga gjëzimi dhe vetëm qeshte. E kishte lënë picën te një shoku i vet dhe e hëngrëm aty të dy, vonë, pasi dolëm nga puna. Pica me sheqer ishte një lemeri, megjithatë ne e hëngrëm. Pastaj ai më puthi. Alba, ishte një paraqës...

Albës iu mbushën sytë me lotë. I erdhi mirë që Gerta ishte e lumtur dhe po i ecte në të gjitha drejtimet. E lexoi letrën rishtazi, duke provuar të njejtat emocione të forta.

Pasdite shkoi në një librari të madhe në Reko dhe bleu një diksioner të gjuhës italiane. Vili kishte kohë që e ëndërronte një diksioner të atillë. Sa të bëhem me para, do ta blej, i kishte thënë ai një ditë kur kishin hyrë në një librari në

Savona. Por deri para se tē largohej nga serrat e Benarrivos nuk e kishte blerë dot. Libri kushtonte gati sa tri ditë pune tē tijat.

Në dhomë, ndërsa po e mblidhete fjalorin me një gazetë, asaj iu kujtua bluza e bardhë e harruar prej tij atë natën e aventurës. E nxori nga sirtari me mendimin që t'ia shpinte Vilit, por pastaj u lëkund. Nuk kishte asnjë lloj kujtimi prej tij. Me duar tē dridhura e ngjeshi përsëri bluzën nën ndërresat e saja.

Ajo e kishte rjoftuar Sartorin se tē shtunën në orën 11 donte tē shkonte në Gjenovë për një konsultim te specialisti i veshkave. Pas orës 10 e deri në mbrëmje je e lirë, i kishte thënë zonja me një pamje tē padëshifrueshme në fytyrë. Por Sartori nuk ishte nga ato që gënjejheshin lehtë. Ajo kishte aftësinë t'i kapte situatat fluturimthi, ndonëse dukej si e përhumbur. Në fillim Alba kishte dashur t'i thoshte copë se donte tē kalonte një ditë me Vilin, por pastaj qe frenuar. Gjatë tërë asaj periudhe Sartori nuk e kishte pyetur kurë përmarrëdhëniet me Vilin. Dukej sikur e kishte harruar fare. Pas kthimit nga mali, kur Alba i qe lutur që tē interesohet për ndonjë punë tjetër, zonja kishte bërë një gjest tē lehtë habije. Ah, nuk është më te serrat e Benarrivos, kishte thënë. Të shohim për ndonjë vend tjetër. Albës i qe dukur e shtitur habija e saj.

\* \* \*

Alba hyri në një rrugë tē ngushtë me kalldrëm, mes ca godinave tē vjetra ngjyrë gri, duke mbajtur në dorë pusullën ku kishte shkruar adresën e Vilit. Rruga qe e mbushur me shitës ambulantë, kryesisht zezakë shtatlartë, që shisnin shalle, çorape dhe lloj – lloj çikërrimash tē tjera. Sinjorina, vu kumpra, pyesnin ata duke treguar mallrat. Blej një çantë,

është lëkurë origjinale, gati iu lut një zezak me flokët bërë bukle – bukle si të Bob Marlit. Jo, falemnderit, ia ktheu ajo duke çarë mes njerëzve. E kuptoi pa vonesë se Vili kishte përfunduar në një nga lagjet më të varfëra të qytetit.

E gjeti pallatin dhe hyri nëpër ca shkallë të pista duke vështruar në bisht të syrit se mos e ndiqnin. Shtëpiq e Vilit ishtë në kat të tretë. Ajo qëndroi para derës, në një korridor të errët që binte era myk e lagështi. Vende – vende muret ishin rrjepur. Trokiti disa herë, pastaj qëndroi në mes të korridorit duke vështruar përreth e hutuar. Sa po matej të zbriste prapë shkallët, kur Vili ia mbërriti me vrap. Ishte me rroba pune, me një palë këpucë me qafa përlyer me llaç. Qe mbytur në pluhur e djersë.

- Alba, paske ardhur?! – thirri duke hapur krahët. Ajo u struk mes krahëve të tij, duke nuhatur aromën e trupit të djersitur e të pluhurosur. Ishte një erë e këndshme, era e njeriut që donte. Vili hapi derën dhe ajo e pa veten në një dhomë pothuaj të zhveshur, me tavan të lartë, të palyer prej vitesh. Kishte vetëm një aneks të ngushtë për të gatuar. Ai i kërkoi leje për të bërë një dush, duke e puthur disa herë radhazi fluturimthi. Ndërsa mbeti vetëm, Alba filloi të hetonte rishtazi gjithçka përreth. Vihej re leht mijedisi ku jetonte i vetëm një djalë, të cilit nuk i del koha as për t'u ngopur me gjumë. Në aneks ishin lënë pa larë disa enë. Kjo pra, qenka shtëpia, mendoi si e trembur. Deshi t'i hynte ndonjë pastrimi të lehtë, por Vili ia mbërriti pas pak dhe e ngriti peshë duke thirrur i lumtur.

Pas ndonjë ore ata po përpinqeshin të dy të përgatisnin një drekë ceremoniale, por Alba ende nuk po mësohej dot me ato kushte. Vili e vuri re zhgënjimin e saj të maskuar keqazi.

- Të lutem, shikoje këtë garsonierë sikur vjen nga Shqipëria dhe jo nga Vila e Trëndafilëve, - tha. – Është një

zgjidhje e përkohshme. Sapo të futem në një punë të rregullt, do të gjej një vend më të mirë.

- Mos u shqetëso, - ia ktheu ajo. – Unë nuk jam rritur në Vilën e Trëndafilëve.

Pasi hëngrën, Alba nxori nga çanta pakon që i kishte sjellë. Ai mori diskionerin në duar sikur të ishte ndonjë thesar.

- Alba, je shumë e mirë, - mërmëriti. – Vetëm se... është një dhuratë shumë e shtrenjtë. Të kam bërë edhe unë një dhuratë, nuk kam shpenzuar kaq shumë.

Vili nxori nga një sirtar një pako të vogël ku qe mbledhur një kapëse flokësh. Ajo u ngrit, qëndroi para pasqyrës dhe e vuri në flokë.

- Të pëlqen? – pyeti ai i pasigurtë.

- Deri sa e ke blerë ti, është shumë e bukur, - ia ktheu ajo dhe e përqafoi.

Ata ndjenjën bashkë, ngjitur në krevatin e ngushtë, deri vonë pasdite. Kur Alba u vesh dhe filloi të krihej para pasqyrës, Vili iu afroa nga pas dhe e shtërmgoi mes krahëve sikur nuk donte ta linte të ikte. Ajo e kupto gjuhën e duarve dhe buzëve të tija.

- Po rri edhe ca, - tha.

Kur dolën në korridorin e madh, gjysmë të errët, Alba klithi lehtazi. Dalloj një palë dhëmbë të bardhë, pastaj fytyrën e një afrikani që buzëqeshte,

- Alba, ky është miku im Ngea, nga Kameruni, - tha Vili.

- Banon ngjitur me garsonierën time.

Alba e përshëndezi zezakun duke buzëqeshur miqësisht.

- Albanezi të mirë – tha tjetri. – Jo racista. Ju përshëndes!

Ata zbritën shkallët dhe morën për nga stacioni i trenit.

- Alba, po sikur të të gjeja ndonjë punë, a do të vije këtu?

- tha Vili papritur.

- Çfarë pune? – pyeti ajo.

- Ti e di shumë mirë ç'punë bëjnë shqiptarët në Itali.

- Të shohim. Përpiqu njëherë.

Ai i shtërngoi dorën.

- Kështu jemi larg. Nuk takohemi dot më shumë se një herë në javë. E kupton ç'do të thotë një javë apo jo?

Edhe ajo iu përgjigj me një shtërngim dore.

U ndanë në stacion, duke lënë një takim për të shtunën e ardhshme në Pieve Ligure. Alba zuri vend në një ndenjëse pranë drifores. Deri sa mbërriti në stacion, mendoi se si do t'ia bënte po sikur Vili t'i gjente punë në ndonjë rrobaqepsi apo fabrikë. Ndjeu pasiguri se nuk do të përshtatej dot. S'do të kishte dhomë komode, ushqime të zgjedhura, shëtitje me "Jaguar", paradite të qeta nëpër bare dhe veranda buzë detit.

Por pastaj mendoi se nuk ishte më e mirë se të tjerat dhe se do të mësohej me çdo lloj pune. Komoditetet nuk i kishte njobur më parë dhe po t'i humbiste, nuk do të ishte ndonjë fatkeqësi e madhe.

U kthye në vilë duke u përpjekur të dukej në humor.

- Hë vogëlushe, si shkoi vizita? – pyeti Sartori.

- Ishte një shqetësim kalimtar zonjë. Mjeku më këshilloi të pij shumë lëngje, - tha Alba duke e nuhatur se po e tradhëtonte veten. Nuk kishte qenë kurrë e aftë në jetën e saj për të gënjer.

- Gjysma e së keqes, - ia bëri Sartori. - Lëngje kemi plot.

Sigurisht që e di fare mirë se kam qenë me Vilin, mendoi Alba.

- Ah, mos harroj, - vazhdoi zonja. – Të kërkoi Renato. Kishte diçka për ty.

- A mund ta telefonj këtu, nga vila?

- Sigurisht vogëlushe. Ti je e shtëpisë. Telefono ku të duash e kur të duash.

- Faleminderit! – tha Alba duke u skuqur. Që gjatë qëndrimit në mal Sartori kishte filluar të tregonte ndaj saj një dashamirësi të veçantë dhe disa herë i kishte vënë në dukje

se ishte si e shtëpisë. Nxori nga çanta një kartvizitë të Renatos dhe formoi numrin e telefonit të tij.

- Alba, doja të vija nesër ardej, - tha Renato. – A mundesh të më shoqërosh?

Ajo u kap e papërgatitur. Heshti gjatë.

- Sikur ta linim për të dielën tjetër? – foli, duke munduar të shprehte keqardhje.

- Si të duash, - tha tjetri.

- Je i sigurtë se nuk të mbeti hatri?

- Jo, të siguroj.

Ai përshëndeti në një mënyrë tepër intime për njohjen që kishin dhe ajo e uli receptorin e hutuar. Atje në banjo, nën goditjen e ujit të ngrohtë, mendoi rishtazi se nuk kishte mundësi që Renato të luante teatër. Ajo ia kishte bërë egërsisht të qartë natyrën e vet dhe ai ishte aq i zgjuar sa për të kuptuar se çdo tentativë për të abuzuar, do t'i kushtonte. Pastaj, ai nuk dukej nga ato natyra që abuzonin. Tipave të atillë u lexohej fare leht në sy ajo që kërkonin.

Pra, s'ka dyshim që është dashruar dhe dreqi e mori këtë punë, ia bëri ajo duke tërhequr peshqirin me inat. Dhe një Zot e di se ç'bën një italian kur dashurohet, dhe unë do të futem në telashe, dhe... dreqi i mori të gjitha! Ajo e përplasi peshqirin e lagur për tokë duke mos ditur si të qetësohej.

\* \* \*

Deri të dielën tjetër, të njejtat mendime vazhduan ta ngacmonin kohë pas kohe deri sa iu duk se po e tepëronte duke e futur veten në situata dramatike joreale.

Pas mëngjesit të ngrënë bashkarisht, Sartori vështroi njëherë jashtë, pastaj foli me një ton ankues:

- Bën shumë vapë. Sot nuk po dal. Ju mund të vazhdoni të dy. Renato, sikur ta çoje Albën sot në Porto – Fino. Alba,

të pëlqen?

- Për mua është njëlloj, - tha ajo.

U nisën me veturën e Renatos

- Ndonjë të re nga ty? – pyeti ai për të hapur bisedë.

E reja është se unë jam tinzare, foli ajo me vete. Dje nuk i tregova njeriut që dua se sot do të dilja me ty. Doja t'i hapesha, t'i kërkoja ndihmë, por nuk munda. Ishte një sjellje e poshtër. Edhe dashuri nuk bëra si përherë. Mesiguri, nga që ndjehesha e pasinqertë. Kur ai iku, u pendova, por ishte vonë. Hë, doni të re më interesante?

- Alba!

- Ah, të gjitha të vjetrat, - u përgjigj ajo pa qejf. – Po nga ty?

- Kanë ndryshuar shumë gjëra, vrullshëm, ja si kjo kthesë.

U ndava me të fejuarën. U grindëm keqazi.

- E pse?

- Nuk jam në gjendje ta dua më. Më nervozonte prania e saj, nuk e duroja dot kur fliste. Kur ajo më kërkoi arsyen e ftohjes, nuk isha në gjendje t'ia shpjegoja. Sigurisht, ajo dyshoi për ndonjë vajzë tjetër. Natyrisht, nuk më besoi.

- Gjithësesi, janë intimitete që mund të mos m'i kishe treguar. Jo çdo gjë që mund t'u tregohet njerëzve të huaj.

Ai ngriti dorën vrullshëm dhe rregulloi syzet miopike mbi hundë.

- E huaj? Ti? Unë nuk të konsideroj më të tillë.

Alba hodhi flokët mbi gjoks në mënyrë që fytyra të mos i dukej. Vërtet është grindur me të fejuarën apo e ka këtë detaj një trillim për të më mikluar, pyeti veten. Për të më treguar se për mua u nda nga e fejuara e tij? Ajo ndjeu brenda vetes atë dëshirën tinzare për të luajtur koketën, si atë ditë në mal, te bujtina e vjetër tip Far – Uest. Pra, nuk paska qenë faji i verës, tha e tmerruar. Edhe tani që jam e kthjellët, diçka më shtyn për ta robëruar këtë njeri, për të parë se si ai

do të më lutet. Pse vallë? Ç'pres prej tij?

Pasi lanë veturën në një shesh të vogël, ata bënë një shëtitje përgjatë skelës së gurtë të Porto – Finos, të ngritur bregut të gjirit të vogël, pastaj u ngjitën lart, te një kishë e bukur.

Duke ndjekur një rruginë të ngushtë, të shtruar me gurë, dolën te godina e bardhë e një fari, në skaj të kepit shkëmbor që kufizonte gjirin. Si edhe shumë turistë të tjerë, u ulën mbi një bordurë të gjerë betoni, nga ku deti dukej si arenë gjigande amfiteatri.

- Që një ditë të mos zhgënjejesh, mos u mbështet shumë në shoqërinë time, - tha befas Alba tepër ftoht.

- Në çfarë sensi? – pyeti Renato me një mpirje të lehtë.

- Në sensin që unë mund të iki një ditë nga zonja Sartori dhe nuk mund të më gjesh dot.

Tjetri tundi kokën vrulltazi.

- Jo! Alba, ti ke nevojë për miq italianë. Nuk duhet të ikësh nga Sartori. Këtujeta nuk është e lehtë, sidomos për një vajzë.

Ajo zgjati instiktivisht dorën dhe e uli në shenjë pajtimi mbi supin e tij.

- Renato, unë nuk jam mosmirënlohëse, - tha. – E vlerësoj dashamirësinë tënde dhe të zonjës Sartori.

- Më vjen mirë për këtë, - foli ai i lehtësuar.

Nga mesdita ai e ftoi të hanin në një restorant, por ajo tha se do të hante vetëm një picë napoletane dhe do ta paguante vetë.

- Dakort, - tha Renato. – Edhe unë po marr një napoletane si ty.

Pjesa tjetër e ditës, deri para largimit të tij, kaloi pa përsëritjen e ndonjë situate tjetër të vështirë. Ndërsa po nisej, Renato i kujtoi premtimin që ajo i kishte bërë për të vizituar një ditë Milanon.

## 9.

Deti e kishte humbur shkëlqimin e dikurshëm të verës. Peisazhi po zbehej. Ishte mes tectori. Alba vështronte nga dritarja e trenit krejt e mpirë. Po kthehej nga Gjenova pa mundur të çlirohej dot nga pamja e dëshpëruar e Vilit. Frika e tij e vjetër qe provuar. Barezi i pllakave ishte zhdukur pa i dhënë 2 milionë lireta. Kishte zbritur poshtë në Jug dhe andej s'kishte burrë ta gjente. Vili e kishte denoncuar në Inspektoriatin e Punës dhe në Policinë Financiare, por shumë shpejt i kishte humbur fare shpresat. Një burokrat i Inspektoriatit të Punës i kishte thënë me ton prej moralisti: "Ju të huajt nuk duhet të bini viktima. Mos pranoni të punoni në të zezë".

Alba qe tmerruar kur kishte hyrë në dhomën e tij. Kishte gjetur tym, rrëmujë, një kanoçe salce mbushur me bishta cigaresh, një tenxhere të nxirosur me ca makarona të pangrëna brenda. Pas afro dy vjetësh, ai kishte filluar të tymoste rishtazi. Duart i binin era duhan. Kishte harruar të qetehj, të rruhej. Albës i qe dukur tmerrësisht i dobësuar, i lodhur, i zhgënjer. Ku do të mbytet nëse nuk gjen dot punë tjetër, kishte pyetur veten ajo e alarmuar. Duke përfituar nga dalja për të derdhur një qese me mbeturina, qe futur në një shitore ushqimesh aty pranë dhe kishte blerë ca fruta e mish. Kishte gatuar biftekë me patate dhe Vili kishte ngrënë i uritur. Më jep një të puthur, kishte thënë kur kishte mbaruar, më shumë nuk mundem. Ua fala shpirtin mobiljeve. Bota nuk mbaron nesër, ia kishte kthyer ajo duke u skuqur.

Dy ditët e fundit ai kishte transportuar mobilje dhe orendi shtëpiake. Ngarkuar si ata bartësit e mjerë të ekspeditave të dikurshme afrikane, kishte thënë. Ishte një sforcim nga dëshpërimi. Më duheshin para për të paguar qeranë e nëntorit. Nëse ke nevojë për para, të jap unë, i kishte thënë ajo. Jo, kishte gënjer ai, më kanë mbetur edhe ca. Pa m'i trego, kishte këmbëngulur ajo. Vili nuk kishte guxuar ta vështronë. Alba, po mbeta keq, do të të kërkoj ndihmë, kishte thënë.

Ajo ishte larguar nga garsioniera e hutuar. Më fal, e shikoj që u trembe, kishte folur ai si fajtor. Gjithë kjo mesele erdhi për shkakun tim. Jam matuf, naiv. Ma hodhi ai tjetri dhe më la me gisht në gojë. Gjithmonë u kam besuar njerëzve pa paragjykime. Plot prej tyre më kanë zhgënjer dhe unë prapë vazhdoj të besoj si një idiot që kërkon të ndreqë pisllëqet e rracës njerëzore. Një naiv, ja se ç'jam!

Alba qe përpjeur ta qetësonte, por ai kishte tundur kokën me dëshpërim...

Ajo u përmend nga frenimi i trenit në stacion. U kthye në vilë duke nxjerrë sa më shumë në pah dy qese plastike të mbushura me sende të blera. I kishte thënë zonjës se do të shkonte në Gjenovë për të parë disa shitore veshjesh për gra dhe qe detyruar të blente disa gjëra.

- Renato do të të telefonojë pas ndonjë ore, - tha Sartori pa e vështruar.

- Ah, po, - ia bëri ajo. - Ma mori mendja. A mund të shkoj nesër në Milano zonjë?

- Sigurisht, - ia ktheu Sartori. - Shko vogëlushe, argëtohu. Në Milano ka plot gjëra për të parë. Vite më parë shkoja shpesh atje. Por tani Milano sikur është prishur. Ka shumë kriminalitet dhe emigrantë të të gjitha ngjyrave. Pastaj ciganët që kërkojnë lëmoshë duke t'u qepur pas si mushkonja. Eh, po prishen qytetet e Italisë!

Alba u largua kokulur. Edhe unë jam një nga emigrantët që po prishin qytetet, mendoi. I vetmi favor është se nuk kam ngjyrë.

U shtri përbys në pritje të ziles së telefonit. Milanos nuk mund t'i shmangej më. Një herë i qe justifikuar Renatos me gripin e Sartorit, herën e dytë me kohën e keqe. Herën e tretë kishte parë një njoftim në gazeten lokale "Shekulli XIX" për hapjen e një eksposite detarie në kështjellën e Rapalos dhe e kishte ftuar atë të vinte, duke thënë se e tërhoqte shumë detaria antike. Ai kishte ardhur dhe skena që Alba po e priste e tmerruar desh kishte ndodhur. A mund të ulemi diku për të biseduar diçka të rëndësishme, e kishte pyetur Renato. Sikur ta linim për një herë tjetër, i qe lutur ajo. Nuk ndjehem e përgatitur për biseda të rëndësishme.

E kishte patur të qartë se nuk kishte më rrugëdalje. Qe nisur për te Vili për t'i treguar gjithçka, për ta shtyrë që të merrnin të dy një vendim shpëtimtar. Por e kishte gjetur ashtu të dëshpëruar dhe nuk kishte guxuar ta mërziste më keq. Do.t'i them ndonjë ditë tjetër, kishte menduar.

Kur zilja e telefonit ra, ajo e ngriti receptorin duke e patur përgjigjen gati. I kërkoj Renatos ta priste në stacion të trenit. Pse shkoj, mendoi pastaj. Pse i përgatis terrenin diçkaje që e di fare mirë se ç'është?

Vendosi të harronte gjithçka, por të nesërmen, në stacionin e Milanos, Renato që e priti gati me krahë hapur, i vuri në dukje se ishte e lodhur. Jam ngritur herët, tha ajo. Ndoshta e kam edhe nga rruga.

- Fillimisht shkojmë nga shtëpia, - tha ai kur u ngjitën në veturnë. - Qetësohu ca.

Ajo u mundua të kundërshtonte, por llogjika e tjetrit ishte e pakundërshtueshme.

Ndërsa bisedonin gjëra të përgjithshme, vutura iu largua shumë qëndrës së qytetit dhe hyri në një lagje të qetë, me

godina të ulëta, të ngjashme me njëra-tjetrën. Ata hynë në njëren prej tyre dhe morën një ashensor të ngushtë deri në kat të katërt. Renato, hapi një derë, në qendër të së cilës që ngjitur një pllakëz metalike me numrin 24 dhe emrin e tij: Boteli R.

Ishte një apartament i këndshëm, plot dritë, me një mobilim modest, por me një llogjikë artistike; një dhomë gjumi, një studio e mbushur me libra dhe një tavolinë e madhe pune, një dhomë ndenjie dhe një aneks gatimi.

- Është një luks për një nëpunës të vogël si puna ime, - tha Renato. - Më merr çdo muaj një të tretën e pagës. Në Milano jeta është e shtrenjtë. Po ty, si të duket?

Ajo hapi krahët sikur donte të tregonte që aty hapësira ishte tepër e bollshme:

- Është i bukur, - tha.

Renato buzëqeshi i kënaqur nga ajo përgjigje.

- Kam punuar shumë për këtë apartament, - tha. - E kam nisur nga hiçi. Por, për fat, në përgjithësi më ka ecur. Eh, këtu te ne, jeta jo gjithmonë të afron shanse. Dëshiron diçka për të pirë?

Ajo i kërkoi një lëng frutash. Ndenjën ca duke biseduar për Milanon dhe punën e tij në bashki, pastaj dolën. Lanë veturën në një shesh të vogël jo shumë larg qendrës dhe morën drejt katedrales së madhe. Ishte një e dielë e kthjellët, e ftohtë, që tregonte se dimri po hynte. Rrugët ishin plot me rjerëz. Sheshi i gjerë para katedrales qe mbushur me turistë të huaj që fotografonin pa pushim dhe ushqenin një mori pëllumbash që u vërtiteshin mbi krye e nëpër këmbë. Alba në fillim nuk u besoi syve. Ishin me qindra pëllumba që e kishin humbur konceptin e frikës nga njerëzit dhe çdo lloj instikti mbijetese. Ishin kthyer në parazitë të majmur që preferonin vetëm gjëra të zgjedhura.

Ata hynë në katedrale. Sapo kishte mbaruar mesha e

madhe e paraditës dhe salla gjysmë e errët ishte plot. Kumbonin ende tingujt e organos. Poshtë e lartë shkëlqenin herë pas here blicet e aparateve fotografikë. Kishte shumë turistë japonezë. Të qeshur, të shkurtër e të shkathët, ata vërtiteshin ngado, me aparatet në qafë. Një grup besimtarësh ndiznin qirinj dhe i vinin ata në një banko të gjerë, në krahun e majtë të sallës. Disa të tjerë qëndronin me duart mbledhur në gjoks duke mërmëritur lutje.

Alba ngriti sytë nga tavani i lartë i mbushur me afreske, pastaj vështroi kolonat gjigande, mbi të cilat mbaheshin me mijra tonelata blloqe gurësh të latuar. Iu duk vetja tepër e vockël brenda atij masivi gjigand. Provoi një lloj ankthi nga gjithçka që e rrethonte.

Ata kishin ca që po vërtiteshin nëpër mjediset e sallës së madhe kur papritur në katedrale u dëgjuan pasthirma të ëmbla habije dhe blicet e aparateve u shtuan. Kishte hyrë një nuse, me një fustan të bukur, të gjatë, bishtin e të cilit e mbanin dy fëmijë. E shoqëruar nga dhëndërri, prindërit dhe të afërmit, nusja u afrua te altari dhe qëndroi me vështrimin hedhur nga ikonostasi gjigand përballë.

- Ç'po ndodh, ceremoni martese? - pyeti Alba.

- Ehë, - ia bëri Renato. - Pate shans që erdhe sot. Ceremoni të tilla këtu kryhen rrallë. Kushtojnë shumë.

Dalëngadalë në sallën e madhe ra qetësia dhe pranë çiftit që po priste kapur për dore, u afrua një prift. Disa zonja të moshuara, të prekura, filluan të qanin, të ngacmuara nga kujtime të vjetra. Turistët japonezë, duke çarë mes kureshtarëve, arritën të zinin vende të përshtatshme për të fotografuar. Alba ngrihej herë pas here në majë të gishtave për të parë nusen. Vuri re se Renato po e vështronte ngultazi.

Zëri i prifti kumboi në sallën e madhe. Ai filloi t'u lexonte bashkëshortëve të ardhshëm mësimet e Zotit për martesën dhe detyrimet që vinin prej saj. Njeriu nuk mund të ndajë

dot atë që ka bashkuar Zoti, përmendi ai gati me kërcënëm fjalët e famshme të Jezuit.

Vështrimi i Renatos u bë edhe më ngulmues. Alba u kthyе paksa drejt tij.

- Empcionuese, - tha Renato duke buzeqeshur.

Ajo pohoi me kokë.

- A pranon ti Anxhelo Orsini të martohesh me Suzana...?

- kumboi rishtazi zëri i mëkëmbësit të Zotit.

Alba ndjeu një prekje në sup.

- Alba, a do të pranoje të martoheshe me mua?

Ajo nuk guxoi t'i ngrinte sytë.

- Më fal, nuk e kisha mendjen, - tha.

Dora e tij e shtrëngoi në sup.

- A pranon ti Suzana...?

- Të pyeta a do të pranoje të martoheshe me mua?

Asaj iu duk sikur turistët japonezë iu vërsulën me aparatet e tyre, sikur të gjithë njerëzit u ktheyen **dhe po** e vështronin. Bile edhe prifti **sikur** po priste përgjigjen e saj pas përgjigjes së vajzës me emrin Suzana. Pse **nuk** i **them** jo, pyeti veten. Pse nuk thërras këtu, në mes të katedrales: Jo! U mat të formonte fjalën, por kordat e zërit dhe buzët nuk iu bindën.

- Të lutem dalim, - mërmëriti pas pak.

Renato e shoqëroi jashtë, duke e mbajtur lehtazi për krahu.

- Doja të mos ma bëje atë pyetje, - tha ajo. - Jam e papër-gatitur për t'iu përgjigjur. Po ti, vërtet je dashuruar me mua?

- Shumë më tepër nga ç'mund ta imagjinosh.

- Dhe më propozon diçka kaq serioze duke e ditur që jam e lidhur me një tjetër?

Renato mori një pozë të lehtë habije.

- Ah, pse, ti vazhdon akoma me atë shqiptarin?

- Po.

- Më qe krijuar një ide sikur ishit ndarë. Nejse. Unë të

ofroj propozimin tim dhe kaq. Nuk mundja të duroja më. Ti nuk je femra e parë që duhet të zgjedhësh mes dy meshkujve.

Ajo e vështroi plotësisht e hutuar.

- Të kupto hemi, - vazhdoi Renato, - unë nuk dua të më përgjigjesh sot. Ti mund të mendohesh.

- Nuk të shqetëson historia ime me atë tjetrin?

- Aspak. Do ta konsideroja një histori të mbyllur.

Alba zgjati dorën për t'u mbajtur në krahun e tij.

- Ulemi pijmë ndonjë kafe, - tha. - Jam shumë e lodhur.

Ai e ka kuptuar që jam e lëkundur, mendoi pastaj. E ka nuhatur që unë e solla deri në këtë pikë. Ai e di që po tundo hem prej tij, prej komoditetit te Sartori, prej apartamentit të tij të bukur, nga oferta e një jete të qetë e të përhershme në Itali. Ai është plotësisht i qetë dhe ka besim se unë do të pranoj, sepse, sipas logjikës së tij, një vajzë e ardhur me anije si e çmendur, mes qindra refugjatëve, nga një vend i mjerë, nuk ka se si ta refuzojë propozimin e një italiani që i ofron atë parajsë të ëndërruar prej vitesh, parajsë për të cilën ajo ka rrezikuar kokën në atë anien e lemerisur panameze.

Pasi e mblodhi disi veten, i kërkoi të dilnin rishtazi. Renato e çoi për të parë godinën e bashkisë ku punonte dhe "Skalën", pastaj e ftoi të ktheheshin në shtëpi për të ngrënë drekë.

- Jo, - tha Alba ftoht. - Më mirë hamë diku afër stacionit të trenit.

- Të pëlqen kuzhina kineze?

Alba bëri një gjest mospëlqimi. Ai hapi krahët, duke u përpjekur të ruante humorin.

- Atëherë, shkojmë në ndonjë restorant indian?

- Nuk i duroj dot restorantet!

- Pra, si gjithmonë, do të marrësh një picë napoletane dhe do ta paguash vetë?

- Po, - tha ajo gati me inat.

- Si të duash.

Ajo i futi krahun paksa.

- Renato, të lutem mos u prek,

- Jo, - tha ai miqësisht. - Po mësohem me natyrën tënde.

- E si të duket natyra ime?

- Ca e komplikuar. Por ky është vetëm fillimi. Më vonë, besoj se gjérat do të ndryshojnë.

- Renato, të lutem më kupto, edhe ti për mua je i komplikuar, - tha ajo duke u pështetur në krahun e tij. - U përkasim dy kulturave dhe shoqërive të ndryshme.

Ai u ndal befas.

- Nuk e kuptoj, ti sikur nuk ndjeve asnjë lloj kënaqësie femërore kur unë të thashë se jam i dashuruar, - foli pa e vështruar. - E njëjtë gjë ndodhi edhe kur të propozova martesën atje në katedrale. A mund të ma shpjegosh këtë lloj sjelljeje?

Vërtet nuk e kupton që unë nuk e dua, tha ajo me vete.

- Egoja ime ka kohë që është kënaqur, - foli me një ton lajkatar. - E kam kuptuar që lart në mal se ti po dashuroheshe me mua. Është e vërtetë, më ka ardhur mirë. Por rrethanat në të cilat ndodhem... Ti zgjodhe një kohë tepër të papërshtatshme për këtë hap.

- Ndoshta, - pranoi ai.

- Megjithatë, unë nuk të thashë jo. Kjo do të thotë se kam nevojë të mendohem, të këshillohem me familjen.

- Ke të drejtë, - tha ai i lehtësuar nga ato fjalë të papritura.

- Faji është i imi. Në të vërtetë isha përgatitur për tjetër reagim. Duhet të jem i lumtur që ti nuk m'u përgjigje me "Jo".

Alba ende nuk po bindej se kishte qenë ajo që e kishte nxjerrë nga goja atë gjysmë premtimi të génjeshtërt. Fjalët sikur i kishin dalë nga buzët tinëzisht. Kordat vokale i kishte

komanduar një vatër misterioze e trurit, me ngut, si me dhunë, me alarmin se ndonje vatër tjeter do të krijonte ndonjë pengesë.

Ndërsa hante picën napoletane të mbushur me salcë përsipër, asaj iu kujtua Gerta dhe debati i vjetër. Je një zuskë tinzare, i foli vetes. Llastohesh këtu, para këtij njeriu të huaj, ndërsa ai tjetri që do, pi duhan i vettuar atje në atë dhomën e lagësht, pa punë, pa para në xhep. Me atë bën dashuri, këtij i thua se ke nevojë të reflektosh, të konsultohesh me familjen.

Befas iu duk se do t'i nxirrte ato pak kafshata që kishte ngrënë.

- Nuk ndjehem mirë, - tha.

Ai e përcollë në stacion pa atë ngrrohtësinë e pritjes së paradites.

- E shoh që nuk e shijove si duhet Milanon, - tha me keqardhje. - Të futa në ca rrethana të pakëndshme. Uroj që të mos më zhgënjenjesh. Do të jetë tepër e vështirë.

Ajo i zgjati dorën miqësisht. Ai ia shtrëngoi gishtat fort, pastaj zgjati buzët dhe e puthi në faqe.

Alba u ngjit në vagon. Ata janë të dy të dashuruar, mendoi. Asnjeri s'ka faj. Fërkoi fytyrën e nervozuar, si e ngritur nga një gjumë i keq, pastaj nxorri nga çanta një revistë dhe filloi të lexonte për të humbur mendjen. Por edhe revista iu duk e bezdisshme. Befas vuri re në cep të ndenjëses një libër të verdhë. Me siguri e kishte lënë aty ndonjëri që kishte zbritur pak më parë. Alba e mori. Ishte një libër erotik. E hapi diku nga mesi dhe filloi të lexonte kot, pa ndonjë interes. Libri tregonte për një prostitutë me emrin Iris, e cila një ditë u njoh me një burrë të pasur. Ajo e magjepsi burrin e pasur me mënyrën se si shtirej e eksituar dhe sajonte gjendje orgazmike fantastike, pa ndjerë në të vërtetë asgjë. Do të martohem me ty, i tha burri i magjepsur. Kurrë s'kam parë

në jetën time një femër që të orgazmojë kështu.

Alba hapi dritaren dhe e flaku librin jashtë me neveri. Një grua në ndenjësen përbri ia nguli sytë me dyshim. Ajo u mbush ca me ajër të pastër, pastaj mbylli dritaren dhe vështroi peisazhin monoton që filloi të mbulohej nga muzgu.

\* \* \*

Tërë javën e kaloi në një gjendje hutimi. I vetmi shpëtim ishin kujtimet e Sartorit. Ajo kishte hyrë në periudhën e martesës së saj të dytë, pas një vjetmie të gjatë prej pesë vjetësh. Në faqet e fundit kishte filluar t'i mëshonte aq shumë idesë së vëtmisë dhe mërzisë sa që Alba kishte filluar të dyshonte se në fakt kishte ndodhur e kundërtë.

Alba e kuptoi lehtë se zonja ishte plotësisht në dijeni të atyre që po ndodhnin mes saj dhe Renatos. E kishte pyetur disa herë për të dielën e kaluar në Milano në shoqërinë e tij. Alba i tregonte të njëjtat gjëra, por për shkak të sklerozës, Sartori i bënte rishtazi të njëjtat pyetje.

Të shtunën pasdite hutimi iu shtua edhe më keq. Duhej të dilte për t'u takuar me Vilin dhe gënjeshrat për Sartorin sa vinte e vështirësoshezin. Ndërsa vërtitej nëpër dhomë e nervozuar, iu kujtua se jo shumë larg Vilës së Trëndafilave ndodhej një kënd i madh lojrash. Do të shkoj të luaj tenis, tha jo duke futur në një çantë shpine një palë tuta dhe një peshqir. Ide e bukur, ia bëri Sartori me një ton ku ishte e vështirë për të kapur ndonjë nuancë.

Vili zbriti nga treni i zymtë dhe ajo e kuptoi pa vonesë se ai nuk i kishte punët mirë. Gjatë javës kishte telefonuar vetëm një herë. Kishte qenë i mërzitur. Kishte thënë shkurt gjëra të përgjithshme dhe kishte premtuar se do të vinte atë të shtunë për ta takuar.

Ata u përqafuan pa atë ngrohtësinë dhe shtrëngimet e

dikurshme. Ishte një mungesë vrulli nga të dy dhe për habi, asnjeri nuk pyeti: Ç'paske sot kështu?"

- Ke marrë ndonjë premtim për punë? - pyeti Alba, ndërsa po zbrisnin në breg të detit, thjesht për inerci, ndonëse kishte hyrë dimri dhe dallgët përplaseshin shkëmbijve me tërsëllimë.

- Jo, - tha ai. - Më duket se nuk do të gjej punë kurrë. Unë jam kot, i pazoti.

Alba nuk diti si ta ngushëllonte.

- Pa punë nuk je vetëm ti, - tha. - Ka plot të tjerë.

- Të tjerët me siguri nuk kanë plane idiole si puna ime.

As e çajnë kokën për të studjuar, shkruar apo ...përkyer!

- Një punë do të gjendet një ditë. Mos u mërzit kështu.

Ai bëri një gjest dëshpërimi.

- Të lutem lëre këtë temë! Nuk e duroj dot.

Ata iu afruan instiktivisht një kabine të madhe prej druri, ku qenë futur disa barka dhe pajisje të tjera plazhi. Qëndruan përballë saj duke menduar të njëjtën gjë, kasollen alpine atje larg mbi Savonë. Por kabina ishte e myllur me dy dryna të mëdhenj që dukeshin si dy roja të harruara aty prej kohësh. Dallgët lëshonin ca zhaurima bezdisëse. Mbi to vërtiteshin ca pulëbardha të mëdha që të acaronin nervat me këlthitjet e tyre.

- Vil... çdo të bëjmë? - foli Alba, duke vështruar profilin e tij të vrenjtur. -Sikur... të shkonim në ndonjë vend tjetër.

- Jo, - ia ktheu ai. - Rrimë këtu.

Ajo iu afrua, iu ngjit për trupi dhe filloi ta puthte, duke ndjerë e tmerruar se nuk kishte më atë etjen e parë për të bërë dashuri me të. Iu duk se edhe Vili ishte ndryshe. Ai u mundua gjatë me puthje e fërkime të krijonte një gjendje të ngrohtë si gjithmonë para dashurisë, por papritur u tërhoq i nervozuar.

- E lëmë, - tha. - Nuk jam në terezi.

- Si të duash, - ia ktheu ajo.

Ata u ulën pranë njëri-tjetrit, duke vështruar të heshtur detin. Ndenjën aty deri sa u err dhe filluan të ndjenin të ftohtë. Vetëm te stacioni Vili e vuri re çantën e saj.

- Po këtë, ç'ë ke? - pyeti. - Do të shkosh në palestër? Apo gënjeve Sartorin për të ardhur te mua?

Ajo nuk guxoi ta vështronte.

- Vil, ç'ke? - foli ftoht. - Po kërkon shkak për t'u grindur?

- Jo, - tha ai. - Mos ma vër re. Jam i acaruar. Vetëm kaq. Afrohu, më jep një të puthur.

Ajo u bind.

- Ndonjë të shtunë do të vij unë në Gjenovë, - tha.

Ai hapi krahët sikur donte t'i tregonte se një të shtunë më herët apo më vonë, nuk kishte rëndësi. Iku duke e puthur shkarazi në faqe. Zoti im, ç'po ndodh kështu, mendoi Alba duke u kthyer për në Vilë. Si u bëmë kështu?

## 10.

Në ditët që pasuan ra pandërprerë shi. Qielli, dhe veçanërisht deti, morën një pamje të shëmtuar. Gjithçka ishte e vranët, e turbullt. Në rrugën "Aurelia" ndodhi një shkarje dheu, trafiku u vështirësua dhe Sartori nuk lëvizi nga vila. Alba e kalonte pjesën më të madhe të kohës pranë dritares së dhomës apo vetratës së madhe në sallën e ndenjies. U bë e ngathët, e hutuar, nuk duronte dot as televizor e as revista apo libra. Natën binte për të fjetur e bindur se e donte Vilin dhe nuk duhej ta braktiste. Por në mëngjes, për habi, zgrohej me mendime të tjera. Vili i dukej më i largët, një e ardhme e pasigurtë. Pastaj, tërë ditën, s'bënte gjë tjetër, veçse hidhej nga njëri pozicion në tjetrin.

Shpesh i kujtohej një dokumentar shkencor televiziv që tregonte për jetën e pinguinëve dhe mënyrën se si ata çiftoheshin. Femrat ishin shumë më pak se meshkujt dhe këta të fundit terrorizoheshin nga idea se mund të mbesnin pa partnere. Femrat, përkundrazi, llastoheshin keqazi.

Ato kishin të drejtë të zgjidhnin një partner mes një grupei prej 9-10 pinguinësh. Meshkujt e mjerë rrinin në rresht si ushtarë dhe pinguinesha i kqyrte njërin pas tjetrit; ky më pëlqen, ky s'më pëlqen.

Albës i qe kujtar vetiu ai emision, kur në katedralen e madhe të Milanos Renato i kishte kërkuar të martoheshin. Ti nuk je femra e parë që duhet të zgjedhësh mes dy meshkujve, i kishte thënë ai. Ti mund të mendohesh sa të duash...

Më vonë, nga lodhja dhe mërzia, ajo e kishte imagjinuar veten si pinguineshë, ndërsa ata të dy i qëndronin përballë, mbi një bllok akulli; Renato dhe Vili. Kishte patur raste që mbi bllokun e akullit qe ngjitur edhe njeriu i Francës dhe atëherë ajo qe trembur se po lajthiste.

Të shtunën, nga mesdita, u bë gati për t'u nisur për në Gjenovë, por pastaj filloj të lëkundej. Jashtë binte shi. Vili do ta kuqtoj se nuk kam shkuar prej kohës së keqe, mendoi. Veç kësaj duhet të jetë akoma pa punë. Po të kishte bërë gjë për ndonjë vend pune, me siguri do të kishte telefonuar. Po të shkoj, do të jetë atmosferë boshe.

U zhvesh, pastaj u plas në krevat duke ngjeshur fytyrën në jastëk.

Në mbrëmje telefonoi Renato. Toni i tij ishte i përmbjajtur. Pyeti gjëra të përgjithshme. A mund të bëjmë ndonjë shëtitje javën e ardhshme, tha pastaj. Sigurisht, ia ktheu Alba. Mund të vish nga e diela. Uroj të hapet koha.

Duke e ndjerë se ajo lloj lëkundjeje shkatërruese do të thellohej edhe më shumë, Alba vendosi t'u shkruante njëherë prindërve e motrës së madhe dhe t'u tregonte gjithçka. Këshillat e tyre iu dukën një zgjidhje shpëtimtare. Vuri disa herë në dukje faktin se propozimi i qe bërë nga nipi i Sartorit dhe jo nga një njeri i rrugës. Megjithatë, ishte e bindur se prindërit nuk do ta kundërshtonin. Ata kishin mbetur të shokuar pas ikjes enigmatike të njeriut të Francës. Ishin ndjerë fajtorë sepse kishin këmbëngulur për ta realizuar fejesën me të. Është familje e mirë, i kishin thënë, serioze. Ajo kishte pranuar. Jo edhe aq nga argumentet me "familje të mirë" se sa nga tipi i veçantë i njeriut të Francës. Ai të tërhoqte që në mënyrën se si vishej dhe krihej. Kishte ca ide alarmante. Shante komunizmin dhe kur shëtisnin, tallej me parrullat që lexonte rrugës. Gjithçka është e gënjeshtërt, thoshte, kalimtare. Sa më shumë shtohen parrullat, aq më i

afërt është fundi i këtij rregjimi...

Alba e kishte pritur ikjen e tij, por jo braktisjen. Pas asaj braktisjeje, prindërit nuk kishin guxuar t'i flisnin më. Ata kishin heshtur edhe kur ajo u kishte thënë një mbrëmje me ton kërcënues: "Nuk mund të rri dot më në këtë vend". Të paktën mos ik vetëm, i qe lutur nëna...

Alba vendosi t'i shkruante edhe Gertës. Asaj i tregoi shumë më tepër detaje në lidhje me dilemën ku qe futur. Ah, sa e lumtur do të kisha qenë sikur të isha futur edhe unë në ndonjë piceri si puna jote, i shkroi në fund. Sikur edhe Vili të punonte atje me mua!

Hipokrite, i foli pastaj vetes. Italia është atdheu i picerive. Pse nuk shkon të fillosh punë në ndonjërën prej tyre? Pse nuk ia ushqen edhe Vilit këtë ide? Nuk ta mban. Sigurisht që s'ta mban. Tani s'para të pëlqen të ikësh nga kjo vilë luksoze dhe të futesh mes tymrave të kuzhinës, vapës, teptive plot yndyrë e salcë. Të punosh dhjetë orë në ditë deri sa të të dridhen gjunjët. Hipokrite!

Ajo i hodhi letrat në kutinë postare si me pendim. E ç'pres prej tyre, pyeti veten. Në fund të fundit, jam unë që do të vendos. Askush nuk mundet të më shpëtojë nga kjo lëkundje e mallkuar.

Të hënën pasdite nga Sartori i erdhë një befasim tepër trulloës. Me gjeste ceremoniale, zonja i futi krahun dhe e çoi në një nga dhomat e vilës që shërbente më të rrallë si studio. Mbi tavolinë qe lënë një pakë e madhe.

- Hape vogëlushe, - tha Sartori. - Është për ty. Nga ana ime.

Alba hapi pakon dhe pa një xhup të bukur, me lëkurë ngjyrë portokalli dhe push të bardhë nga brenda. Duhet të kishte kushtuar të paktën gjysmë milioni.

- Është... është dhuratë? - ia bëri e hutuar.

- Po, - u përgjigj Sartori. - Uroj të të pëlqejet.

- Më pëlqen zonjë, por... nuk mundem... është një dhuratë tepër e shtrenjtë...

- E dashur, dhuratat nuk kanë kurrë çmim.

Pas pak Sartori e ftoi të uleshin.

- Renato më tregoi për ju të dy, - tha. - Të kishte kërkuar të martoheni?

- Po, - u përgjigj Alba.

- Më vjen mirë për ty vogëlushe. E meriton këtë fat. Renato do të të sigurojë një jetë të rehatshme. Për këtë unë jam gati të bëhem garant edhe para familjes tënde. Prindërit e tu i respektoj.

Zonja priti që ajo t'i përgjigjej në ndonjë farë mënyre, por Alba nuk guxonte ta ngrinte kokën.

- Dëgjo vajzë, - foli befas Sartori me tonin e sertë të një kryemurgeshe. - Ti duhet të bësh një zgjedhje. Ky është për ty një rasti artë që nuk duhet humbur. Neve femrave, sigurisht jo të gjithave, na e jep Zoti nga një rast të artë. Më kuptove? Na e jep vetëm një herë në jetë.

Alba pohoi me kokë. Fjalët e zonjës iu dukën si një urdhër. Ajo i di të gjitha, mendoi. Unë përpinqem më kot t'i fshihem.

- Ç'kohë e keqe! - tha Sartori duke vështruar nga deti. - Lagështia s'më bën mirë. Më therin kockat, kokën e ndjej të turbullt.

Alba e pati të qartë se tjetra nuk kishte më gjë për të thënë. Kishte folur shkurt e sakt. Kishte lënë të kuptohej se një refuzim i mundshëm ndaj Renatos nuk do të ishte gjë e këndshme. Alba filloi të vriste mendjen për pasojat që mund të kishte po t'i përgjigjej Renatos me "Jo". Sigurisht, me shumë takt, ashtu siç kishin pushuar Vilin në verë, zonja do t'i linte të kuptonte se nuk kishte më nevojë për shoqërim.

Ku do të shkoj, pyeti veten Alba dhe në çast, para syve iu fanit garsoniera e lagësht e Vilit, gjysmë e zhveshur, me banjo të përbashkët me kamerunasin Ngea dhe një filipinas. Iu

duk vetja në udhëkryq. Nga grupi i shoqeve të kursit, me të cilat kishte ardhur në Itali, vetëm njëra prej tyre qe vendosur në Napoli me të fejuarin. Një tjetër kishte përfunduar në Zvicër në familjen e ca emigrantëve të vjetër politikë. Nga farefisi ndodhej në Itali vetëm Sava, kushërrira e saj e dytë, me të cilën Alba qe takuar dikur në Brindizi. Ajo kishte mbetur poshtë në Jug së bashku me familjen dhe ende nuk po rregullohej dot. Kështu i kishin shkruar prindërit në një letër.

Nuk duhet të ndërmarrë aventura, mendoi. Italia është e vështirë, me rreziqe. E pafytyrë, i foli vetes pastaj. Të gjitha këto janë argumente për t'i mbushur mendjen vetes se duhet të martohesh me Renaton. Pse nuk e pranon se të pëlqen? Se një djall të ka ngacmuar përbrenda që në fillim, kur ai provoi të të afrohej? Jo, s'jam e pafytyrë, tha pas pak. Është gjë normale që një vajzë të lëkundet, të detyrohet të zgjedhë. Fakti që Vili më dashuroi më parë dhe Renato më vonë, nuk ka asnje rëndësi. Unë duhet të zgjedhë rastin më të mirë. Një vajzë me mend vetëm një herë martohet. Sot është e lehtë të gjesh burrë, por e vështirë të gjesh pasuri dhe jetë komode. Unë trazohem shpirtërisht sepse vij nga një shoqëri ku komoditeti urrehej zyrtarisht dhe sakrificat idealizoheshin, nga një kulturë ku femrat duhej të ishin burrëresha dhe të besës, ku leku shpërfillej dhe ndjenjat idealizoheshin...

Alba e frenoi për pak një lëvizje të pakontrolluar nervozizmi.

- Zonjë, a do të shkruajmë ndonjë paragraf? - iu drejtua Sartorit.

- Jo, - tha tjetra. - Ndoshët nga mbrëmja.

Alba u detyrua të vështronte jashtë. Kot. Fare kot. Diku tutje, nga malet, bubulliu. Shiu u dendësua. Era e detit filloj ta përplaste atë në vetratën e gjerë.

\* \* \*

Vili vështroi pér ca çaste ujét e turbullt tē shiut që formonte rrëke në rrugën e vjetër me kalldrëm poshtë dritares, pastaj ndezi një cigare. Mbeta brenda edhe sot, mendoi. Këpucët dhe rrobat i qenë lagur nga shirat e ditëve tē fundit. Një barist italian i kishte treguar se shirat dhe përmbytjet ishin gjërat më tē zakonshme në Gjenovë. Pér shkak tē kohës së keqe shumë kantjere mbylleshin. Klientela e restoranteve dhe bareve zvogëlohej. Ishte fat i madh tē tē afronte dikush punë me orë apo me ditë. Ai çoi instiktivisht dorën në xhepin e prapmë tē xhinseve dhe nxori kuletën. Ndorese e dinte fare mirë se kishte gjithsej 54 000 lireta tē fituara në fundjavë me larje pjatash, i numëroi kartmonedhat rishtazi. E kishte tē qartë se qeranë e dhjetorit nuk do tē arrinte ta paguante dot. Mbetja jashtë, në rrugë, i shkaktonte një panik tē pandashëm.

Kur shiu u rrallua disi, vendosi tē dilte njëherë aty rrotull. Sapo kishte rënë mbrëmja dhe prostitutat e para po dilnin pér tē filluar punë. Ai hyri në rrugën famëkeqe "Pre", ku gjithmonë mund tē gjeje njerëz. Muajt e fundit aty kishte patur sherre dhe shkëmbime grushtesh tē thatë mes shqiptarëve dhe mafiozëve tē vegjël nga Maroku apo vendet e tjera afrikane. Afikanët nuk pranonin t'i lëshonin zonat e tyre tē influencës. Çdo fytyrë tē re që dukej shpesh poshtë e lartë rrugës, ata e vështronin me dyshim, sidomos kur ishte femër.

Vili pa një grup prostitutash nigeriane tē mbledhura nën dy çadra tē mëdha. Më poshtë, nën një ballkon tē gjerë, kishin qëndruar dy gej tē truuar si femra.

- Afrohu mik, - tha njëri prej tyre me një zë tē ëmbël, duke nxjerrë para një gjoks misterioz. - Je ndopak maniak seksi?

- Nuk kuptoj italisht, - ia ktheu Vili.
- Oh, i dashur, mes nesh gjuha nuk ka fare rëndësi, - vazhdoi tjetri. - Universi i seksit nuk ka limite të asnjë lloji.

Vili i këputi një të sharë në shqip. Gejt thanë diçka mes tyre, pastaj filluan të qeshnin. Ai vendosi të largohej nga ajo rrugë. Patrullat e policisë apo karabinierët kalonin shpesh aty dhe bënин kontolle dokumentesh. Në krye të rrugës dëgjoi një zë që i foli. Pa një fytyrë të njojur shqiptari. Ai kishte qëndruar struktur me një pamje të dyshimtë.

- Kemi qënë bashkë në kamp, - tha. - Të kujtohet?
- Vili pohoi me kokë.
- Me se merresh? - pyeti.
- Punë palle, - tha bashkëkampsi. - Fitoj me grushte. Do ta tërheqësh njëherë? Të ta dredh?
- Çfarë? - pyeti Vili i hutuar.
- Hë mor ti, se nuk je çun mami! Do ta tërheqesh nje me hashish?

- Jo! - kundërshtoi Vili prer.  
 - Si të duash. Pse je kështu i mërzitur? Ke mbetur pa punë? Eh, ma mori mendja. Vetëm një budalla nuk di të fitojë para sot. Hë, ke ndonjë mendje? Do të punosh me mua? Hashishi është pa ndonjë zarar të madh. Ka të tjerë që bëjnë batërdinë me droga të egra. Dëgjo plakun, nuk vihet paraja duke punuar. Me djersë fiton lesh. Ndryshe nuk do të kishte kaq shumë pisllëqe në këtë botë.

- Falemnderit! - tha Vili duke u larguar. - Nuk e bëj dot.
- Do të pendohesh! - i foli tjetri nga pas.

Ai shëtitë edhe ndonjë gjysmë ore nëpër rrugët e lagura, pastaj u rikthyte në dhomë. Hëngri si zakonisht makarona, duke i mbajtur sytë sa më pak që të ishte e mundur mbi pjatë. Deri nga ora 22 lexoi. Ndërsa fiku driten për të fjetur, jashtë vazhdonte të binte shi. Vend i mallkuar, shau. Pse rri akoma këtu? Por në çast iu kujtua Alba dhe idea e ikjes e

frikësoi. Do ta humb, mendoi. Por pastaj iu duk se edhe duke ndenjur rrugëve të Gjenovës, i papunë, do ta humbte gjithësesi. Kishte filluar të dyshonte keqazi se nipi i pronares së Vilës së Trëndafilëve kishte hyrë mes tyre. Mosardhja e Albës të shtunën ishte një provë tjetër. Ajo me siguri kishte shëtitur me atë tjetrin, kishte ngrënë darkë në ndonjë restorant të shtrenjtë dhe pastaj... Idea se italiani mund të kishte bërë dashuri me të i shkaktoi një urrejtje të egër. Por pastaj e kuptoi se ajo ide i kishte ardhur nga gjendja e dëshpëruar në të cilën ndodhej dhe u mundua të kujtonte diçka tjetër.

E nesërmja vazhdoi po me shi. Vili doli vonë. Ndërsa po kalonte përbri një bari, në vetratat e të cilit qenë varur skedina futbolli e hipizmi, iu kujtua se të dielën e kaluar një person i panjohur kishte fituar llotarinë e futbollit. Ishte fjala për disa miliarda lireta. Ai mendoi se ishte treguar budalla që tërë atë kohë nuk e kishte luajtur kurrë llotarinë. Tregonin se edhe me një skedinë me dy kolona njerëzit kishin fituar. Por ata ishin të zgjedhurit e Zotit, kishin fat. Mbase futem edhe unë te të zgjedhurit, tha Vili.

Do të luaj të shtunën lloton. Sikur të fitoj 100 milionë... jo, mjaftojnë 50, siguroj gjithçka. Fitoj edhe Albën. Do të ulem para kompjuterit dhe do të përkthej Moravian. Do të vazhdoj edhe romanin tim. Mëngjeseve do të nisem për në fakultetin e letrave. Do të jetë Homeri aty, Virgjili, Dante Aligieri. Mirsejugjej kolosë të letrave! Kush jam unë? Një i krisur që mori arratinë për të ardhur te ju.

Ai u përmend nga frenimi i fortë i një vture. Kishte zbritur në rrugë me semafor të kuq. Po të mendosh shumë për para, e ke pas qafe, mërmëriti.

Ndërsa po vazhdonte më poshtë, u ndesh me një djalë nga Elbasan, i cili konsiderohej njohës futbolli dhe në shtator kishte bërë 12-pikësh me një kolonë të thjeshtë, pa asnje

dopio.

- Jam vetëm, - tha ai. - Po ti?
- Siç e sheh, - ia ktheu Vili.
- A të pëlqejnë bastet me kuaj? Shkojmë njëherë? Mbase ka shkruar Zoti ndonjë gjë të mirë.

Vili pranoi nga që s'kishte ku shkonte. Tjetri fillooi t'i tregonte për një mikun e tij që para një javë kishte futur në xhep 5 milionë, duke gjetur kombinimin e një trisheje kuajsh fitues, tek e cila asnjerit s'i kishte shkuar mendja. I pashë me sytë e mi qindëshet kur ia numëruan në dorë, thoshte elbasanasi me një ton lakmitar. Oj nëne! Pesëdhjetë copë! E si? Ulur në karrike. Eh, këtu në Itali është paraja sheshit.

Hynë në një sallë të madhe të mbushur me një ajër të rëndë dhe tym duhani. Aty brenda kishte lloj-lloj tipash. Të gjithë i mbanin sytë nëpër televizorë që transmetonin gara me kuaj. Herë pas here dëgjoheshin thirrje, psherëtima zhgënjimi, të shara.

- Luajmë një dorë të fortë, - tha elbasanasi. - 12 000 lireta. Zgjidh tre kuaj në garën e Napolit që është tanë shpejt.

Vili preku kuletën me dorë të dridhur. Nuk kishte luajtur kurrë bixhoz në jetën e tij. As kishte vënë baste. Ta provoj, mendoi. Mbase jam i përkedhelur i Zotit. Vuri 12 000 lireta për kuajt me numrat 3, 5 dhe 8. Numrat i vendosi kot, pa lexuar asnje lloj informacioni nëpër gazeta apo në njofitimet e ngjitura nëpër stenda aty, në sallë. U ul para televizorit duke pritur mrekullinë.

Gara ishte me ca karroca të vogla, sipër të cilave garistët ngjanin qesharakë. Në ekran u shfaqën numrat kryesues; 3, 5 dhe 7. Për disa sekonda ata nuk ndryshuan, pastaj vendin e 7-ës e zuri 8-ta. Vili ngriu. Në ato çaste kuajt iu dukën kafshët më të bukura në botë. Garistët morën kthesën e fundit. Treshja e tij ishte fare pranë fitores, por tamam në metrat e fundit, karroca me numrin 3 mbeti prapa. Në vend

të saj hyri karroca me numrin 4.

Vili u pështet në karrike duke mbuluar fytyrën me duar. Jam pa fat, mendoi. Tërësisht pa fat.

- E pe? - i foli elbasanasi duke e shtyrë në sup. - Për pak desh fitove. Hajt, provoje edhe njëherë tjetër. Nuk kapen milionat me të parën.

Vili u lëkund. Ta provoj, tha me vete. Mbase... Por u kujtua se si i kishte fituar ato lireta dhe u frenua. Pastaj provoi rishtazi një ngacmim të fortë. U lëkund gjatë. Më në fund vendosi të rrezikonte përsëri. Por herën e dytë asnjeri prej kuajve të tij nuk hyri në treshen fituese.

Vili mbeti për ca çaste me një ngërdheshje të lehtë në fytyrë. E kapi inati dhe duke sharë, vuri edhe dy herë të tjera nga 12000 lireta në garat e Romës dhe Firencës. Ishte e kotë. Kombinimet e tija dolën nga vendet e fundit. E pa veten me 3000 lireta në xhep. Doli nga ai vend i zhurmshëm e me ajër të rëndë me stomak të përzier. Filloi të mallkonte karrocat, rracën e kuajve, elbasanasin që e kishte nxitur të luante dhe veten e tij, pastaj atë qytet plot lagështirë dhe ditën që kishte vendosur të vinte aty. Kur nuk diti ç'të mallkonte më, qëndroi me duart në xhepa para vitrinës së një agjencie udhëtimesh dhe për herë të parë i shkoi mendja të kthehej në Shqipëri. Aventurën e Italisë e quajti papjekuri dhe një hap të gabuar. Nuk duhej të kisha ikur, mendoi.

Por pas pak iu duk vetja si një fëmijë i trembur. Ec, i foli vetes, je akoma në krye të rrugës. Mos u dorëzo. Mos u trego naiv. Këtu naivët mbesin me gisht në gojë, sidomos ata që presin miliona nga kuajt apo llotaritë.

Të nesërmeni i zëvendësoi paratë e humbura duke punuar për një bojaxhi. Iu lut atij ta merrte si ndihmës, duke e gënjenyer se në Shqipëri ishte marrë me pikturë. Por kur mbaruan punë, tjetri i zgjati miqësisht 50 000 lireta, duke thënë:

- Miku im, ti s'je marrë kurrë as me lyerje e as me pikturë.

- Si... nuk do të mbash më?! - foli Vili i prerë.

- Nuk mundem. Edhe sot të mora se më erdhi keq. Mu duke në ditë të hallit.

Vili i shtëngoi dorën me mirënjohje. Të paktën kam diçka në xhep në se të shtunën vjen Alba, mendoi. Provoi mall. Pse shkoi kaq gjatë pa bërë dashuri, pyeti veten. Jemi vetëm pak kilometra larg njëri-tjetrit.

\* \* \*

Të shtunën priti në stacion gjatë. Iu duk se Alba nuk do të vinte. Sa po i mbushte mendjen vetes se gjithçka po merrte fund, kur ajo u duk në platformë. Qe veshur pa kujdes, nuk ishte trukuar, bile ai dyshoi se ishte e pakrehur që nga mëngjesi.

- Më fal që u vonova, - tha duke e përqafuar.

Ai nuk foli. E mbajti pranë vetes deri sa dolën jashtë në rrugë.

- Më ke munguar shumë, - tha pastaj me sytë përdhe. - Po kaloj ca ditë gjithnjë e më të këqija. Më është qepur njëters i llahtarshëm.

Ajo nuk foli. Me sa dukej ishte e papërgatitur për ato lajme të zymta. Vetëm i shtrëngonte dorën. Vili ndjente dridhjen e gishtave të saj.

Ishte një dridhje e pakontrolluar. Kur hynë në dhomë, Alba iu ngjesh për trupi dhe ndonëse kishte ftoht, pas pak filloj të zhvishej. Ai nuk e kuptoi dot atë lloj dashurie. Ishte hera e parë që i ndodhët. Ajo pëshpériste automatikisht: mos ik, jo, mos ik. Krahët e saj e shtërmgonin të pafuqishëm.

Pas aktit të dashurisë Alba qau për pak minuta.

- Ndjahesh mirë? - e pyeti Vili.

- Po, - u përgjigj ajo. – Vetëm më kishte marrë malli.

- Në se Sartori... në se nuk do të vonohesh...

- Në fakt... Nejse... në se ti do akoma...

- Më mjafton edhe një orë, - tha ai.

Ndërsa Vili po e përcillte, i tregoi se mund të ndërronte shtëpi dhe se ajo nuk duhej të vinte më të shtunave aty. As në shtëpinë e re sepse atje do të ishte së bashku me dy shqiptarë të tjerë.

Kur Alba u afrua për ta përqafuar, ai foli gati me mundim:

- Pra, është e vërtetë që nipi i Sartorit të ka propozuar?

Ajo ia nguli sytë e mekur.

- Jo, - tha pas pak me zë të çnatyruar.

Vili buzëqeshi me dhimbje.

- Je e mirë edhe kur gënjen. Shumë e mirë.

- Unë nuk gënjej, - foli ajo me një pamje të vajtueshme.

Atij i erdhi keq ta ngacmonte më.

- Mirupafshim! - tha. - Do të vij andej.

Kur Vili u kthyte në dhomën e ftohtë, iu duk vetja si i braktisur. Janë ditët e fundit, mendoi. Mbase do ta kërkoj këtë garsonierë dhe nuk do ta gjej. Ndezi një cigare, pastaj mori tenxheren e nxirosur dhe e përplasi në sobë. Kishte ditë që hante vetëm makaronia me vaj vegjetal dhe pak salcë. Mbushte një pjatë me majë dhe i hynte me vrull deri sa stomaku i fryhej nga brumi dhe i shkaktonte gromësimë të hidhura.

Por atë ditë nuk mundi të hante as gjysmën e pjatës. Makaronat iu dukën të neveritshme.

## 11.

Vili ngriti sytë nga kisha e madhe me një ndjenjë pasigurie. Ajo ishte një godinë e vjetër dhe hijerëndë. Ndoshta edhe më të zympët ia bënte pamjen ajo mbrëmje e ftohtë fillim - dhjetori.

- Jam një i pastrehë, - foli në citofon.

Pas disa minutash derën e hapi një prift i moshuar. Nga je, pyeti ai. Jam shqiptar, iu përgjigj Vili. Ju lutmë më strehoni sa të sistemohem në ndonjë punë. Hyni, ia bëri prifti, i mësuar me të atilla pamje. Biri im, këtu mund të strehohesh vetëm për një muaj. Ndërsa për të ngrënë mund të vish kur të duash. A e di se ç'është kisha dhe si respektohet ajo? Vili i tha se e dinte dhe se besonte te Zoti.

Prifti i tregoi një dhomë të madhe, të thjeshtë, me disa shtretër, në murin ballor të së cilës qe vendosur një kryq i madh. Vili iu afrua një krevati të pazënë dhe la çantën mbi një komodinë të vjetër. Nga ora 19 mund të zbresësh për të ngrënë, foli njeriu i Zotit duke u larguar.

Ai ndenji shtrirë për ndonjë orë, me vështrimin fiksuar në tavan. E përmendën këmbanat shungulluese të kishës. Zbriti poshtë në mencë me një ndjenjë pasigurie. Nuk po mësohej dot me faktin se ndodhej aty si një lëmoshëkërkues. Në tavolinat e gjata qenë ulur rrëth 40 vetë. Nga shprehja e fytyrës dukeshin të gjithë njëlloj. I mbanin kokat ulur. Kishte aziatikë, amerikano-latinas, rusë, rumunë dhe ndonjë zezak tek-tuk.

Vili dalloi një grup shqiptarësh dhe u ul pranë tyre. Përshendet. Ata ia kthyen përshëndetjen thatë. Hëngri me ngut një pjatë supë, pastaj një gjellë të dytë me patate. Vuri re se te porta e mencës po prisnin të pastrehë të tjerë. Zot, na sill ndonjë gjë të mirë nesër, mërmëriti pastaj.

Por të nesërmen nuk pati asgjë të mirë. Të pasnesërmen po ashtu dhe për disa ditë të tjera me radhë. Idea e ikjes nga ai qytet filloj ta ngacmonte gjithnjë e më shumë. Iu duk se aty nuk do të gjente punë kurrë.

Situata u përbys papritur kur një mbrëmje, në një nga rrugët kryesore të qytetit, Vili pa të zbriste nga një veturë luksoze një tiranas simpatik me të cilin ishte njohur një të dielë tek shëtiste nga zona e portit. I foli. Tjetri u ndal dhe e takoi miqësish. Eja, tha, të pijmë nga një birrë. Sonte jam në qejf. Jeta është e bukur kur di të mashtrosh.

Vili pandehu se ai kishte pirë. I hapi pa vonesë hallin e punës. Nuk u besoi veshëve kur tiranasi tha se mund të ndreqnin diçka. Pronari i tij kishte nevojë për njerëz. Ishte fjala për një kantjer të madh ndërtimi në periferi të Gjenovës.

- A më pe kur zbrita nga ajo BMV-ja e bukur? - pyeti tiranasi pasi u ulën në një bar.

- Po, - tha Vili. - E kujt ishte?

- E dashnores time, - u përgjigj tjetri me mburrje. - Është një dyzetvjeçare që shtiret si qejflie.

- Italiane?!

Tjetri pohoi duke qeshur i kënaqur.

- Po si u sajove me të?

- Ah, mor vëlla! Femrat të afrohen me vrap po t'u thuash që je i pasur. I këputa një rrenë të fuqishme sikur jam nipi i ministrit grek të turizmit. Pra, unë jam grek. E kuption? Im atë ka një plantacion të madh agrumesh në periferi të Selanikut. Ajo mbeti gojëhapur. Bëri vickla nja dy herë, pastaj, herën e tretë, më futi në krevat. Kurva! Kishte një

shtëpi fantastike! Për seks është koti fare, megjithatë, ia vlen. Unë nuk kam para për të paguar prostitutat. Në jetën time nuk do të paguaj kurrë për seks. Përkundrazi! Kurvat do të paguajnë përmua. E kupton? Kjo është filozofia e mashtimit. Sot duhet të mashtrosh se ndryshe të mashtrojnë të tjerët ty.

Vilit iu kujtua barezi i qelbur i pllakave që i kishte përlarë 2 milionë lireta dhe tiranasi iu duk vërtet njeri i kohës. Tipa si ky duhen për këtu dhe jo unë, mendoi.

- Po... nuk ke frike se të denoncon në polici? - pyeti pastaj.

Tiranasi qeshi gjatë duke thënë si italianët: ma va fa n'kulo me polici e me atë kurvën. E çdo të më bëjnë? Do të më fusin në burg për seks? Unë i kam premtuar asaj se në verë do ta marr me vete për të parë plantacionin e agrumeve. Në se më zbulon, no problem, gjemë një tjetër.

Vili u kthyte në kishë si i trullosur, i bindur se ishte njeriu më i ngathët në botë, se Alba do të ishte plotësish e larë po t'i largohej. E ç'mund të priste prej tij? Romane? Apo përkthime? Ato që vendosnin gjithçka në parajsën italiane, nuk ishin ndjenjat dhe fjalët e bukura, por paratë. Pa para përfundoje rrugëve ose në kishë së bashku me lloj-lloj emigrantësh të largët e lypësish.

Të nesërmen, që në mëngjes herët, u takua me tiranasin në stacionin qëndror të autobuzëve. Mbërritën në një kantjer të rrëmuishëm ku me sa dukej po ndërtohej një fabrikë.

- Pronarit do t'i thuash se je murator. Do të pranosh të punosh në të zezë. Në se ndodh ndonjë aksident, do Zoti jo, i gjithë faji bie mbi ty dhe nuk duhet të bësh asnje lloj denoncimi.

Ato ishin porositë e fundit të tiranasit. Vili do të kishte pranuar edhe sikur të ishte fjala për të punuar në ndonjë fabrikë eksplozivësh.

- Dua vetëm një siguri, - tha. - Paratë.

- Paratë janë të sigurta, - ia ktheu tjetri.

- Pra, ti je murator, je? - ia bëri pronari duke e vështruar shtrembër. Ishte i ri në moshë dhe kishte një fytyrë të mufatur. Dukej sikur kishte ditë pa fjetur dhe i jepte siklet çdo gjë rrretherrotull.

- Të gjithë kështu thoni ju dhe pastaj nuk dini të ngrini një copë mur. Hajt, shko njëherë manoval së bashku me atë shqiptarin tjetër!

Pronari nuk ia hodhi më sytë.

Një brigadier e caktoi t'u shërbente dy muratorëve njëherazi. Ata ishin të së njëjtës prerje: zevzek, turivarur, shanin, pinin duhan dhe nuk të vështronin në sy. Vili filloi të vraponë poshtë e lartë për të mos i lënë pa llaç e tulla.

Në mbrëmje, me të zbritur nga autobuzi, u fut i gëzuar në një kabinë telefonike për ta njoftuar Albën se kishte filluar punë. Në atë orë governantja nuk ndodhej në vilë. Por befas u dëgjua zëri i Sartorit. U lëkund disa çaste. Desha Albën ju lutem, tha pastaj. Jam Vili. Ah, më vjen keq, Alba ka dalë me të fejuarin e saj, u përgjigj zonja. Ai nuk u besoi veshëve.

- Jeni e sigurtë? - pyeti i tronditur.

- Tepër e sigurtë. - u përgjigj tjetra, pastaj uli telefonin.

Nuk ka mundësi, mërmëriti ai, nuk është e vërtetë. Plaka ka lajthitur. Por pas tronditjes së parë gjithçka iu duk e besueshme. Ishin një varg detajesh që të çonin në përfundimin e zonjës. Ai e kishte provuar në kurriz të tij fsheh-tësinë dhe dinakérinë me të cilën femrat të linin hijen, pa denjuar të thoshin edhe lamtumirë. Por largimin e mundshëm të Albës e kishte imagjinuar tepër fisnik. Ajo do ta vështronte drejt e në sy dhe do t'i thoshte copë: Vil, më vjen keq, nuk mundem më, po iki. Ata do të përqafoheshin për herë të fundit dhe do të thoshin lamtumirë. Fundja, nuk i kishin premtuar asgjë konkrete njëri-tjetrit. Vetëm kishin vendosur të ecnin së bashku në rrugën e parajsës italiane.

\* \* \*

Vendosi të priste deri të shtunën. Me të lënë punën në mesditë, u la e pastrua aty në kantjer dhe u nis drejt e në stacion të trenit. Ndjehej disi më i qetë. Besonte se Sartori kishte lajthitur, ndërsa governantja e urrente. Ndoshta i kishte ardhur në majë të hundës nga telefonatat e tija. Fundja, në vilat e të pasurve nuk mund t'i bije telefonit kur të të tekej.

Ai i mendoi të gjitha këto me dhjetra herë deri sa mbërriti në Pieve Ligure. Mori drejt Vilës së Trëndafilave me hapa të mëdhenj. Qëndroi para portës së madhe metalike për disa minuta, pastaj i ra ziles gjatë. Nuk mori përgjigje. E shtypi butonin disa herë radhazi, por më kot. Filloi të vërtitej para portës i nxehur. Për një çast iu duk se perdja e një dritareje lëvizi.

U ul në bordurën pranë portës dhe vendosi të priste. Ndoshta Alba kishte dalë me Sartorin dhe mund të kthehej. Pas perdes duhej të kishte qenë e fshehur governantja. Alba nuk mund ta bënte atë gjë.

Por ndërkohe ia mbërriti një veturë e karabinierisë. Dy karabinierë simpatikë zbritën prej saj dhe i kërkuam dokumentat. Vili u tregoi qetësisht kartidentitetin dhe leje-qëndrimin. Atëherë ata e pyetën pse po rrinte aty, para portës. Pres të fejuarën, u përgjigj ai. Ajo punon këtu.

- Ne jemi njoftuar se jujeni një person i huaj, - tha njëri prej karabinierëve që dukej më i ri. - Nuk mund të rrini këtu. Është pronë private.

- Unë po qëndroj në rrugën komunale, - ia ktheu Vili. - Këtu nuk cënoj askënd.

- Na vjen keq, - foli karabinieri tjetër. - Po nuk u largove, do të detyrohem i të marrim me vete në kazermë.

Vili u bind.

Të dielën e kaloi mbyllur brenda në kishë, duke fjetur kohë e pa kohë. Të hënën u nis për në punë i mërzitur. Kundër dëshirës së tij, Alba i shfaqej para syve duke bërë dashuri me nipin e Sartorit. Ajo fanitje i kishte ndodhur edhe një herë tjetër më parë. Instiktivisht, ai provonte një urrejtje të pafrenueshme për italianin. Qen, mos e prek, gati sa nuk thërriste. Mos e prek se do të të vras!

Ndërsa punonte majë një skele në kat të dytë, iu fiksua se të shtunën, kur ai kishte shkuar për ta takuar, Alba kishte qenë me nipin e Sartorit në ndonjë vend të bukur. I hutuar, nuk po shikonte ku shkelte. Në atë vendin e bukur, ata të dy... Papritur ndjeu këmbën t'i hynte në një boshllëk. Kova e rëndë e llaçit e mori me vete. Ra anash. Provoi të mbahej te hekurat anësorë, por nuk mundi. E pa veten duke rënë mbi një pirg të madh mbeturinash ndërtimi dhe zgjati duart për të mbrojtur kokën.

U përmend vetëm në spital. Ndjeu një dhimbje të fortë në krahun e majtë dhe në shpatull. Ndodhej i shtrirë në një krevat. Pranë i kishin qëndruar dy njerëz veshur në bojqelli. Njëra ishte Alba me flokët e mbledhur topuz mbi kokë, ndërsa tjetri... me siguri nipi i Sartorit.

Ata po i buzëqeshnин. Ai provoi të ngrihej, por nuk mundi.

- Ti maskara nuk ke punë me Albën, - foli. - Ajo është imja.
- Sigurisht që është jotja, - u përgjigji tjetri. - Përpiku të qetësoshesh.

Vili i hapi sytë edhe më. Vuri re se vajza nuk ishte Alba, por një infermiere. Ndërsa tjetri dukej se ishte mjek. Atëherë atij iu kujtuan të gjitha. Më fal, mërmëriti. Si dukem, a kam pësuar gjë serioze? Keni nxjerrë shpatullën e majtë, foli mjeku. A mund të na tregoni si ndodhi aksidenti? Atij iu kujtua porosia e tiranasit që i kishte gjetur punën, se në rast fatkeqësie pronari nuk duhej denoncuar. U rrëzova me

biçikletë, tha. Dhe rrobat i kishe me llaç, vazhdoi mjeku. Rastisi, po kthehesha nga puna, këmbënguli Vili në gënjeshtren, e tij.

- Nuk je i pari që gënjen kështu, - tha mjeku dhe u përkul për t'i parë shpatullën. - Veçse gënjeshtra është tepër naive. Si të duash! Ne nuk të detyrojmë të thuash të vërtetën. Atë e dinë të gjithë në këtë vend që po zhytet në baltë.

Vili nuk u ndie.

- Pas nja dy ditësh mund të dalësh, - vazhdoi mjeku. - Përpiku të mos e sforcosh shpatullën dhe krahun. I ke të fiksuar me hekur dhe allçi.

Vili ia nguli sytë i tmerruar.

- Për sa kohë mund të shërohem plotësisht? - pyeti.

- E pakta dy muaj. U trembe, ë? Punoje në të zezë dhe tanë nuk do të përfitosh raport mjeksor.

- Po për spitalin, duhet të paguaj?

Mjeku e vështroi me keqardhje.

- Jo, - tha. - Paguan shteti italian që të krijoi mundësi të vriteshe. Është paradoksale. Apo jo?

Vili nuk guxoi ta vështronte.

- Faji qe i imi, - tha. - Unë nuk kam gjë me shtetin italian. Përkundrazi, i jam mirënjohës. Shteti jeni ju, italianët që paguani taksa.

Tjetri buzëqeshi miqësisht.

\* \* \*

Nga mbrëmja në spital erdhi tiranasi i kantjerit.

- Më vjen keq, - tha. - Mbase bëra gabim që të çova në atë kantjer të qelbur. U përpoqa t'i zhvasja atij zagarit ndonjë lek më shumë, por nuk pranoi. Më dha vetëm 400 000 lireta për katër ditë punë.

Vili ngriu.

. - Si... vetëm... vetëm 400 000 lireta?! As ditën e sotme nuk e quajti?!

- Jo. Tha se aksidenti ndodhi në mëngjes dhe...

Vili pshëretiu gjatë e gradualisht për të mos ndjerë dhimbje.

- I poshtri! - shau. - Edhe kalë lufte të kisha qenë...

- Atij s'i bëhet shumë vonë për kokat tonë, - tha tiranasi.

- Viktima si puna jonë ka plot.

- Ky nuk është kapitalizëm, por kafshëri!

- Lere, mos e vrit mendjen. Ne nuk kemi ardhur këtu për të ndrequar Italinë. Kështu e gjetëm dhe duhet të përshtatemi. Ti e di nga biologja ç'ndodh me ata që nuk përshtaten.

Vili u mundua të queshte.

Kur doli nga spitali, iu duk vetja tamam si invalid. Nuk dinte si ta shtynte ditën. Për të lexuar e përkthyer nuk ndjente asnje lloj shtytjeje. Idea e kthimit në Shqipëri rifilloi ta ngacmonte më dendur. E mbërtheu një gjendje e rëndë dëshpërimi. Një mbrëmje i shkroi Albës një letër të gjatë ku i shpjegonte se po detyrohej të kthehej mbrapsht dhe se ajo ishte e lirë të martohej me nipin e Sartorit. Por në mëngjes e grisi atë dhe idea e kthimit në shtëpi iu duk një dorëzim frikacaku. Vendosi të duronte akoma.

Gjendja shpirtërore iu përmirësua disi kur prifti që e kishte pranuar në kishë, e pa një mëngjes me krah të lidhur dhe e pyeti në se kishte nevojë për ndihmë. Vili iu lut që ta lejonin të strehohej në kishë deri sa të shërohej. Të qëndrosh biri im, tha ati. Vili e falënderoi dhe për disa ditë kaloi një fazë qetësimi.

Por pastaj, dalëngadalë, ndjeu se si merzia po e pushtonte rishtazi. U plogështua. Cigaren e shpeshoi. Rrinte mbyllur. Nuk i duronte dot zhurmat dhe rrëmujën. Kur nuk binte shi, pjesën më të madhe të kohës e kalonte nga porti, duke parë anijet që shkonin e vinin. Pas çdo dite që kalonte, Alba

bëhej përherë e më e largët. Atij filloi t'i dukej normale që ai tjetri ia kishte marrë. Asaj nuk guxonë t'i vinte faj. Kishte raste që dashuria e tyre i dukej si një ëndërr, që befas kishte mbaruar, siç mbarojnë një ditë të gjitha ëndërrat. I dukej sikur ajo histori nuk kishte ndodhur, nuk i përkiste atij.

Vendosi të mos i telefononte më.

Filloi të mendonte rishtazi për t'i dërguar një letër të gjatë. Një mbrëmje, ndërsa po thurte në kokë njëren frazë pas tjetrës, befas vuri re se rrugët e qytetit dhe vitrinat qenë zbukuruar e ndriçuar fort. Sytë i shkuante një reklamë e madhe e një firme të njojur që afronte panetone të mrekullueshëm me bajame e rrush të thatë. Vetëm atëherë iu kujtua se të pasnesërmen ishin Krishtlindjet.

## 12.

Alba qëndroi para pemës së madhe të Krishtlindjeve, të zbuluar me llampushka ngjyra-nga, pa ndjerë asnjë lloj emocioni. Gouvernantja që vërtitej poshtë e lartë nëpër sallën e madhe të ndenjies, i buzëqeshi me shtirje.

- Zonjushë, këto Krishtlindje më duket se do të të sjellin një dhuratë të madhe, - tha pa pikën e taktit, duke nënkuptuar lidhjen me nipin e Sartorit.

Alba e mbajti nëpër dhëmbë një të sharë. I ishte kriuar bindja e plotë se gubernantja duhej të ishte sjellë si harbute me Vilin në telefon. Ndryshe nuk kishte si shpjegohej një heshtje aq e gjatë nga ana e tij.

Por gubernantja nuk ishte për të vënë edhe aq faj po të mendoje se Sartori vetë kishte kriuar një situatë tepër revoltese, me një mënyrë tepër cinike, të cilën Alba nuk kishte mundur ta besonte. Një ditë, ndërsa po priste ndonjë lajm nga Vili, për dreq telefoni kishte rënë pikërisht kur ajo ndodhej në banjo. Kishte nxituar nëpër shkallë, por ndërkokë zonja e kishte ngritur atë. E shtangur, Alba kishte dëgjuar të përmendej emri i saj, pastaj fjalët: "Ka dalë me të fejuarin e saj".

Ajo qe ulur te shkallët, pa arritur ta shpjegonte dot atë sjellje të Sartorit. Por dalëngadalë qe kthjelluar dhe e kishte kuptuar se zonja po e ndihmonte të merrte vendimin e duhur në favor të të nipit. Ksante dashur të zbriste poshtë për t'i thënë Sartorit se nuk kishte të drejtë të sillej në atë mënyrë.

Por nuk kishte guxuar. Në të vërtetë, diku thellë, kishte provuar një lehtësim djallëzor që Sartori kishte gjetur atë zgjidhje. Kot e lodh veten, kishte menduar. Më pëlqen të lidhem me nipin e saj...

Renato do të vinte në Pieve për të kaluar Krishtlindjet dhe ndoshta do të kërkonte diçka më shumë. Dy herët e fundit që kishin dalë bashkë, ai i kishte lënë të kuptonte se ishte i bindur për një përgjigje pozitive. Një të shtunë kishin shkuar në kishën e bukur të Montalegros, mbi Rapalo. Kishin shëtitur nëpër pyll dhe kishin ngrënë drekë në një restorant përballë detit. Ajo kishte pirë verë më tepër nga ç'duhej dhe pasi ishin ngritur, ai e kishte ftuar të shlodheshin në një nga dhomat e hotelit mbi restorant. Alba kishte refuzuar prer, duke u penduar që kohët e fundit kishte filluar të pinte verë me tepërim. Ajo i dukej e vetmja mënyrë për të humbur mendjen e për të fjetur natën pa shqetësime.

Alba ndenji ca pranë pemës së zbukuruar, pastaj u ngjit për t'u veshur. Hyri në dhomë gati me frikë. Mbi krevat kishin mbetur të hapura letrat e ardhura, së fundi nga prindërit, motra e madhe dhe Gerta. Jo më larg së atë mëngjes i kishte rilexuar ato për të pestën apo të gjashtën herë. Siç e kishte parashikuar, letrat nuk kishin ndryshuar asgjë. Ajo vazhdonte të ishte e lëkundur.

Nga të gjitha letrat, vetëm ajo e motrës së madhe anonte dukshëm nga Renato. Shembulli im duhet të të bëhet mësim, i shkruante ajo. Një djalë shqiptar vërtet mund të të dashurojë fort, por ajo dashuri do të jetë e shoqëruar me mundime e sakrifica. Unë jam 30 vjeçë dhe koka po më mbushet me thinja. Kam dy fëmijë të vegjël për të rritur. Pardesyja e vetme që kam, po më griset, ndërsa këpucët më fusin ujë. Dhe jam mësuese Anglishte! Pika që s'më bie! Ti e di fare mirë që unë jam martuar me dashuri. Tani nuk jam penduar për këtë, por ndjehem tepër e lodhur, e zhgënjer, më duket se përpara

s'do të ketë më asgjë të bukur...

Letra e motrës ishte e mbushur me pesimizëm dhe një lloj ironie për dashurinë. Nuk të këshilloj një dashuri me sakrifica, i kishte shkruar ajo. Renaton nuk duhet ta humbësh. Nuk do të ta falja një gabim të tillë. Aq më tepër që atij shqiptarit nuk i ke premtuar asgjë konkrete dhe ai është i ndërgjegjshëm për këtë. Hiqe nga mendja idenë e kthimit këtu në se do që koka të mos të mbushet me thinja...

Në letrën e nënës kishte një neutralitet të dhimbshëm. Unë nuk mund të të them të lësh shqiptarin për hir të italianit, i shkruante ajo. Je ti që duhet të përpinqesh të mos gabosh. Por fakti që italiani është i nipi i zonjës Sartori më ngroh. Zonja është me përvojë. Më duket se duhet ta dëgjosh atë. Besoj se ajo të do të mirën...

Ndërsa letra e babait ishte më e qeta. Vë re nga letra jote se je shumë e tensionuar, i shkruante ai. Këtu nuk ka vend për alarm. Njeriu është vetvetja. Ai bën atë që ka në natyrë. Ti ndiq instiktin tênd. Në se gabon në zgjedhje, shumë shpejt do ta kuptosh këtë gjë dhe do të fillosh të kërkosh vetveten. Përpiku të mos i krijosh drama vetes, edhe në se gabon. Fundja, në jetë bëhen gabime. Do të të këshilloja vetëm një gjë: përpiku të jesh e barabartë me atë që do. Mos u tundo ngajeta e rehatshme dhe paratë. Dhe e fundit, mos hiq dorë nga plani për të mbaruar fakultetin, kudo që të jesh...

Alba filloi t'i mbledhite letrat tok. Atë të Gertës e hapi edhe një herë. E kishte pritur sinqeritetin e saj. Të betohem se nuk e di ç'do të kisha bërë sikur një pasanik apo një njeri me një farë pozite të vinte te dera e picerisë dhe të më propozonte, thoshte ajo. Nuk e di në se do të lëkundesha dhe dashuria për Arnoldin do të pësonte ndonjë deformim. Të kuptoj, je në një pozitë tepër të vështirë. Nganjëherë, në jetë ndodhin gjëra për të cilat nuk jemi përgatitur. Por unë

kam besim se herët a vonë ti do të bësh një zgjedhje të drejtë. Në letër më kishe ngritur dy herë atë pyetjen e vjetër: prostitutë lindesh apo bëhesh gjatë jetës. Mbetem e mendimit se prostitutë lindesh...

Alba i futi letrat në sirtar dhe filloi të vishej, pa e patur mendjen te rrobat që zgjidhte. Pas pak jashtë, te porta e madhe u dëgjua boria e makinës së Renatos. Në vetratën e madhe shkëlqyen ngjyrat e fortë të fishekzjarreve të para. Po ndërrrohej data 24 dhjetor me 25-ën. Sartori mori e para një gotë të madhe verë duke thënë e mallëngjyer: gëzuar Krishtlindjet vogëlushët e mi. Zoti ju bekoftë! Gëzuar hallë Ana, tha Renato. Gëzuar, iu përgjigj edhe Alba.

Ata ishin ulur të tre në tavolinën e madhe të sallës së ndenjies, e cila shtrohej rrallë, vetëm për raste festash. Alba ndjeu vështrimin ngulmues të Renatos.

- Dalim? - pyeti ai. - Kam sjellë ca fishekzjarre.

Ajo pranoi. Dolën të dy në oborrin e madh të vilës. Ishte një natë e ftohtë dhe e kthjellët. Qielli ndriçonte ngado. Kishte raste që ndriçimi ulej deri poshtë në det dhe ai dukej mahnitës, i lyer në të kuqe të ndezur, jeshile, të verdhë. Alba mbajti me të dyja duart një fishekzjarre në formë tubi, duke e larguar sa më shumë nga fytyra, sikur ajo të ishte ndonjë granatë. Renato e ndezi me një çakmak. Fishekzjarrja lëshoi një shpërthim të lehtë, disa fjolla tymi, pastaj fluturoi lart brenda sekondit. Alba klithi njëherë e trembur, pastaj, kur fishekzjarrja plasi tutje në qiell, duke u shpërndarë në dhjetra shkëndijime të veçanta në formë këpurdhe, buzëqeshi e lehtësuar.

- Qenka bukur, - tha. - Më jep edhe një tjeter.

Renato i la në duar të njëjtin tip fishekzjarreje. Ajo e ndezi vetë, duke provuar emocione edhe më të forta.

- Edhe një tjeter! - iu lut Renatos. Ai ia dha duke qeshur. Ndërkohë ajo ndjeu një dëshirë të papërbajtur për të

harruar gjithçka dhe për ta gëzuar atë natë sa më shumë. Filloi të therriste si fëmijë dhe të përplaste duart kur fishekzjarret shpërthenin lart me ngjyra verbuese.

- Bëre një luftë të tërë, - tha Renato. - Mos kërkoi më se nuk kam.

- Si?! U mbaruan? - ia bëri ajo me keqardhje. - Me fal, harxhova edhe të tuat.

- S'ka gjë, - ia ktheu ai. - Rëndësi ka që u kënaqe.

Ata qëndruan pranë njëri-tjetrit duke ndjekur me sy shpërthimet nëpër qìell. Në një moment dobësie Alba u pështet në supin e tij dhe Renato i hodhi krahun. Ai e puthi në flokë i pasigurtë.

- Sonte po më habit, - mërmëriti. - Dukesh e lumtur si një fëmijë. Rrallë të kam parë kështu. Tani je Alba e vërtetë apo kur rri e mërzitur, me ball të rrudhur e sy të lodhur?

- Hymë brenda, - tha ajo. - Bën ftohtë.

Kur mbeti e vetme përballë tij, Alba ktheu një gotë të madhe me verë, duke gjetur në të të vetmen aleate. Iu lut Renatos t'i tregonte diçka nga Bibla dhe sa besonte ai në faktin që Jezui qe ngjizur me frymën e shenjtë. Tjetri pranoi, ndonëse pa ndonjë dëshirë të veçantë. Alba po e dëgjonte pa vëmendje. Koka iu turbullua.

- Jezui ka qenë simpatik, - tha. - Ka sy goditës.

Tjetri pohoi me kokë.

- Sikur... të vinim ndonjë disk? - tha pastaj.

Ajo e vështroi në mënyrë lutëse.

- Sikur të më lejoje të shkoja. Më flihet.

- Si të duash.

Ai e shoqëroi deri pranë shkallëve të katit të tretë. Aty, e ktheu nga vetja dhe i pasigurtë e puthi si më parë në oborr. Ajo nuk lëvizi. Tjetri kërkoi buzët e saj, por Alba u têrhoq vrulltazi.

- Të lutem! - tha. - Më ler!

Renato u bind.

- Nuk po më thua ndonjë gjë të bukur? - pyeti.
- Ndonjë ditë tjetër, - ia ktheu ajo duke bërë përpjetë shkallëve. - Gëzuar Krishtlindjet! Dhe dije se Jezui duhet të ketë patur ndonjë të dashur. Jam e sigurtë për këtë.

Ajo arriti të mbyllte derën nga brenda, shkoi deri te krevati duke u lëkundur, pastaj fjeti veshur siç ishte.

Të nesërmen u kujtua për ato që kishin ndodhur dhe kur vuri re se dera qe mbyllur nga brenda, u qetësua disi. Hyri në banjo, dhe gjëja e parë që i ra ndër mend kur pa veten në pasqyrë, qe prostituta me fat e librit të verdhë të lexuar kohë më parë në trenin e linjës Gjenovë-Milano. Deformoi fytyrën, pastaj, si edhe herë të tjera kur kishte brerje të forta ndërgjegjëje, i foli vetes me përcëmim: Iris, o Iris, pive dje se ishte festa e Jezuit apo që të kishe argumente mbrojtës për ç'mund të ndodhë?

Kur u ngop së përqeshuri veten dhe e kuptoi se nuk ishte në gjendje të qante, bëri një dush për t'u kthjelluar disi. Zbriti poshtë e vrenjtur. Renato po e priste duke buzëqeshur, por kur vuri re pamjen e saj, u step.

- Nuk je më ajo e djeshmjë, - tha me një ton të ftohtë. - Po e lodh veten jashtë mase. Më në fund duhet të marrësh një vendim.

Ai kishte të drejtë. Por mënyra se si e kërkonte marrjen e vendimit ishte acaruese, poshtëruese. Renato kishte një besim të tepëruar se ajo do t'i përgjigjej pozitivisht, ashtu si edhe Sartori që e kishte bërë gjithçka fakt të kryer. Pa dashjen e saj ata e kishin futur në ca rrëthana torturuese, i kishin shkaktuar aq lodhje e dhimbje koke sa që kishte raste që ajo donte të merrte çantat e t'ia mbathte nga sytë këmbët pa u përshëndetur me rjeri.

Por ndoshta ata nuk do të kishin këmbëngulur në ofertën e tyre po sikur ajo t'ua kishte prerë që në fillim, të mos u

kishte lënë të kuptionin se po lëkundej, se ishte tunduar nga lidhja me trashëgimtarin e vetëm të një zonje të pasur.

Disa herë radhazi e bindi veten se fajtore ishte vetë për gjithçka. Se ishte sjellë në mënyrë të ulët ndaj Vilit dhe Renatos njëkohësisht. Për disa ditë pati një lloj kthjellimi. Iu zgjua dashuria dhe malli i vjetër për Vilin. Provoi rishtazi atë e tjetër e parë për të bërë dashuri me të, një etje të natyrshme femërore për të arritur një orgazmë të ëmbël, të cilën s'ë kishte gëzuar prej javësh të tëra. Iu duk se po të vonohej edhe ca, do ta humbte Vilin përfundimisht.

Vila e Trëndafilëve filloi t'i zbehej, t'i dukej e ftohtë, e huaj, dhoma t'i ngjante si burg. Governanten filloi ta krahasonte me një gardiane, ndërsa Sartorin me një drejtoreshë staliniste gjimnazi që kishte patur dikur në Tiranë. Kujtimet e saja filluan t'i dukeshin sajme të shpifura e të stërgjatura, dashamirësia e saj një hipokrizi.

Filloi të ndjente neveri për gjithçka rrëth e rrötull, bile një ditë desh ia ngeshi me shqelm edhe kones së llastuar të Sartorit, e cila ishte bërë edhe më aristokrate se më parë në shtrirjen, dhe lëvizjet e saja. Dëshira për t'ia mbathur nga ajo vilë dhe nga ata njerëz të huaj iu bë edhe më e papërmabjatur.

Mëngjesin e një të diele janari, pas një nate të lodhshme, gjatë së cilës ajo nuk e kishte kuptuar dot në se kishte fjetur apo jo, shkoi drejt telefonit tepër e qetë dhe e kthjellët. Kishte vendosur t'i jepte Renatos një shpjegim të shkurtër e të prerë, duke e paraqitur refuzimin e saj si vendim përfundimtar, duke iu lutur që të mos fyhej dhe ta kuptonte drejt. E formoi numrin e tij pas asnjë lloj emocioni. Priti gjatë me telefonin pranë veshit, por nga krahu tjetër nuk iu përgjigj njeri. Ajo vetëm nënqeshi.

Çdo gjysmë ore i ra telefonit me këmbëngulje, por më kot. Pak para mesditës u vesh me ngut dhe i tha Sartorit se

duhej të dilte për një problem. Mori trenin e Gjenovës dhe e mbajti fryshtën drejt e në rrugën "Pre" ku mblidheshin shitësit ambulantë zezakë. Dikush i tregoi se ku mund ta gjente kamerunasin Ngea. Ajo nxitoi nga stacioni qëndror i autobuzëve. Atë ditë të gjithë afrikanët po i dukeshin njëlloj. Iu afrua dy zezakëve shtatlartë që po shisnin shalle.

- He, he, unë Ngea, - qeshi njëri prej tyre. - Ti e fejuara e Vilit. Unë mbaj mend.

Alba iu lut ta ndihmonte për të gjetur Vilin. Me një pamje të menduar Ngea u përpooq me shenja t'i tregonte se si mund të arrinte më shkurt te kisha e emigrantëve.

Ajo iu afrua një porte ku hynin e dilnin njerëz. Vështroi njëherë nëpër një korridor të gjatë e të errët, pastaj bëri para. U gjend në një mencë të madhe. Disa djem ngritën kokat sa po e panë dhe e sulmuani me vështrime të etura.

Ajo i kaloi me sy të gjithë emigrantët dhe vetëm herën e dytë e njoihu Vilin. Nuk mundi t'u besonte syve. Ai ishte dobësuar edhe më, flokët e gjatë i binin mbi jakën e një xhupi të palarë prej kohësh. Nga që ishte i parruar, dukej edhe më i drobitur. Po hante i uritur një pjatë supë. Ajo iu afrua. Vili nuk e vuri re. Ishte krejt i hutuar. I ktheu sytë vetëm kur ajo i qëndroi pranë dhe luga i ngriu pranë gojës. Supa ra çurg në pjatë. Ajo vuri re se si buzët e tij u drodhën dhe ai bëri një sforçim të mundimshëm për të mbajtur veten. Albës iu mbushën sytë me lotë kur pa krahun e tij të lidhur.

- Vil, - mërmëriti, - ç'të ka ndodhur kështu?

Iu ul dhe filloi ta prekte me dorë sikur nuk po bindej që e kishte pranë. Ai iu lut ta priste pesë minuta. Mbaroi së ngrëni me ngut, pastaj e ftoi të dilnin. Morën drejt portit.

- E dija që do të vije, - tha Vili i lehtësuar. - Bëre mirë që nuk u vonove më shumë. Ndoshta nuk do të më kishe gjetur.

- Ç'do të thuash? - pyeti ajo.

- Unë jam burracak. Po mendoj kthimin në Shqipëri.

- Je i sigurtë?!

- Po.

Ajo vështroi profilin e tij të hequr.

- Mos... për shkakun tim... të ndodhën të gjitha këto terslliqe?

- Jo, - tha ai. - Ti s'ke asnë faj. Askush nuk më ka faj.

E pasigurtë, Alba zgjati dorën drejt dorës së tij. Vili ia shtrëngoi me ca gishta të thatë e të ftohtë.

- Ti nuk duhej të kishe ardhur pas meje, - foli. - Unë jam njeri i dobët.

- Unë kam pjesën time të fajit, - tha ajo. - Ndoshata pjesën më të madhe. Mund të kishim shpëtar po të kisha ikur me kohë nga Sartori. Vil, të kisha premtuar se nuk do të të gënjeja kurrë. Kam ardhur të të them të vërtetët.

- Po të prisja.

Ata hynë në port dhe zunë vend në një bordurë buzë detit. Aty pranë, mbi një motoskaf të vogël, qe ulur një çift pulëbardhash. Po luhej një skenë dashurie. Femra llastohej dhe mashkulli i vinte vërdallë.

- Vil, ajo vilë më vau, - tha Alba. - Ishte një realitet që nuk e kisha shijuar kurrë. Më kuption?

Në motoskaf mashkulli nuk po arrinte ta bënte dot për vete femrën. Papritur, aty ia mbërriti një mashkull tjetër.

- Të kuptoja, - tha Vili. - Ne vinim nga skamja.

- Por vrasja e vërtetë filloj kur erdhi nipi i Sartorit.

Mashkulli i sapoardhur në motoskaf filloj ta ngacmonte femrën me sqep.

Me sa dukej asaj filloj t'i pëlqente dhe iu përgjigj. Mashkulli i parë u nervozua dhe filloj të hidhej në veprim. Por femra i kthente krahët.

- Ti e tundove atë? - pyeti Vili duke u kthyer nga Alba. - Më thuaj, e tundove me këta sy kaq të bukur?

Ajo e vështroi ngultazi.

- Po, - u përgjigj. - Nuk e kuptova se si më ndodhi. Më shtynte diçka e mistershme. Nuk më kishte ndodhur kurrë më parë.

- Të besoj, - ia ktheu ai. - Me mua s'ke luajtur kurrë koketën, ndaj fillova të të doja.

Vili vuri re se mashkulli i parë, nga dëshpërimi, u bë agresiv dhe filloi ta godiste mashkullin e dytë për ta dëbuar nga motoskafi. Pulëbardha u hoq mënjanë dhe po vështronë e trembur se si ata ziheshin egërsisht duke këlthitur.

- Ke filluar ta duash? - pyeti.

- Jo, - u përgjigj ajo ftoht. - Vil, erdha te ty për të mos u kthyer më atje. Ndryshe nuk shpëtoj dot. Duhet të më ndihmosh.

Ai mbuloi fytyrën me dorën e lirë.

- Alba, ti duhet të kthehesh atje, - tha me një zë të shuar.

Ajo lëvizi vendit e tmerruar.

- Vil, çfarë po flet?!

- Unë nuk mundem të të ndihmoj. Të ardhmes time nuk i dihet. Ndërsa ai tjetri e ka të ardhmen e sigurtë. Unë nuk dua që ti të rrezikosh për hatrin tim.

- Vil, nuk po të njoh dot, - tha Alba me sy të shqyer.

Sulmet e mashkullit të dytë u bënë të papërballueshme. Mashkulli i parë filloi të tërhiqej. Femra anoi nga më i forti dhe filloi t'i jepte zemër duke këlthitur.

- As unë nuk po e njoh veten, - tha ai. - Atëherë, kur i hip arijes, isha i dehur nga idea e ikjes. Nuk e kisha menduar se ç'më priste këtu. Nuk po arrij të përshtatem. Italia nuk është rozë si nëpër imaginatat tonë të dikurshme. Kërkon specie të forta. Kurse unë, po ta përsëris, jam i dobët.

- Ti nuk je i dobët! - thirri ajo. - A nuk ishe ti që zbrite nga vaporë dhe më more atje poshtë, mes katrahurës?

- Atëherë ishte fillimi i aventurës. Isha gati t'i nisësha edhe detit me not. Kurse tanë...

Alba vështroi me inat nga pulëbardhat. Klithmat e tyre u bënë të padurueshme. Mashkulli i parë mori një goditje me sqep në kokë dhe u përgjak. Këmbët iu lëkundën dhe pas pak u largua. Fitimtari iu afrua femrës dhe e mori nën krahë duke gugatur me një krenari të egër.

- Vil, të lutem më shpëto! - foli Alba e ngashëryer. - Mos më ler të kthehem atje! Do të marrë fund gjithçka.

- Ti duhet të kthehesh, - nguli këmbë ai. - Unë nuk mundem të të afroj asnje zgjidhje. Nuk më shikon si jam katandisur? Më ler të humbas i vetëm. Të paktën të shpëtojë njëri. Unë jam pothuaj në kthim. Të kujtohet, të jam lutur një ditë që të mos më premtosh asgjë. Edhe unë nuk të premtova. Ti je e lirë. Nuk ke asnje detyrim ndaj meje. Shko e qetë. Jam unë që kam një lloj përgjegjësie ndaj teje. Nuk duhej të ishim afruar aq shumë.

Albës i shkuani rishtazi sytë te çifti i pulëbardhave mbi motoskaf. Ato po bënин seks me atë stilin e tyre shpezëror që në thelb nuk ndryshonte shumë nga ai njerëzor.

- Vil, më do vërtet? - pyeti.

Ai e vështroi thellë në sy, duke ndjerë brenda vetes humnerën e tmerrshme që do t'i shkaktonte humbja e saj.

- Të dua, - tha. - Si ty nuk kam dashur asnje vajzë në jetën time.

- Po atëherë, pse po më le?

- Pikerisht sepse të dua.

Për herë të parë Alba e vështroi me mosbesim.

- Nuk është e vërtetë! - thirri e dëshpëruar. - Ti nuk më do. Ty të ka tërhequr te mua vetëm femra. U magjepse pas seksit tim dhe kaq. Tani më thua shko, po të lë të lirë sepse të dua. Ç'është kjo sjellje e poshtër?

- Si, e poshtë?! Atëherë, le të gjejmë një rrugë të mesme. Përpiku të më presësh. Mbase...

Alba uli sytë.

- Sa duhet të të pres?

Ai nënqeshi lehtë.

- Një njeri që dashuron, pret. Mos guxo të më vesh kushte!

- Ti i di fare mirë rr Ethanat në të cilat ndodhem!

Sytë e tij shkrepëtinë dhe fytyra e hequr iu egërsua.

- Ah, ke frikë se të persekuojnë po t'i refuzoh nipi të Sartorit! Ç'tragjizëm! Po ti, nuk e sheh në ç'rrethana ndodhem?

Ku të të çoj? Ta mban të vish me mua në kishë?

Asaj i erdhën pranë buzëve fjalët "Unë kam kursyer ca para. Ne mund të ikim nga ky qytet tersi dhe të shkojmë në ndonjë vend tjeter". U mat t'i shqiptonte ato fjalë, por buzët nuk iu bindën. Një fuqi djallëzore i tërhiqte fjalët mbapsht. Provoi rishtazi, por më kot. Një instikt i egër egoizmi e mundi. Uli kokën për të mos e ngritur më. Jam e mbaruar, mendoi. Kot bëj skena. Nuk më pëlqen të rrezikoj.

U tërhoq disa hapa mbapsht sikur të kishte frikë se ai tjetri do ta mbërthente për të mos e lëshuar.

- Le të ndahemi si njerëz, - foli Vili. - Ti tashmë vërtet je e vrarë. Këtë ardhje e pate vetëm një ringjallje të përkohshme. Afrohu, më jep një të puthur. Kemi bërë goxha rrugë bashkë. Nuk mund të ikësh kështu.

Por ajo vazhdoi të tërhiqeja, pastaj u kthyte dhe vrapi si e ndërkryer. Kishte frikë nga vetja.

Vili e pa tek po largohej dhe në çastin e fundit ngriti dorën. U mat të thërriste, por fytì iu mbërthye, i dogji. Arriti të lëshonte vetëm një klithje të shuar. Iu duk vetja krijesa më e braktisur në atë vend të huaj të mbushur me anije dhe ftohtësi.

\* \* \*

Alba duhej të ishte krejt e shfytuar sepse kur u ndesh me Sartorin, zonja ia nguli sytë e tronditur.

- Të ka ndodhur gjë? - pyeti.

Alba u përpoq të mohonte.

- Dëgjo, - vazhdoi Sartori. - Le të jemi ca më të sinqerta. Nëse ai shqiptari të ka kërcënuar, ne mund të lajmërojmë policinë. Kam dëgjuar se shqiptarët sillen egër me vajzat, i detyrojnë të bëhen edhe prostituta sepse vetë nuk duan të punojnë.

- Falemnderit zonjë! - tha Alba. - Gjithçka është sinqruar. Nuk kam më asnje lidhje me të.

Ajo u ngjiit në dhomë dhe gjëja e parë që i ra ndër mend qe kthimi në shtëpi. Filloi të bënte çantat gati, por kur nuk kishte më gjë për të futur në to, iu kujtua letra e motrës së madhe dhe u kthjellua. I zbrazi çantat rishtazi.

Poshtë, nëpër shkallë, u dëgjua zilja e telefonit. Ishte Renato. Asaj iu duk një mrekulli që ai po e kërkonte pa ditur gjë përvendimin e saj të paradites. Sa mirë që nuk e humba, mendoi me atë pjesën më tinzare të trurit të vet. Ndërsa dëgjoi përshëndetjen e tij, u ngushëllua nga fakti se Renato e donte. Ndoshta më tepër se ai tjetri.

- Alba, më ke kërkuar paradite? - foli Renato. - Një fqinji im më tha se telefoni ka rënë disa herë radhazi.

- Po, - u përgjigj ajo. - Të kam kërkuar. Sikur... të vije nga e shtuna tjetër?

- Më pret ndonjë surprizë?

Në çast ajo ndjeu një dëshirë të egër hakmarrjeje ndaj Vilit.

- Po, - u përgjigj. - Do të martohem me ty.

Atë mbrëmje e kaloi pranë vetratës së madhe duke menduar për ata muaj të qëndrimit në Itali. Iu duk vetja tepër naivë që nuk kishte vënë mend nga braktisja që i kishte bërë studenti i Francës. Që atëherë duhej të ishte bindur se dashuria ishte diçka e përkohshme, një lloj sëmundjeje e shpirtit, një lloj epidemie gripi që një ditë kalonte dhe linte pas vetëm zhgënjim. Ajo kishte ikur për të kërkuar një jetë

të re dhe qe dashruuar me një njeri të panjohur, thjesht sepse ai kishte bërë një akt kalorsjak për ta ndihmuar të ngjitej në anije.

Por gabimi më trashanik kishte qenë se ishte lidhur me një njeri të marrosur pas letërsisë, me një romantik të vonuar që donte të hynte në një botë materialiste e të pamëshirshme me poezi e idealizëm. Nëse nisesh për të kërkuar një jetë të re në një botë egoiste, të komanduar nga ligjet e hekurta të parasë, duhet t'u nënshtronshesh atyre ligjeve, mendoi ajo. Duhet të lidhesh me më të fortin. Duhet të shkosh përpëra me llogjikë të ftohtë, pa brerje ndërgjegjeje dhe kompleksi faji. Kur more anijen nuk i dije shumë nga këto gjëra. Por tani që i mësove, duhet ta përcaktosh përfundimisht nëse more anijen e duhur apo jo.

Kur ra për të fjetur, e ndjeu veten më të lehtësuar dhe në mëngjes u zgjua e befasuar, pa atë dramën e kohëve të fundit: me Vilin apo Renaton. Tërë atë ditë dhe në ditët që pasuan, vazhdoi të bindte veten për përshtatjen që duhej bërë në botën e re ku kishte ardhur për të jetuar. Edhe Gerta iu duk po aq naive sa ç'kishte qenë ajo deri ca ditë më parë. Qe dashruuar marrëzisht me një Arnold picashpërndarës dhe kishte iluzionin se në Amerikë mund të shkoje përpëra me pica. E mjera ti Gertë, thoshte me vete. Një ditë dashuria, së bashku me picat, do të të vijnë në majë të hundës dhe atëherë do ta kuptosh se materia vret. Vret gjithçka.

## 13.

Era e shkurtit frynte nëpër rrugët e zbrazëta, duke e bërë edhe më të padurueshme vetminë. Vili shtrëngoi edhe më fort shallin nën mjekër dhe u kërrus brenda një palltoje të madhe stofi të cilën ia kishin dhënë në kishë. Për të shtyrë kohën, qëndronte kot para vitrinave.

Nga ora 21 hyri në stacionin e trenit dhe kërkoi për ndonjë stol bosh. U shtri në brinjë, duke e vënë kokën në çantën që mbante me vete. Ishte hera e dytë që vinte në atë vend ku mblidheshin plot lypës dhe të pastrehë.

Pas largimit nga kisha, kishte fjetur disa netë në një garazh ku punonte një shqiptar. Por e kishin pikasur dhe qe detyruar të largohet. Netëve të ftohta, ndërsa dridhej nën pallto, kishte vendosur të shkonte në kuesturë, të merrte një letër shoqëruese për të udhëtuar pa pagesë dhe të kthehet në Shqipëri. Por mëngjeseve, kur dilte jashtë, mes njerëzve, ndërronte mendje. Duro edhe ca, i thoshte vetes. Kushedi ç'del sot.

E vetmja shpresë e atyre ditëve kishte qënë shërimi i plotë. Pas vizitës së fundit, mjekët kishin thënë se mund të bënte përsëri nga të gjitha llojet e punëve.

Nga mëngjesi i doli gjumi nga të ftohit. Vështroi drejt një ore muri aty pranë. Ishte ende 5. U përpoq të flinte rishtazi, por më kot. Pas ndonjë ore doli. Pas ikjes nga kisha, kishte punuar vetëm një ditë. Kishte pastruar kopshtin e madh të një vile dhe kishte fituar 50.000 lireta. I mbante ato vetëm për cigare dhe për të ngrënë ndonjë fokaçë në mëngjes.

Drekën dhe darkën vazhdonte t'i hante në kishë.

Si gjithmonë, doli në një kryqëzim rruge ku mëngjeseve emigrantët e huaj prisin ndonjë sipërmarrës të vogël apo artizan për t'iu dhënë punë. Por ata ishin shumë. Zakonisht arrinte të gjente ndonjë punë ditore ose javore vetëm çerekur i tyre. Kishte raste që kërciste sherri. Emigrantët shtyhejshin njëri me tjetrin për të rënë sa më shumë në sy. I përshtatur me atë mjedis, edhe Vili kishte filluar të shtynte e të thërriste, por si gjithmonë humbte sepse sipërmarrësit preferonin muratorët.

Atë mëngjes ofertat qenë të pakta. Vili nuk arriti dot as të fliste me ndonjërin prej italianëve. E kaloi tërë paraditen rrugëve dhe kur gjunjët filluan t'i dhimbnin e stomaku t'i therte, mori drejt kishës.

Për një javë rresht kreu mekanikisht të njëjtat veprime, pa arritur të gjente qoftë edhe një punë disa orëshe.

Një mbrëmje, ndërsa po qëndronte struktur në vitrinën e një lokalitë shtrenjtë, futi dorën në xhep dhe pa i tmerruar se kishte mbetur me 2.000 lireta. Shungullima e disa këmbanave e përmendi. Ai u kthyte dhe vështroi nga një kishë aty pranë dhe ndërkohë disa pikë të akullta shiu i ranë në fytyrë. Iu duk se në atë qytet nuk kishte njeri më të mjerë se ai. Në ato çaste i erdhi ndër mend refreni i një këngë tepër të njojur italiane:

*Një endacak jam unë,  
endacak dhe asgjë më shumë.  
Me xhepat mbetur pa asnë qindarkë,  
por kam Zotin atje lart.*

Zot, bëj diçka, mërmëriti. Kam kaq kohë që të lutem. Nuk e kuptoi se sa kohë ndenji ashtu, me vështrimin fiksuar nga kupola e kambanares së kishës. Një vajzë i qëndroi pranë,

por ai nuk e vuri re. Vajza iu afrua edhe më.

- Vildan, je ti? - foli në shqip.

- Janë katër këmbana, - tha ai.

Vajza e mbërtheu për krahu.

- Vili, eja në vete! Ç'të ka ndodhur kështu? Më njeh? Jam Meri, shoqja jote e gjimnazit. Të kujtohet kur uleshim bashkë orën e letërsisë?

Ai vështroi drejt saj duke rrudhur sytë.

- Meri, a e di për kë bien keto këmbana?

- E di, - tha ajo duke e tërhequr për krahu. - Eja me mua tanë.

Ai e ndoqi pas pa kuptuar asgjë. Vetëm kur hynë në një apartament të ngrohtë e të bukur, u kthjellua disi. Vështroi veten, pastaj vajzën përballë dhe mjekra iu drodh.

- Meri, - mërmëriti, - të lutem më ndihmo! Më duket se po sëmurem.

Ajo filloj të qante.

- Do të të ndihmojë motra, - tha. - Prandaj të solla këtu.

Ajo i bëri me ngut një kafe dhe i mbushi një gotë uiski.

Vili e ndiqte me sy, pa i besuar akoma ato që po ndodhnin.

- Sa ke ndryshuar! - tha. - U bënë vite pa u parë. Pra, edhe ti paske ardhur në Itali?

- Siç më sheh.

- Me marsin?

- Jo, më herët. Nja një muaj pas ambasadave. Po ti?

Ai i tregoi gjithçka, duke shtrënguar mes duarve gotën e uiskit.

- Zoti im, ç'fat i poshtër! - psherëtiu Meri. - Nejse, tani mos e vrit mendjen! Do të gjemë edhe ndonjë punë. Dhe, ta hajë dreqi, mos shkruaj më poezi! Poezitë të heqin sensin e jetës. Kupton?

Ai pohoi kokulur. E kam kuptuar, tha me vete. Kam kohë që e kam kuptuar .

Meri përplasi duart dhe qeshi papritur.

- Ua, Vili, ç'do të kujtojmë tërë ato qyfyre! Sa mirë që të takova! E mban mend kur më bëje hartimet në gjimnaz? Do të kemi kohë të flasim, mos u mërzit. Tani lahu, ndërrohu dhe ha ç'të duash. Ndërresa burrash ke në atë dhomën majtas. Mua më duhet të shkoj në punë. Më premton se do të rrish si në shtëpinë tënde?

- Të premtoj, - foli ai i prekur.

Vilit i doli gjumi të nesërmen nga dreka. Nga kuzhina vinte një erë e këndëshme. Ai u ngrit dhe pa Merin që po gatuante. Ajo e përqafoi miqësish dhe e ftoi të hanin drekë.

Ndërsa qe ulur përballë saj, Vili u mbërthyte nga një lloj hutimi.

- Je bërë më e bukur, por se ç'ke një pamje tjetër, - tha.

Meri u skuq.

- Punoj në një klub nate, - foli pa e vështruar. - Kam klientë të pasur. Shqip, jam një prostitutë e klasit të parë.

Edhe Vili nuk guxoi ta vështronte. Që në vitet e gjimnazit Meri ishte shquar për një emancipim tepër të parakohshëm, që nga shumëkush konsiderohej liberalizëm borgjezo-revisionist. Ajo mbronte idenë se vajzat duhej të dashuronin kur u dashurohej dhe se ruajtja e virgjërisë s'ishte gjë tjetër veçse një konvencion hipokrit që nuk kishte fare lidhje me ndershmërinë e vërtetë. Një ditë i kishte bërë shoqet e klasës të skuqeshin duke u thënë se virgjëria e vërtetë ishte në shpirt dhe jo në atë vendin e shenjtë në mes të këmbëve.

Kishte patur një histori dashurie me një futbollist të njobur, pastaj me një aktor kinemaje. Vajzat e tjera e konsideronin atë një amerikane të vërtetë, por Meri nuk e çante kokën. Njëherë, ndërsa mësuesja e marksizmit po u shpjegonte për superioritetin e shoqërisë socialiste ndaj asaj kapitaliste, duke vënë në dukje se në socializëm nuk kishte plagë të tilla si papunësia, kriminaliteti, prostitucioni e

imoraliteti, Meri ia kishte pritur me inat: "Nuk është e vërtetë. Vetëm në lagjen time ka njëzet vajza pa punë dhe pesë gra që tradhëtojnë burrat". Mësuesja kishte mbetur e shtangur për disa minuta, pastaj kishte vrapuar në drejtori. Merit i kishin thyer notën në sjellje...

- Po të vjen keq? -pyeti ajo me një ton cinik.

- Pandeha se do ishe martuar, - ia ktheu ai.

- Do të martohem një ditë, - tha ajo pa qejf. - Po pres një njeri fisnik si Xhulia Roberts te "Gruaja e bukur". Burrat i urrej. Nuk u zë më besë. Janë të gjithë qelbanikë. Ika nga Shqipëria me një njeri që e desha. Por pas nja gjashtë muajsh ai më mori të gjitha paratë që kisha fituar me djersë dhe u zhduk. Më la vetëm në mes të Torinos. I besova gjithçka. Më kishte premtuar se do të martoheshim. Por ai më mashtroi. Pastaj njoha një italian dhe ai më solli këtu. Hyra në borxhe dhe u detyrova të filloja punë në një klub nate. Italianin e kam menaxher. Edhe apartamenti është i tiji. Por përfat, nuk është i egër. Më trajton mirë. Para kam plot.

- Më vjen keq, - tha Vili.

- Unë s'kam nevojë për keqardhje! - thirri ajo me inat. - Kam nevojë për një mik të vërtetë. Nëse ti më vështron shtrembër për punën që bëj...

Vili i zgjati dorën në shenjë miqësie.

- Ke mbetur po ajo, - tha. - Rrebele. Urren gjithçka rrëtherrotull. Por që të jem i sinqertë, do të doja që ti të mos e bëje këtë punë.

Meri tundi njëherë kokën, pastaj nënqeshi.

- Ka raste që e përcmoj veten, por më vonë e kuptoj se nuk kam ç'bëj, - foli me trishtim. - Është një kohë e lavdishme prostitucioni. E kuption? Të gjithë, në një mënyrë apo tjetrën, prostituojnë. Morali i botës paraqitet si himen virgjerie, por në fakt është katandisur si një tabele qitjeje. Është një botë e qelbur. Po nuk prostituove, je i mbaruar. Me prostitucion

nuk kam parasysh vetëm nxjerrjen e seksit në pazar, por prostitucion shpirtëror~~x~~. Për mua prostitucioni shpirtëror është shumë më i lig se ai i rrugës. Prostitutat e vërteta nuk janë ato që ti sheh në rrugën "Pre" apo nëpër klube nate. Prostitucioni i madh luhet lart, atje ku është paraja dhe pushteti~~x~~. Prandaj kam vendosur të mos kem turp nga kjo shoqëri ku jetoj, përkundrazi, shoqërisë duhet t'i vijë turp nga unë.

- Gjithmonë me ide të çuditshme! - tha Vili.

Ata filluan të kujtonin me mall kohën e shkollës, ndërkohë që hanin e pinin ulur përballë njëri-tjetrit. Vili u gjallërua. Nuk e mbante mend sa kohë kishte pa e njojur humorin. Kur Meri tregonte qyfyre, ai shpërthente në të qeshura të gjata e plot shpirt, të cilat i dukeshin të çuditshme, si të huaja e të largëta. Ajo e vuri re ndryshimin e menjëhershëm të tij dhe vazhdoi njérën histori pas tjetrës, deri sa ora iu afroa 15-ës.

- Tani ngrihu, - tha. - Do të të çoj në një berber që të të qethi bukur, si Riçard Gir dhe të të heqi mjekrën. Aty në korridor ke ca rroba të reja. Merri dhe vishu.

Ai ngriu për një çast.

- I ke blerë për mua?!

- Dëgjo, léri nazet! - foli Meri prerë. - Vil, ta hajë dreqi, kemi qënë shumë shokë. Mos përmend paratë të lutem! Po sikur të më gjeje atje, në rrugë, ti s'do të më ndihmoje?

Ajo telefonoi diku, pastaj tregoi se i kishte gjetur punë në një kantjer të madh në Rapalo, me kontratë të rregullt.

- Ta mban të punosh prapë në ndërtim? - pyeti.

- Po, - u përgjigj ai në çast. - Po qe shkruar për t'u rrëzuar prapë, le të rrëzohem.

Ajo i hodhi krahun miqësisht.

- Mos mendo gjëra të mbrapshta. Nuk do të rrëzohesh më. Tani përpiku të shlodhësh edhe trurin. Shëtit nga të

duash. Ç'është sot, e premte? Deri tē hënën nē mëngjes je nē apartamentin tim. Dakord?

Vili e vështroi gjatë me mirënjohje dhe pati dëshirë ta puthte.

Tē shtunën pasdite, ndërsa kishin pirë kafe dhe ishin ulur nē dhomën e ndenjies pranë njëri-tjetrit, ajo iu pështet nē sup duke thënë:

- Vili, e mban mend kur më ke puthur njëherë te kabineti i Anglishtes dhe më the: "Meri, kam frikë nga ty sepse je tmerrësish teksti"?

Ai qeshi.

- Jo, - tha. - Nuk më kujtohet.
- Ti, atëherë, më pëlqeje?

- Sigurisht. Ne, tē gjithë djemtë e klasës, tē pëlqenim dhe fantazonim skena dashurie me ty. Këtë nuk më vjen turp ta pohoj.

- Kam kohë pa bërë dashuri me një njeri pér tē cilin ndjej diçka, - tha ajo duke e vështruar ngultazi. -Ti ...

Vili e përkëdheli.

- Meri, më mirë le tē mbetemi miq. Nuk mundem.
- Mos pandeh se unë kam para dhe jam e lumtur, - foli ajo me një ton lutës. - Përkundrazi, jam shumë e vetmuar, e dëshpëruar.

- Tē besoj. Megjithatë... tē lutem, më kupto. Dua tē tē jem mirënjohës kështu. Më jep një tē puthur dhe më thuaj se nuk po zemërohesh.

Ajo psherëtiu njëherë, pastaj afroi buzët.

Tē hënën, ndërsa po ndaheshin te porta e apartamentit, Meri i futi nē xhepin e xhupit që i kishte blerë po vetë, 200.000 lireta. Ai kundërshtoi vrullshëm, por ajo e qetësoi duke thënë:

- Janë borxh. I vetmi rder që po tē bëj është se po t'i jap pa interes. Paç fat Vil! Besoj se do tē takohemi.

- Meri, pse ke kaq zemër të mirë?
- Të gjitha prostitutat kanë zemër të mirë, - tha ajo ftoht.
- Jo, - kundërshtoi ai. - Ti nuk je prostitutë. Je ndër njerëzit e paktë të mirë që kam njojur në jetën time. Mirupafshim!

\* \* \*

Ai i zbriti trenit në Rapalo duke e ndjerë veten krejt të ndryshuar. Pyeti për një hotel me emrin "Ekselsior" që po rikonstrukohej dhe drejtimi e çoi në një kodrinë të butë pranë detit. Një plak i tregoi se ai hotel dikur kishte qënë krenaria e Rivierës Ligure, së bashku me një vilë gjigande buzë detit, e cila edhe ajo po rikonstrukohej.

Vili kërkoi për një inxhinier me emrin Andrea.

- Ah, ti je ai kushëriri i Merit, - ia bëri ai sapo e pa. - Eja me mua!

Andrea e njoju me kapon e kantjerit, pastaj u largua. Kapoja ishte një tip i shkathët, me mustaqe, veshur me bluxhinse dhe shpesh u fërshëllente punëtorëve duke futur dy gishta në gojë. Fliste dialektin e llahtarshëm të Bergamos dhe Vili tek-tuk i kuptonte ndonjë fjalë.

- Shko te meksikanit, - tha ai prer.

Ndërkohë dikush e thirri që nga një skelë dhe kapoja ia priti me inat: Kyle! Vili pandehu se mos fjala e pakuptueshme kishte lidhje me të dhe pyeti një punëtor ç'do të thoshte "kyle". Tjetri qeshi. Është varianti bergamask për "Va fa n'kulo", tha. Mos u habit or mik. Është si tip përshëndetje. Vili vazhdoi rrugën në kërkim të meksikanit.

U prezantua me pak fjalë. Tjetri po bënte mure ndarës me tulla gazbetoni dhe e urdhëroi të afronte disa prej tyre. Tullat ishin lënë me vinç në një skelë aty pranë. Vili mori një karrocë dhe e mbushi. Ndërsa po kthehej nëpër skelen me dërrasa, iu kujtua rrëzimi atje në Gjenovë dhe nuk guxoi të

vështronte poshtë. Jo, mendoi pastaj, nuk e besoj të kem përsëri atë fat të mallkuar.

Nga mesdita zbritën së bashku me punëtorët e tjerë për të ngrënë drekë te një pension i lirë në qendër të qytetit dhe meksikanë e njohu me dy shqiptarë të tjerë që punonin në kantjer. Ishin një tiranas, që meksikanë e thirri me emrin Esmaele dhe një lezhjan me emrin Gramoz, emër që nga marokenët e kantjerit qe deformuar në Ramosh. Vili i takoi ata me një ndjenjë lehtësimi dhe u tregoi nga vinte. Ata e ftuan të vendosej në apartamentin e tyre.

Vili ndjeu frikë kur llogariti se sa duhej të ishte qeraja. Por Esmaelja i ra supit duke thënë:

- Muajin e parë nuk do të paguash asgjë. Shyqyr që u bëmë tre.

Pas dushit Vili e gjeti krevatin gati. Ramoshi i zgjati një birrë "Tuborg".

- Jo, - tha Vili instiktivisht. - Kjo është e shtrenjtë.

Tjetri qeshi.

- Pije, - ia bëri, - se mbaroi epoka e kishës.

Ai u afroa te një radiomagnetofon i madh dhe vuri një CD.

- Është Vasko Rosi, - tha. - Më i preferuari im nga italianët.

Vili u shtri në krevat me kanaçen e birrës në dorë. Por pas disa minutash e mbërtheu një mall i pakontrolluar. Vasko Rosi filloj të këndonte një këngë dashurie kushtuar një vazje me emrin Alba-Kiara. E humba kot, mendoi. Ndoshta, po të kisha duruar edhe ca... Ajo me siguri nuk është lidhur me nipin e Sartorit. Sikur t'i telefonoja... Por ajo ide iu duk foshnjore. Ç'do t'i thoshte? Se kishte gjetur punë dhe qe bërë optimist? Se e ftonte për të rinisur rrugën e lënë përgjysmë? Padyshim, Alba do t'ia kthente me tallje: e kush më siguron se nuk do të pendohesh përsëri dhe nuk do ta lësh rrugën pak më tej se gjysma? Më përcolle njëherë tek Renato, tani më fton të kthehem prapë te ty! ...

Nuk shkon, tha ai me vete. Është histori e mbyllur. Megjithatë, ajo nuk është lidhur me atë bastardin e Sartorit. Nuk do ta bëjë kurrë.

Ditët e javët filluan të kalonin njëra pas tjetrës dhe dalëngadalë ai u bind se periudha e tersllëqeve kishte mbaruar. Punonte në kantier deri të shtunën në drekë. Të shtunën dhe të dielën në darkë një pronar restoranti pranoi ta merrte pjatalarës me orë. I vetmi argëtim ishte shëtitja bregut të detit të dielave paradite. Kur Esmaelja dhe Ramoshi i përmendnin ndonjë diskò apo kinema, Vili ngrinte duart lart sikur donte t'u thoshte: amani, mos më ngacmoni.

Një mbrëmje nxorri nga çanta me duar të dridhura librin e Moravias dhe fletoren e përkthimeve. Por arriti të hidhte në shqip vetëm një paragraf. Koka iu var mbi libër. I la materialet mbi komodinë. Të paktën t'i shoh përditë, mendoi. U ngrit, freskoi fytyrën, pastaj iu afrua komodinës së Ramoshit dhe kërkoi CD-në e Vasko Rosit. Kishte filluar ta kujtonte Albën shpesh e më shpesh. Netëve, në errësirë, ato pak minuta para se ta këpuste gjumi.

Pas çdo dite që kalonte Vili pyeste veten se çfarë priste që nuk i telefononte. Pse nuk i thoshte se, gjithçka kishte ndodhur në një periudhë dobësie dhe se tani ai qe penduar keqazi. Fundja t'i lutej që ajo ta kuptonte dhe ta falte. Por pastaj ndërronte mendje duke përsëritur të njëjtin refren se ajo histori ishte mbyllur.

Megjithatë, një ditë maji...

...Vili iu afrua telefonit të pensionit ku hanin drekë dhe me duar të dridhura formoi numrin e Sartorit.

- Flas nga Shqipëria, - tha. - Jam kunati i Albës.

- Si? Nuk e dini?! - u përgjigji zonja. - Alba është martuar. Tani jeton në Milano.

Ai e uli telefonin sikur po mbyllte një kapak të rëndë bauleje mesjetare.

## 14.

Në Milano kishte filluar vapa. Zagushia e paradites ndjehej edhe brenda në apartament. Alba shtyu me këmbë batanijen, pastaj vështroi orën. Kishte kaluar 9-ta. U ngrit nga krevati duke e ndjerë trupin të plogësht. U detyrua të bënte një dush për t'u gjallëruar disi, pastaj me veprime të përsëritura, u vesh, hëngri mëngjes dhe piu një kafe. Për habinë e saj, atë ditë apartamenti iu duk si një dhomë hoteli. Atëherë, në mars, kur pas muajit të mjaltit, ishin kthyer në Milano, ajo kishte përbysur gjithçka në atë apartament. E kishte rregulluar si kishte dashur dhe Renato nuk e kishte kundërshtuar për asgjë. Por kishin kaluar disa javë dhe ai mjedis po i dukej monoton.

Ajo ngriti sytë nga një foto e madhe e darkës së dasmës dhe buzëqeshi pa ndonjë emocion të veçantë. Në atë darkë kishte qënë tepër e hutuar dhe e mbërthyer nga pasiguria. I qe dukur vetja si një robinë në mes të të huajve. Renato i kishte kërkuar që të ftonin edhe prindërit e saj, por Alba i qe lultur që një javë të muajit të mjaltit ta kalonin në Shqipëri. Ai e kishte pranuar atë zgjidhje. Darka qe organizuar në një restorant dhe të ftuarit, kryesisht miq dhe kolegë të Renatos, e kishin kthyer lokalini përbys duke kënduar e kërcyer. Në fund ata ishin larguar duke ia mbushur duart me dhurata të shtrenjtë. Alba nuk njihte askënd prej tyre, përveç Sartorit. I kishte përcjellë me buzëqeshje të sforcuara; duke i falënderuar për pjesëmarjen. I qe krijuar idea se gjatë gjithë

kohës dasmorët as që e kishin patur mendjen te ajo. Ata kishin ngrënë e kishin pirë, kishin dëfryer deri vonë, sikur të ishin në ndonjë piknik.

Por të nesërmen ajo dhe Renato ishin nisur për në Egjipt dhe gjithçka kishte ndryshuar. Kishin qënë dy javë tepër të bukura, si nëpër përralla. Fillimi isht ata kishin ndalur në Kajro. Kishin vizituar piramatat dhe kishin shëtitur me deve. Atë ditë Alba qe veshur si arabe. Renato e kishte ndihmuar të hipte në deve, duke thënë tërë solemnitet: ejani princesha Sheherezade, jemi gati për udhëtim. Ata kishin ecur për afro dy orë nëpër rërën e verdhë të shkretëtirës, të shoqëruar nga dy fshatarë egjiptiane që i ndiqnin pas në këmbë. Para se të zbrisnin, i kishin afruar devetë brinjë më brinjë dhe ishin puthur. Për çudi edhe kafshët kishin filluar të bënин të njëjtën gjë, duke zgjatur turinjtë e tyre të shkumëzuara. Fshatarët i kishin ndarë që puna të mos shkonte më larg. Alba dhe Renato ishin larguar duke qeshur.

Pjesën tjetër të muajit të mjaltit e kishin kaluar në qytezën turistike të Hurrgeadas, në breg të Detit të Kuq.

Ndonëse dimër, atje ishte vapë. Turistët bënин plazh. Albën e kishte mrekulluar ai det. Ishte i kulluar deri në marramendje. Mëngjeseve, nën shkëlqimin e diellit që lindte, sipërfaqja merrte një ngjyrë të kuqërremtë magjepsëse. Por magjepsja më e madhe ishte fundi i detit. I veshur me korale dhe bimë nga më të ndryshmet.

Ata ishin bashkuar me një grup turistësh dhe nën drejtimin e një instruktori, ishin zhytur në thellësi. Gjatë njërsë prej zhytjeve Alba kishte gjetur një koral të bukur në formë lulebore dhe e kishte marrë me vete si gjënë më të shtrenjtë të atij muaji mjalti.

Netëve të ngrrohta rrinin deri vonë duke shëtitur buzë detit apo ulur në ndonjë lokal ku kërcimtaret egjiptiane i bënин burrat të marroseshin me ato tundjet e tyre të frikshme

të gjinjve dhe vitheve, me përdredhjet turbulluese të belit. Një natë ata të dy kishin shkuar në një lokal tipik egjiptian, ishin ulur këmbëkryq mbi disa shilte të mëdha dhe kishin pirë duhan me nargjile. Qeshnin dhe ia lëshonin tymin në fytyrë njëri-tjetrit deri sa i zinte kolla.

Atyre netëve të ëmbla ajo e kishte pyetur shpesh veten se ç'kërkonte më shumë ngajeta. A mund të kishte më gjë tjetër përtetj asaj lumturie?

Vetëm kur ktheheshin në dhomë dhe hynin me zhurmë për të bërë dush së bashku, Alba e kuportonte se nuk ishte më e lirshme. Nuk mund t'i jepej njeriut me të cilin qe martuar me tërë dëshirën. Ndjente një frenim të pashpjegueshëm. Ia linte atij trupin e vet në duar të bënte çfarë të donte. Mbase kështu është fillimi, mendonte. Dalëngadalë do të ndjej etje edhe për seks.

Natën e fundit në atë dhomë të largët buzë detit ajo kishte provuar të bënte dashuri shfrenuar dhe të arrinte në orgazmë, por nuk kishte mundur. Me sa duket do më duhet ende kohë, e kishte ngushëlluar veten...

E përmendi zilja e telefonit. E ngriti duke dyshuar se nuk do t'i përgjigjej njeri. Ato ditët e fundit, kishte rënë zilja disa herë, qe ndjerë matanë linjës një frysma marje nervoze, pastaj heshtje.

- Alo, kush je? - pyeti Alba.

- Albanese di merda! - foli një zë femre me urrejtje.

Pas asaj sharjeje telefoni u përplas thatë. Alba u mundua të ruante qetësinë. Të djeshmen, ndërsa po dilte nga supermarketi ku blinte zakonisht, vështrimi i qe ndeshur në sytë plot urrejtje të një vajze të panjohur. Në fillim nuk qe kthjelluar dhe kishte pandehur se tjetra duhej ta ngatërronte. Por pas ziles bezdisëse të telefonit, e kishte nuhatur se gjithçka duhej të kishte lidhje me Renaton.

Ajo u kaloi flokëve një krëher, pastaj doli për të bërë

shpenzimet e zakonshme të ditës. Ai ishte i vetmi variacion që e lehtësonte disi nga monotonia e të ndenjrit brenda. Renatoja vinte rregullisht për të ngrënë drekën në shtëpi dhe ajo duhej ta përgatiste atë si shumë e shumë gra shtëpiake italiane.

U kthye në shtëpi duke bërë të njëjtën rrugë që e kishte mësuar përmendësh, pa e ngritur kokën. Hapi mbi tavolinë një libër të madh kuzhine dhe filloi të përgatiste një gjellë të re me emrin "Vitel tornato". Ishte një gatim i thjeshtë, që kërkonte pak kohë; filetot e mishit të viçit mblidheshin tub, me djathë brenda, pastaj viheshin në zjarr me pak ujë dhe qepë të grirë imët.

Në ato çaste, ndërsa qëndronte në këmbë para tavolinës së mbushur plot, iu kujtua kuzhina e shtëpisë në Shqipëri dhe tmerri që kishte përjetuar kur Renaton e kishin ftuar për dreka e darka. Në treg gjeje vetëm ushqime të dyshimta importi, shumica e të cilave shiteshin rrugës, pa asnje lloj kontrolli. Megjithë kujdesin e tepëruar të nënës, ditën e dytë, Renaton e kishte zënë një dhimbje e fortë barku dhe diarrea, pasi kishte ngrënë mish pule. Ata të dy kishin marrë një dhomë në hotel "Dajti" dhe pothuaj tërë natën ai nuk kishte fjetur. Alba qe detyruar t'i kërkonte falje për të metat e kuzhinës, por Renato kishte ngulur këmbë se nuk ishte faji i gatimeve.

Në përgjithësi, ai nuk kishte shfaqur asnje lloj habie apo trembjeje nga realiteti i hallakatur shqiptar që e rrethonte. Nuk i bënин përshtypje rrugët e pista, trotuaret me pllaka të shkulura, ku lypësit shtriheshin përtokë dhe shitësit ambulantë afronin çikërrima të të gjitha llojeve, vitrinat me shufra hekuri apo makinat shkatarraqe që ngrinin pluhur e tym nëpër kryqëzimet pa semaforë, muret e mbushur me parrulla e sharje në prag të zgjedhjeve. Bile edhe netët pa drita. Në darkën e madhe të shtruar në një restorant pranë

shtëpisë, ku qe ftuar farefisi, fqinjët dhe disa shoqe të Albës, ai qe kënaqur kur papritur, pas mesnatës, dritat ishin fikur. Ju raftë pika, ku e gjetët! Do tmerrohet italianni, kishte thënë njëra nga gratë e fisit. Duke e parashikuar atë lloj incidenti, prindërit i kishin marrë masat dhe ndezën qirinj. Renato, të kërkoj ndjesë, kishte thënë Alba e mërzitur. Përpiku ta kuptosh, rrjeti mbingarkohet nga pajisjet elektrike dhe... Është fantastike, ia kishte kthyer ai me qejf, nuk kam ngrënë kurrë në jetën time një darkë si kjo. Thuaju prindërve të mos shqetësohen...

Vetëm kur po ktheheshin për në Itali, Alba e kishte besuar se tjetri nuk qe shtirë. Ishte një vizitë e rrallë, kishte thënë ai gati me nostalqji. Nuk kisha parë kurrë ndonjë vend të botës së tretë.

Ajo filloi të kujtonte njërin detaj pas tjetrit nga qëndrimi i shkurtër në Shqipëri. Nuk je treguar e zgjuar, i kishte thënë një shoqe ditën e mbërritjes. Ke gjetur kohë të papërshtatshme për të ardhur. Edhe vetë dukesh si e trembur. Vetëm pas atyre fjalëve Alba qe kujtuar për përshtypjet që mund t'u linte rjerëzve. Kur kishte takuar prindërit, nuk kishte guxuar t'i vështronte gjatë në sy. Gjatë një darke nëna e kishte pyetur befas në se ishte e lumtur. Sigurisht mama, qe përgjigjur ajo e kapur e papërgatitur, pse më pyet. Se si dukesh, kishte thënë e ëma. Nuk je e qetë. Jam e shqetësuar për Renaton, ia kishte kthyer ajo. Ti e shikon edhe vetë. Këtu... kushtet... Ai vjen nga një vend ku... Alba e kishte përqafuar për t'i treguar se nuk kishte asgjë për t'u mera-kosur, por e kishte nuhatur se nuk ishte plotësisht e aftë për atë gjë. Me siguri duhet të pasqyroj akoma gjurmët e lëkundjeve të dikurshme, kishte menduar. Të atyre zyrtarizime të kryera me ngut, me frikë nga e panjohura, atje në zyrën e gjendjes civile të bashkisë së Milanos...

Iu kujtua se pas daljes nga bashkia, kur më në fund

figuronte zyrtarisht e martuar me Renaton, i kishte thënë atij e alarmuar: në kishë nuk dua të bëj asnjë ceremoni. Ai e kishte vështruar njëherë i menduar. Po pse, kishte pyetur. Nuk dua të jem përgjegjëse para Zotit për gjithçka mund të ndodhë më vonë, ia kishte kthyer ajo. Ç'mund të ndodhë, qe habitur ai. Nuk e di, kishte thënë ajo pa guxuar ta vështronë. Si të duash, kishte pranuar Renato. Edhe unë s'kam ndonjë ngacmim të veçantë për ceremoni në kishë. Veç hiqe nga koka mendimin se mund të ndodhë gjë. Ke për të parë, çdo gjë do të shkojë për mrekulli...

Një ditë para largimit nga Shqipëria, babai i kishte kërkuar të bisedonin dhe e kishte pyetur nëse ndjehej e qetë pas asaj martese. Po, i qe përgjigjur ajo. Uroj të mos jesh ngutur, kishte thënë ai. Në fillim më shkruaje se kishe plane të tjera, se do të vazhdoje fakultetin. Alba nuk kishte ditur si të mbrohej. Baba, fakti që jam martuar, nuk do të thotë se kam hequr dorë nga fakulteti, i kishte thënë. Unë u martova se ashtu erdhën rrethanat. Isha vetëm. Kisha nevojë për një mbështetje.

I ati kishte lënë të kuptohej se i pranonte të gjitha arsyetimet.

- Ti e do atë njeri? - e kishte pyetur në fund.

Alba nuk kishte guxuar t'i ngrinte sytë. Të lutem më vështro dhe më thuaj a e do atë njeri, kishte këmbëngulur i ati. Po, qe përgjigjur ajo. Ai është burri im dhe unë do ta dua e respektoj. Babai nuk kishte mundur ta mbante një nënqeshje. Alba, s'e kuptoj pse flet në kohën e ardhshme sikur nuk je martuar akoma? Sepse aktualisht nuk e dua aq shumë sa do ta dua më vonë, kishte thënë ajo me inat. Është e vërtetë se kam bërë një zgjedhje pa zemër, por më duket se nuk jam e vetmja që e bën këtë gjë.

Babai ia kishte ngulur sytë i shtangur.

- Si, pra, ti po më bën mua leksion për jetën bashkëshortore?!

- Baba, nuk e kuptoj ç'kërkon nga unë? - i kishte thënë ajo e prekur.

- Asgjë, - ia kishte kthyer ai. - Thjesht kisha krijuar një ide se nuk do të lidheshe me atë njeri. Kaq. Uroj të mos jesh gabuar.

Ata ishin ndarë ftohtë dhe për Albën qe bërë e qartë se, ndonëse i ati nuk i kishte shkruar dikur "mos u lidh me Renaton", ai në të vërtetë kishte qenë kundër asaj lidhjeje.

E vjetmja që e kishte përgëzuar me plot gojën kishte qënë motra e madhe. Shpëtove, i kishte thënë ajo. Ke marrë pamje zonje. Erdhe ca ditë për të na parë ne indianëve këtu dhe do të ikësh atje, mes pastërtisë dhe bollëkut. Dëgjo, lëri sentimentalizmat! As prindërve mos ua vër veshin se ata nuk marrin dot kthesë. Nuk e dinë ç'është kapitalizmi dhe bota e parasë. Ata pandehin se në këtë botë hileqare ecet me zemër dhe ndërgjegje. Kanë standarte morali të vjetëruara. Besojnë në një moral që tani s'e përfill më askush. E ç'është fundja morali? Kush ia pa hajrin moralit dhe zërit të zemrës?

Albës i qe dukur motra tepër e acaruar dhe gati-gati në një gjëndje depresive.

Por para se të ndaheshin ajo kishte patur disa çaste dobësie.

- Alba, po atë, shqiptarin, e doje shumë? - kishte pyetur befas.

Alba ia kishte ngulur sytë e hutuar, pa guxuar të përgjigjej.

- Mos vallë u bëra unë shkak që u ndave prej tij?

Alba kishte ngritur dorën me nervozizëm për t'i treguar se ajo histori ishte myllur...

Ajo u përpoq t'u shpëtonte atyre kujtimeve që e mbërrthenin shpesh kur vërtitej e vetme nëpër shtëpi. Qëndrimi i shkurtër në Shqipëri nuk i kishte sjellë asnjë lloj ndryshimi. Përkundrazi, e kishte nervozuar, e kishte ftohur edhe më shumë me gjithçka.

Kur minutazhi i recetës "Vitel tornato" u plotësua, e hoqi tenxheren mënjanë dhe vuri ujin e makaronave. Renatos i pëlqenin makaronat me këpurdha dhe Albës i dukej se ato ishin e vëtmja gjellë që ia kishte marrë dorën plotësisht.

Sapo hyri brenda, Renato lëshoi një thirrje habie.

- Këtu ndihet një aromë fantastike! Çfarë ke përgatitur sot thesari im?

Ai zbuloi tenxheren, pastaj férkoi duart duke u afruar pranë saj. Alba u pérpoq të buzëqeshte dhe mënjanoi kokën që tjetri ta puthte në gushë. Gjatë atyre javëve ajo qe mësuar me ato skena dhe me fjalët eëmbla pa fund: thesar, e dashur, e shtrenjta ime, vogëlushja ime, shpirti im. Si shumica e meshkujve italianë, Renato i përdorte ato fjalë përkëdhelësë aq shpesh sa asaj kishin filluar t'i dukeshin krejt boshe.

Ai hëngri me oreks, duke i treguar me qejf për një festë të bukur ku do të shkonin në mbrëmje. I quajti makaronat fantastike, "Vitel tornaton" një kryevepër, pastaj piu kafen dhe doli duke e puthur rishtazi. Mirupafshim e dashur, foli nëpër shkallë.

Alba u kthye në kuzhinë dhe filloi të pastronte tavolinën. Lau pjatat, pastaj u ul para televizorit. I mori kanalet me rradhë për të gjetur ndonjë telenovelë. Gjatë asaj periudhe të ndenjes në shtëpi kishte filluar t'i ndiqte seritë e pafundme të telenovelave amerikane rregullisht.

Pa një seri të "Santa Barbara" pa ndjerë asnjë lloj emocioni, pastaj mori një roman. Por edhe atij mezi i mbaroi një kapitull. Ajo ishte periudha më nervangacmuese e qëndrimit në shtëpi. I telefonoi njëherë Sartorit. Ajo u shtir matanë linjës tepër e emocionuar.

Nga ora 15 ra zilja e derës dhe Alba e hapi atë me një lloj lehtësimi. Ishte teze Karmela, një fqinjë e moshuar, e vëtmja me të cilën kishte bërë miqësi në pallat.

- Alba, mikja ime e vogël, të solla numrin e ri të revistës

"Miq tē shtëpisë", - tha fqinja, duke e konsideruar atë fakt një ngjarje tepër tē rëndësishme.

Alba e mori revistën në duar, duke e falënderuar. "Miq tē shtëpisë" ishte një botim luksuz kushtuar qenve e maceve tē shtëpisë. Teze Karmela ishte ijtare e Brixhidë Bardosë dhe anëtare e një klubit tē njohur milanez pér mbrojtjen e kafshëve. Ajo kujdesej pér disa mace tē braktisura që vërtiteshin poshtë pallatit mëngjeseve e mbrëmjeve.

Ndërkohë që zonja e moshuar filloj tē tregonte pér takimin e fundit në klubin ku bënte pjesë, Alba i solli një kafe, duke u munduar tē tregohej e vëmendshme.

- Misioni juaj është vërtet fisnik, - tha. - Kafshët e gjora duhen mbrojtur nga barbaritë e njerëzve.

Teze Karmela buzeqeshi e kënaqur.

- Alba, u kam folur mikeshave tē mijë pér ty, - tha. - Ato do tē ishin tepër tē lumtura sikur edhe ti tē bëheshe anëtare e shoqatës sonë.

Alba buzëqeshi e zënë ngushtë.

- Në parim nuk jam kundër, - tha.

- Atëhere, do tē vendosësh edhe pér tē mbajtur një mace? Jari tē shumta kriesat e mjera që presin ndihmën tonë.

- Do tē mundohem.

Pasi piu kafenë, teze Karmela filloj tē ankohej pér një seri sëmundjesh që i ishin qepur dhe që kishin lidhje me njëratjetër. Alba ishte mësuar me Sartorin dhe nuk i bënин përshtypje ankesat e plakave.

Më në fund tezja u kujtua pér diçka dhe u ngrit. Nesër tē pres pér vizitë, tha. Alba i premtoi se do tē shkonte.

Mbylli derën, pastaj ferkoi ballin. I vetmi ngushëllim iu duk festa pér tē cilën i kishte folur Renato.

## 15.

Në mbrëmje ata shkuan me makinë në një vilë të vjetër në periferi, ku në një verandë të madhe të ndriçuar bollshëm, qenë mbledhur disa çifte. Ishin një rreth miqsh e kolegësh të Renatos dhe Alba ishte njohur me disa prej tyre. Ata mbledheshin zakonisht nëpër lokale apo në ndonjë shtëpi të madhe, organizonin festa të zhurmshme, hanin e pinin, këndonin e kërcenin, merrnin nëpër gojë politikanë e eprorë, pastaj, natën vonë, shpërndaheshin me sy të skuqur dhe fytyra të përgjumura.

Në fillim ajo kishte kundërshtuar të merrte pjesë nëpër festa. Një ndjenjë e fortë inferioriteti e frenonte. Por Renato kishte këmbëngulur. Për herë të parë ai e kishte çuar në një lokal, duke u përpjekur ta bindte se femrat që do të takonte atje nuk kishin asgjë më shumë se ajo. Dhe Alba qe bindur për atë detaj. Prezantimi i saj me fjalët “nusja shqiptare e Renatos” kishte tërhequr vëmendjen. Ajo kishte ndjerë mbi vete vështrime lakmitare meshkujsh dhe sy ziliqarë femrash. Qe trembur nga ai mjedis. Qe përpjekur të tërhiqej mënjanë.

Atë detaj e kishte kapur një tip që mbante vazhdimesh në dorë një gotë të madhe me uiski. Ishte një koleg i Renatos. Ai i ishte afruar nga pas dhe kishte thënë miqësisht:

- Alba, gabon që trembesh. Këta që të rrethojnë janë të gjithë njerëz ordinerë. Sidomos femrat. Janë ca biba llafazane dhe asgjë më shumë. Konsideroje veten të barabartë me to. Mos ngurro për këtë.

Alba qe kthyer dhe e kishte vështruar gati me mirënjojhe.

- Quhem Marko, - ishte prezantuar ai. - Defekti im fatal është se jam jugor, kalabrez. Ashtu siç është fatalitet për ty të qenit shqiptare. Rraca e këtyre veriorëve nuk e do rracën time, aq me pak të huajt. Është një realitet me të cilin duhet të mësohemi. Ata nuk e shfaqin përcmimin e tyre, përpiken të tregohen të sjellshëm, por unë e ndjej hendekun, siç e ndjen edhe ti.

Alba kishte pohuar me kokë.

Marko kishte kthyer gotën e uiskit si me pendim.

- Sigurisht, ti do të më pyesësh, pse rri me ta kur nuk të pëlqejnë. Vlij thjesht për Silvian. Ajo është gruaja ime. Asaj i pëlqejnë këto festa dhe unë nuk dua t'ia prish. Silvia është veriore. Megjithatë, më do. Të paktën kështu më duket mua.

- Veriorët nuk duhet të janë të gjithë negativë, - i kishte thënë Alba.

- Sigurisht, - ia kishte kthyer ai...

Gjëja e parë që Alba bëri sapo doli në verandë qe kërkimi i Markos. Por me sa dukej ai ende nuk kishte mbërritur. Ajo u afrua te një grup i vogël grash që ishin ulur rrëth një tavoline të bukur prej kashte. Ato i hapën një vend duke buzëqeshur, pastaj i bënë disa pyetje të përgjithshme. Njëra u tregua e interesuar për situatën në Shqipëri. Pse nuk i vini ndonjë bombë në shtëpi atij presidentit tuaj, pyeti. Tani është përmbysur komunizmi, ia ktheu Alba duke qeshur, nuk ka nevojë për bomba. Ashtu, ia bëri tjetra. Po pse njerëzit vazhdojnë të ikin? Ç'kanë? Alba u përpoq ta sqaronte.

- Nuk më bind, - ndërhyri një tjetër, me një kapele të gjerë në kokë. - Shqiptarët ikin sepse nuk duan të punojnë. Vijnë këtu për të ndenjur rrugëve.

Një mesogrua me flokë të shkurtëra dhe mollëza rrumbullake e mbështeti.

- Një mikeshë më tregonte se i kishte afruar punë një çifti

shqiptarësh në fermën e saj, por ata s'kishin pranuar.

- Sikur janë shtuar edhe vjedhjet, - tha e pakënaqur kapelegjëra.

Alba u skuq.

- Ç'lloj njerëzish janë shqiptarët? - pyeti flokëshkurtëra pa pikën e taktit.

Alba nënqeshi.

- Zonja, të kuptohemi, unë nuk jam ambasadore e Shqipërisë në Itali, - tha pa e përmbajtur dot ironinë. - Unë përfaqësoj veten time. Ambasada shqiptare është në Romë. Po të doni, mund të interesoheni për të dhëna të çdo lloji.

- Interesante! - ia bëri njëra prej italianeve.

- Ti s'ke pse prekesh! - tha flokëshkurtëra me ton pajtues.

- Ne s'kemi asgjë kundër teje.

Alba i përshëndeti dhe u largua. Rraca e këtyre veriorëve nuk e do rracën time, aq më pak të huajt, iu kujtuan fjalët e Markos. Iu afrua Renatos dhe iu lut të qëndronin sa më pak. Ai e nuhati se ajo qe merzitur.

- Për hatër të Zotit, - ia bëri me një nervozizëm të lehtë. - Ç'ke kështu?

Pa ardhur akoma më kërkon të ikim! Fillova avazin! Dëgjove nga ndonjëri se shqiptarët kanë vjedhur ndonjë supermarketatë? Apo se kane përdhunuar?

Ajo uli kokën.

- Dëgjo, mos e vrit mendjen për këto gjëra! Edhe italianët vjedhin e përdhunojnë. U kuptuam? Eja, pijmë diçka. Ja, mbërritën edhe Marko me Silvian.

Alba i ngriti sytë nga kalabrezi e lehtësuar.

- Pra, paske ardhur edhe ti, - pyeti ai kur në verandën e madhe shumica e cifteve filluan të kërcenin.

- Ndoshfa do të jetë hera e fundit, - ia ktheu ajo.

Tjetri psherëtiu duke mbushur një gotë të madhe me uiski.

- E ndjej se një ditë këto festa hipokrite do të mbarojnë edhe për mua.

Alba nuk e ngacmoi me pyetje. Ndërkohë që ai po i tregonte për një vizitë që kishte bërë ditët e fundit në një galeri arti, ajo ndjeu mbi vete vështrimin ngulmues të një burri të gjatë që kishte qëndruar në cep të verandës. Dinte që ai ishte një nga eprorët e mëdhenj të Renatos dhe që në festën e fundit e kishte vështruar po ashtu, duke i shkaktuar siklet. Ajo u mundua t'i shmangej, por pas pak tjetri, u afroa dhe e ftoi të vallëzonin.

- Quhem Lazarini, - u prezantua ai. - Bashkë nuk kemi patur rast të njihemi. Më tregoni diçka për veten.

Alba i tha disa detaje të shkëputura deri te lidhja me Renaton.

- Histori interesante! - ia bëri tjetri. - Do të kisha dashur të isha në vend të Renatos. Ju jeni shumë tërheqëse.

Alba u mundua të buzëqeshte.

- Jeni jashtë mase tërheqëse, - vazhdoi Lazarini.

- Nuk e besoj, - ia ktheu ajo.

Qelbanik, mendoi pastaj. Ndjeu se si dora e tjetrit e shtrëngoi në bel dhe e afroi nga vetja. U detyrua të nxirre bërrylin e majtë para për t'i treguar tjetrit se nuk kishte asnjë lloj dëshire për atë intimitet.

- Ju pëlqejnë kuajt? - pyeti Lazarini pas pak.

- Jo, - ia ktheu Alba. - I kam frikë.

- Mëkat! Unë kam një fermë të vogël dhe disa kuaj. Ndonjë ditë mund të vini me Renaton po të doni.

Ajo e falenderoi. Tjetri provoi rishtazi ta afronte nga vetja, por Alba nuk e lejoi. Lazarini bëri një psherëtimë nervozizmi.

- Duhet të jeni shumë e veçantë, - tha, duke lënë të nën-kuptohej së asnjë femër nuk qe sjellë ashtu me të. - Do të doja të njiheshim nga afër.

- Nuk besoj të kem kohë, - ia ktheu Alba. - Kam filluar të

studjoj Biblën dhe jam shumë e zënë.

Tjetri qeshi me zë.

- Për Biblën mund të diskutojmë edhe bashkë, - tha.
- Të shohim, - foli Alba me ton neutral.

Pas disa minutash u ndanë dhe ndërsa i puthi dorën, Lazarini lëshoi një kompliment tjetër provokues. Alba qëndroi pak pranë një tavoline, e turbulluar. Shko freskohu ca, dëgjoi zërin e Markos. Do të të bëjë mirë. Ajo hyri në vilë, në një korridor të gjerë dhe u kthyte djathtas në një tualet. Por dialogu i dy femrave që ndodheshin brenda, e bëri të ngrinte në majë të gishtave. Pa e përbajtur dot kureshtjen u afrua edhe më të dëgjonte. Është rrjepacakë Shqipërie, por e bukur, foli një zë paksa i ngjirur. E ka hutuar Renaton e gjorë. E bëri të linte Sinthian. Duhet të jetë ndonjë lavire. Ndoshta jo, tha një zë tjetër ironik. Mund të jetë e mirë dhe Renato e ka marrë për të qënë i qetë. Ajo është në hall dhe do t'i bindet. As që do t'i shkojë mendja për t'i vënë brirë. Shiko! Lëri këto budallallëqe, vazhdoi zëri i ngjirur. Prite kur ajo të përfundojë në krevatin e Lazarinit. Ai nuk do ta fali. Eh, i erdhi radha edhe Renatos së gjorë të bëjë karrierë! Nuk mund ta duroj dot kurvën, foli papritur një zë i tretë, i ngarkuar me urrejtje. Është e bukur. Meshkujt tanë janë gomerë, mazohistë, vuajeristë. Bien në gjunjë para një femre seksi edhe sikur ajo të jetë nga Bangladeshi.

Alba u tërhoq mbapsht e neveritur. Duhej të isha përgatitur edhe për këto fjalë, mendoi pastaj. Mirë ma bëjnë derisa unë vij këtu, në këtë vend të qelbur ku kutërbimi i imoralitetit mbulohet me perfume të shtrenjta. Ndoshta e tepëroj, tha pastaj kur u afrua te Marko dhe i kërkoi t'i mbushte një gotë me uiski. Me siguri nuk duhet të jenë të gjithë të këqirnj. Duhet të ketë edhe të ndershëm, me zemër të mirë. Katër femra dashakeqe dhe katër qelbanikë mund t'i gjesh në çdo festë.

- Sikur të shëtisim ca në kopësht? - tha Marko.
- Ajo e ktheu uiskin me një frymë.
- Shkojmë. Aty duhet të jetë më freskët.
- Tjetri e vështroi i menduar ndërsa ajo e la gotën e zbrazur në tavolinë

Natën, vonë, ndërsa festa kishte mbaruar dhe ata po ktheheshin në shtëpi, Alba vuri re se Renato ishte në formë. Mbështetja kishte pirë diçka më shumë se zakonisht.

- Hë, vallëzove me Lazarinin? - pyeti gati me padurim. - Si t'u duk?

Ajo mbloodi supet.

- Njeri i zakonshëm, - iu përgjigji.
- Ç'të tha? - vazhdoi ai edhe më me padurim.
- Asgjë, - ia ktheu Alba gati me inat.
- Si asgjë?! Nuk folët fare?
- Më tregoi për fermën e tij. Na ftoi të dyve të shkojmë atje ndonjë ditë.

Renato buzëqeshi i kënaqr.

- Është e vërtetë se prej tij varet karriera jote? - pyeti Alba ftohtë.

Renato u bë befas serioz.

- Ai është një nga shefat e mëdhenj, - tha. - Ka shumë në dorë. Po ty, ç' t'u kujtua karriera ime?

- Ashtu kot.

- Të pëlqen të shkojmë ndonjë ditë në fermën e Lazarinit?
- Jo - ia ktheu ajo. - Edhe nëpër këto... festat, nuk vij më. Ai u mundua ta merrte me të mirë.

- O, e dashur, nuk besoj se po flet seriozisht. E kuptoj se je mërzitur nga ndonjë ngacmim. Por ti duhet ta kesh të qartë se tani je italiane dhe çfarëdo që të flitet poshtë e lart për shqiptarët nuk duhet të të bëjë më përshtypje.

- Mos u bëj naiv, - tha ajo duke nënqeshur. - Askush nuk do të më pranojë kaq shpejt për italiane. Sa për festat, në se

ato tē pëlqeijnë ty, kjo nuk do tē thotë se duhet tē më pëlqeijnë edhe mua.

Ai pérplasi dorën e djathtë në timon.

- Pra, e ke ndarë mendjen tē grindemi?

- Më duket se je ti që po nxehesh kot.

- Dëgjo, unë po bëj çmos tē tē kënaq. Ti më thua se nuk tē pëlqeijnë festat. Po çfarë tē pëlqen xhanëm? Mos duhet tē shkojmë në ndonjë kamp refugjatësh?

Ajo u skuq në çast.

- C'hyjnë refugjatët këtu? - thirri. - Mos do tē thuash se ne që erdhëm në këtë vend si refugjatë, duhet tē biem vdekur pér një festë? Dije se ato lloj festash më neverisin! Nuk dua tē vij më!

- Ti do tē vish kur tē tē them unë! – thirri edhe Renato.

- Jo. Unë nuk jam ushtarja jote!

- Më duket se duhet tē jesh ca më realiste dhe mirënlohëse, - nënqeshi ai.

Ajo u ngërdhesh.

- Të tē jem mirënlohëse pér bamirësinë që bëre duke u martuar me mua? Kështu?

- Mirënlohëse pér gjithçka.

Alba zgjati këmbën te pedali i frenave dhe e shkeli fort. Vutura frenoi me zhurmë, devijoi dhe Renato u detyrua ta nxirrte nga marshi pér ta ndalur.

- Deri tani unë nuk tē kam borxh asgjë! - thirri ajo. - Dëgjove? Jam gati tē jetoj vetëm me pica e fokaçe, me paratë e mijë. Të paguaj edhe një pjesë tē qerasë.

Tjetri nuk e kishte pritur atë veprim.

- Je në vete?! - ia bëri i trembur. - Jemi në rrugë. Desh na pérplase. Dreqi ta hajë. Nuk tē thashë ndonjë gjë tē madhe. Mos shko kaq larg. Hajt, le tē pajtohem. Unë nuk desha tē tē fyeja, tē betohem.

Ajo u pështet në ndenjëse duke psherëtirë

- Më fal, - tha. - Ndoshta e tëpërova, por duhet ta dish se unë nuk kam ndër mend të të bindem verbërisht për gjëra që nuk më pëlqejnë.

- Dakord, - tha ai duke i kapur dorën. - Me duket se edhe unë nuk të kam detyruar deri tanë për asgjë.

Pjesën tjeter të rrugës ata folën fare pak. Renato i kërkoi një opinion për Markon dhe Alba iu përgjigj se ai i dukej njeri tepër i mirë.

- Ti e di, pse rri ashtu, i mërzitur? - pyeti pas pak.

Renato u mendua një hop.

- Ashtu ka ca probleme me të shoqen, - tha.

- Sigurisht ajo e tradhëton.

Tjetri pohoi me kokë.

- Me ndonjë shef të madh?

Renato përsëri pohoi.

- Kam frikë se po shkojnë drejt ndarjes, - tha.

Kur mbërritën në shtëpi dhe hynë në dhomën e gjumit, ndërsa po zhvishej, Alba e kuptoi se e priste një natë e sikletshme. Renato iu afroa nga pas dhe filloi ta puthte në supet lakuriq. Ajo u mendua ca, por pastaj e kuptoi se do ta kishte të vështirë t'i shmangej një akti dashurie krejt të padëshiruar. U përpooq më kot të shmangej, duke u shtirë si e lodhur nga festa. Duke e përkëdhelur me fjalë të embla dhe me duar Renato e shtriu në krevat. Ajo mbylli sytë për të mos parë asnje veprim të tjegrit, veçanërisht fytyrën e tij.

- E dashur, tundu, mos fli, - i foli ai me një ton të pakënaqr.

Dhe si gjithmonë, gjatë atyre akteve të padëshiruara dashurie, asaj iu kujtua prostituta me emrin Iris, për të cilën kishte lexuar dikur në romanin e verdhë. Filloi të shtirej si e eksituar derisa Renato e përfundoi sulmin e tij të misionarit me ca rënkimë të zgjatura kënaqësie.

- Oh, edhe festa mbaroi përfundimisht! – psherëtiu.

Pas pak u kthyte në brinjë dhe fjeti.

Alba u ngrit, shkoi në banjë dhe atje, nën ujet e ngrohtë të dushit, filloi të qante. Për herë të parë që pas martesës pati frikë se nuk do të ishte në gjendje ta donte atë njeri. Sidomos aktet e dashurisë e tmerronin. Emocionet që kishte kaluar në krevat pak më parë, nuk ndryshonin aspak nga ato që kishte pranuar kur qe detyruar të bënte dashuri për herë të parë me Renaton. Kishte ndodhur një javë para martesës, në vilën e Sartorit. Ajo nuk kishte si i shmangej më. Renato kishte dashur të ngjiteshin në dhomën e saj, por Alba kishte kundërshtuar. I qe dukur se do ta përdhunonin. Të paktën të mos përdhunohet gjithë dhoma, kishte menduar. Kundër vullnetit të saj i qe kujtar se në atë dhomë kishte bërë dikur dashuri me Vilin dhe ndoshta nuk do të ishte në gjendje të përsëriste të njëjtat skena me një tjeter.

Renato e kishte shpënë në dhomën e tij dhe atje kishte ndodhur një akt dashurie nga i cili Alba gati kishte tentuar të shkëputej. Ishte një lloj dashurie që s'i ngjante asnjë dashurie të mëparshme. Asaj i qe kujtar rishtazi Vili dhe kishte menduar frazën e vjetër se meshkujt janë ndryshe. Por pas muajit të mjaltit ajo kishte filluar të alarmohej. Kishin filluar ta mundonin lloj-lloj dyshimesh. Ndoshta ai mund ta merrete për ndonjë femër frixhide, pse jo, edhe lesbike. Pikërisht në ato rrethana, i kishte ardhur ndër mend Irisi me mrekullitë e saj të shtirura, me të cilat kishte bërë për vete atë klientin e pasur. I qe dukur sjellje e ulët, por nuk kishte mundur të shmangej. Kishte filluar të shtirej si e eksituar, pastaj sikur arrinte në orgazëm. Kur Renaton e zinte gjumi, shkonte në barjo dhe vështronte veten në pasqyrë si idote.

Atë natë që kishte luajtur për hërë të parë rolin e Irisit, kishte parë një nga ëndërrat më të frikshme të jetës së saj. I qe afruar në krevat një Albë e zbehtë, veshur si prostitutë dhe me një thikë të madhe i kishte çarë kafazin e kraharorit.

Kush je ti, e kishte pyetur ajo e lebetitur. Unë jam shpirti yt i ri, i qe përgjigjur e veshura si prostitutë. Tani e tutje do të jetojmë bashkë. Unë jam e mirë, shumë e mirë. E veshura si prostitutë qe përpjekur ta nxirte me forcë shpirtin e vjetër nga kafazi i çarë i kraharorit, por ai nuk dilte. Atëherë ajo e kishte goditur me thikë. Rri aty i vdekur, i kishte thënë. Unë do të qëndroj sipër teje. Alba qe zgjuar duke dihatur dhe kishte vënë duart në kraharor...

Atëherë, para martesës, kur sforcohej për të harruar Vilin me çdo kusht, ajo qe përpjekur të bindte veten sejeta bashkëshortore do ta shtynte drejt dashurisë për njeriun me të cilin do të bashkëjetonte. Dashuria do të vijë gradualisht, me kalimin e kohës, mendonte. Dy njerëz që jetojnë së bashku dhe që nuk u mungon asgjë, patjetër që do të fillojnë të duhen një ditë...

Por ja, para dhjetë minutash, kishte ndodhur ai akt i padëshiruar dashurie dhe tani ajo pyeste se kur do të vinte ajo ditë. Mbase është ende herët, mendoi duke u përpjekur të qetësobej. Kanë kaluar vetëm dy muaj martesë. Por befas iu kujtua se si kishte qarë dy muaj pas njohjes me Vilin, si bënte dashuri me të dhe nuk guxoi të vazhdonte arsyetimin.

E trembur që Vili i qe kujtuar rishtazi, doli nga banja me ngut. U detyrua të khente nja dy hërë një shishe me verë që koka t'i turbullohej disi.

## 16.

Zilja e telefonit kishte sekonda të tëra që binte, por Alba nuk u ngrit. Me siguri duhet të ishte ajo femra misterioze që kishte sharë të djeshmen ndyrësisht dhe që duhej ta kishte emrin Sinthia. Ajo ndenji shtrirë gjatë, pastaj filloi të kryente me atë plogështinë e zakonshme veprimet e mëngjesit. Papritur, u kujtua se të djeshmen kishte harruar të pinte pilulen e përditshme kontraceptive dhe e mbërtheu paniku. Do Zoti nuk ka ndodhur gjë, mendoi dhe u afroa me ngut te sirtari ku mbante pilulat. I kishte blerë ato në sasi të madhe, të nesërmen e dashurisë së parë me Renaton. Fakti se mund të mbeste shtatzënë, e kishte futur në një tension të përgjithshëm dhe kishte vrapuar drejt e në farmaci. Idea për të patur fëmijë me Renaton i dukej tmerrësisht e largët dhe e papranueshme.

Pas ndonjë gjysmë ore, kur pa në pasqyrë se fytyra dhe sytë i qenë çliruar nga mufatja dhe përgjumja, doli. Te hyrja e supermarketatës vuri re një figurë të rjohur që me sa dukej po e priste. Duhej të ishte vajza e telefonit. Ajo i ktheu shpinën apo e pa, pastaj, brenda në supermarketatë, vazhdoi ta ndiqte me vështrime plot urejtje.

Kur doli, Alba vendosi ta priste. La qeset e mbushura në trotuar dhe i doli përballë. Tjetra provoi të shmangej.

- Prit! - i foli Alba. - Mos m'i ngri nervat më shumë! A ka mundësi të më thuash ç'kérkon? Duhet të jesh Sinthia. Apo jo?

Tjetra i përtypi fjalët nëpërnofulla për disa sekonda.

- Të urrej, - ia bëri pastaj. - Ti më more të fejuarin. Ju qepe siç të qepeni ju lindoret që vini këtu pér të kërkuar lëmoshë dhe pér të gjetur një burrë që t'i shpëtoni mizerjes.

- Nuk është e vërtetë, - ia ktheu Alba qetësisht. - Dhe... nuk më intereson fare ç'ke patur ti me Renaton. Ju mund të sqaroheni të dy.

Italiania i tundi gishtin para fytyrës.

- Ti duhet të shkosh në punën tënde, në vendin tënd! Një lindore si ti nuk mund të zërë dot vendin tim!

Sinthia bëri një hap prapa, pastaj u largua duke thënë me zë të lartë: lindore rrjepacake, vini këtu nga stepat. Po s'kini faj ju! Ky vend s'ka qeveri, as polici, që t'ju marrin të gjithëve dhe t'ju hedhin në det, andej nga kini ardhur!

Alba u kthye në shtëpi dhe i përplasi qeset e plastikta në dysheme pa mundur ta ruante dot qetësinë. Përgatitja e drekës filloj ta nervozonte. Ndërsa po skuqte ragunë e makaronave, e përplasi lugën brenda në tigan pa arritur ta kontrollonte veten. Salca kërceu përpjetë dhe piklat i ranë në rroba dhe në fytyrë.

Ajo u ul e tronditur. Nuk rrihet më këtu brenda, mendoi. Duhet të filloj të dal, të bëj diçka.

Kur ia mbërriti Renato, u mundua të tregohej e qeshur, megjithatë, ai arriti të nuhaste diçka. Ka ardhur një letër nga Amerika, tha duke lënë mbi tavolinë një zarf. Mbase do të ta largojojë ca mërzinë.

- Renato, sikur të më gjeje ndonjë punë, - foli Alba. - Ç'të jetë, qoftë edhe piceri.

Ai qeshi.

- Ti, në piceri?! O, e dashur, ç'i ke këto ide! Unë do të përpinqem pér një punë më serioze.

- E kur do të gjendet kjo punë serioze? - pyeti ajo me ankim.

- Të shohim. Asgjë nuk na ngut.

- Unë dua të punoj! E kupton? Nuk mund të rri dot tërë

ditën mbyllur këtu brenda!

Habia e tij u kthyte në një çudi ironike.

- Si, ty nuk të pëlqejnë shëtitjet, televizori, revistat?! Do t'i ndërrosh të gjitha këto me një piceri?!

- Po, - u përgjigj ajo qetësisht, - Po nuk më gjete punë ti, do ta gjej vetë.

Renato u dorëzua.

- E kuptova. Ti i kërkon gjërat vetëm me kokëfortësi. Për punë do të interesohem unë dhe kjo histori është e mbyllur. Dakort? Hiqe nga koka idenë e picerisë! Ta haje, dreqi! Përpiqu të argëtohesh! Këtu është Milano, jo Tiranë. Nuk ke arsyе pse të rrish brenda.

Ai u ngrit nga tavolina i vrenjtur.

- Më fal, - mërmëriti Alba - Nuk doja të të nervozoj.

- Të kuptoju, - ia bëri Renato duke u afruar për t'i dhënë një të puthur.

Që prej asaj dite ajo vendosi të bënte diçka për ta ndryshuar steriotipin e plogësht të atyre muajve të fundit. Pakësoi gjumin dhe mëngjeseve filloj të bënte shëtitje të gjata në këmbë në një park të madh jo shumë larg pallatit. Për t'i shpëtuar vëtmisë iu duk e zgjuar këshilla e teze Karmelës për të mbajtur një mace. Ia kërkoi Renatos atë gjë dhe ai iu përgjigj pa ngurim: sigurisht e dashur, mund të mbash mace dhe kone, c'të duash. Siç pritej, teze Karmela afroi një zgjidhje bamirësie ndaj botës shtazore. I solli në shtëpi një mace të braktisur, nga ato që mblidheshin mbrëmjeve poshtë pallatit.

- Alba, ti duhet ta kthesh atë mace në një kafshë dinjitoze, që të mos i shkojë mendja te rruga dhe kazanët e plehrave, - tha.

Alba pohoi e bindur. E mori macen, një kuqalashe me qime të shkurtëra, pa ndonjë bukuri të veçantë, për të cilën teze Karmela tha se kishte origjinë aziatike, e lau tri herë radhazi me shampo, e ushqeu dhe i përgatiti një vend në

ballkon. U mendua gjatë për emrin që do t'i vinte. Kaloi nëpër mend disa emra shqiptarë macesh, por asnjeri nuk e bindi. Pastaj, duke u nisur nga ngjyra e kuqe e saj, vendosi të bënte një shpikje dhe ta quante Kuqjana.

Ditët e para filloi ta ndiqte pas nëpër shtëpi dhe ta llastonte, po Kuqjana dukej se e kishte mendjen jashtë në rrugë, ku kishte lënë miqtë e vjetër. Ajo dilte kohë pas kohe në ballkon dhe kërkonte me mjaullima ndonjë të njojur. Një mëngjes, Alba pa poshtë ballkonit një maçok të bardhë me ca sy prej pirati që po i mjaullinte Kuqjanës në gjuhën misterioze të maceve. Sigurisht, duan të takohen, mendoi Alba. Iu kujtuan fjalët e teze Karmelës dhe e futi macen brenda me inat.

- Dëgjo ti, mistrece! - i foli vrazhdë. - Me maçokët rrugaçë nuk ke më punë! Kupton? Tani je një mace zonjë dhe duhet të sillesh si zonjë.

Kuqjana mjaulliu njëherë si me ankim dhe u tulat.

\* \* \*

Por shumë shpejt Alba e pati të qartë se as shëtitjet e gjata në mëngjes dhe as macja me problemet e saja macërore nuk mund ta shpëtonin nga mërzia. Ajo hyri në një periudhë hutimi të plotë, kur, si edhe më parë, kundër vullnetit të saj, Vili filloi t'i kujtohej shpesh e më shpesh.

Gjithçka nisi një mëngjes në parkun e madh, ndërsa po shëtiste. Ai i erdhi ndër mend natyrshëm dhe ajo nuk mundi as ta arrente e as ta dëbonte. Iu duk sikur e kishte pranë, aty përbri, si në kohën e qëndrimit në kamp kur shëtisnin së bashku tërë ditën.

Ajo u ul në një stol dhe befas ndjeu mall. Është normale të më ndodhë, mendoi e turbulluar. Kaluam tërë ata muaj bashkë. Ja, është një moment dobësie, nuk e besoj të më përsëritet prapë.

Por u gabua. Malli jo vetëm që nuk i kaloi, por pas çdo dite sa vinte e i shtohej. E trembur, ajo e nuhati se po ndodhte diçka serioze. Frika iu shtua një mëngjes, pas një ëndërre jashtëzakonisht të çuditshme, kur e pa veten duke bërë dashuri me Vilin në dhomën e saj bashkëshortore. Ishte një ëndërr erotike me të gjitha detajet e saja, deri te orgazma e shoqëruar me rënkim. Ajo brofi ndenjur e pataksur, por Renato nuk ndodhej në krevat. Mori frysë e lehtësuar që atë detaj tepër privat femëror e kishte përjetuar në vetmi. Por pastaj, nga mëngjesi në darkë, vazhdoi të pyeste veten se pse kishte ndodhur ajo gjë aq magjepsëse. Pse gjatë asaj periudhe të martesës nuk kishte arritur dot asnjëherë në orgazmë dhe e kishte provuar atë në një ëndërr erotike me Vilin.

Vendosi të bënte çmos për ta larguar mendjen prej tij. Filloi të ndiqte më rregullisht telenovela dhe të lexonte revista. I rrinte Kuqjanës si xhandar mbi kokë që ajo të mos dilte në ballkon apo në ndonjëren prej dritareve për t'u parë me maçokun e bardhë me sy pirati. Filloi të gatuante gjellë të reja që kërkonin mund dhe vëmendje. Shtoi vizitat te teze Karmela.

Një pasdite pranoi me qejf ftesën e saj për të shkuar në një takim të shoqatës së mbrojtjes së kafshëve. Takimi qe organizuar në një vilë të bukur ku jetonte vetëm një zonjë plakë dhe një dyzinë me kone e mace. Aty qenë mbledhur rreth dhjetë zonja, kryesisht të moshuara. Në sallën e madhe të takimit binte në sy një fotografi gjigande e Bardosë, rrethuar me kafshë shtëpiake.

Atë ditë do të diskutohej një problem tepër serioz.

- Pra, është fjala për mbrojtjen e qenushevë dhe maceve tonë të ndershme nga shtatzania e padëshiruar, - tha kryetarja e shoqatës.

Alba uli kokën dhe kafshoi buzën për të mbajtur të

qeshurën. Kryetarja e shoqatës vazhdoi të fliste për mënyrat se si duhej penguar afrimi i qenve dhe maçokëve rrugaçë, me konet dhe macet shtëpiake. Ne nuk duhet të lejojmë dhunë seksuale ndaj kriesave të dobëta, tha ajo. Kjo dhunë mund të shkaktojë bastardimin e rracës. Kryetarja tregoi një rast tepër fisnik të një zonje amerikane, e cila për ta shpëtuar qenushen e saj nga shtatzania e padëshiruar, kishte paguar 20 000 dollarë për t'i hequr asaj mitrën.

Albës iu duk vetja mes njerëzish të lajthitur. U detyrua të duronte deri në mbyllje të takimit thjesht për edukatë dhe sapo doli jashtë, u betua të mos hynte më në atë vilë.

\* \* \*

Ndonëse në festën e fundit Lazarini i kishte shkaktuar neveri, një të dielë ajo provoi të shkonte me Renaton përvizitë në fermën e tij, thjesht për të larguar mendjen nga një valë e papërbollueshme kujtimesh që lidheshin me Vilin dhe që po e mësynin përherë e më dendur.

Shëtitën gjatë me kuaj, por ashtu siç e kishte parashikuar, Lazarini gjeti rast për të ndenjur vetëm me të dhe për t'i kërkuar që ndonjë ditë të vinte në fermë. Do të isha i lumtur të qëndroja pranë një gruaje si ti, i tha ai duke e mbajtur për beli, ndërsa po kalonin një urëz druri pranë fermës. Alba iu shmang me takt. Nxitoi hapin për të arritur Renaton dhe të shoqen e Lazarinit që po çapiteshin pak metra më tutje. Nuk duhet të kisha ardhur, mendoi. Ai e ka konsideruar ardhjen e sotme si një ngacmim kokete dhe ndoshta nga fjalët e mijë nuk beson më asgjë.

Të dielën e ardhshme, ndërsa Renato i tha se do të shkonin për darkë në shtëpinë e Lazarinit, Alba kundërshtoi prerë. Me atë njeri nuk dua të takohem më, këmbënguli. Në fillim Renato nuk arriti ta kuptonte atë këmbëngulje. Nuk mund

të tregohemi harbutë, foli i nxehur, ai na ka ftuar.

- Unë nuk dua të të vë në pozitë qesharake, - tha Alba pa e vështruar. - Ai njeri mund të më bëjë ndonjë propozim të paturpshëm dhe atëhere...

- O, léri këto ekzagjerime! - ia bëri Renato me mosbesim të hapur.

- Atëherë, unë po të them se ai gati ma bëri propozimin e paturpshëm të dielën e kaluar në fermë! - thirri Alba - Të lutem mos më detyro të kryej veprime të pakontrolluara dhe t'i hedh Lazarinit në surrat ndonjë pjatë me spaghetti!

Renato e vështroi një copë herë i hutuar.

- Duhet ta kesh keqkuptuar, - tha.

Ajo nënqeshi.

- Ti s'ke dyshuar ndonjëherë për koeficientin e zgjuarsisë time! Me Lazarinin duhet t'i japim fund. Po vij sonte me që nuk kemi kohë për t'ia refuzuar ftesën dhe më, pastaj...

Ai po vazhdonte ta vështronte i hutuar.

- Je e çuditshme! - tha.

- Ke të drejtë të mendosh ashtu, - ia ktheu ajo. - Ne nuk patëm kohë të njiheshim.

- Që Lazarini është bajgë, këtë e dija, - psherëtiu ai. - Por... ai ka në dorë karrierën time. Mund të zemërohet, të hakmerret.

Alba i ktheu shpinën vrulltazi.

- Besoj se nuk ke ndër mend të më lësh të shkoj në krevatin e tij për hir të karrierës, - tha duke shtrënguar dhëmbët.

- Mos fol budallallëqe! - ia ktheu ai. - Është fjala për t'iu shmanjur me zgjuarsi.

Asaj i kaluan të dridhura dhe për herë të parë dyshoi në sinqeritetin e tjetrit. Humnëra e mosnjohjes së njeriut me të cilin qe lidhur, iu duk më e thellë se kurë.

- Dëgjø, unë nuk mund ta di se ç'bën një grua italiane e një nëpunësi të vogël kur i propozon shefi i të shoqit, - foli ftohtë. - Unë do të tregohem ajo që jam dhe do të veproj si të

më thotë koka ime. U kuptuam? Mënyrën për t'iu larguar Lazarinit duhet ta gjesh ti.

Renato iu afrua nga pas dhe e shtrëngoi në supe.

- Në këtë shoqëri të fëlliçur, të të lakmojnë gruan e prorët, është një nga gjërat më pak të fëlliçura, - foli me një ton të trishtuar. - Por ti nuk duhet ta mendosh kurrë se unë do të abuzoja me ty për hir të karrierës, duke luajtur rolin e kodoshit dhe të naivit. Mos e lodh shumë kokën. Janë të tjera gra ato që shkojnë me shefat e burrave të tyre. E dinë mirë ç'kërkojnë. Gjuajnjë larg. Kurse ti je një shqiptarkë, ca kokëfortë, që nuk do të infektohesh nga veset e Italisë, sepse kërkon pak. Qetësi dhe një jetë ndryshe nga ajo që ke lënë pas. Ti nuk ke arsyе për të më vënë brirë. Është kështu?

Alba u kthye përballë tij.

- Besoj se po, - tha. - Veç mos pandeh se do ta bëj këtë nga që jam e varfër, nevojtare dhe se vij nga një vend i shkatërruar i botës së tretë. Besnikeria ime ndaj teje nuk lidhet aspak me këta detaje. Për fat të keq, edhe ti mendon njëlloj si ato gratë llafazane që kam takuar nëpër festa.

- Nuk është tamam ashtu, - kundërshtoi ai.

- Nuk më gënjen dot, - ia ktheu ajo. - Nuk ia vlen të lodhesh.

## 17.

Kjo fazë nervozizmi është kalimtare, filloj t'i mbushte mendjen vetes ajo si edhe më parë, pak ditë pas atij debati. Fundja Renato nuk është edhe aq i komplikuar sa ç'më duket mua. Jam unë që nuk po përshtatem dot. Përpinqem të gjej te ai dhe te miqtë e tij, vetëm gjëra negative. Ndoshta edhe Lazarinin mund ta kem keqkuptuar. S'është çudi. Jam bërë një tekanjoze që as vetë nuk e di se çdo. Hedh vickla kur s'më mungon asgjë dhe kur me dhjetra vajza të tjera ëndërrojnë për këtë fat. Me sa duket Renato duhet të më tregojë ndonjë ditë derën që të më vijnë mendtë. E bëra vetë këtë zgjedhje dhe tani duhet ta pranoj. Renato ka të drejtë kur thotë se kërkoi një jetë ndryshe nga ajo që lashë pas. Ai e di fare mirë se u martova me të thjesht e shtyrë nga interesa materialiste dhe unë më kot përpinqem t'i rebelohem këtij fakti, duke u shtirë si krenare. Haja, rri urtë aty dhe mos shit dëngla!

Dhe ti më lër në hallin tim të mori dreqi, iu kthyen një mëngjez korriku Vilit, ndërsa ai iu kujtua, sapo hapi sytë. I foli atij me zë të lartë sikur të ishte struktur aty, në ndonjë cep të dhomës dhe sikur të donte ta dëbonë. Por Vili nuk u largua. Ajo filloj rishtazi përpjekjet për ta harruar atë, por më kot. Kur nuk mundi të rezistonte dot më, hoqi dorë nga çdo lloj sforcimi. Njëherë dyshoi se ajo gjendje i shkaktohej nga që ishte e pakënaqur seksualisht. Për t'u çliruar nga ngacmimet, një mëngjes, ndërsa qe futur në ujin e ngrohtë

të vaskës, në mënyrë gati të pakontrolluar filloi të masturbonte. Pas disa minutash, kur e ndjeu veten të ç'tensionuar, i erdhi turp dhe nuk guxoi të vështrohej në pasqyrë. Masturbimi i qe dukur gjithmonë një gjë e mistershme dhe në jetën e saj e kishte provuar atë fare pak herë. Dikur, fillimisht, i kishte ndodhur kur kishte qenë gjimnaziste, thjesht nga kurioziteti. Pastaj më vonë një qershor me vapë, kur kishte qënë me provime dhe nuk përqëndrohej dot mbi libra. Atëherë, me naivitet, kishte menduar se masturbimi ishte diçka e keqe, një ngasje djallëzore, të cilën e praktikonin vetëm vajzat e përdala. Sapo ishte njojur me studentin e Francës dhe nuk e kishte provuar ende dashurinë...

Por nga ai mëngjes i turpshëm provoi vetëm një lehtësim të përkohshëm. U detyrua ti dorëzohej masturbimit sa herë që ndjente ngacmim, duke menduar se ndjenja e turpit nga ai lloj veprimi ishte budallallëk, pasojë e injorancës dhe tabuve seksuale me të cilat qe rritur.

Për ironi, masturbimi jo vetëm që nuk e shpëtoi nga malli për Vilin, por ia shtoi edhe më shumë dëshirën për të bërë dashuri me të. Detyrohej të fantazonte skena dashurie me të për të rritur kënaqësinë dhe për të shpëtuar nga ajo gjendje torture. Dyshoi se po bëhej maniakë dhe vendosi të hiqte dorë nga ajo praktikë njëherë e mirë.

Ditët e gjata e me vapë sa vinin e bëheshin më të padurueshme. Jashtë mund të dilej vetëm në mëngjes herët ose në mbrëmje vonë. Zagushia të mbyste. Alba filloi të vërtitej nëpër shtëpi gjithnjë e më e hutuar dhe e mërzitur. Telenovelat amerikane iu velën dhe revistat e mbushura me skandale VIP-ësh gjithashtu. Kuqjana nga ana e saj kishte filluar të bëhej tepër e bezdisur. Mjaullinte, ankohej, férkohej nëpër këmbët e karrikeve e kërkonte vazhdimiisht të dilte në ballkon. Maçoku me sy pirati nuk po i ndahej. Një paradite ndërsa po kthehej nga supermarketata, apo hapi

derën e apartamentit, Alba mbeti e tmeruar dhe qeset e plastikta i ranë nga duart. Maçoku me sy pirati ndodhej brenda. Duke përfituar nga dera e hapur, ai doli vrulltazi dhe u zhduk nëpër shkallë. Alba vështroi nga ballkoni. Dera e tij ishte e hapur. Ajo nuk u besoi syve. Kur kishte dalë, e kishte lënë atë të mbyllur. Pastaj, mbetej mister fakti se si maçoku ishte ngjitur deri në kat të katërt. Ajo doli në ballkon dhe pa se afër tij kalonte një tub i bakërt për shkarkimin e ujrale të shirave. Poshtë, në sheshin e asfaltuar, kishte qëndruar një kamion i madh.

Ajo filloi ta ndërtonte takimin macëror detaj pas detaji. Fillimisht, maçoku kishte hiper mbi kamion. Prej aty kishte kërcyer në ballkonin e katit të dytë dhe nëpërmjet tubit të bakërt kishte arritur në katin e katërt. Derën sigurisht ia kishte hapur Kuqjana duke kërcyer drejt dorezës dhe duke e ulur atë poshtë. Ai ishte një veprim elementar për macet e shtëpisë. Ato ishin të afta të hapnin jo vetëm doreza, por edhe lloze.

Alba vështroi nga Kuqjana me inat. Ajo qe struktur si e përgjumur në një kolltuk. Dukej e lehtësuar. Sigurisht ka bërë dashuri me atë piratin, mendoi Alba. Iu afrua dhe ia ngjeshi me shpullë në kokë.

- Rrugaç! E fute që e fute atë banditin brenda!

Kuqjana rënkoj njëherë si me ankim. Pas asaj dite Alba nuk pati më durim të luante rolin e xhandarit dhe e la macen të lirë të bënte ç'të donte. Derën e ballkonit nuk e mbylli më. As dritaret nga ku sypirati mund të rrezikonte kokën për të hyrë.

Vapa brenda në apartament u kthye në një torturë. Pasditeve Alba filloi të dilte në parkun e madh ku shëtiste mëngjeseve.

- E shoh që ke filluar të mërzitesh prapë. - i tha Renato një ditë. - Nuk ke ç'i bën. Vera është e bezdishme në Milano.

Kurajo, duro edhe pak! Për pushime do të shkojmë tek hallë Ana, në Pieve.

Ajo përfitoi t'i hapte bisedën e një shqetësimi të vjetër, ndonëse e dinte se do të merrte përgjigje negative.

- Po afron shtatori, - tha. - Ti e di se atje, në Shqipëri, e kam lënë fakultetin në vit të fundit. Do të doja ta vazhdoja këtu.

Renato mblođhi njëherë supet.

- Në parim nuk jam kundër. Por ti e di, këtu fakulteti ka shpenzime. Vetëm me pagën time... Ndoshta më vonë...

- Unë mund të punoj vetë.

- Durim të thashë!

Alba lëvizi vendit e nervozuar.

- Çfarë dreq durimi! Pse nuk më le të punoj në ndonjë piceri? Unë dua të fitoj para me djersën time.

- Akoma me picerinë ti?! Ta hajë dreqi! Më duket se duhet të kesh më shumë respekt për mua! Të lutem, tregohu më e arsyeshme! Edhe puna do të gjendet. Më vonë të shohim për fakultetin.

Ajo uli kokën.

- Je e sigurtë se nuk ke ndonjë problem tjeter? - pyeti ai papritur.

Alba ngriti sytë rrufeshëm.

- Çfarë problemi? - pyeti si e trembur.

- Nuk e di. Ndonjë problem që nuk të le të qetë.

- Jo, - u përgjigj ajo. - Problemet janë ato që të thashë pak më parë.

Është e pamundur që ai të mos ketë nuhatur diçka, mendoi pastaj. Nuk është naiv. Unë nuk jam femra e parë për të.

- Kam një ide që do të të pëlqejë, - foli Renato. - Pse nuk fillon të mësosh makinën? Patenta do të të duhet në rast se gjejmë ndonjë punë... Si të duket?

- Më pëlqen, - tha Alba, - por tanë është shumë vapë.

- Si të duash. Kursi do të të shpëtonte disi nga mërzia.

Ajo filloi ta ngushëllonte veten me ditët që do të kalonin në breg të detit në Pieve. Me siguri ndryshimi i mjedisit do të ndikojë për mirë, mendoi. Shtyrja e ditëve të gjata dhe të nxehta u bë disi më e lehtë. Nga fillimi i gushtit i erdhi një letër nga shtëpia, ku ndër të tjera prindërit e njoftonin se Sava, kushërima e saj e dytë, qe vendosur më në fund familjarisht në Torino. Ata i kishin dërguar adresën dhe numrin e telefonit të saj. Alba i ra numërit në çast. Sava me sa dukej e kishte pritur atë telefonatë dhe thirri e gjëzuar. Të lutem eja ndonjë ditë për vizitë, iu lut, se nuk kemi të njohur këtu.

Në mbrëmje Alba i foli Renatos për Savën dhe i kërkoi të shkonte në fund të javës në Torino.

- Ide e bukur, - ia bëri ai me një ton dhe fytyrë të padëshi-frueshme. - Shko dhe rri nja dy ditë.

Alba u nis me qejf. Mbërriti në apartamentin e vogël të kushërirës të shtunën pasdite. Sava me të shoqin, një inxhinier mekanik që kishte filluar punë në një oficinë riparimi makinash, apo ishin kthyer. Kishin marrë edhe djalin 3-vjeçar në çerdhe. Ishin të lumtur së bashku dhe Albën e tërroqi ajo ngrrohtësi familjare. Kishte kohë pa folur shqip dhe dashur pa dashur, instiki i rracës bëri të veten. Në darkë, ndërkohë që i tregonte për punën që kishte filluar në një punishte makaronash, Sava përgatiti ravioli të freskëta të cilat i kishte bërë me duart e saja. Albës i shijuan jashtë mase.

- Bravo! – tha. - Qenke bërë specialiste.

- E kam nisur me qejf. Është një zanat që s'të lë kurrë pa bukë. Pronarja është e mirë, më do. Burri i saj ka qënë ushtar në Shqipëri në kohën e luftës.

Të nesërmendite ato shkuan të dyja nga punishtja e makaronave dhe Alba bleu një kile ravioli për t'i marrë me

vete. Sava e futi nga dera e pasme e lokalit dhe i tregoi vendin ku punonte. Është ca e lodhshme, tha, duhet të rrish tërë kohën në këmbë, por pronarja na paguan mirë. Të dielave dhe festave na jep dyfish. Kohë pas kohe ka edhe shpërblime.

Alba ktheu sytë nga një tavolinë e madhe ku po punonin dy gra të reja. Duart e tyre i mbushnin raviolet e vockla me mish të grirë dhe i palosnin me një shpejtësi të habitshme.

Pasdite, ndërsa kthehej me tren për në Milano, asaj i shfaqej kohë pas kohe para syve tavolina e mbushur me brumë dhe mish të grirë, ku gratë duarshkathëta përgatisnin ravioli.

\* \* \*

Ditët para nisjes për në Pieve ajo u gjallërua disi. Bleu disa rroba vere dhe vogëlsira të tjera që nevojiteshin për në plazh. E kishte marrë malli për detin dhe Vilën e Trëndafilave. Që pas martesës kishin shkuar atje së bashku me Renaton vetëm dy herë. Sartori nuk kishte pajtuar ndonjë vajzë tjetër për ta shoqëruar. Kujtimet vazhdonte t'i shkruante në të rrallë.

Ata u larguan nga Milano me 15 gusht, pasi Alba e la Kujjanën nën kujdesin e teze Karmelës.

Kur vetura mbërriti para vilës, Renato u ndal ca, psherëtiu njëherë i menduar, pastaj foli me një ton ngazëllues:

- Shiko e dashur! A e di se një ditë kjo vilë e bukur mund të jetë e jona?

Alba u shtir si e paditur.

- Si e jona?! Nuk të kuptoj.

- Unë jam aktualisht njeriu më i afërt i hallë Anës. Një ditë, kam besim se do të trashëgoj prej saj një pasuri fantastike.

Alba uli kokën. Ishte hera e parë që Renato i fliste për të atilla gjëra dhe ajo nuk e kuptoi pse zgjodhi pikërisht atë ditë.

- Nuk të kam pyetur, - tha, - si ka mundësi që zonja Sartoni është kaq e pasur dhe ti nga yt atë...?

Ai nënqeshi.

- Gjithçka që halla ka sot e ka trashëguar nga tre burrat e saj. Më kupton? Im gjysh ka qënë një peshkatar i varfër. Kur u njoh me burrin e parë, atë oficerin e marinës, hallë Ana këndonte në Gjenovë, në një kabare. Ajo ka qënë shumë e bukur dhe ai u marros pas saj. E mori për grua, ndonëse familja e tij nuk pranoi. Oficeri i përkiste një familjeje aristokratësh të vjetër.

Alba nuk foli më. Në kujtimet e veta Sartori nuk e kishte përmendur kurrë atë detaj dhe punën në kabare. Ajo ishte ende e hutuar kur u takua me zonjën dhe governanten. U afrua te vetrata e madhe e sallës së ndënjos dhe vështroi tutje në det për ta larguar disi vëmendjen nga rrëfimi i befasishëm i Renatos. Por pas ndonjë ore, kur u ngjitet lart në dhomën e saj të dikurshme dhe u pështet në parvazin e dritares, sytë i shkuar padashur te serrat e luleve ku Vili kishte punuar dikur dhe ndjeu sytë që iu njomën nga lotët. I ktheu shpinën dritares duke mbuluar fytyrën me duar.

Pasdite, ndërsa po zbrisnin me Renaton për në plazh, ai e ndali veturnën para një semafori dhe pyeti papritur:

- S'po më thua asgjë për atë që të tregova paradite?

Alba e vështroi qëtësisht.

- E ke fjalën për trashëgiminë e zonjës Sartori?

Renato pohoi me kokë.

- Nuk di ç'të them. Nuk jam mësuar me këto gjëra. S'kam patur ndonjëherë të bëjë me pasuri e trashëgimi. Andej nga ne, deri vonë, gjithçka ka qënë e shtetit.

Renato nënqeshi.

- Të lutem tregohu më e singertë! A do të doje që një ditë Vila e Trëndafilave të ishte e jona?

- Për mua, si me vilë si pa vilë, është njëlloj.

- Mos do të thuash se është njësoj edhe për paratë e trashëguara? Mos harro se me to mund të shkosh në fakultet!

Alba i ktheu sytë mënjanë.

- Mos guxo të më provokosh, - tha ftoht.

- Unë s'po të provokoj, - tha tjetri me një ton më miqësor.

- Unë i përulem parasë. Punoj si kafshë tërë vitin për ato para. Deri vonë më kanë munguar. Kam patur një fëmijëri të varfër.

- Unë do të doja t'u përulesha vetëm parave të mia, - tha Alba. - Është një përulje e justifikuar.

- E lëmë këtë temë, do të bisedojmë ndonjëherë tjetër më shtruar, - ia bëri Renato, duke u përqëndruar në timon.

Para të neveritshme, mendoi ajo, pse janë kaq të gjith-pushtetshme? Sikur Vili i gjorë të kishte pasur atëherë qoftë dhe një milion lireta, nuk do të kishte përfunduar ashtu. Po unë, pse nuk ia dhashë? Atëherë kisha para. Eh, ai nuk do t'i kishte pranuar. Ishte tepër krenar për të pranuar para. Le që atë ditë në port ai kishte vendosur të ndaheshim...

Në ditët që pasuan nuk mundi të shkëputej më nga kujtimet e vjetra. Një mbrëmje, ndërkokë që Renato kishte shkuar për të gjuajtur peshk me një mikun e vet, doli vetëm dhe këmbët e shpunë vetiu poshtë, në breg të detit, në vendin e fshehtë mes shkëmbinjve, kur dikur futej me Vilin për të bërë dashuri. U afroa dhe i preku shkëmbinjtë me dorë si të njojur të vjetër.

Një mëngjes, në breg të detit Renato e vështroi ca çaste, pastaj tha papritur:

- Nuk të kam pyetur, ç'bëhet ai shqiptari?

Alba shtangu.

- Cili shqiptar?

- Ai që ti doje dikur.

Ajo u ul në shezlong e tronditur.

- Ç't'u tek të pyesësh për të?

- Ashtu, kot.
- Nuk di asgjë. Ndoshta është kthyer në Shqipëri.
- Nuk të ka telefonuar kurrë?
- Kurrë! Ai nuk e di as adresën e as numrin tonë.
- Ndonjëherë dukesh tepër e mbërthyer nga nostalgjia në këtë vend.
- Ti dyshon se kjo nostalgi lidhet me atë, shqiptarin?
- Unë bëra vetëm një konstatim.
- Ah, konstatim! - shfryu Alba me ironi. - Të është shkrepur të luash xhelozin apo çfarë?

Renato qeshi për ta kapërcyer atë situatë pa sherr.

- Çfarë xhelozie! Të shkuara të harruara! Pyeta ashtu, kot.

Nuk më mashtron dot, mendoi Alba, ke filluar të dyshosh.

- Me që e hape këtë histori, dua të të bëj edhe unë një pyetje, - tha. - Ai pronari i serrave e pushoi atë shqiptarin pa asnjë shkak, pikërisht kur ishte piku i punëve. Ja kërkove ti këtë gjë?

Renato nuk i ngriti sytë.

- As mos të të shkojë nëpër mend! - tha me një prekje të lehtë.

- Nuk të besoj!

- Si të duash! Por edhe sikur ta kisha bërë, do të kishte qënë diçka normale. Ai atëherë ishte rivali im. Unë doja të të shkëpusja prej tij. Kisha filluar të të doja. Ti e di shumë mirë këtë.

- Pra, ishe ti që e pushove?

Renato heshti gjatë.

- Jo, - tha.

- Po zonjës Sartori i ke kërkuar të ndikojë mbi mua për t'u martuar me ty? - këmbënguli Alba.

- Ah, po, kjo është e vërtetë. Unë Sartorin e kam hallë. Asaj i pëlqeu ideja ime për t'u lidhur me ty. Ajo kishte dobësi për ty. Ndoshta ishte një dobësi subkoshiente. Ti i kujtoje

rininë e vet të varfër. Renato, martohu, më tha. Bëje zonjë. Bëj një bamirësi në këtë botë të egër.

Alba e hodhi vështrimin larg në det dhe nuk foli më. Deri ditën e fundit nuk mundi të ndahej nga e shkuara që e lidhte me atë vend. Në mëngjes, para se të iknin, doli edhe njëherë në dritaren e dhomës së saj të dikurshme dhe vështroi poshtë nga stacioni hekurudhor. Atje po shkëmbeheshin dy trena. Asaj iu kujtuan ditët kur dilte në platformë dhe priste ardhjen e Vilit. Zot, sikur ta takoja edhe njëherë, mërmëriti. Ashtu kot, thjesht për t'i shtrënguar dorën.

## 18.

Vili u ngrit vrulltazi, nxori trupin në dritaren e hapur dhe vështroi lart nga Vila e Trëndafilave. Në dritaren e dhomës së dikurshme të Albës iu duk sikur po qëndronte pështetur në parvaz një figurë e ngjashme më të. Ai fërkoj sytë, por ndërkohe treni u nis dhe vila u zhduk pas një masivi shkëmbor. Ose ishte ajo ose unë kam filluar të lajthis, mendoi duke rënë në ndenjëse i hutuar. Ai solli ndërmend tërë ato netë plot vapë kur nuk mund të flinte, ndonëse ishte i dërrmuar nga puna. Kishte kohë që u ishte dorëzuar plotësisht historive të vjetra që e lidhnin me Albën. Një ditë qershori, si pa kuptuar, kishte kërkuar në çantë, mes librave dhe fletoreve, një fotografi të vjetër ku kishte dalë së bashku me Albën, në Savonë. E kishte vështruar atë gjatë, me një mall mbytës, pastaj, instiktivisht e kishte afruar te buzët dhe kishte puthur fytyrën e saj. Një herë, dy herë, tri... Që atë ditë nuk kishte mundur të shkëputej prej saj. Fotografinë e kishte vendosur pranë kokës së krevatit, në mur dhe kur shtrihej në brinjë e kishte fare pranë.

Një të dielë korriku kishte shkuar në Pieve për të bërë plazh dhe qe ulur pranë shkëmbinjve ku dikur strukej me Albën. Kishte pritur për disa orë me rradhë ta shihte atë duke ardhur. I qe bërë fiksim se ajo do të vinte një ditë, krejt papritur, diku, në një vend të papërcaktuar, ku ai do të ishte duke pritur...

U përmend vetëm kur treni mbërriti në stacionin qëndror

të Gjenovës. Zbriti dhe u nis drejt universitetit duke u përpjekur të harronte gjithçka. Atë ditë duhej të jepte provimin e gjuhës italiane. Ndërsa iu afroa godinës së madhe, iu kujtua se si dhjetë ditë më parë kishte qëndruar në atë vend, i mbytur në djersë, i mbërthyer nga ankthi, me një deklaratë të lëshuar nga Banka e Kiavarit dhe Rivierës Ligure, me anën e së cilës dëshmohej se ai kishte të depozituara në atë bankë 8 milionë lireta. Kur e kishte paraqitur atë në sekretari, për t'u rregjistruar në universitet, njëri prej sekretarëve kishte lëshuar një thirrje miqësore habije: bravo shqiptar.

- Si ke mundur t'i mbledhësh tërë këto para? - kishte pyetur pastaj.

Vili kishte nxjerrë përpara duart e fryra, të mbushura plot kallo, të çara e me gjurmë plagësh. Sekretari kishte bërë një gjest keqardhjeje.

- Në emër të Zotit, lyeji me ndonjë krem të mirë, - i kishte thënë.

Pas rregjistrimit Vili kishte dalë nga godina me sy të përlotur, duke sjellë ndër mend ditë pa fund pune, me erë, me shi, me diell përvëlues, me thasë çimentoje e kova llaçi në supe, me sharje ustallarësh të pakënaqur, që vetëm pinin duhan dhe blasfemonin, me një frikë të përhershme se mos kapoja i kantjerit e dëbonte. Nga maji, kur kishte filluar sezoni i turizmit, ai kishte filluar të lante pjata në fundjavë në një piceri të re, tepër të pëlqyer. Kishte raste që e thërrisin edhe gjatë javës. Kur kthehej në shtëpi nga mesnata, gati dremiste duke ecur. Duart iu acaruan nga solucionet larëse. Ato iu keqësuan edhe më shumë gjatë korrikut e gushtit kur filloi të punonte në piceri gati çdo natë, pasi qe kthyer nga kantjeri dhe kishte pushuar vetëm një orë.

Ai hyri në sallën e provimit me një ndjenjë pasigurie. Bëheshin një grup i madh studentësh të huaj që do të jepnin

gjuhën. Provimit do t'i nënshtroheshin me shkrim dhe gjatë verës Vili nuk kishte patur kohë të ulej gjatë mbi librat e sintaksës e gramatikës.

Kur pa tezën, e ngrohu njëra prej kërkesave. Duhej riprodhuar shkurtimisht subjekti i ndonjë vepre artistike nga letërsia italiane. Atij i erdhën ndër mend fragmente të tërë nga një novelë e Moravias, me të cilën kishte filluar të merrej nga pak të dielave, kur kishte disa orë të lira. Iu fut asaj të parës dhe për habinë e tij, vuri re se dora i ecte lirshëm.

Ndenji në sallën e provimit rrëth tri orë dhe kur e pa se nuk kishte ç'të shkruante më, doli. Një sekretare e njoftoi së përfundimin e provimit mund ta mësonte shumë shpejt, thjesht duke telefonuar. Vili e falënderoi dhe doli.

Vendosi të ecet ca dhe këmbët e çuan vetiu nga porti. Shkoi dhe u ul në bordurën ku muaj më parë qe ndarë me Albën. Nuk mendoi kurrgjë. Nuk pati dëshirë të lidhë atë vend me ndarjen e tyre. Zot, bëj një mrekulli dhe më ndihmo ta takoj njëherë, mërmëriti. Vetëm një herë. Sa t'i flas, sa ta prek.

U largua pas ndonjë gjysmë ore, duke përkëdhelur me dorë vendin ku Alba ishte pështetur dikur.

Në të dalë të portit pa një kabinë telefonike dhe iu kujtua Meri. Futi dorën në xhep dhe nxorri një monedhë. Me Merin kishte biseduar shpesh në telefon, ndërsa ajo kishte ardhur një ditë qershori në Rapalo për ta takuar. Kishte qënë së bashku me një mikun e vet italian, një detar me emrin Xhakomo. Pak ditë më parë, kur kishte ardhur në Gjenovë për t'u rregjistruar në universitet, Vili e kishte kërkuar, por nuk e kishte gjetur. Atëherë, kishte dalë në kërkim të fqinjët të tij të vjetër, kamerunasit Ngea.

Zëri i Merit u përgjigj që matanë linjës. Ai mori frysme i lehtësuar, pastaj i foli.

- Ua, Vili! - thirri ajo. - Je në Gjenovë?! Eja shpejt se po

**ftohen makaronat!**

Ai u nis drejt shtëpisë së saj duke qeshur.

Meri i dha një të puthur te dera dhe e uli drejt e në tavolinë.

- Surrat i poshtër! - tha me një ton miqësor. - Pse s'je dukur?

Vili i tregoi për problemet që kishte patur ato kohë me universitetin.

- Pra, u fute edhe në universitet?! - thirri Meri e gjëzuar. - Urime! Prit ta pij një gotë verë me fund, - ajo e thau gotën, pastaj fshiu buzët me kurrizin e dorës e shkujdesur. - Vili, dëgjo, - ia bëri pastaj tepër serioze. - Përpiku të dalësh i pari i kursit! Ne duhet t'u tregojmë këtyre evropianëve pordhacë se jemi të zgjuar dhe me kulturë, pavarësisht se vijmë nga ferri. Prit, ta mbush edhe njëherë. Hapt, gjëzuar!

Vili e vështroi ca çaste i menduar.

- Meri, ç'ka ndodhur? - pyeti. – Të shoh shumë të lumtur, ke ca sy...

- Si?

- Ndryshe. S'di si ta them... si...

- Janë sy të sëmurë, - ia bëri ajo duke u skuqur. - Sëmundja e vjetër. Jam e dashuruar.

- Me...?

- Po, me atë marinarin, Xhakomon. Të pata thënë Vili se do të më vinte fati. Para pak ditësh ai më propozoi të martoheshim. Unë pranova. Është tip si unë, më ngjan. Eja, më tha, jetojmë bashkë. Unë po martohem me shpirtin dhe jo me seksin tënd. Ka raste që seksi më duket pjesa më e neveritshme te një femër. Dhe unë pranova. Ai ka një shtëpi të vogël, diku andej nga San Remo. Do të shkojmë atje.

Vili u zgjat dhe e puthi në faqe.

- Urime! – tha. - Po më bëhet shumë qejfi. Besoj se ke ndryshuar opinion për botën.

Meri tundi kokën.

- Jo! Kjo botë mbetet e qelbur dhe me fare pak njerëz të mirë.

Vili nuk u përgjigj.

- Jepi, të pijmë, - vazhdoi ajo. - Qënkemi të dy për t'u dehur.

Ata ndenjën në shtëpi deri vonë pasdite, kur vapa ra disi, pastaj dolën së bashku. Bënë një shëtitje të gjatë dhe hëngrën akullore në një bar. Para se të ndaheshin, Vili nxori nga xhepi një zarf të vogël dhe ia zgjati Merit i mallëngjyer.

- Të kujtohet? – tha. - Është ai borxhi i vjetër. 200 000 liretat që m'i dhe pa interes.

Meri e vështroi njëherë shtrembër, pastaj e shtyu zarin me kurrizin e dorës.

- Vil, mos u bëj fare! As që do të më binte ndër mend për to.

- Të lutem! - këmbënguli ai i prekur. - Borxhi është borxh.

- Ashtu? Atëherë, s'po i mbajmë as ti e as unë. Shko dhe bëj ndonjë bamirësi. Ka plot njerëz që janë në ditë të hallit, siç ishe ti dikur.

Vili pranoi. U nda me Merin duke i premtuar se do t'i telefononte rregullisht dhe ndonjë ditë, kur të kishte kohë, do t'i shkonte për vizitë andej nga San Remoja, ku ajo do të jetonte me atë detarin e saj.

- Vil, i duhem i njëri-tjetrit, - tha ajo. - Mos harro, jemi pak në këtë botë!

Ai pohoi me kokë.

- Të kuptova. Do të të jem për jetë mirënjoës Meri. Paty... ndoshta...

- Hajt, léri këto, - ia bëri ajo duke e përqafuar. - Të uroj të gjitha të mirat! Kujdes me poezitë!

Ai e ndoqi gjatë me sy, deri sa figura e saj humbi mes njerëzve.

Ndërsa mbrëmja po binte. Vili u nis drejt kishës ku ishte strehuar dikur. Te porta e madhe e korridorit të mencës kishte njerëz. Ai njozu nga pamja një grup shqiptarësh. Njëri prej tyre shau vrazhdë. S'na u ndanë rradhat edhe në Itali, ia bëri i mërzitur. Vili u mendua ca, pastaj u çapit pak më poshtë dhe i ra ziles së portës kryesore. Derën ia hapi prifti që e kishte strehuar dikur.

- Mirëmbrëma ati im! Desha t'ju lija këto, - Vili i zgjati zarfin me para. – Janë ndihmë për të pastrehët.

Prifti e vështroi njëherë i menduar.

- Bir, kush je ti dhe nga vjen? - pyeti pastaj.
- Jam strehuar këtu muaj më parë.

Vili ia la zarfin në dorën e rrudhur, pastaj ia puthi atë dhe u largua. Porta ndenji gjatë hapur pas shpatullave të tija.

Ndërsa treni lokal u ndal në Pieve Ligure, ai nxorri përsëri trupin në dritare dhe vështroi sipër nga Vila e Trëndafilave. Por dritarja e dhomës së dikurshme të Albës ishte e mbyllur. Asnjë dritë e ndezur nuk dukej. Në mëngjes duhet të më kenë gënijyer sytë, mendoi ai. Ka qenë thjesht një fanepsje dhe kjo tregon se nuk jam në terezi.

\* \* \*

Me të mbërritur në Rapalo, doli nga shëtititorja e bregut të detit kur zakonisht mblidheshin shqiptarët. E gjeti grupin e tyre të vogël mbështetur në bordurat e hekurta buzë ujit. Aty pranë, një këngëtar shëtitës po jepte koncert. Vili u afrua dhe përshëndeti.

- Hë? - pyetën ata gati njëherazi. - Si dole?
- Të shohim, - ua ktheu ai.
- Tosi kishte diçka për të të thënë, - foli Ramoshi me një pamje neutrale.

Vili filloi të kërkonte njëpër shëtitore i emocionuar. Tosi, një tiranas te të tridhjetat, punonte në peshkërinë Bartoli, një nga pikat më të mëdha të shitjes së peshkut në zonë. Vili i qe lutur disa herë pronarit të tij që ta merrte në punë me një turn të pandryshuar, nga ora 14-22.

- Unë nuk flas po nuk piva një "Xhek Daniel's" me akull,
- tha Tosi. - Hajde, tundu, se kemi lajme të mira.
- Ata u ulën në një bar dhe tjetri e ktheu uiskin duke buzëqeshur i kënaqur.
- Ia hodhe, - tha pas pak. - Bartoli do të të marrë në punë. Mund të vish që nesër të fillosh.

Vili zgjati krahët dhe e përqafoi.

- Veç dije se aty është lemeri, akull dhe lagështirë, - vazhdoi tjetri.
- Nuk kemi për të vdekur, - ia ktheu Vili.
- Për të vdekur jo, - psherëtiu Tosi, - por do të marrim reumatizëm sa për të rënkuar tërë jetën.

Vili e vështroi njëherë i menduar. Tjetri pinte shumë duhan dhe ndenjen pranë gotës së uiskit e kishte kënaqësinë më të madhe të ditës.

Kur ata u bashkuan me grupin te shëtitoreja, dikush përmendi diskotekën e Kovos që ndodhej pak kilometra më tutje. Shkojmë, ia bëri me qejf pjesa më e madhe.

- Unë jam i lodhur, - tha Vili. - Po kthehem në shtëpi.
- Ti ke për të bërë detyrat, - foli Tosi duke i rënë supit. - Ne, klasa punëtore, s'kemi detyra. Ne duam rrok, seks dhe "Xhek Daniel's" deri sa të na shkojë truri në zero. Poshtë peshku, tullat dhe llaçi!

Ata u nisën duke qeshur.

Vili mbërriti të nesërmen pasdreke në peshkërinë Bartoli me një ndjenjë pasigurie, ndonëse kishte pastruar peshk në jetën e tij me dhjetra herë.

Pronari e mati njëherë me sy.

- Djalosh, mua nuk më interesojnë universitetet apo akademitë që do të vazhdosh ti, - tha. - Unë dua punë dhe disipline absolute. Mua më intereson vetëm peshku!

- Ju siguroj se nuk do të më kapni kurrë në faj, - ia ktheu Vili.

- Të shohim.

Vili përveshi mëngët dhe iu afrua Tosit. Tjetri i kishte sytë të skuqur e fytyrën të mufatur. Kishte ardhur nga diskoteka drejt e në punë.

Ai i vuri para një arkë me sepje dhe i tregoi si pastroheshin ato.

- S'mbarohen kurrë peshqit e detit! – shfryu i mërzitur. - Pas nja gjashtë muajsh edhe ti do të katandisesh si unë. Do të kërkosh aspirina, cigare dhe uiski.

Vili nuk iu përgjigj. Vazhdoi të pastronte sepje, duke qënë i bindur se pronari do të fillonte ta përgjonte në bisht të syrit. Pasdite mbeti vetëm me një punëtor italian. Ai i vuri para disa arka me peshk, pa folur. Vili i vështroi ato i trembur. Durim, tha me vete. Nuk janë asgjë para llaçit e tullave.

Vonë në mbrëmje, kur nëpër arka nuk kishte mbetur më peshk, filloi të lante bankot e veshura me pllaka majolike dhe dyshemenë. Pronari kishte qëndruar në prag të lokalit dhe po bisedonte me një mikun e vet. Vetëm pasi kaloi ora 22, ai u kujtua.

- Mjaft për sonte, - ia bëri duke vështruar njëherë lokalin cep më cep.

Vili lau duart, pastaj i vështroi ato duke psherëtirë i lodhur. Kishte hequr një copë lëkure me thikë dhe qe shpuar në tre-katër vende nga halat. Jo edhe aq keq si fillim, mendoi. Kur u takua me shqiptarët te bordurat e hekurta, u mat të kërkonte një cigare. Por në çast u përmbjait. Kishte kohë që nuk tymoste më. E kam nga lodhja, tha me vete. Është dita e parë. Iu kujtuan fjalët e Tosit për cigaret, aspirinat dhe

uiskin. Aspirina ndoshta po, por cigare dhe alkool kurre, mërmëriti gati me inat.

Të pasnesërmen, para se të hynte në peshkëri, u ndal te një kabinë telefonike dhe formoi numrin e sekretarisë së universitetit me dorë të dridhur.

- Jam Vildan Bregu, - tha. - Desha të dij për provimin e gjuhës italiane.

- Ah, ti je ai shqiptari! - iu përgjigj një zë miqësor. - Urimë mik! Ke dalë shumë mirë. Më 1 tetor eja të fillosh fakultetin.

Vili doli nga kabina duke qeshur si i marrë.

\* \* \*

Ditën e parë të fillimit të fakultetit, ai veshi rrrobat më të mira të garderobës së tij të varfër. Kishte blerë disa gjëra të shtrenjta me rrogën e fundit që kishte marrë në peshkërinë Bartoli dhe kur e krahasoi veten me studentët e tjera italiane, nuk vuri re ndonjë ndryshim. Vetëm duart e tradhëtonin. Të ashpra e tërë vragna ato kontrastonin dukshëm me veshjen. Vili nuk dinte si t'i fshihte. Herë pas here i fuste në xhepat e pantallonave.

Ndenji gjatë para godinës së madhe të universitetit sikur donte të bindej që në atë vend nuk ishte më i huaj, pastaj hyri në një auditor ku qenë mbledhur studentët e kursit të parë të letërsisë. E ngushëlloi fakti që mes tyre kishte edhe të huaj; dy zezakë, dy afrikano-veriorë, një amerikano-latinas, bile edhe një kinez apo ndoshta korean. Vili zuri vend dhe filloi të shkruante pak rradhë në një bllok të trashë që e përdorte si ditar.

Pas pak minutash e përmendi një zë vajze që iu ul pranë.

- Tungjatjeta! - tha ajo duke i zgjatur dorën. - Jam Lorela.

Vili ia shtrëngoi dorën fare leht. Vajza dukej një krijësë tepër delikate. Kishte trup të imët, fytyrë hollake, por tepër

simpatike. Ishte qethur fare shkurt dhe në veshin e majtë kishte vënë disa vathë të florinjtë radhazi. Kishte dy sy të shndritshëm që reflektonin një ëmbëlsi tepër të natyrshme.

- Unë quhem Vildan, - foli ai me një hutim të lehtë. - Jam nga Shqipëria.

Tjetra u tërhoq pak mbrapsht me habi.

- Uau! Hera e parë që takoj një shqiptar. Kështu janë të gjithë shqiptarët, të këndshëm, si ti?

- Unë jam nga më të shëmtuarit, - ia ktheu Vili. - Dhe... për fat të keq konstatoj se pak vajza italiane kanë sy kaq të ëmbël si të tutë.

Lorela buzëqeshi e kënaqur.

- Faleminderit! Nuk ma kishte thënë njeri më parë.

Ai tërhoqi instiktivisht duart për t'i fshehur disi. Por Lorela arriti t'i shihte ato.

- Pse ke ardhur kaq vonë në fakultet? – pyeti. – Ke punuar më parë?

Vili u detyrua t'i tregonte gjithçka, pa zbukuruar asnje detaj.

- Bravo! - ia bëri tjetra pa e përbajtur admirimin. - Unë s'kam punuar kurrë në jetën time. S'di të gatuaj as spageti.

Pas pak në auditor hyri një profesor i moshuar.

- Të dashur miq, le të fillojmë rrugën e gjatë nëpër botën e madhe të letrave, -tha ai në formë pëershendetjeje.

Më në fund, ia bëri Vili duke u mbushur thellë me frymë.

Vetëm nga mesdita, kur doli nga godina e universitetit, atij iu duk se u çlirua disi nga mrekullimi të cilin e kishte ëndërruar prej vitesh. Ndërsa po çapitej me duart në xhepa, vuri re Lorelën që i kaloi përbri. Një djalë simpatik po e priste me një veturë të hapur luksoze. Me sa kuptohej, edhe ai ishte student. Ajo iu afrua; i hodhi krahët dhe e puthi gjatë. Pastaj u ngjit në veturë duke qeshur.

Vili e ndoqi për pak çaste me sy. Është normale të ketë

---

një djalë, mendoi. Duhej ta kishte patjetër. Megjithatë Albës nuk i afrohet dot. Sikur njëqind vathë floriri të verë në të dy veshët dhe ta presin me "Ferrari", nuk bëhet dot më e bukur se Alba. Me siguri më tërhoqi se kam kaq muaj pa u ulur pranë një femre. Ishte e zakonshme, fare e zakonshme. Veç syve... Megjithatë, sytë e Albës... Ai u kujtua për trenin dhe nxitoi drejt stacionit.

Mbërriti në Rapalo në 14 pa 20 minuta. Mori në një bar panine me proshutë dhe duke ngrënë vazhdoi drejt peshkërisë. Kur mbërriti para lokalit, fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe vuri re se pronari kishte qëndruar te dera. Vili vështroi orën me bisht të syrit dhe e pëershëndeti. Ishte në kohë. U ndërrua me ngut dhe nuhati njëherë fort erën tipike të peshkut.

## 19.

Alba shtrëngoi fort timonin dhe e rrrotulloi me vrull. Megjithatë, nuk arriti ta merrte kthesën brenda hapësirës së duhur dhe rrota e veturës u ngjit në trotuar. Instruktori ndërhyri dhe e ndihmoi të zbriste rishtazi në rrugë.

- Më falni, - tha ajo duke frenuar. - Duhej ta kisha marrë kthesën më shpejt. Instruktori hapi krahët i mërzitur.

- Kjo u mor vesh. Sikur të më thoje, pse je kështu e hutuar?

- Kam një problem privat, - ia ktheu ajo duke u skuqur. Instruktori u detyrua të buzëqeshte në shenjë solidariteti.

- Hajt Alba, kurajo. Të gjithë kemi probleme private. Përpiku të përqëndrohesh. Për një javë do të marrësh patentën. Gjithçka po shkon shumë mirë. Vetëm vëmendje! Të lutem vëmendje! Ajo bëri një sforcim të shqisave dhe vëmendjes, pastaj e rinisi veturën mes trafikut të dendur milanez. I kishte hyrë kursit për të marrë patentën, duke shpresuar ta shkëpuste disi mendjen nga historia e saj e vjetër. Por, si edhe më parë, kishte dështuar. Pushimet në Pieve i kishin bërë dëm. Tani ajo e kuptonte se kishte qënë një zgjedhje vendi e gabuar.

Zot, sa e paskam dashur, mendoi e trembur, ndërsa po kthehej në shtëpi. Me sa duket është hera e parë që dashuroj me të vërtetë. Nuk kisha si ta kuptoja. Atë tjetrin e paskam dashur cektësisht. Ndryshe nuk do ta harroja aq shpejt.

Me të hyrë në shtëpi, u lëshua në një kolltuk. Kuqjana iu afrua dhe filloi t'i fërkohej te këmbët. Alba e mori mbi gjunjë

dhe filloi ta përkëdhelte. lu duk se macja qe trashur dhe rënduar. Edhe lëvizjet i ishin bërë si më të ngathta. Kështu është kur nuk e nxjerr bukën vet, i foli ajo. Dembele! Gjumash!

Kur ia mbërriti Renato, Alba u pérpoq të dukej në humor, por me sa dukej tjetri nuk mund të gënjehej më.

- Hë, si shkon kursi? - pyeti ai. - Kur do ta festojmë patentën?

- Së shpejti, - ia ktheu ajo.

Renato piu pak verë duke e vështruar ngultazi.

- Se si je kështu, - tha.

- Jo, - u përgjigj ajo. - Jam ca e mërzitur nga koha. Vjeshta s'më ka pëlqyer kurër.

Ai e ndërpree të ngrënët dhe u tërhoq mbrapsht me gjithë karrike.

- Je e sigurtë se nuk të mundon ajo lidhja e vjetër... me atë shqiptarin?

Alba ngriu.

- Jo, - tha me zë të fikur. - Ç'hyn shqiptari këtu?!

- Je e sigurtë se ai nuk ndodhet diku këtej rrotull?

- Si, këtej rrotull?!

- Në ndonjë qytet pranë.

- Unë nuk di asgjë për të! - thirri ajo me inat. – Të lutem mos më bjer kot në qafë!

- Gënjen! Është patjetër diçka që lidhet me të. Mua nuk më bën dot naiv me zor. Kuptove?

Renato u ngrit dhe doli nga shtëpia me hapa të mëdhenj.

Pasi e mblodhi disi veteren, ajo pastroi tavolinën ku ishin konsumuar fare pak gjëra, u vesh dhe u nis nga katedralja e madhe e qëndrës. Kishte filluar një punë të çuditshme, që pakkujt i kishte shkuar nëpër mend. Bënte guidë nëpër Milano për turistët e huaj, kur dy apo më shumë prej tyre binin dakort të shoqëroheshin prej saj. Gjithçka kishte filluar një pasdite kur Alba kishte ndeshur në rrugë një çift të

moshuar japonezësh. Ata i kishin kërkuar t'u tregonte si të dilnin në "Skala". Ejani, u kishte thënë ajo, po ju shoqëroj unë. Të prekur nga veprimi i saj, japonezët i kishin dhënë 50 000 lireta. Alba kishte kundërshtuar, por turistët kishin këmbëngulur... Ajo e kishte kuptuar se nuk kishte rrugë tjetër për të fituar para. Kishte gjetur një historik të Milanos dhe materiale të tjera që mund t'u interesonin vizitorëve të huaj. Pasditeve dilte në D'Uomo dhe brënda dy javëve kishte arritur të mblidhët 400 000 lireta. Renato nuk ia kishte kundërshtuar atë ide. Gjithësesi, është më dinjitoze se piceria, i kishte thënë.

Atë ditë u vërvit gjatë nëpër sheshin e madh para katedrales deri sa më në fund arriti të gjente një grup të vogël prej tre vetësh. Ishin skandinavë. Një grua e re e pyeti për çmimin. Sa të doni, tha Alba duke u skuqur. Mund të jepni sa të doni. Nuk ka asnje rëndësi.

Pas rrëth dy orësh, kur u nda nga skandinavët me 60000 lireta në xhep, ajo vështroi njëherë nga katedralja e menduar. Imagjinoi Vilin t'i afrohej dhe t'i thoshte: ju lutem, kam nevojë për një guidë. Idea e një takimi me të kishte filluar t'i vinte ndër mend në forma nga më të ndryshmet: në rrugë, në bar, nën një strehë ndërsa binte shi, në stacion të trenit. Ajo kishte imagjinuar me dhjetra skena nga ai takim. Nuk donte ta besonte që Vili qe kthyer në Shqipëri.

Ndërsa po zbriste në stacionin më të afërt të metrosë, vuri re një patrullë policësh që kishin ndalur dy afrikanoveriorë dhe po u kontrollonin dokumentet. Rrufeshëm i erdhë në kokë mendimi se kuestura e Gjenovës duhej të kishte të dhëna ne së Vili ndodhej ende në atë zonë apo jo. U kthye në shtëpi e gjallëruar.

Atje gjeti Renaton. Ai sapo qe kthyer nga puna.

- Atëherë, ke ndër mend të më thuash gjë? - pyeti.

- Jo, - këmbënguli ajo. - Të lutem mos lodh kokën me

dyshime. Në se kërkon të bësh patjetër sherr, jepi!

- Pra, ty të duket normale gjendja jote? - tha ai me keqardhje.

Alba buzëqeshi.

- Është kalimtare. Ja, do ta shohësh. Sikur të shkonim gjékundi sonte për ndonjë picë? Do të paguaj uqë.

Renato e vështroi gjatë me dhimbsuri.

- Si të duash. Veç dije, kot e shtyjmë. Një ditë duhet të bisedojme patjetër.

Me sa duket, mërmëriti ajo.

Tërë mbrëmjen dhe atë natë i shtyu me mendimin se të nesërmen do të mësonte diçka për Vilin. Që në mëngjes mori nga shërbimi i informacionit numrin e telefonit të zyrës së të huajve në kuesturën e Gjenovës. Vendosi njëherë të telefononte pas kursit, por nuk mundi të duronte dot. U prezantua si qytetare italiane.

I kërkuan të priste. Ndërkohë që nga kuestura filluan t'i jepnin informacion, ajo filloi të qante me një gëzim të papërmbaritur. Të lumtë Vil, foli me vete. Nuk më kishte shkuar mendja kurrë se do të kishe filluar edhe fakultetin. Të paktën fitove diçka. Më mirë pa mua. Isha unë që të solla të gjithë tersllëqet, që tundova Renaton dhe ai të dëboi nga puna që të të shmangte si rival. Isha unë që të lashë vetëm kur t'i kishe më shumë nevojë. Dhe ti më doje, më doje aq shumë...

\* \* \*

Pas disa ditësh, mori pjesën më të madhe të parave që kishte fituar nga guidat nëpër Milano, hyri në një nga libraritë më serioze të qytetit dhe i bëri të gjitha libra letërsie dhe diksionerë. Iu lut shitesit që t'i përgatiste një pako dhe t'ia postonte librat Vilit me adresën e universitetit.

- Emri juaj zonjë? - tha shitësi. – Në se më pyesin...

- Nuk do t'ju pyesin, - ia ktheu ajo. - Është një porosi që ai e pret. Ju falemnderit!

Dikush duhet ta ketë ndihmuar, mendoi Alba ndërsa po kthehej në shtëpi. Është e pamundur t'ia ketë dalë mbanë vetëm. Ndoshta ndonjë femër. Me siguri ndonjë femër. Tani mbas janë afruar dhe... Ajo provoi një xhelozë të egër ndaj femrës pa identitet që aktualisht qe lidhur me Vilin. U përpoq t'i jepte tipare konkrete që të arrinte ta urrente më lehtë, duke e imagjinuar para syve.

Ajo xhelozë imagjinare vazhdoi për ditë me radhë deri sa Alba u lodh. Dalëngadalë, e tmerruar, filloj të besonte se po sëmurej. Ai besim iu përforcua kur një ditë, rastësisht, ndërsa po gjërmonte në një sirtar të mbushur me veshje intime, të cilat kishte kohë pa i përdorur, dora i zuri një bluzë burrash me mëngë të shkurtëra. Ishte e palarë. Kishte marrë erën tipike të rrobës së ndenjur. Në pjesën e gjoksit dhe në sqetulla i dallosheshin ende njolla djerse. Alba e njohu. Ishte e Vilit. Ai e kishte harruar atë natën e aventurës në dhomën e saj në Pieve. Kur qe nisur për në Milano, ajo e kishte futur në valixhe së bashku me ndërresat e saja, pa e vënë re.

Pa se si duart filluan t'i dridheshin ndërsa po e shtrëngonte bluzën fort e më fort. Nuk mundi ta kontrollonte veten. E afroi rrobën e vjetër te buzët dhe e puthi. Pastaj ngjeshi fytyrën në të, duke nuhatur atë aromë që kishte mbetur. Me një të qarë të shfrenuar vazhdoi ta puthte bluzën, ta shtrëgonte në fytyrë e në gjoks, deri sa ndjeu një dhimbje të fortë koke dhe marrje mendsh.

Kur u freskua në banjë dhe u vështrua në pasqyrë, nuk mundi ta njihet veten.

- Idiote e mjerë, - mërmëriti. - E kupton tani çfarë ke humbur?

Në ditët që pasuan ajo filloj ta merrte bluzën në duar

rregullisht dhe të qante mbi të për t'u lehtësuar. Kur e pa se ai veprim iu kthyesh në mani, e futi bluzën thell në një sirtar, e kyçi atë dhe çelsin e vërviti mbi dollap ku nuk mund ta merrte dot veçse me shkallë.

Me shumë takt, një ditë dhjetori, Renato i kërkoj të konsultohej me ndonjë psikolog. Do të mendohem, ia ktheu ajo. Tani për tanë kam marrë ca qetësues. Besoj se do të më bëjnë mirë.

Por pas pak ditësh...

...Ata kishin ngrënë darkë jashtë, në një lokal në periferi dhe po ktheheshin për në shtëpi vonë, nëpër një rrugë të ngushtë dytësore. Alba i qe latur Renatos ta ngiste makinën vetë dhe ai kishte pranuar. Papritur, ndërsa po parakalonte një veturë, ajo vuri re një kamion që po vinte përballë. Nuk kishte kohë për kthim prapa. Kaloi në marshin e katërt dhe e shtypi pedarin e gazit deri në fund.

- Alba, ç'bën? Kujdeees! - thirri Renato duke mbuluar fytyrën me duar.

Ajo e preu timonin djathtas me vrull duke hyrë mes veturës dhe kamionit ndërsa kishte mbetur një hapësirë prej fare pak metrash. Frenoi ca më tutje, duke vështruar e mekur xhamin e veshur me avull. Renato ngriti kokën pa u besuar syve.

- Porko Dio! - klithi pastaj. - Desh na vrave! Pse e bëre këtë, ë? Pse e bëre? Je maniake? Të pëlqen të rrezikosh si atëherë në pyll me atë kalin? Shko, rreziko vetë! Mua nuk më pëlqen të rrezikoj. A, ba, ba, çfarë koke mor Zot!

- Të kérkoj falje, - mërmëriti ajo. - Nuk e pashë kamionin në kohën e duhur.

Pas shpërthimit të parë ai e mori vetë timonin duke thënë:

- Absolutisht ke nevojë për t'u konsultuar me një specialist. Kështu nuk vazhdohet më. Ke filluar të flasësh me vete. Në se nuk do të më tregosh mua se ç'të mundon, të

paktën tregoja mjekut.

- Ke të drejtë, - pranoi ajo. - Të kërkoj edhe njëherë falje. Makinën nuk do ta ngas më.

Por Renato nuk foli më...

Gjithësesi, Alba nuk pranoi të bënte asnjë konsultë. Mori disa qetësues dhe filloi t'i pinte rregullisht. Vendosi të bënte edhe një provë tjetër për ta kaluar atë gjendje pa ndihmën e kurkujt. Përpiquej ta zinte veten sa më shumë me punë shtëpie. Telenovelat i qenë neveritur. Ato kishin një skematizëm dhe përsëritje motivesh të padurueshme. Revistat gjithashtu nuk i prekte dot.

I vetmi shpëtim i vërtetë ishte dalja pasdite në D'Uomo. Për shkak të dëmrit turistët ishin pakësuar dukshëm, megjithatë ajo mundohej të mos kthehej me duar të zbrazura.

Ndonëse ishte betuar që në festat e rrethit miqësor të Renatos të mos shkonte më, u detyrua t'u rikthehej atyre që të mos mbetej e vetme në shtëpi. Ai nuk e luste më. Vetëm e vinte në dijeni për vendin dhe orën. Kur ajo nuk reagonte, përgatitej vetë dhe dilte duke thënë një "mirupafshim" të thatë.

Por një mbrëmje janari, ishin ditët e para të vitit të ri, edhe festave u rierdhë fundi. Nuk qe faji i saj. Ndoshta nuk qe faji i askujt. Atë paradite, në një nga lulishtet e Milanos, dy emigrantë të huaj kishin përdhunuar një grua italiane që kishte dalë pér të shëtitur. Të gjithë ishin të revoltuar. Dyshohej se dy përdhunuesit ishin shqiptarë.

Ata ishin mbledhur rreth 15 vetë në një lokal dhe apo televizioni filloj lajmet, të gjithë u acaruan. Lajmi i përdhunimit u transmetua i pari, bile edhe para arrestimit të një figure tepër të rjohur politike dhe një aksidenti rrugor me katër viktima. Plasën të sharat dhe kërcërimet ndaj kriminelëve.

- Italia mori fund, - shfryu Lazarini. - Po e bëjnë ligjin të

huajt. Ky është kulmi! Të vijnë e të përdhunojnë në shtëpinë tënde! Me sa duket duhet t'ia fillojmë edhe këtu me bomba si në Gjermani që qeveritarët të zgjohen.

- Qeveritarë leshi! - ia priti një tjetër. - Ky shtet nuk ka qeveri.

Alba e vështroi Lazarinin duke u munduar të ruante qetësinë. Pas ftohtësisë së treguar prej saj dhe shmangies përmuaj me rradhë, ai, në dy takimet e fundit, e kishte përshëndetur fare ftohtë.

- Është e tmerrshme, - ia bëri njëra prej grave. - Jo më larg se dje mu qep një "Vu kumpra" përmë shitur një shall. Më ndoqi deri afër shtëpisë. Ndoshta donte të hynte brenda me forcë dhe...

- "Vu kumpratë" janë të neveritshëm, - e mbështeti e shoqja e Lazarinit.

- Të gjithë të huajt duhet të shkojnë në shtëpitë e tyre! - thirri një zonjë, e cila në pamje iu duk Albës tepër e moderuar.

Pas pak televizioni njoftoi se policia qe vënë në ndjekje të përdhunuesve. Ata duhej të ishin klandestinë rumunë ose shqiptarë.

- Ja, shikoni! - thirri Lazarini. - Hyjnë këtu fshehurazi, vjedhin, nuk duan të punojnë dhe arrijnë të përdhunojnë! Barbarët!

Kudo përdhunohet zoti Lazarini, - ia priti Alba ftohtë. - Dhuna seksuale është një problem global. Vetëm në SHBA në çdo gjashtë minuta përdhunohet një femër. Përdhunuesit nuk janë klandestine rumunë apo shqiptarë. Apo jo?

Të gjithë ngritën kokat dhe ia ngulën sytë me mosmiratim. Alba i vështroi me radhë përmë kërkuar mbështetje, por më koto. Marko s'ishte mes tyre. Ai pothuaj qe ndarë me të shoqen.

- Zonjë, kur përdhunojnë amerikanët apo italianët është ndryshe. Ata janë në shtëpitë e tyre. Por të huajt duhet ta

dinë mirë se janë të huaj! - Lazarini tregoi me gisht i pakënaqur andej nga duhej të shkonin të huajt.

- Secili në vendin e vet! - përsëriti me cinizëm zonja me dukje të moderuar. - Që kur u shemb Muri i Berlinit, Evropa është bërë han.

Alba provoi më shumë se kurrë ndjenjën e vjetër se mes tyre ishte e huaj. Në ato çaste iu dhimbën të gjithë bashk-atdhetarët e mjerë që kishin marrë arratinë nëpër det. Iu dukën të poshtëruar, të pambrojtur. Ajo ishte njëra prej tyre dhe nuk mund të heshtte kur i fyeni rracën e saj.

- Gaboheni! - thirri me inat - Lindorët apo afrikanët, si edhe ju, kanë të drejtë të shkojnë kudo. Italia dhe bota ku jetojmë janë të Zotit. Kufijtë i kanë vënë njerëzit. Kur ne lindorët vuanim nën komunizëm, ju hartuat karta të mëdha si ajo e OKB-së dhe e Helsinkit, në bazë të të cilave njerëzit janë të lirë të jetojnë e punojnë ku të duan. Ju nuk doni të huaj këtu dhe harroni se gjysmë shekulli më parë, bile dekada më parë, askush nuk ju pengoi të merrnit botën nga të donit. Juve nuk ua mohoi kurkush lirinë. Atëherë pse kjo liri u duhet mohuar të tjerëve? Atyre që janë më të dobët e më të varfër?

Ajo u detyrua të ndalej e të ulte kokën sepse filloj të mallëngjehej.

- Alba, më duket se ti nuk përfaqëson këtu Emnisti Internejshënëll-in, - tha Renato me inat. - Të lutem përbahu!

- Alba, të jemi realistë, - foli një shok zyre i Renatos. - Ato karta që ti përmende, janë idealiste. E paraqesin botën jo siç është, por siç duhej të ishte. Duhet të pranojmë se liri absolute lëvizjeje nuk mund të ketë.

- Më duket se e tepëruam, - ndërhyri me diplomaci njëra prej grave. - Njëzetë apo dyqind kriminelë nuk përfaqësojnë të gjithë të huajt në Itali. Kur e shëmbën komunizmin, Evropa dhe Amerika duhej t'i kishin parashikuar këto gjëra.

Pas atyre fjalëve tema u ndërrua për shkak të imazheve të një përbmbytjeje. Alba ndenji në lokal edhe ca, pastaj kërkoi leje të largohej. Renato nuk shfaqi asnjë shenjë nervozizmi. E dashur, përpiku të flesh, i foli nga pas. Je shumë e lodhur. Ajo mori një taksi dhe u kthyte në shtëpi vetëm. Mjaft edhe me festat, tha me vete. Nuk do të gaboj më të shkoj.

Renato ia mbërriti vonë. Megjithëse e pa që ishte zgjuar, ai nuk reagoi fare për ato që kishin ndodhur në lokal. Kishte filluar të tregonte hapur se nuk kishte më nerva të duronte asnjë lloj skene të asaj natyre.

\* \* \*

Pas pak ditësh Alba mbeti vetëm fare në shtëpi. E trembur, ajo vuri re se Kuqjana qe fryrë jashtë mase në ije dhe mezi lëvizte. Një mëngjes thirri teze Karmelën dhe i shprehu dyshimet e saja.

- Është bars, - tha tezja me keqardhje. - Shkoi në rracën e vet. Është tepër e vështirë t'i fisnikërosh këto mace rrugaçë.

Albës iu kujtua maçoku me sy pirati. Në mbrëmje ajo i tregoi Renatos. Mos u mërzit, e zgjidh unë, tha ai ftohtë. E mori Kuqjanën me vete në veturë dhe u kthyte pas ndonjë gjysmë ore.

- Ku e çove? - pyeti Alba.

- Në një shtëpi të braktisur, - foli ai duke shkundur duart.

- Më mirë pa mace.

Alba u fut në dhomë pa i kthyer përgjigje.

I vetmi ngushëllim i atyre ditëve të hirta dimri qe një letër e gjatë nga Gerta dhe ardhja e Savës nga Torino. Alba i qe lutur prej kohësh që ajo të vinte dhe më në fund kushërima kishte arritur të mblidhët bashkë dy ditë pushimi.

- Erdha vetëm se Gjergjit i vinte zor nga ky italiani, - tha.

Ajo e nuhati shumë shpejt situatën.

- Ç'po ndodh? - e pyeti ndërsa po merreshin të dyja me gatime në shtëpi. - Mos... po ndahesh? Alba, je në vete?! Pse kërkon t'i biesh të mirës me shkelm?

Alba e ndjeu veten tmerrësisht të lodhur për të dhënë shpjegime.

- Të lutem! - tha. – Të lutem mos më bëj të tilla pyetje!

Sava nuk e ngacmoi më.

- Më fal. Ti i di më mirë punët e tua. Në se do të kesh nevojë për mua, më kërko kur të duash.

- Falemnderit! - mërmëriti Alba duke e përqafuar.

## 20.

Ndërsa treni u ndal si çdo mëngjes në Pieve Ligure, Vili i ngriti sytë nga Vila e Trëndafilëve. Përkëdheli një libër të hapur mbi gjunjë. Ishte një histori e letërsisë botërore që Alba ia kishte dërguar javë më parë me një pako misterioze të postuar nga një librari e Milanos. Vili qe befasuar nga ajo pako dhe qe bindur se Alba vazhdonte ta kujtonte, pavarësisht nga ndarja e hidhur. Kishte nguruar gjatë dhe një ditë kishte telefonuar në vilë. Ishte prezantuar si një kushëri i Albës dhe kishte kërkuar numrin e saj të telefonit në Milano. Zëri i governantes, që ai e njihte shumë mirë, i qe lutur të priste. Ajo qe vonuar gjatë dhe Vili kishte filluar të dyshonte.

- Si ka mundësi që ju djalosh dini këtë numër dhe jo atë të Milanos! - kishte thënë befas governantja - Pastaj, pse duhet të pyesni pikërisht këtu?

Ai qe hutuar.

- Numrin nuk e jap! - kishte thënë govenantja duke ulur receptorin.

Idiot, kishte sharë veten ai. Ndërkohë që t'i prisje me telefon në vesh, ajo ka verifikuar se nga telefononin.

Kishte pritur gjatë për ndonjë sinjal tjetër, por më kot. Alba nuk qe bërë më e gjallë...

Me të dalë nga hyrja e madhe e stacionit të Gjenovës, vuri re se Lorela po e priste me veturë. Ai tentoi të shmangej, por ajo e pa dhe i tundi dorën. Vili iu afrua. Lorela u ngrit majë gishtave dhe i dha një të puthur. Ai hyri në veturë i

hutuar. Të djeshmen, pas leksionit të fundit, Lorela i kishte kërkuar ta shoqëronte me veturë deri në stacion dhe atje, para se të ndaheshin, kishte thënë papritur:

- Vildano, më jep një të puthur. Ndjehem shumë e mërzitur.

Ai e kishte puthur për të mos e fyter, duke menduar se po ndodhët një skenë kalimtare. Por kur Lorela përsëriti po atë skenë pak më parë, ai e nuhati se po ndodhët diçka shumë më serioze. Me siguri do të jetë grindur me atë pordhacin e vet, mendoi Vili me siklet. Dhe për inat të sime vjehrre...

Ditët e fundit i dashuri i Lorelës kishte filluar të shoqërohej me një vajzë tjetër, të bukur, të gjatë, me ca flokë të lyer në një të verdhë goditëse. Një mëngjes ata ishin puthur jo shumë larg Lorelës dhe ajo i kishte parë fare mirë. Qe nervozuar dhe tërë ditën kishte zhgarravitur pa e patur mendjen në leksion.

- Akoma ndjehesh e mërzitur? - pyeti Vili pa e vështruar.

- Po, - tha ajo. - Kam nevojë përt ty. Ndryshe do të çmendem.

Ndonëse të shtirura, atij iu dukën deri në një farë mase normale ato fjalë. Gjatë atyre muajve të parë të fakultetit ia kishin kaluar mirë së bashku dhe disa herë kishin shkëmbyer libra. Një të dielë Lorela e kishte ftuar në shtëpinë e saj për t'i treguar bibliotekën. Prindërit e Lorelës e kishin lutur të qëndronte për drekë dhe ai kishte pranuar.

Babait të saj, një arkitekti të njojur në Gjenovë, i pëlqente letërsia dhe ata kishin biseduar gjatë në lidhje me autorësinë e Homerit ndaj "Iliadës" dhe "Odisesë". Lorela e kishte njojur edhe me të dashurin e saj, një tip me një qethje tepër të veçantë të flokëve, të kopjuar nga një këngëtar amerikan, i cili e pasqyronte që në ngjyrën e lëkurës bollëkun në të cilin jetonte. Vili nuk e kishte kuptuar pse ai i kishte shkaktuar siklet kur i kishte shtrënguar dorën.

- Ç'thotë Aldo, pse jeni grindur? - pyeti.

- Va fa n'kulo me gjithë Aldo! - ia bëri ajo me inat. - Mos ma përmend! Dëgjo, ti je i lirë këtë të dielë?

- Besoj se po.

- A vjen me mua në një vend të bukur?

- Ku?

- Nuk ta them. Dua të të befasoj.

Ai nguroi gjatë.

- Vildano, të lutem! - ia bëri ajo me llastim, duke i dhënë si gjithmonë emrit të tij një intonacion tipik italian.

- Mirë, - pranoi Vili. - Do të vij.

Për dy ditë me rradhë e vuajti pendimin për atë përgjigje, megjithatë, të dielën në mëngjes, mori trenin lokal dhe zbriti në Kamoli. Nuk mund të tregohem i paedukatë, mendoi. Lorela po e priste me veturë në stacion. Ajo e përqafoi në një mënyrë që e bëri Vilin të dyshonte në ato që do të ndodhnin më pas.

- Është e vërtetë që të pëlqejnë shumë sytë e mi? - pyeti Lorela ndërsa iu afroan një shtëpie të vjetër e të veçuar në breg të detit. - Më vështro dhe ma thuaj.

Ai u bind.

- Po, - tha. - Ke sy me një embëlsi të veçantë.

Lorela buzëqeshi e kënaqur.

- Ai idioti nuk di të vështrojë kaq bukur si tu, - shfryu me inat.

Ata zbritën nëpër një rrugë të vjetër të shtruar me pllaka dhe Lorela e hapi shtëpinë me një çelës të madh. Vili u gjend në një korridor të ngushtë, pastaj në një studio të madhe të mbushur me libra. Ishte letërsi pa fund në italisht dhe anglisht. Mbi tavolinën e gjerë të studios qe vendosur portreti i një burri të moshuar.

- Kush është ky? - pyeti Vili.

- Im gjysh, - tha Lorela. - Ka vdekur. Ka qënë dramaturg dhe përkthyes. Shtëpinë ma dhuroi mua sepse e dinte që do

të studjoja për letërsi. Shikoje këtë bibliotekë. Kushton miliona. Ka shumë libra të rrallë.

Lorela hapi dritaret e studios që vështronin nga deti.

- Pra, kjo shtëpi dhe biblioteka janë... të tuat? - pyeti Vili i shtangur.

- Ehë. Verës vij shpesh këtu.

Vili vështroi njëherë raftet e librave, pastaj i ktheu sytë nga deti. Nuk e kishte besuar se në realitet do të gjendej një shtëpi që t'i ngjante aq shumë shtëpisë së ëndërrave të tija.

- Të pëlqen?

Ai nuk guxoi t'i tregonte Lorelës atë që po mendonte.

- Po, - u përgjigj. - Është një shtëpi tepër e veçantë.

Ata qëndruan ca në studio, pastaj kaluan në një dhomë të vogël ndenjie. Lorela ndezi një calorifer dhe vuri mbi tavolinë një shishe me verë dhe një shportë me fruta. Mbushën gotat dhe biseduan për ndonjë gjysmë ore gjëra pa rëndësi.

- Vildano, do të doje të bëje dashuri me mua? - pyeti Lorela befas, duke e vështruar në një mënyrë tepër provokuese.

- Pse duhet ta bëja? - ia ktheu ai qetësisht.

- Për të treguar se më pëlqen.

Ajo filloi të zhvishej plotësisht e vendosur.

- Të lutem jo! - tha Vili. - Nuk shkon!

- Përkundrazi! - ia bëri Lorela, duke qëndruar më në fund plotësisht e zhveshur para tij. - Më vështro. Është e pamundur të mos pranosh.

Vili u mat të dilte nga shtëpia, por ai veprim iu duk qesharak. E vështroi gjatë. E krahasoi me Albën dhe nuk mundi të tërhiqej pas saj. Megjithatë, nuk mundi ta kontrollonte veten. Ndërsa u shtrinë në një divan të gjerë aty pranë dhe Lorela nxori me ngut nga çanta një prezervativ, ai e kuptoi se ajo e kishte ftuar në atë vend me një pikësynim tepër të qartë. Vili bëri dashuri me të me ngut, pa guxuar ta

vështronte në sy. Lorela gjithashtu ishte nervoze. Nuk donte të ndjente kënaqësi. Vetëm ta kryente atë akt me një inat të verbër.

- Ishte fantastike! - psherëtiu ajo. - Tepër fantastike.

Mos më shit dëngla, tha Vili me vete duke pritur me padurim që të shkëputej prej saj.

- Vildano, ne të dy mund të lidhemi tepër seriozisht bashkë, - foli Lorela papritur. - Kjo shtëpi do të jetë jona. Babai mund të të gjejë një punë shumë më të mirë se peshku.

Ai u skuq i téri.

- Pse nuk më përgjigjesh? - vazhdoi ajo.

- Nuk mundem. Është një ofertë tepër e papritur.

- Ti mund të mendohesh. Nuk na ngut njeri. Ndërkohë mund të vijmë këtu për të ndenjur bashkë sa herë të duam.

Si rrallë herë në jetën e tij ai provoi përcëmim për veten. Pse nuk e kundërshtoj, mendoi. Pse nuk ngrihem të iki, por rri këtu si një burracak që përfiton nga hakmarrja torollake e një bibe xhelozë?

Ndërkohë u dëgjua një zile telefoni. Lorela u ngrit duke nënqeshur. Me sa dukej po e priste atë telefonatë.

- Po, unë jam, - dëgjoi Vili zërin e saj ironik. - Çfarë po bëj? Ha, ha! Jam me Vildanon, atë shqiptarin. Si? A kam bërë dashuri me të? Sa u kënaqa. Ishte fantastik dhe jo tekanjoz si ti.

Vili mbuloi fytyrën me duar.

- Po ti, u kënaqe me atë putanën tënde bjonde? Dëgjo, a s'më thua kur do të hysh në atë shoqatën e gejve? Aldo, je një bajgë!

Telefoni kërciti me zhurmë. Lorela u kthyte në divan dhe vazhdoi të shante nëpër dhëmbë.

- Ndjehesh më e lehtësuar tanë? - pyeti Vili.

- Po, - tha ajo. - Tani le të shkojë me atë flokëkashtën!

Vili ia nguli sytë tavanit dhe nuk foli më.

Ndërsa po ndaheshin në stacion, ai u mat t'i thoshte se kishte kaluar një ditë të neveritshme dhe se nuk donte ta shihte më, por nuk mundi. Nuk po arrinte ta kuptonte veten.

- Të dielën tjetër i dashur! - ia bëri Lorela duke i buzëqeshur.

Tërë ditën ai bluajti në kokë premtimet e saja për shtëpinë me libra në breg të detit, për një punë më të mirë, pa lagështi dhe hala peshku, me më shumë para. Në darkë, ndërsa po binte për të fjetur, vështroi Albën në fotografi dhe i uli sytë në çast. Pse nuk e kundërshtova, mërmëriti. Si guxova të mos i kundërshtoja propozimet e saja të neveritshme?

Të nesërmen do të sqaroj gjithçka, vendosi.

Por në mëngjes Lorela doli rishtazi ta priste në stacion me veturë dhe ai nuk mundi të revoltohej. Më vonë, mendoi, kur të gjej ndonjë rast të përshtatshëm.

Pa kuptuar, ajo "më vonë" u shty me orë dhe me ditë. Zoti im, ç'po ndodh, pyeti ai veten i trëmbur. Vërtet më kanë trullosur aq shumë ato propozime?

E ndau mendjen që ta refuzonte ftesën e saj të së dielës për të shkuar rishtazi në Kamoli. Por ajo ftesë nuk u përsërit. Të shtunën e pa Lorelën duke u përqafuar që në mëngjes me Aldon. Pas leksionit të fundit ai e priti si shpeshherë më parë me veturë.

- Lorela, si do t'ia bëjmë për nesër? - pyeti Vili pa e përbajtur ironinë. - E diela e kaluar më pëlqeu jashtë mase!

- Më vjen keq, - ia ktheu ajo. - Ti e sheh. U pajtova me Aldon. Megjithatë, babait mund t'i them të të ndihmoj për ndonjë punë më dinjitoze.

- Falemnderit! Tani për tanu nuk dua të ndahem nga peshku.

- Si të duash!

Zuskë, mendoi Vili. Mund të më gjesh një punë për të më bërë borxhli. Kështu, në rast se prishesh rishtazi me Aldon dhe kërkon të shfrysh, më fton në atë shtëpinë e mallkuar.

Në darkë, ai e vështroi gjatë Albën në fotografi dhe për herë të parë e kuptoi lëkundjen e saj pas njohjes me Renaton. Çdo të ndodhët po sikur Lorela të mos pajtohej me atë pordhacin e saj, pyeti veten i tmerruar.

\* \* \*

Kaloi disa ditë tepër të shqetësuara, duke dyshuar keqazi te vetja dhe te vlerat morale që kishte respektuar deri vonë. Vështronte Albën në fotografi dhe gjithnjë e më shumë ajo i dukej më e afërt, më e dashur, më e pastër. Filloi të ndjente për të një mall gjithnjë e më të papërmajtur. Vazhdoi të mendonte për një takim që do të ndodhë patjetër një ditë.

Deri sa...

...paraditen e një të diele shkurti, ndërsa po kthehej me Esmaelen nga një panair i organizuar në qytet, i ngarkuar me sende të blera, vuri re Ramoshin që po priste para pallatit me një pamje të çuditshme.

- Vili, ka ardhur Alba, - tha ai tepër serioz. - Po të pret lart.

Ai nuk guxoi t'u besonte veshëve.

- Si Alba?! Cila Albë?

- Ka vetëm një Albë, ajo e fotografisë. Ngutu se ishte tepër e tronditur. Ne të dy nuk kthehem sonte. Po shkojmë në Gjenovë për të parë ndonjë koncert. U kuptuam?

Vili falenderoi i hutuar dhe u ngjit shkallëve gati me vrap. Lëshoi sendet e blera në korridor, pa mundur të fliste i pari.

- Vili, jam këtu, - dëgjoi zërin e saj aty pranë, në dhomën e vogël të ndenjies. Hyri ngadalë sikur po shkelte në një mjedis ëndërrash. Alba kishte qëndruar në këmbë, me një pamje të dhimbshme; e lodhur, e hequr, me ca sy që vështronin nga larg, nga tepër larg, ku ekzistonte një botë tjetër krejt ndryshe nga realiteti. Ai e vështroi. Edhe ajo e vështroi. Në cepat e syve iu mblodhën dy bula të mëdha

loti. Kurrë në jetën e tij Vili nuk kishte parë bula loti aq të mëdha e aq të rënduara nga pikëllimi. Ai u afroa dhe e preku në flokë për t'u bindur se nuk ishte në ëndërr. Ajo gjithashtu e preku në supe, pastaj iu ngjesh për trupi dhe filloj ta përqafonte duke shpërthyer në një të qarë të vrullshme.

Ata nuk e kuptuan sa kohë kaloi ashtu, duke u shtrënguar në krahët e njëri-tjetrit e duke u puthur ku të mundnin.

- Vetëm Zoti e di sa të kam pritur, - foli ai i pari. - E ndjeja se do të vije.

- Më ke mbajtur mëri?

- Kurrë. Po ti, më ke urryer?

- Ashtu, jam përpjekur ndonjëherë. Po nuk kam mundur.

Vil, pse duhet të na ndodhë kështu? Pse ishim kaq pa fat?

- Mbasejeta është kështu.

- Unë erdha të të them se gjithë fajji ishte imi. Unë...

Ai ngriti dorën drejt buzëve të saja.

- Mos u lodh të më sqaresh asgjë. Historia jote më ndodhi edhe mua, para pak kohe, me një vajzë italiane. Të kujtohet ëndërra ime e vjetër për një shtëpi plot me libra në breg të detit? Ajo e kishte atë...

Vili i tregoi gjithçka që lidhej me Lorelën.

- Ishte një tundim i egër, tepër i egër, - psherëtiu.

- Jo, - tha Alba. - Ti je ndryshe. Ajo nuk do të të kishte bërë dot pér vete. Ka qenë një lëkundje fare e përkohshme.

- Mos u mundo të më ngushëllosh, - kundërshtoi ai. - Me sa duket të gjithë jemi të tundueshëm e të korruptueshëm në këtë botë. Është shkruar edhe në Bibël.

- Vil, të lutem mos më shtyj të mendoj ndryshe pér ty. Je njeriu pér të cilin nuk do të besoj kurrë asgjë të keqe.

Ajo u struk në gjoksin e tij.

- A... bëre dashuri... me atë? - pëshpëriti pas pak.

Ai nënqeshi.

- Vetëm një herë. Në se mund ta quaj dashuri. Pas largimit

tënd më është dukur se nuk do të jem në gjendje të bëj më dashuri me asnje vajzë tjetër. Të kam ëndërruar shpesh. Kam bërë dashuri me ty... netëve, si idiot...

- Edhe unë... si idiote...

- Ku?

- Atje... ti e di fare mirë ku...

Ajo ngriti kokën dhe ata filluan të putheshin vrullshëm, duke menduar të njëjtën gjë. U zhveshën duke i tërhequr rrobat me inat, ndërsa vazhdonin të putheshin, pastaj u shtrinë në dysheme, duke rrëzuar karrike e duke bërë gjithçka rrëmujë. Ishte një dashuri e çmendur, e kërkuar prej muajsh të tërë, që nuk arriti ta shuanet etjen e vjetër, por vetëm ta ndizte atë edhe më shumë.

- Të lutem, rri sonte! - i pëshpëriti ai në vesh duke e shtërtnguar fort.

- Do të rrrij, - ia ktheu ajo. - Tani u djallosën të gjitha.

Për herë të parë Vili guxoi ta pyeste për Renaton.

- Ka dështuar gjithçka, - psherëtiu Alba. - Gjithçka.

- Pra, do të ndaheni?

- Me sa duket... Nuk mundem të duroj dot më. Po sëmurem.

- A mundem të ndihmoj në ndonjë farë mënyre?

- Tani për tani jo.

Ata ndenjën shtrirë pranë njëri-tjetrit deri sa filluan të ndjenin të ftohtë.

- A do të më lejosh të të përgatis ndonjë gjë për drekë? - pyeti Alba pastaj.

Vili pranoi me qejf. U ul dhe filloi ta ndiqte me sy ndërsa ajo lëvizte nëpër kuzhinë. Nuk po e besonte dot atë që po ndodhët.

Për orë me rradhë ata ndenjën pranë njëri-tjetrit, duke kujtuar e treguar ngjarje pa fund. Nuk lëvizën nga shtëpia. Kapeshin për dore dhe përqafoheshin sikur kishin frikë se

papritur do t'i ndanin me dhunë dhe nuk do t'i lejonin më të shiheshin.

Ndërsa Vili e falënderoi për pakon me libra, Alba e vështroi e menduar.

- Lëri librat Vil! Më trego për atë Merin. Ajo... të donte?
- Më donte, - tha ai. - Në kuptimin më njerëzor të fjalës.
- Po me të... ke bërë dashuri?
- Jo, nuk mundesha. Ajo pati një moment dobësie. Ishte e mërzitur.
- A e ke krahasuar atë ndonjëherë me mua?
- Jo. Pse duhet ta bëja?
- Për të parë se cila ishte prostituta e vërtetë, - foli Alba befas me përcnim.

Vili i hodhi krahun dhe e afroi nga vetja.

- Ç'i ke këto mendime?! Mos e lodh kokën tanë. Ti je për mua ajo Alba e parë e asaj dite marsi të eksodit. E mban mend si më zgjate dorën dhe më kërkove të të ndihmoja? Edhe tanë unë jam gati të të ndihmoj. Më kërko ç'të duash.

- Jo, - kundërshtoi ajo. - Nuk do të të kërkoj asgjë.

- Alba, në se ti... kësaj here unë mund të të ndihmoj vërtet për ndonjë punë. Ne... mund të rifillojmë. Le ta provojmë të vazhdojmë të njëjtën rrugë.

- Të lutem jo! - ia bëri ajo si e trembur. - Mos më fol tanë për këto gjëra. Do të bisedojmë ndonjëherë tjetër. Të lutem!

- Dakort, - pranoi ai.

Ata u shtrinë për të fjetur të dy në krevatin e tij. Alba vështroi edhe njëherë fotografinë e kohës së Savonës. Kishin dalë një ditë kur në kamp kishte ardhur një gazetare italiane për të shkruar një reportazh. Ata i qenë lultur t'u bënte një fotografi. Kopjen e saj ajo e kishte grisur kur që nisur për në Milano, atëherë kur po bindte veten se po urrente Vilin dhe po dashuronte Renaton.

Arritën të mbyllnin sy vonë, tepër vonë.

Alba u nis në mëngjes herët me një tren ndërqytetës që deri në Milano bënte fare pak ndalesa. Ndërsa po e përcillte, Vili iu lut pér numrin e telefonit, por ajo nuk ia dha.

- Pse nuk ma jep? - u arkua ai. - Nuk do të shihemi më?  
 - Do të të telefonoj unë, në fakultet, - tha Alba. - Të lutem mos ngul këmbë!

- Më premtto që do të takohemi prapë!

- Të premtoj.

- Po në se... ndahesh prej atij... do të vish në Rapalo?

- Këtë nuk ta premtoj, - u përgjigj ajo pa e vështruar.

Vili e përqafroi fare pranë derës së vagonit. Alba e vështroi gjatë, pastaj me buzë të dridhura mërmëriti:

- Vil, e mban mend kur ishim në kamp në Savona dhe dilnim në breg të detit kapur pér dore? Atëherë nuk kishin asgjë, asnje lek në xhepa, por ishim të lumtur. Më të lumturit në botë.

Zoti im, çfarë po ndodh kështu, pyeti veten ai i hutuar, ndërsa treni u nis.

## 21.

Alba qau pjesën më të madhe të rrugës, me fytyrën kthyer nga dritarja. Nuk duhej ta kisha bërë, mendonte. Nuk duhej të kisha ardhur para ndarjes me Renaton. Gjithësesi, ai nuk më ka asnë borxh. Ajo u drodh e tëra kur kujtoi

ç'kishte hequr për t'iu shmangur asaj arratje në Rapalo. Nuk kishte dashur ta kryente atë veprim. Por malli për Vilin kishte qënë më i fortë dhe ajo qe detyruar të gënjente se po shkonte në Torino.

Renato nuk kishte kundërshtuar. E kishte përcjellë deri te hyrja e stacionit dhe pastaj qe larguar gati me ngut, sikur donte t'i tregonte që ajo mund të shkonte në çfarëdo drejtimi që t'i tekej. Ja, unë s'pashë gjë se cilin tren more, sikur thoshte pamja e fytyrës së tij. E bindur se ai kishte kuptuar pothuaj gjithçka, Alba kishte prerë një biletë për në Rapalo....

U kthye në shtëpi para mesditës dhe filloj të përgatiste me ngut drekën, por Renato nuk erdhi si zakonisht për të ngrënë. Ia mbërriti vonë në mbrëmje. Me sa dukej nuk e kishte parashikuar kthimin e saj aq shpejt.

- Hë? - ia bëri me një ironi të hapur. - Si ia kalove në Torino?

- Mirë, - u përgjigj ajo shkurt.

- Gënjeshtare! - klithi ai befas. - Mashtruese! Nuk ke qënë

aspak në Torino, por te ai shqiptari yt!

- Nuk është e vërtetë, - tha Alba qetësisht.

Renato u xhindos edhe më keq.

- Po, është e vërtetë! Pa më trego, u kënaqe duke bërë dashuri me të?

- Unë s'di asgjë për të.

- Ai është këtu në Itali. Ka telefonuar në vilën e hallë Anës dhe të ka kërkuar ty. Mua nuk më bën dot lolo! Kuptove? Ke kaq kohë që të gënjen mendja se po ma hedh. Edhe në krevat shtiresh. Pandeh se më le gojëhapur me ato eksitimet dhe orgazmat e tua fallco! Bën dashuri me mua dhe mendjen e ke te ai shqiptari.

Ajo uli kokën.

- Fol! - vazhdoi Renato. - Tregomë si bëre dashuri me të. Më mburreshe se kishe neveri nga ngacmimet e Lazarinit dhe shkove me këtë tjetrin. Je një putanë dhe asgjë më shumë! Rracë e keqe! Mosmirënlohëse!

Ai vazhdoi të lëshonte njérën sharje pas tjetrës deri sa Alba nuk e duroi dot më. Hyri në dhomën e gjumit dhe provoi të mbyllej brenda, por Renato e goditi derën me grusht.

- Mu përgjigj! - thirri duke e tërhequr për krahu.

- Mos guxo të më prekësh! - foli Alba duke shrënguar dhëmbët. - Mos më prek! Shaj dhe bëj ç'të duash tjetër. Në se të pëlqen, unë jam gati edhe të iki. Kjo është shtëpia jote dhe ti mund të më dëbosh.

Renato shau edhe ca, pastaj doli nga shtëpia duke tërhequr derën me zhurmë. Alba priti deri afër mesnatës, por ai nuk u kthyte. Atëherë u mbyll në dhomën e ndenjies dhe fjeti e mbledhur kruspull në një divan. Ndjehej krejtësisht e dërrmuar.

Gjumi i doli nga një ëndërr e çuditshme, tepër e njohur, të cilën e kishte parë dikur, në fillim të martesës. Ishte një ëndërr me shpirtëra. Kësaj here shpirti i saj i vjetër u zgjua nga letargjia dhe u rebelua ndaj shpirtit të ri prej të cilit ishte mundur dikur. Ky i fundit ishte veshur përsëri si prostitutë,

por nuk i ngjante më Albës. Shpirti i vjetër hapi kafazin e kraharorit dhe e shtyu prostitutën jashtë. Ajo iku pa u ankuar. Përkundrazi, qeshi me tallje. Ti pandeh se unë nuk gjej dot një trup tjetër, tha. Ha, ha! Ka plot që më presin. Ne jemi shumë. Kjo është një botë prostitutash...

Si edhe herën e parë, Alba brofi ndenjur me duart mbi kraharor. U kujtua për ato që kishin ndodhur të djeshmen dhe mbërtheu kokën me duar. U ngrit dhe hodhi një sy nga dhoma e gjumit, por Renato nuk qe kthyer.

Ajo bëri një dush, pastaj piu një kafe me qumësht dhe u ul në tavolinë duke vënë përparrë disa fletë të bardha. Shkroi dy letra; njëren për shtëpinë dhe tjetrën për Gertën. Doli t'i postonte ato dhe në kthim bëri një shëtitje të gjatë, nga e shpunë këmbët. Drekën e hëngri vetëm. Renato përsëri nuk erdhi.

Ai u kthye në shtëpi vetëm të nesërmen në darkë. I kërkoi të bisedonin. Alba iu ul përballë, duke e vështruar qetësisht.

- Unë e kuptoja se kjo e jona është një martesë e dështuar,
- tha Renato. - E kisha kuptuar më parë, por shpresova se diçka do të ndryshonte me kalimin e kohës. Si mendon? Do të ndahemi përkohësisht apo...? Ti mund të kthehesë ca kohë pranë familjes. Mbështetje... më vonë, mund të bëjmë një tentativë të fundit.

Alba vështroi e menduar fytyrën e tij të lodhur. Është njeri i mirë, mendoi. Shumë i mirë. Nuk më ka asnjë faj. Bile më ka duruar shumë. Është gati të durojë akoma.

- Unë kam nevojë të largohem disa ditë, - tha. - Do të bisedojmë prapë.

- Si të duash, - pranoi ai.

Të nesërmen Alba u nis për në Torino. Ndenji te Sava një javë. Një paradite shkoi në punishten e makaronave dhe takoi pronaren. I tregoi gjithçka për veten.

- Aktualisht nuk kam ku shkoj, - tha. - Do të doja të punoja

te ju, bashkë me kushërirën time.

Tjetra e vështroi disa çaste e mallëngjyer.

- Kurajo! – foli pastaj duke e përkëdhelur në faqe. - Jeta shkon përpara. Unë do të të ndihmoj. Eja, fillo punë kur të duash. Sipër punishtes është një apartament i vogël, i zbrazur. Mund ta marrësh atë pa qera për disa muaj. Je dakort?

Alba mori rrugën e Milanos tepër e qetë shpirtërisht.

- Atëherë, vendose gjë? - pyeti Renato në mbrëmje, ndërsa ishin ulur të dy përballë njëri-tjetrit, në dhomën e ndenjies.

- Po, - u përgjigj ajo. - Do të iki. Nga ty nuk kërkoj asgjë. Përkundrazi, të lutem njëqind herë të më falësh. Të kam shkaktuar shumë telashe.

Ai mbeti i mekur një copë herë.

- Si... po ikën?! - foli i çuditur. - Nuk të marr vesh! Pse duhet të ikësh?! Çfarë të mungon, ma thuaj. Le të bëjmë një tentativë tjetër. Mbështetur...

- Jo, - kundërshtoi Alba. - Fatkeqësia ime është se nuk mundem të të dua. Nuk mundem të jetoj dot me ty. Megjithëse nuk më mungon asgjë.

- Pra, ke dashur gjithmonë atë tjetrin?

Ajo pohoi me kokën ulur.

- Po pse atëherë u martove me mua?

Alba e vështroi e skuqur nga turpi.

- Ti e di shumë mirë psenë. Unë vija nga varfëria dhe gabova. Pandeha se duke u lidhur me ty do të shpëtoja njëherë e mirë. Kjo ishte pjesa ime e fajit. Pjesa jote është se më pe që u trullova dhe tinëzisht bëre gjithçka të më tèrhiqje nga vetja, ndonëse dyshoje në dashurinë time.

- I imi mbështetur nuk është faj. Unë fillova të të doja. Besova se edhe ti do të më doje një ditë.

- Të kërkoj falje për këtë. Edhe unë u nisa me të njëjtin besim të gënjeshtërt. Të kërkoj falje edhe... për atë të dielën e Torinos. Është e vërtetë, isha te ai.

Renato u ngrit me pamjen e çudisë ende të mbërthyer në fytyrë.

- Nuk e kisha menduar kurrë se do të ndodhët kështu, - mërmëriti.- Nejse, ti tani ke vendosur gjithçka.

Të nesërmen paradigmë, ndërsa Alba po përgatiste çantat, ndonëse nuk e kishte caktuar ende ditën e largimit, telefonoi papritur Sartori.

- Mirëdita zonjë! - tha Alba me ndrojtje, duke parashikuar gjithçka.

- Pra, ti po braktis nipi tim? - foli Sartori me një ton të akullt.

- Ne po ndahemi si njerëz zonjë.

- Si?! Ti rrjepacakë të ndash nipi tim? Je një bukëshkalë! Një harbute! Kurrë nuk do të bëhesh një zonjë fisnike! Do të kthehesë në rracën tënde!

Alba ruajti qetësinë.

- Zonjë, në se ju e kuptoni fisnikërinë si pasuri, do të jetë më mirë kthimi në rracën time. Sa për të tjerat, unë ju jam mirënjohejse. Ju lutem më besoni për këtë!

- Veprimi yt është i pahijshëm! - thirri Sartori.

- Unë e konsideroj të hijshëm. Renaton nuk e doja dhe kjo qe zgjidhja më e drejtë. Zonjë, në ditarin tuaj, ju i ngrini himn dashurisë. Në se i besoni vërtet asaj, atëherë duhet të më kuptoni. Në se... në se ditari juaj nuk është i téri një hipokrizi.

- Si guxon? E paedukatë!

- Ju nuk keni asnjë të drejtë të më fyeni. Në se unë meritoj të fyhem, kjo më takon përfaktin se desha të hyja vjedhurazi në një botë që nuk më përkiste. E kam vuajtur boll këtë zonjë... ndaj... ju lutem...

Alba e uli receptorin duke e ndjerë se po ngashërehej. Duhet të iki sa më shpejt nga kjo shtëpi, mendoi. Sa më shpejt.

Nga mesdita e kërkoi Vilin në telefon në fakultet. Iu lut që të shtunën të merrte pushim dhe të takoheshin pasdite në stacionin e trenit në Savona.

- Patjetër, - tha ai. - Do të vij.
- Kaq, - ia bëri Alba. - Mos më kërko shpjegime të tjera. Mirupafshim!

\* \* \*

Ajo iku duke marrë me vete vetëm veshjet dhe sendet e blera me paratë e saj, pa një gram flori në trup. Bizhuteritë, duke filluar nga ato që i kishte falur dikur Sartori e deri te dhuratat e martesës, i mblodhi të gjitha në një vazo të bukur qelqi dhe i la mbi një komodinë.

- Nuk arrita të të kuptoj dot kurrë, - tha Renato, ndërsa i hapi derën për të dalë. - Megjithatë, të kam dashur.

Alba u zgjat dhe e puthi në faqe miqësisht.

- Të besoj, - u përgjigj.

- Alba, në se ti... ndonjë ditë... vendos të kthehesh...

Ajo tundi kokën vrullshëm.

- Jo! - foli ftoht. - Kurrë! Mos të të shkojë nëpër mend!

Ndërsa treni ikte nëpër hapësirën e përhimtë, pështetur pranë drifores, Alba nuk qe në gjendje të përjetonte kurrgjë tjetër përveç asaj ikjeje të shoqëruar me kërcitjen e shinave. La çantat në vendruajtjen e bagazheve të stacionit të Savonës dhe pastaj doli të priste Vilin. Ai mbërriti me çantën e librave hedhur shkujdesur në sup, duke kërkuar me sy e duke u përplasur me njerëzit.

Alba ngriti dorën. Vili u afroa me vrull dhe e përqafoi gjatë.

- Dyshova se nuk do të më kërkoje më, - tha si me frikë.

- Eja, - foli ajo. - Nisemi.

- Do të shkojmë atje?

- Po.

Ata dolën nga qyteti dhe morën nëpër pyllin e madh përballë detit.

- Pra, u ndave? - pyeti ai ndërsa po ecnin njëri pas tjetrit në një shteg të ngushtë.

Alba u ndal dhe pohoi me një lëvizje të lehtë të kokës.

- Po tani...?

- Do t'ia nis nga fillimi Vil. Do të punoj sa të mundem. Do të fitoj para me djersën time. Po arrita dot, nga tetori do të filloj fakultetin.

- Ku do të ndodhin të gjitha këto?

- Nuk e kam vendosur akoma.

Vili e mbërtheu për supesh dhe e tundi fort.

- Unë nuk do të lë të ikësh më! Të lutem, eja me mua!

Kam nevojë për ty. Kemi nevojë për njëri-tjetrin. Më premto!

Ajo uli sytë.

- Të shohim, - mërmëriti.- Do të bisedojmë.

Vili ia futi duart nën flokë dhe filloi ta puthte duke dihatur.

- Le të shkojmë te kasollja, - tha Alba.

Ata qëndruan para kasolles alpine, duke e vështruar me mall. Ajo nuk kishte ndryshuar. Si edhe dikur, qe mbyllur me një lloz të thjeshtë. Hapën derën dhe hynë. Vili ndezi zjarrin. Pastaj, ndërsa flakët filluan të ngrohnin, ata u vështruan dhe u hodhën në krahët e njëri-tjetrit. Bënë dashuri në dysheme si atë herën e parë në historinë e lidhjes së tyre.

- Zoti im, pse je kaq e mirë? - rënroi ai duke pështetur fytyrën në gjoksin e saj. -Pse duhet të të humbja kaq gjatë?

- Vil, ti nuk më meriton mua, - foli ajo papritur. - Tani... nuk shkon. Nuk është më si më parë.

- Jo! - thirri ai. - Është njëlloj. Unë e ndjej.

- Të duket ashtu sepse je i magjepsur nga unë. Je i dobët.

Mjaft që unë të zhvishem dhe ti bie në gjunjë si një rob i bindur. Kjo nuk më pëlqen. Ti duhet të çlironesh nga unë.

- Jo! - kundërshtoi ai. - Unë mbas mund të jem i magjepsur

nga gjithçka jotja. Por magjepsja vjen se të dua. Është hera e parë që dashuroj kështu. Nuk dua të të humbas më.

Ajo heshti.

- Më thuaj diçka, - iu lut ai.

- Kam nevojë të mendohem, - ia ktheu Alba. - E lëmë. Bisedojmë më vonë. Tani, le të pijmë diçka. Më trego përfakultetin.

Ata ndenjën ulur pranë zjarrit deri vonë pas mesnatës.

- Edhe një herë, - i pëshpëriti atij Alba në vesh. - Pastaj flemë.

Vili e tërhoqi nga vetja duke nuhatur ende i pangopur aromën e trupit të saj.

- Pse na solle pikërisht këtu? - pyeti pastaj si i trembur nga ai akt i zgjatur dashurie. - Seç kam një parandjenjë të keqe.

- Tani flemë, - tha Alba. - U bë vonë.

- Më premtó që nuk do të më ikësh!

- Do të bisedojmë nesër.

Ai u fut nën batanije, struku fytyrën në gjoksin e saj dhe fjeti. Alba e vështroi gjatë, duke e përkëdhelur herë pas here në flokë. U shkëput ngadalë, pasi ndjeu humbjen e tij të thellë në gjumë. Ulur pranë zjarrit, ndenji zgjuar, duke qarë mbytur, me lotë të mëdhenj që i vareshin faqeve dhe ajo nuk kishte më fuqi t'i fshinte.

Kur jashtë filloj të zbardhete, mori çantën, shkroi një pusullë, ia la Vilit pranë jastëkut dhe doli vjedhurazi. Aty u mbush njëherë me frymë dhe vrapi tatëpjetë si e çmendur, duke mos guxuar të kthente kokën prapa.

Ai u zgjua pasi ndjeu se pranë nuk kishte njeri. Dora i preku pusullën. E hapi dhe filloj të lexonte duke kuptuar gjithçka.

"Vil, i shtrenjtë përgjithmonë. Besoj se do të ecim në të njëjtën rrugë. Mbësime, dikur, diku, do të takohemi në ndonjë

stacion tē saj dhe tē dy do ta mbajmë kokën lart. Tungjatjeta, do tē më përshëndesësh ti. Ç'kemi mik i vjetër, do tē tē përgjigjem unë. Kështu do tē jetë më mirë. Ti do tē mbetesh pér mua njeriu ideal, i paarritshém, tē cilin e pata dhe nuk dita ta ruaja. Tē lutem mos më kérko! Alba".

Ai u vesh me ngut, doli para kasolles dhe thirri si i ndërkryer:

- Alba! Albaaaa!

Thirrja jehoi nëpër pyll. Vrapoi tatëpjetë shtegut tē ngushtë duke u rrëzuar e duke u penguar nëpër degë. Por atë nuk e gjeti në stacion. Një tren sapo u nis. Vili vrapoi pas tij deri në fund tē platformës.

- Por unë do tē tē gjej! - thirri. - Do tē tē gjej sikur tē shkosh edhe në fund tē botës!

## FUND

*janar-korrik 1996*

